


Prof. Dr. KOZMA GRILLO

ALPINIZMI YNË
(1936 - 1992)



Tiranë, 2009

Prof. Dr. Kozma Grillo
Alpinizmi ynë
(1936-1992)

Redaktor: **Saimir Bakalli**
Arti grafik & Kopertina: **Filloreta Ibrahim**

© Të gjitha të drejtat e autorit janë të rezervuara .

*Questo libro lo dedico ai miei nipoti, Fabio e
Mattia, che devono sapere che il loro nonno
albanese (NONNU KUMA) non e stato sempre
cosi vecchio.
Con immenso affetto,*

nonno Kozma



INTERVISTA ME GAZETARIN IMAGJINAR

- *Vërtet jeni 73 vjec?*

- Edhe disa muaj më shumë.

- **Lexova dorëshkrimin e librit tuaj. Më pëlqeu. Krijova bindjen se alpinizmi ka qënë pasioni juaj. Si lindi kjo ndjenjë e fuqishme tek ju?**

- Faleminderit që thatë se libri u pëlqeu. Por, të jem i sinqertë me ju, nuk ju besoj. Jo vetëm se është profesioni juaj të ruani etiketën e dashamirësisë, por se alpinizmi është një sport që njihet pak. Sado të pasqyrojë dhe të flasë masmedia për ngjitjet alpinistike – kacavarjet në shkëmb apo ngjitjet dimërore – përsëri alpinistët nuk do të njihen si ata që ushtrojnë sporte të tjerë, madje as sa shahistët. Vazhdon edhe sot e kësaj dite debati se “kush janë më budallenj”: ciklistët që nisen nga këtu e shkojnë në Korçë, apo alpinistët që ngarkohen si ngarkojnë mushkën dhe “bredhin maleve” në vapë dhe në mes të dimrit. Pasionet njerëzore janë aq të fuqishëm sa cdo diskutim për to, në fund të fundit, është humbje kohe se janë iracionalë, nuk i shpreh dot me fjalë dhe nuk arsyetohen.

- Ishte një rastësi që nisa alpinizmin. Si gjithë adoleshentët merresha me sport, me basketboll. Në kampionatet midis fakulteve të Universitetit kam lozur edhe kundër Renato Radojës. Të kuptohemi, thash kam lozur dhe jo që unë isha si ai. Ishte një talent i vërtetë dhe njeri shumë i mirë.

Rastësia ishte kjo: në një mbrëmje të ditëve të para të korrikut 1956-ës takova dajën tim - Minella Kapo, themeluesi i alpinizmit tonë. Pas pyetjeve e përgjigjeve rutinë, më tha:

Do të vish në Alpe? Do të zhvillohet zbori i parë alpinistik në vendin tonë.

Kjo ofertë dashamirëse më habiti pak. Male kisha parë nga larg por nuk kisha shkuar “t’i takoja”. I thash se nuk e di a do ta përballoja dot nga ana praktike, ndërsa për anën teorike nuk pyes. (Isha student shumë i mirë). Nuk kishte përse të mos pranoja. Në vendtë kërkoja

ndonjë punë ato ditë vere për të blerë në shtator një palë pantallona, më mirë t'i futesha një aventure. Pas pak ditësh u nisëm...

- Cilat ishin mbresat e para?

- Si dolëm nga Shkodra gjithcka ishte e re për mua. Cdo gjë që shihja nuk e kisha parë ndonjëherë, as qytezën e Koplikut, as fshatrat, as gjithë ato male. Mbresëlënëse ishin gropat në shpatet e maleve me dëborë të përjetshme. Më duket sikur përjetoj ndjenjat e asaj dite që makina jonë doli në Qafën e Thores, jo vetëm për atë pamje të papërsëritshme që të duket sikur Alpet i ke në pëllëmbë të dorës por edhe humnerën marramendëse bri rrugës së ngushtë automobilistike.



Shaljan

- Po fshati si t' u duk?

- Ndoshta është turp ta them por deri më 15 korrik 1956 (isha 20 vjec) nuk e kisha dëgjuar emrin e Thethit. As që më shkonte ndërmend që unë do të dashurohesha përjetësisht me të dhe malësorët e tij. Thethi është perlë e vërtetë. Gjatë dyzetëvjetëve kam vajtur me dhjetra herë në Theth dhe në Valbonë, por kjo e fundit nuk krahasohet me atë. Të them të drejtën ditët e para u zhgënjeva se mësuesit e fillores na kashin folur shumë për malësorët, na kishin krijuar përfytyrimin se ata janë shtatlartë, i kanë shpatullat e gjera etj. Ata ishin njerëz të zakonshëm, njerëz të mirë.

Çadrat i ngritëm buzëlumit, karshi ku sot është shkolla 9-vjecare. As 200 metra më larg, në një shtëpi fshati, ishte kampi i punëtorëve. Me bukën e kishim punën jo mirë. Por nuk e kaluam keq se na jepte bukë të kampit një njeri i nderuar i sportit - Zef Hila, që aty ishte përgjegjës i fiskulturës. Në kamp bënë cdo ditë mbrëmje. Kur na jepte leje Minella shkonim edhe ne. U njohëm shpejt. Kjo njohje bëri që Zef Hila të mos dilte me shumë bukë te gardhi se e "ndihmonin" kampistët, shumica ishin nga Tirana. Në errësirë nuk kërcëhet. Rrymë elektrike kuptohet që nuk kishte. Sa mbaronte së ngrëni darkën shoferi i kamionit të kampit që bënte furnizimin ndizte makinën dhe ndizte fanarët. Vërtet që tingujt e fizarmonikës dëgjoreshin me zhurmën e motorrit, por për këtë nuk fliste njeri. Mjafton të kërcënim.

Ditën e dytë na erdhi për vizitë komandati i postës së kufirit. Midis të tjerave, na tha që në rast se do të ngjiteni në male duhet të na lajmëroni. "Duhet të bëni kujdes të mos lëvizni natën. Them kështu se herë pas here në fshat vijnë diversantë. Me përjashtim të kufitarëve asnjë nuk duhet të lëvizë natën. Në rast se lëvizja është e domosdoshme duhet pa tjetër të ecni me fener ndezur". Ato ditë as pamë dhe as dëgjuam për diversantë.

- E di që vazhdoni të jeni pedagog i psikologjisë, që kini botuar disa libra, madje dhe "Fjalor Edukimi" (psikologji-sociologji-pedagogji). Kur vendosët të shkruani librin që kemi në dorë?

- Fatkeqësisht nuk kam mbajtur ditar gjatë jetës. Por në kuptimin figurativ më kanë mbetur pak faqe për të shkruar në të; me fjalë të tjera - sa do të jetojë akoma. Ishte vdekja e mikut tim Vasil Stambuli që më nxiti t'i futesha kësaj pune. Kaluan dy vjet nga ajo ditë. Sapo

kisha ardhur nga Italia ku u operova nga aorta. Erdhi Aci (Aleksandër Bojaxhi) që më mori me makinë dhe vajta në atë mort. Përjetova gjithcka rëndë në atë pasdite të nxehtë korriku. Krahas emocioneve që jeton njeriu kur ndahet nga një i afërt, u "habita" që para varrit të Shilit nuk kishte ardhur asnjë nga kryesia e Federatës së Alpinizmit. Me plotë gojën them: Turp të kenë! Fjalët e fundit që dëgjoj Shili ynë ishin të një njeriu të respektuar, por ai asnjëherë nuk është ngjitur në male, është marrë dhe me sport, madje ka qenë edhe kryetar i Federatës së Futbollit. Qoftë në Tufinë qoftë ditët që pasuan nuk më hiqej nga mendja zbori i Thethit, ku takova për herë parë Shilin.

Numri i pjesëmarrësve në zborin e parë alpinistik nuk jepet i njëjtë në shkrimet e shtypit periodik. Kam mendimin se kemi qënë 13 vetë. I kërkoj ndjesë atij (ose atyre) që nuk e/i kam listuar:

1. Minella Kapo
2. Luigj Shala
3. Vasil Stambuli
4. Petraq Kule
5. Manol Bozaxhiu
6. Myftar Marku
7. Grigor Perikliu
8. Vehbi Seiti
9. Bardhyl Saqillari
10. Dhimitër Banushi
11. Koco Qafzezi
12. Kozma Grillo
13. _____

Në rast se do të bëhej apeli i pjesëmarrësve në atë tubim rezulton se, fatkeqësisht, për secilin nga 10 të parët do të dëgjohej fjala: "Mungon!". Gjithnjë që kujtoj miqtë e mi që nuk jetojnë më kujtohen vargjet e mrekullueshëm të këngës popullore:

*"O shokë, ç'është kështu?
Vitet tutje e ju tëhu!"*

Me botimin e këtij libri më duket se unë u solla me miqtë e mi të paharruar i njerëzishëm. Jam i bindur se ata do të më presin atje ku ndodhen si 54 vjet më parë kur ktheheshim pas një ngjitje të vështirë, por pa shkëmbyer asnjë fjalë, në heshtje të plotë.

- Ju na keni dhënë historikun e alpinizmit shqiptar nga viti 1936 deri më 1992?

- Pyetja është me vend. Përgjigjja ime kërkon disa rreshta. Duke punuar gjithë jetën në mjedise akademike unë i njoh kriteret për të shkruar një historik. Në këtë rrafsh mosmbajtja e ditarit nga ana ime e bën librin më të besueshëm.

- Pse thoni kështu?

- Ka mbi 30 vjet që kur u shpjegoj studentëve kujtesën në disiplinën e psikologjisë sociale theksoj se ajo është "lozanjare". Është në natyrën e njeriut të shuaj nga kujtesa gjithcka që në të kaluarën i ka shkaktuar ndjenja dhe mendime të pakëndshme. Themeluesi i psikanalizës, Frojdi i madh thoshte: "Nuk më kujtohet emri i asnjë pacienti që kam dështuar, që nuk e shërova". Në të njëjtën kohë, çdo njeri, në mënyrë të pavetëdijshme, zbukuron dhe bëhet figurë e dorës së parë në ngjarjen që ka përjetuar shumë vite më parë, do të rrisë vlerat dhe kontributin e tij. Të gjithë pa përjashtim vendit ku lindim dhe jetojmë, profesionit që ushtrojmë dhe statusit social, kemi lindur dhe gjithë jetën vazhdojmë të jemi egoistë, na pëlqen vetja.

Për t'iu shmangur këtij kurthi të kujtesës dhe për të qënë i besueshëm për alpinistët dhe lexuesin e mundshëm, librin e kam hartuar në këtë mënyrë:

Pjesa e parë dhe faqet e fundit është intervista me ju. Kuptohet që në të unë shpreh kujtimet e mendimet e mia. Në këto faqe jo gjithcka mund të jetë "e vërtetë e kulluar". Për t'iu afruar të vërtetës ndihmojnë fuqimisht tre kapitujt që vijojnë:

1. "Arkivi". Alpinizmi është një trashëgimi kulturore. Ashtu si dhe në trashëgiminë e pronave dhe objekteve me vlerë edhe alpinizmi ka arkivin e vet. Në rastin tonë arkivi përbëhet nga informacionet, reportazhet, shkrimet problematikë etj., që janë fiksuar në shtypin e kohës. Si thoshin filozofët e lashtësisë: "Fjalët i merr era, e shkruara mbetet". Të jeni të bindur se, në punën tejet të lodhshme në shfletimin e atij mali me gazeta për gjetjen e gjithckaje që dëshmon për alpinizmin, unë nuk kam ndryshuar absolutisht asgjë. Nuk kam hequr asnjë fjalë apo rresht që në ditët tona lexuesit pa kulturë i "vret veshin". Është interesante që në "arkiv" janë shumë e shumë shkrime që fiksojnë edhe brohoritjet në castin e pushtimit të majave, shprehje e ndjenjave të përjetuara, por në asnjë nga ato nuk shkruhet që alpinistët broho-

ritën për partinë apo Enver Hoxhën. Në 261 faqet e “këtij arkivi” vetëm në një shkrim autori shkruan se në një ditë dimri të akulltë, si u kthyen nga ngjitja gjysëm të ngrirë dhe u futën në cadrat e ngrira, një alpinist nxorri nga canta e shpinës librin e Enver Hoxhës “Titistët” dhe të gjithë e dëgjonin me vëmendje dhe u bëhej zemra mal për udhëheqësin e dashur. Më habit jo aq shumë gënjeshtra e këtij niveli e atij që e ka shkruar, por edhe budallallëku i redaksisë që e botoi. Kur je i lodhur, i ushqyer keq, kur bën gjithcka të ngrohesh sado pak në cadrën e ngrirë dhe dyshekun tërë lagështi nuk të shkon mendja për libër dhe Enver Hoxhë, madje edhe besimtarët fanatikë nuk hapin Biblën ta lexojnë. Gjithë vëmendja dhe forcat fokusohen në përpjekjet për të mposhtur mangësitë dhe vështirësitë për të mbijetuar.

2. *“Hipoteka”*. Hipoteka, pjesa që të takon në alpinizëm, është kartela. Të 21 ekipet e alpinizmit që funksiononin para vitit 1992 kishin në Federatën e Alpinizmit dhe Ciklizmit një dosje me fletët e përgatitura më parë për secilin alpinist. Kur mbaronte aktiviteti alpinistik kombëtar komandati dhe anëtarët e shtabit të ngjitjes dorëzonin në federatë gjithë dokumentacionin e sanksionuar në Statutin e Federatës dhe në rregullore të posacme. Krahas përshkrimit të përgjithshëm të mbarëvajtjes së aktivitetit, për cdo treshe (tre alpinistët e lidhur në të njëjtin litar kolektiv) bëhej përshkrimi me fjalë dhe dorëzohej skica e itinerarit të përshktuar duke saktësuar edhe shkallën e vështirësisë ngjitjes. Me kalimin e viteve, kur ndërmerreshin itinerarë që ishin realizuar edhe më parë, nuk kërkohej që drejtuesit e aktivitetit të interpretonin shkallën e vështirësisë, se ato ishin përcaktuar. Kështu, për shembull, në rast se treshja kishte arritur në stinën e dimrit nëpërmjet itinerarit nga Gropat e Bukura në Majën e Rinisë (Jezercës) ngjitja ishte e shkallës së pestë të vështirësisë, pavarësisht nga dukuritë atmosferike të asaj dite.

Kërkoj ndjesë që po zgjatem pak. Në këtë rast, si gazetar që jeni, nuk keni të bëni me një deformim profesional timin si pedagog (që flasim shumë), por me dëshirën për ta bërë çështjen të kuptueshme për lexuesin. I gjithë materiali i ardhur në federatë i jepej komisionit teknik (për funksionet e të cilit do flasim më poshtë) që shqyrtonte dhe “legjimitonte” ngjitjet për cdo alpinist, realizuar në dimër apo në verë, të cilat i hidhte në kartelën e secilit, në kolonat nga shkalla e dytë e vështirësisë (më e lehta) deri tek më e vështira që ishte e gjashta.

Si përfundim, cdo alpinist i asaj kohe apo kureshtar gjen në këtë “dokument hipotekar” gjithcka që ka realizuar, gjithcka që i përket.

- Njoh një alpinist. Më ka folur shumë për ngjitjet që ka bërë. Ku mund ta gjejë këtë dokument të tij? Më duket se po qeshni?

- Jo. Vetëm po buzëqesh. As ju dhe asnjë alpinist nuk mund ta gjejë këtë dokument që duhet të ishte në federatë.

- Më duket se nuk është e vështirë të gjesh federatën në mes të Tiranës?

- Keni të drejtë. Federatën mund ta gjesh, por ato nuk i gjen atje. I kam unë, në shtëpi. Më 1990 më zgjodhën Kryetar të Federatës së Alpinizmit, në një mbledhje të organizuar nga Komiteti i Kulturës Fizike dhe Sporteve ku kishte të deleguar nga cdo rreth apo klub sportiv. Më kujtohet që më propozoi alpinist i Beratit Stefan Kule, djali i mjeshtrit të merituar të sportit Petraq Kule.

Më 1992, sekretar i Federatës ishte Agim Tabaku ai i solli kartelat në Institutin e Studimeve Pedagogjike, ku unë isha drejtor, për t’u ruajtur më mirë. I futa në arkivin e institutit. Në vitin 2000, si kishin kaluar disa muaj që më nxorrën në pension, më telefonoi arshivistia e institutit dhe më tha se cfarë duhej të bëja me “kutinë” time. Vajta dhe i mora. Më vinte keq t’i thoshja - digji!. Kanë kaluar më shumë se 15 vjet dhe asnjë nuk është interesuar për ato. Tani më duket se po qeshni ju? Keni të drejtë, është një histori “shqiptarce”.

Për ta mbyllur këtë histori, që ato të mos dëmtoheshin, të mosbëhdhin të palexueshme, i kam hapur disa herë për ditë të tëra. Cuditërisht mungon vetëm dosja me kartelat e alpinistëve të ekipit “Studenti”. Së fundi në këtë libër janë dhënë vetëm 20 kartela, një alpinist për cdo ekip.

Do të më pëlqente të mos i digjja, por edhe shumë kohë nuk mund t’i mbajë.

3. “Trashëgimtarët”. Janë të gjithë ata që kanë kartelën në “hipotekën” tonë. Me gjithë që cdo ekip duhej të përbëhej nga 12 alpinistë, numri i tyre është më i madh se 250, se jo të njëjtët e ushtruan këtë sport gjatë gjithë asaj periudhe (1956-1992).

- Cilët nga alpinistët ju kanë lënë më shumë mbresë?

- Kam bindjen se nuk mund të jesh alpinist i mirë, alpinist i ngjitjeve shumë të vështira, në rast se, në radhë të parë, nuk je njeri i mirë. Kjo nuk është një thirrje moralizuese, por një e vërtetë, një kërkesë e këtij sporti. Edhe në lokalim më të mirë të Tiranës nuk e ndjen kënaqësinë e kafesë së mëngjesit në rast se vjen e të ulet një njeri që e njuh, por nuk e honeps, të rëndon prania e tij afër, mezi përcjell fjalët. Po në rast se në grupin e vogël ku bën pjesë edhe ti ndodhesh në Alpe në mes të dimrit (qoftë edhe të verës) dhe ke dhe një tip të tillë – mendje-madh, gënjeshtar, meskin, dembel në përgatitjen e jetesës, egoist tej mase, thashethemexhi etj. si do ta ndjenit veten? Sigurisht që keq. Kjo ndjenjë negative do të rritej në përmasa ende më të mëdha në rast se do të punonit në të njëjtin litar.

Për të mos tjerrur fjalë më kot dëgjo çfarë thotë Tensing Norgej, një ndër dy të parët që hipën në majën më të lartë të rruzullit tokësor (Everest, Xhomolungma, 8.848 m) më 29 maj 1953: *“Gjatë jetës krijova bindjen se në asnjë mënyrë njeriu nuk mund të bëhet i zoti, sado aftësi që të ketë, në rast se atij i mungon ndjenja e mrekullueshme e dashurisë për shokun, gatishmëria për t’i ardhur atij në ndihmë. Shoqëria është po aq e rëndësishme sa edhe vetë heroizmi...Egoizmi e bën njeriun të jetë përherë i vogël. Ja dhe një mësim tjetër që kam nxjerrë nga malet – njeriu nuk duhet të pres dhe të kërkojë nga të tjerët më shumë se ç’u jep atyre. Njeriu duhet të ketë zemrën të madhe. Ndiemoji të tjerët të bëhen të tillë”.*

Janë shumë alpinistë që i kujtoj me nostalgji. Në pamudësi të përmend të gjithë, veçoj:

Minella Kapo. Njeriu që kur i vinte një qëllim vetes e realizonte pa tjetër. U kthye nga studimet në Bashkimin Sovjetik me qëllimin e mirë të vinte në baza shkencore alpinizmin në vendin tonë. Për këtë mjafton të kujtojmë se solli me vete tre palë pajisje alpinistike dhe një cadër (Pamir-in e famshëm). Kishte aftësinë e vecantë të ruante energjitë për në castet më të vështira të ngjitjes. Kurajoz dhe plot besim te njerëzit dhe njohuritë e veta. Edhe sot habitem si mbas 4-5 ditësh na vuri të kalonim një traversë aq të vështirë në një ditë me mjergull. Bëri maksimumin e asaj që mund të bëhej në vendin tonë për zhvillimin dhe progresin e alpinizmit.

Vasil Stambuli – Shili. Alpinisti dhe trajneri më cilësor deri në mesin e viteve shtatdhjetë. Njeri me vullnet të celiktë, më i varfëri nga të gjithë ne. Dy muajt e verës i shtynte duke ngrënë vetëm rrush, nga hardhia e shtëpisë ku banonte. Priste të fillonte viti akademik të hante në mencën e studentëve. Inxhinier novator me duar të arta. Trajneri dhe sportisti që u shpinte të gjithëve kur ishin të shtrirë nga lodhja cajn dhe ushqimin që kishte përgatitur vet. Njeriu që ngarkohej sa për dy alpinistë. Gjithnjë i gatshëm t'i ndihmonte të tjerët, vecanërisht në shkëmb apo në akull. Njeri i dashur, me zemër të madhe, por që jeta nuk e përkëdheli.

Luigj Shala. Kopshtari i pasionuar i fidanishtes së përgatitjes së alpinistëve të rinj. Njeriu që bëri mrekullira në Pallatin e Pionierëve të kryeqytetit. I përkushtuar edukimit dhe dashurisë për adoleshentët që dashuronin malin. Njeri me sedër të madhe. Nuk do të harroj ditët që ishim bashkë në Kaukaz. Si u ngjitëm në Mallij Dombaj (reportazhin e keni në faqet e vititit 1959. Shënimi ynë K.G.) ai pa larg një grup alpinistësh që po zbrisnin. Ishte i bindur që ata ishin të kampit tonë dhe ne duhet të shkonim para tyre. Na erdhi keq që nuk na la të shijonim disa minuta më shumë atë pejsazh mahnitës, por e dëgjuam nga respekti që kishim për atë. Por, më vjen keq që nuk arritëm t'i plotësonim amanetin e tij – kur të vdiste ta varrosnim në Malin e Dajtit...

Petraç Kule. Dha kontribut të cmueshëm jo vetëm në rritjen e cilësisë së alpinizmit, por edhe në propagandimin dhe shtrirjen e turizmit malor në rrethin e Beratit, kryesisht në radhët e punëtorëve të Kombinatit të Tekstileve "Mao Ce Dun". Në marrëdhëniet me njerëzit ishte gjithnjë korrekt dhe dashamirës. I respektonte të tjerët dhe dëgjonte me vëmendje mendimet e të tjerëve.

Aleksandër Bojaxhi. Është vështirë të shkruash në pak rreshta për Acin. Kredoja e tij ka qënë të shkel atje (zonë, shteg, kanion, mal) ku nuk ka shkelur më parë këmba e alpinistit. Ai na mësoi se edhe lalët e Myzeqesë mund të bëhen alpinistë. Si mbaroi studimet u emërua në shkollën e Patosit. Falë dashurisë për malin ai ngriti ekipin e alpinizmit "Apollonia" që, për pak kohë, në veprimtaritë kombëtare spikati si një ekip cilësor në të gjithë treguesit. Nga mesi i viteve 70 e këtej pa dyshimin më të vogël deklaroi që ishte trajneri më i mirë. Dha

ndihmesë të madhe në mbarëvajtjen e komisionit teknik. Ishte i vetmi që rrimonte bibliotekave për të vjelur informacion për alpinizmin, që mbajti gjithë ato referate e kumtesa në seminarët që bëheshin me trajnerët. Botoi disa shkrime dhe një libër, vec atij që punuam bashkë: “Alpinizëm”. Është një libër instruktiv me vlerë edhe në ditët tona. Me gjithë peripecitë e vështirësitë e jetës si emigrant, ai nuk u nda nga alpinizmi. Mjafton të përmend librat që ka botuar këto 4-5 vitet e fundit për alpinizmin dhe ngjitjen në Mon Blan vitin e kaluar. Aleksandër Bojaxhi është intelektual me kuptimin e plotë të fjalës, njeri korrekt dhe dashamirës.

Kristaq Korcari. Njeriu ynë i dashur, i vetmi që mbante mustaqe. I shkonin. I pasionuar si ai për alpinizmin. Një herë erdhi dhe m’u lut se doktori i Klubit Sportiv “17 Nëntori” (Manush Thanasi, kunati im) nuk e lejonte të vinte atë dimër në Alpe. Gati sa nuk lotonte. Më darke vajta për vizitë tek Manushi. Më tha se i ka shumë keq varicet, shihja. Më në fund arrita të më thoshte: “Kur po ngul kaq shumë, dakord. Le të vijë”. Pas pak ditësh kaluam Shpellën e Pejës dhe dolëm tek Livadhi i Pleqve. Binte dëborë, por qetë-qetë. Për ta vajtur tek Posta Verore e Kufitarëve kishim kohë. U ulëm. Hapëm cantat dhe nxorrëm takëmet. Bëmë një kafe (hera e parë dhe e fundit që më ka ndodhur kështu) që aq shumë na shijoi. Ka vite që nuk e kam parë Kickën, njeriun aq të mirë që na gjallëronte, që me pasion këndonte këngën “jepi shoqe luje...”

Ali Ago. Ai erdhi tek ne si meteor, nuk e vazhdoi gjatë sportin tonë. Kishte gjithë të dhënat të bëhej alpinist i shkëlqyer. Serioz në punë, i ciltër me shokët. Kishte një zgjuarësi që të linte mbresë. Fliste fare pak, por dëgjonte me vëmendje. Gjithnjë buzagas. Jo rrallë dëgjoje që thoshte “Po mban era peshkë!?”. Ata që nuk e njihnin fillonin e nuhatnin. Ne e kuptonim që deshte të thoshte se biseda ishte coroditur dhe po thueshin idiotësira. U bë kohë e gjatë që nuk e kam takuar me gjithë që jetojmë në të njëjtin qytet.

Pëllumb Llobanishti. Më dhemb zemra kur e kujtoj atë djalë të qeshur që fjalët e para kur takoheshim ishin: “Dobro, shef-o?”. Vdiq në malet e pellgut të Valbonës. Gabuan organet e hetuesisë dhe ata që ishin me të atë verë që nuk na thanë si ndodhi ai kob. Si kishte emrin ashtu kishte edhe shpirtin. Ato vite familjes së tij i kishte ardhur një

televizor i vogël nga të afërmit që jetonin në Maqedoni. Të shtunave që shkonim në Dajti krahas cantës Pellumbi ngarkonte edhe televizorin se e porositnin shokët. Ai për shokët bënte cfarë t'i thonin. Dhe kur njërit prej tyre gjatë kthimit i ra dhe u prish, Pëllumbi përsëri tha: "Dobro, shef-o?!?".

Në pamundësi të shkruaj për gjithë miqtë e mi, po mjaftohem duke i përmendur: *Niko Stamo, Maridon Hito, Andon Tapia, Shefki Juma, Myftar Marku, Veligjar Velaj, Nuredin Seci, Gëzim Oruci e disa të tjerë për të cilët kam shkruar në shtypin e asaj kohe, reportazhe që janë përmbledhur në këtë libër.*

Është e natyrshme që një vend të posacëm zënë "alpinistët e mi" të Klubit Sportiv Dajti, për të cilët do të flasë në fund.

- Po nga alpinistët e huaj cilët do veçoni?

- Nuk më kujtohet sa herë kam lexuar Ditarin e Skotit në Polin e Jugut. Sfidon edhe romanet e korifejve të letërsisë botërore. Në mënyrë të shkëlqyer tregohet forca e shpirtit të njeriut, dashuria për shokun. Mbaron së lexuari dhe të është krijuar bindja se këto tipare të personalitetit njerëzor janë më të bukura dhe më të larta se arritja e suksesit. Skoti me shokët e tij nuk mbërriti i pari në Polin e Jugut, ai nuk e arriti suksesin sportivo-shkencor, por ata me veprën e tyre u bënë të lavdishëm. Jam i dashuruar edhe pas Dulferit. Ai kishte dy pasione në jetë - ekzekutimin në piano dhe malet. Emrin e tij e kanë përmendur mijëra dhe mijëra herë alpinistët e gjithë botës, bashkë me ata edhe ne. Ai u dha një dhuratë tejet të dobishme alpinistëve: "Zbritjen Dulfer" - zbritjen e shpejtë me litar nga lartësia edhe kur paretit është negativ. Largohej nga shtëpia dhe hipte në majat më të larta të Europës. Herën e fundit nuk u kthye...

Nuk ka si të mos dashurohesh me Herman Buhl-in, i cili mbërriti i vetëm në majën e "Malit vrasës" - Nanga Parbat, që e kanë quajtur "Mali i epopeve dhe i tragjedive të mëdha", një ndër 14 majat e Himalajave me lartësi mbi 8.000 metra. Buhl, ai djali i ri nga Austria, bëri realitet ëndrrat e 31 vetëve (14 alpinistë europianë dhe 17 sherpë) që vdiqën në përpjekjet titanike për të mbërritur në majë.

I pari mbetet gjithnjë i pari. Majën e Everestit, Xhomolungma, 8.848 m nga ngjitja e parë e deri më sot e kanë ngjitur dhjetra e dhjetra alpinistë nga e gjithë bota (përfshi këtu edhe shtetet e Ballkanit me përjashtim të Shqipërisë), por gjithnjë të kujtohen emrat Tencing

Norgej dhe Edmund Hillar. Po kështu Mesner, i pari që mposhti i vetëm 14 majat mbi 8.000 m në Himalaja. Këta emra kanë hyrë në historinë e këtij sporti dhe do të mbahen mend për shumë kohë. Kështu që nuk ka asnjë habi që ne nuk e mbajmë mend emrin e një sherpi, që deri para pak vjetësh, ishte ngjitur 15 herë në Xhomolungma (!?).

E tillë është edhe alpinistja Italiane, 47 vjecarja, Nives Meroi që deri më sot është ngjitur në 11 majat më të larta të Himalajave, pa përdorur asnjëherë bombolën e oksigjenit, e cila udhëhiqet nga kredoja se ka shumë mënyra për t'u ngjitur në majën e malit, por një rregull duhet respektuar gjithnjë, nuk duhet ndryshuar - respekti për jetën tënde dhe të të tjerëve.


Edhe të dua nuk e harroj dot alpinistin francez Llamber. Disa herë u nis drejt Everestit. Herën e fundit (bashkë me Norgej) i duheshin vetëm 100 m për të mbërritur në majë. Alpinist shumë i mirë dhe njeri i mrekulueshëm. Në shënjë kujtimi i dha Norgejt shallin e vet. Ky e vuri në qafë ditën që mbërriti në "catinë e botës". Kur vajti si triumfator në Zvicër takoi mikun e tij, Llamberin, dhe i ktheu shallin, për t'i thënë që një pjesë e qënies së tij kishte mbërritur në majë.

- Cilat kanë qënë ngjitjet tuaja më të bukura. Po për kontributin tuaj në lëvizjen alpinistike çfarë mund të na thoni?

- E para mbetet gjithnjë e para. Ju kujtohet shprehja "dashuria e parë nuk harroet". Vecoj zbritjen nga Guri i Capit, ngjitjen për here të parë në stinën e dimrit, nga ana e liqejeve, në Majën e Rinisë (Jezercë), një itinerar në Arap me Shilin dhe Acin etj.

- Ndhimesa ime?

U mësova shokëve fjalën *sherp - hamall, guidë*, nëpërmjet librit të Norgejt "Tigri i dëborës" që e përktheva dhe u botua më 1964. Botova më 1982 librin "Si u "dorëzua" Everesti". Në të tregohet për ngjitjet më të bukura të bëra në Alpet e Europës dhe në Himalaja. U pëlqye nga gjithë lëxuesit. Të 10.000 kopjet u shitën në pak ditë. Mos harroni se ky "sukses" u arrit edhe për faktin se atëherë botoheshin shumë pak libra të kësaj natyre, mungonte informacioni. E di që nuk do të më besoni kur t'u them se unë nuk kam asnjë kopje të tij në bibliotekën time. Në rast se nisemi nga "statistika", nga shkrimet e botuara, dokumentarët dhe emisionet televizive të asaj kohe, kam bërë më shumë se kolegët. Do të më pëlqente të kisha bërë akoma më shumë.



Ju nuk mund të më kundërshtoni se edhe me këtë libër unë ndihmoj, qoftë edhe pak, lëvizjen alpinistike.

Jeta e pruri që të isha jo vetëm aktor (alpinist) por disi edhe autor i kësaj lëvizje. Duke përgatitur këtë libër rikujtova se kam qënë anëtar dhe për shumë vite kryetar i komisionit teknik, anëtar i kryesisë së federatës, kryetar i federatës dhe trajner vitet e fundit. Ngrita dhe drejtova ekipin e Klubit Sportiv "Dajti" që u themelua i fundit, më 1981. Duke përfituar nga rasti, falenderoj me gjithë zemër kryetarin e

atij klubi – Fatos Korbi, i cili na ndihmoi aq shumë sa kur niseshim për ngjitje na dukej se edhe ai do të ishte me ne.

U them singerisht se unë nuk kam bërë heroin, vetëm jam përpjekur të ndërgjegjësoj se c'është alpinizmi, të tregoj për ngjitjet e alpinistëve tanë, ku edhe unë isha një nga ata, të evidentoja probleme që pengonin si masivitetin e mëtejshëm ashtu dhe rritjen e cilësisë sportive.

- Kur e keni ndjerë veten më ngushtë në mal?

- Më 23 Nëntor të vitit 1963. Në kuadrin e 20-vjetorit të themelimit të BRASH-it (Organizatës së Rinisë) KQ i Rinisë organizoi me këtë rast edhe një ngjitje në majën e Jezercës. Ishim gjithë-gjithë katër. Unë, alpinisti Stefan Grillo, Vildan Tufi dhe Gani Lahi nga "Vlaznia" e Shkodrës. Deri në Gropat e Bukura shkuam me kanotjerë. Herët në mëngjes na kapi "murlani i parë" i atij viti. Malësorët i trëmben më shumë atij se dimrit. Veshëm ato pak gjëra që kishim marrë me vete. Tani fjala ishte jo për të sulmuar majën, por për të shpëtuar veten. Cadrën e ngrirë e zvarritëm. Murlani dhe retë nuk më penguan të orientohesha deri në Qafën e Pejës. Atje u thash të treve të qëndronin. Me takt tërhoqa mënjanë vëllanë dhe i thash: "Ruaj veten!". Nisa të shihja se ku duhet të fillonim zbritjen. Ishte e kotë dhe nuk e di sa zgjati sorollatja ime. Për fatin tonë të mirë retë e dëndura u larguan për pak sekonda dhe unë pashë shtegun e shokët. Në kamp mbërritëm të raskapitur. Ato orë ndjeja në gjithë qenien time këshillën e babait: "Mirë që shkon për vete, por mos e merr Stefanin". Kishte të drejtë. Që nga ajo ditë ai vazhdoi alpinizmin në ekipin e "Partizanit", nuk vajtëm më bashkë në të njëjtën ngjitje.

Organizmi i njeriut është i cuditshëm. Ju mendoni se nata më e keqe që kam kaluar në mal ka qenë ajo e janarit të 1968-ës, kur u nisëm për në Majën Shnikut me rastin e 500-vjetorit të Skënderbeut. Të gjithë shokët patën ngrirje në duar dhe në këmbë, vetëm Niko Stamo dhe unë nuk pësua gjë. Unë nuk isha më i stërvituri dhe më i forti fizikisht se ata. Natën që kam ngordhur si qeni nga të ftohtit ka qenë po duke u gdhirë 23 Nëntori në Helmës, ku vajta jo si alpinist, por bashkë me qindra të rinj të rrethit të Korcës, për të kremtuar të nesërmen përvjetorin e Organizatës së Rinisë. Ishim pa cadra dhe zjarri i ndezur nuk ngrohte.

- E di që alpinistët janë njerëz të guximshëm. Në konfidencë mund të më thuash: A keni frikë?

- Alpinistët janë njerëz, nuk janë qenie jashtëtokësore. Gënjejnë ata që thonë "Unë nuk kam frikë!". Kjo ndjenjë njerëzore na shoqëron gjithë jetën. E rëndësishme është të shmangësh panikun, të mos humbësh vetëdijën; me fjalë të tjera, të marrësh masat për ta zbutur dhe mënjanuar atë. Alpinisti këtë e ka më të lehtë se në mal ai nuk është i vetëm, gjithnjë ndjen fuqinë e dy shokëve të lidhur në të njëjtin litar. Frika nuk tregon mungesë burrërie. Përkundrazi. Është alarmi që vë në lëvizje gjithë organizmin për të përballuar rrezikun e madh që i kanoset.

- Edhe në alpinizëm ka vdekje, a ka ngjashmëri ai me luftën?

- Alpinizmi nuk është luftë, megjithëse ne vazhdojmë të përdorim zhargonin ushtarak. Kështu, për shembull, ne themi dhe shkruajmë:

"Alpinistët sulmuan anën veriore të Arapit", "Me gjithë kohën e keqe ne e mposhtëm Korabin", etj. Alpinizmi është pasion dhe një zgjedhje e jetës, edhe kur në stinën e verës "nxjerr buletin e trishtuar të luftës" dhe cdo mëngjes masmedia azhurnon numrin e viktimave. Verën që sapo kaluam vdiqen brenda 50 ditëve 30 alpinistë (deri më 20 gusht). Nuk janë të pakët edhe sot komentatorët që theksojnë se është humbje njerëzish e kotë ose alpinizmi është i dënueshëm. Më 1961, gazetari dhe shkrimtari i famshëm Dino Buxati shkruante në "Corriere":

"Për sa u takon atyre që mbrojnë idenë e absurditetit të ngjitjeve alpinistike duke theksuar rrezikun e madh, kotësinë praktike të tyre, dëshirën për t'u dukur dhe kështu me radhë, kemi të bëjmë me një polemikë që gjithnjë ka ekzistuar dhe do të vazhdojë me siguri deri sa të ekzistojë njerëzimi. Kur Ikari bëri fluturimin e famshëm...., komentet ishin të njëjta me ato që sot e urrejnë për tragjeditë në Malin e Bardhë". Fatkeqësitë që ndodhin nuk do të thotë se njerëzit nuk do të nisen përsëri drejt maleve. Përkundrazi. Numri i alpinistëve, i atyre që ushtrojnë skitë në pjerresi të lartësive, i kacavjerësve në shkëmb gjithnjë vazhdon të rritet. Interesi për alpinizmin rinovohet nga një brez në tjetrin, shpesh herë duke kërkuar forma të reja, forma më komode dhe më të sigurta. Por gjithnjë dihet qysh më parë se në alpinizëm nuk ka asgjë të sigurt, e sigurt është vetëm aventura..

- Në "arkivin" e alpinizmit ju qëndroni në vitin 1989. Si e komentoni këtë fakt?

- Në Bibliotekën Kombëtare gazeta "Sporti Popullor" gjendet deri në fund të vitit 1989. Nuk ka asnjë numër të vitit 1990 e më vonë. Nuk besoj se ka qenë pakujdesi e këtij institucioni serioz. Mendoj se kushtet e rënda ekonomike ndaluan botimin e saj. Por ngjitje u bënë edhe më 1990 dhe dy vitet që pasuan. Kjo më kujtohet mirë, por numri i ekipeve që vinin në veprimtaritë kombëtare ishte shumë i vogël.

- Po më vonë cfarë ndodhi?

- Cdo intelektual jo vetëm e ndjente por edhe e kuptonte që ditët e regjimit komunist po mbaronin dhe një rend i ri po lindte mbi gërmadha. Edhe unë, si i shumica e intelektualëve u inkuadrova në protestat dhe veprimtaritë për lindjen sa më shpejt të demokracisë në kuptimin e përgjithshëm të fjalës. Nga auditorët ku jepja leksione, Fakulteti i Gjuhësisë dhe Historisë, deri në Sheshin Demokracia, në qytetin "Studenti" nuk janë më shumë se 200-300 m. Ishin të shpeshta rastet që zbrisja nga katedra kur studentët më thonin se do të grumbulloheshin atje. Shkonim bashkë...E njëjta gjë ndodhte pasditeve edhe me ekipin e alpinistëve.

Në verën e vitit 1981, sapo zbritëm nga Alpet, në Shkodër hipëm në autobuzin që të shpinte në stacionin e trenit. Krejt rastësisht nisa bisedën me një ushtarak. Fjala pruri fjalën. Më tregoi për ardhjen e Bejkerit në Tiranë. Për mitingun e madh që ishte bërë, që në të nuk ishte i pranishëm Presidenti i RPSSH, ku njerëzit ishin në gjendje deliri, ku kishte sa nuk thuhet flamuj të SHBA, por "ishte harruar" të kishte flamurë të Shqipërisë...Ishte një lajm i madh për ne që nuk e kishim dëgjuar.

Ishte fillimi i ndryshimeve rrënjësore në jetën politike, ekonomike e sociale, në çdo qelizë të jetës në vendin tonë. Ashtu si në çdo fillim edhe atëherë flitej shumë. Flitej edhe për "Çekun e bardhë". Me fjalë të tjera, mjaftonte që Shqipëria të futej në rrugën e demokracisë dhe SHBA do të na jepte një çek të bardhë (pa shkruar shumën), Shqipëria do të shënonte në të shifrën prej miljarda e miljarda dollarë. Me të do të shkonim në bankën e caktuar dhe do të merrnim paratë. Me fjalë të tjera, do të hante qëni petulla!

Por Bejkeri deklaroi në Kuvend se: "SHBA nuk të japin peshk, por të mësojnë si zihet peshku". Ishte koha që një popull i tërë kishte

nevojë për “peshq” se ishte me kuptimin e plotë të fjalës i uritur. Kur dëgjuan Sekretarin e Shtetit që Amerika do t’i jepte Shqipërisë vetëm 2 milionë dollarë, secili bëri llogarinë dhe i takonte vetëm gjysëm dollari. Kuptohet që pjesa më e madhe e atyre që kishin qënë në atë miting mbetën të zhgënjyer për disa vite...

- Kanë vajtur alpinistë tanë në male të vendeve të huaja, kanë ardhur alpinistë të huaj në Alpet tona?

- Në regjimin e kaluar, kur Shqipëria u vetizolua nga bota, këto takime thuajse nuk ekzistonin. Deri më 1962 pesë alpinistë tanë vajtën në Bashkimin Sovjetik (Kaukaz), tre në Gjermaninë Lindore dhe një në Cekosllovakia. Në vendin tonë erdhën alpinistë nga këto tre shtete. Ndihej për madhe për kacavarjet në shkëmb na dhanë alpinistët gjermanë. Kur vendi ynë u lidh aq shumë me Kinën bëmë c’ ishte e mundur që disa alpinistë të shkonin në Kinë (Tibet), por nuk u bë asgjë.

Më 1991 ishte tronditur në themel pushteti politiko-ekonomik dhe ai social në vendin tonë. Falë Vladimir Gjonajt, dhe ndihmës së Vasil Tocit si njohës i rumanishtes, Federata e Alpinizmit të Rumanisë ftoi një ekip prej tetë vetësh. Pas shumë peripecish nëpër konsullatat e shteteve ku do të kalonim, më 27 gusht të vitit 1991 u nisëm. Ishte hera e parë që alpinistët tanë u futën në një shtet imperialist, në Greqi. Përjetova tre befasisme. I pari ishte fare pranë kufirit tonë, e përpjeta e Pico Derrit, një vend i bleruar. Për herë të parë pamë teleferikun për të bërë ski në dimër. E dyta ishte bollëku i produkteve ushqimore. Ishte koha që ne ishim të uritur. I treti ishte trafiku në qytetin e Selanikut. Ne udhëtonim me mikrobuzin “Robur” te universitetit, që ishte tejet “i lodhur”. “Lodhjen” e tij e përballoi shoferi, por edhe ne vuajtëm sa nuk thuhet. Pas 4-5 servisesesh (në Bullgari i vunë sebatore të ri) na pruri në shtëpi.

Sekretarin e federatës Floricoiu e takuam në qytetin e Brashovës, në godinën e klubit sportiv “Astra”, ku na akomoduan. Ishte rreth 60 vjec. Mësuam që kishte qënë alpinist cilësor, kishte bërë ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë në Pamir. Fliste pak. Kërkoj të shihte pajisjet tona. Nuk i pëlqyen litarët tanë. Rumania kishte vite që prodhonte litarë për alpinizmin. Si e njohëm shkurtimisht me alpinizmin tonë na bëri vetëm dy pyetje: a) E përdorni sigurimin nga

lart dhe b)keni poligone, bëni ngjitje artificiale?. Fliste pak, njeri serioz dhe dashamirës me ne.

Qysh atë pasdite na drejtuan në një nga poligonët e tyre. Me ne ishte edhe kamarieria që na shërbente. Kjo vajzë e re, Simona, po përgatitej si pjesëtare e ekipit rumun për kampionatin botëror të ngjitjeve artificiale që do të zhvillohej në Inbursk. Në një faqe shkëmbore, e vetme ndërmori një itinerar të shkallës së lartë të vështirësisë. Nuk përdori lidhje në gjoks, por vetëm një “tetësh” që ne përdorim për sportiven. Kacavarej në mënyrë fantastike, “na turpëronte kur të donte”. Tanët punuan në një itinerar më të lehtë (gozhdët ishin të fiksuara në shkëmb). Të nesërmen na shpunë në një qytet të vogël ku ishte poligoni i ngjitjeve artificiale, në natyrë. Ishte hera e parë që shihnim një të tillë. E fotografuam disa here, bëmë gjithë ato skica, me synimin e mirë të ndërtohej ndonjë dhe në vendin tonë. Vullnetarisht u përpoqën të ngjiteshin alpinistët I. Tapia, Vakia, D.S., I. Sado. Kuptohet që....Ato ditë bëmë edhe trekinge ku na la mbresë të vecantë Pojana Brashova, një ngjitje në malet e Buceshit 2.300 m, etj. Na vunë në dispozicion revista alpinistike në gjuhë të huaja, na dhanë adresat e fedaratave botërore dhe europiane. Kur u kthyem, në cilësinë e kryetarit të federatës, u shkrova zyrtarisht këtyre forumeve për të na instruktuar se çfarë duhet të bënim të aderonim në to. Fatkeqësisht dhe cuditërisht asnjë nuk na u përgjigj.

Krahas Floriceut, përfitoj nga rasti të falenderojë dy miqtë që na u gjëndën gjithnjë pranë: Leusca Nikolae, Nae Olteanu. Më vjen keq dhe nuk e di përse nuk u respektua marrëveshja që më 1992 alpinistët rumunë të na kthenin vizitën.

Në kthim, në ato pak orë që kishim në dispozicion në Sofie, bashkë me Ladin (Vladimir Gjonaj) e gjetëm dhe vajtëm në Komitetin e Fizkulturës së Bullgarisë, në Federatën e Alpinizmit, me synimin të gjenim pikat e kontaktit për bashkëpunimin midis dy vendeve. Na pritën shumë ngrohtë, në mënyrë të vecantë nënpresidenti i federatës - Todor Grigorov. Biseduam më shumë se dy orë. Midis materialeve që na dhanë (si ishte organizuar ky sport, rregullore të alpinizmit, plan-stërvitje etj) ishte edhe kutia me diapozitivat e ngjitjes së alpinistëve bullgarë në Everest. Na ftuan (ekip alpinistësh) në zborin që zhvillohej në korrik me shpenzimet e tyre...Fatkeqësisht nuk u realizua asgjë nga këto.

- Në marsin e vitit 1992 Shqipëria u nda përfundimisht nga sundimi i partisë-shtet. Vendi ynë hyri juridikisht dhe defakto në regjimin demokratik dhe ekonominë e tregut. Si ndikuan këto në sportin tuaj të preferuar?

- Nisi një epokë e re...Ditë shkurti e vitit 1992. U gëzova sa nuk thuhet kur Zoti Vladimir Gjonaj, sekretar i Federatës së Alpinizmit, më tha: “Nesër do të vijnë dy alpinistë italianë të ftuar nga komiteti. Jemi caktuar unë e ti, që t’i shoqërojmë gjatë ditëve që do të qëndrojnë në Shqipëri. Nesër në ora 9 do t’i presim në Durrës”.

E nesërmja erdhi. Prisnim para monumentit të Mujo Ulqinakut. Turmë e madhe njerëzish. Gjithçka e rrethuar me tela gjembi. Shumë ushtarë që shtynin njerëzit siç dinin ata. Me letrën zyrtare që duhet të prisnim dy të ftuar, Ladi (e quaj kështu se njiheshim. Ai punonte në Klubin Sportiv “Studenti” dhe interesohej edhe për ekipin e alpinizmit. Në atë pellg unë stërvitja alpinistët e “Dajtit”) vuajti shumë sa na lejuan të kalonim postbllokun me aq shumë tela me gjëmba. Pritëm më shumë se dy orë. Përfytyroja si do të ishin ata që prisnim. Dinim vetëm që ishin nga Napoli. Shullohesha në diell. Mendoja se çfarë do t’u thosha atyre që vinin nga tejdetit. Pak a shumë fjalët do të ishin këto:

- Alpinizmi në vendin tonë nuk mund të ishte i shkëputur nga jeta politike, ekonomike e sociale e vendit. Fatkeqësisht, Shqipëria u vetizolua nga e gjithë Bota. Kështu për 30 vjet nuk erdhi asnjë alpinist i huaj. Ky izolim hermetik ndikoi për keq edhe në rritjen cilësore të alpinizmit tonë.

- Për dy dekada alpinizmi ynë u zhvillua në formën e alpinizmit klasik. Synimi i ngjitjes ishte marrja e majës, pavarësisht nga shkalla e vështirësisë.

- Në malet tona nuk ka kasolle për alpinistët. Ata e kalojnë natën në çadra ose në kullat e malësorëve.

- Në vendin tonë partia-shtet solli edhe këpucë Adidas, por nuk lejoi të futej asnjë botim apo revistë alpinistike.

- Federata e Alpinizmit Shqiptar nuk është anëtare ose vëzhguese në ndonjë federatë apo forum alpinistik ndërkombëtar apo europian.

Me përshtypjet e tyre zyrtare për Shqipërinë u njohëm nga shkrimi që botuan kur u kthyen në Itali:

“Sapo zbritëm në Durrës përjetuam emocione të llojit që kemi njohur pasluftës në Napoli – skenografia urbane, rrugët dhe arkitektura, fytyrat dhe veshja e njerëzve, që shpresojnë në të ardhmen – gjithçka shumë e ngjashme me atë të vitit 1944 në Napoli...Të huajtë habiten nga tre gjëra: a)natyra dhe peizazhi bujqësor krejt i pandotur; b) niveli i ulët ekonomik në qytet dhe në fshat; c) bunkerë çimentosh të panumërtë.

...Ashtu siç po verifikohet në Europë, trekinget dhe ekskursionet krijojnë shpejt një kapilar rritjeje të mikroekonomisë lokale (agrikultura, zooteknia, tregtia), duke ndihmuar në këtë mënyrë drejtpërdrejt dhe të menjëhershme rimëkëmbjen ekonomike të të gjithë vendit. Malet dhe plazhet e Shqipërisë, që fatkeqësisht sot nuk i ndesh në vendet e industrializuara, janë të pasur me burime natyrore dhe kulturore, të ruajtura shumë mirë, të imunizuara nga trafiku automobilistik, nga ndotja urbane si dhe nga teknologjitë ndotëse. Si të tilla, përbëjnë një kusht optimal për këtë lloj të veçantë turizmi.

Mendimet tona për zhvillimin e turizmit në Shqipëri, duke argumentuar dobitë ekonomike, sociale dhe kulturore, që të mos lejohen ndërtimet prej betoni shumëkatëshe në këto vende, ia dërguam zyrtarisht KFSSH dhe kryeministrisë...”.

Më në fund, u takuam. Ishin:

Xhuzepe Falvela, president i Komisionit Regional të Kampanjës për Tutelën Malore, 61 vjeç, arkitekt, alpinist prej shumë vitesh, anëtar i klubit alpin të Kampanjës, që asnjë moment nuk hiqte nga dora një shkop që i ngjante më shumë një shkopi skish se kazmës alpine. Shumë i komunikueshëm.

Manlio Monriko, avokat, 83 vjec, alpinist i njohur, shumë i dashuruar pas malit. Kishte pësuar vitet e fundit dy infarkte miokardi dhe vazhdonte si më parë vajtjet në mal. Të imponohej me njohuritë për problemet sociale. Nuk ishte aq komunikues sa Falvela.

Pas takimit zyrtar me kryetarin e Komitetit - Agim Zeka, të nesërmen u nisëm për në Razëm, te kampi i punëtorëve. Mbërritëm pasdite vonë. Na prisnin. Sa u futëm në dhoma, Falvela zbriti poshtë, mori kovën dhe nxorri ujë nga pusi. U zhvesh dhe bëri dush me tre kova ujë pusi. Ladi këtë deshte dhe më thoshte që ju alpinistët kini mangut jo një por disa dërrasa. Por edhe ai pas pak minutash ndoqi shembullin e Falvelës. Vajtëm për të ngrënë darkë. Për këtë darkë, kur vajtën në Itali, ata shkruan: “Na vunë përpara një mal me pilaf dhe një tjetër me mish dashi të pjekur”.

Një ditë e kaluam me shëtitje rreth Bogës, nga Okoli deri tek mulliri, ku përgatitëm edhe drekën në zjarrin që ndezëm. Natën e kaluam tek Rrok Lleshi. Atyre u la mbresë mikpritja. Por edhe njerëzve të shtëpisë u la mbresë fakti që Falvela gjithë natën e mbajti dritaren hapur....

U nisëm për në jug, Sarandë...

Bisedonim gjerë e gjatë për mundësinë e ardhjes së alpinistëve italianë tek ne.

Ishin njerës shumë të mirë dhe kontribuan konkretisht nëpërmjet disa shkrimeve në revistat e alpinizmit Italian, ku krahas përshtimeve, jepnin adresat, ftesën për të shkëlur në një vend sa afër gjeografikisht aq edhe të panjohur.

Darkën e fundit e kaluam në shtëpinë time bashkë me Ladin dhe Xhixhin (gruan e tij). Edhe pas kaq vitesh kur takohemi kujtojmë duke qeshur skena nga ajo natë.

Pa kaluar 7 muaj ata erdhën përsëri në Shqipëri, me shpenzimet e tyre. Kësaj radhe jo vetëm, por edhe me 22 alpinistë napoletanë.

Sipas planit që kishim hartuar përshkuam (me atë autobus të Klubit Sportiv "Dajti", ku kishte më shumë pluhur brenda se ai që linim pas në rrugët e asaj kohe) itinerarin: Durrës-Tiranë-Krujë (tranzit)-Shkodër- Bogë-Theth-Valbonë-BajramCurri-Lushnjë-Sarandë-Himarë-Durrës.

Ata na mësuan sa duhet të paguante cdo alpinist i huaj në vendin tonë. Kur mbaroi trekingu, nga kuotat që ata derdhën kishin tepruar 1 milionë lireta! Më 1992 për ne, nëpunësit, ishin shumë. Mendoja se për punën që bëme do t'i ndanim midis nesh. Por Ladi vajti dhe i dorëzoi ato zyrtarisht në zyrën e llogarisë të komitetit. Më erdhi keq por nuk e kundërshtova. Edhe sot e kësaj dite ja përmend kur më kujtohet.

Ai vazhdon të ngulë këmbë në të tijën.

(Këtë itinerar e drejtova edhe me alpinistë të Firences, Udines dhe të Bolonjës. Ndër ngjijtjet shkëmbore që realizuan po veçoj atë në Majën e Arapit, direkt nga Rrethi i Vishnjës dhe disa ngjijtje të bukura në brendësi të kanionit të Gjipesë, etj.).

- E kuptoj që me historikun e alpinizmit njihe si të mbarosh së lexuari krejt librin, por cfarë mund të na thoni në përgjithësi?

- Është vështirë të ketë të huaj dashamirës të vendit tonë që, kur

kujtojnë Shqipërinë, të mos i kujtohen edhe malet. Ky asociacion i ka rrënjët jo aq në rrafshin gjeografik (Shqipëria është një ndër vendet më malor të Ballkanit dhe të Europës) se sa në atë që malet kanë qenë barrikada të luftrave, përpjekjeve dhe rezistencës së popullit tonë për pavarësi e liri.

Shqipëria ishte vendi më i prapambetur i Europës edhe në sport. Kështu që nga vitet e shumtë të së kaluarës ne trashëguam një numër fare të vogël shëtitjesh turistike malore, të zhvilluara me iniciativën e disa mësuesve, nxënësve dhe intelektualëve përparimtarë, midis të cilëve kontribuan veteranë si Avni Zajmi dhe, në mënyrë të veçantë, mjeshtri i sportit Luigj Shala.

Alpinizmi lindi si sport në vendin tonë kur në Europë prej më shumë se 165 vjet më parë ishte mposhtur maja më e lartë e kontinentit dhe ishin hedhur sytë në malet e kontinentëve të tjerë. Hapat e parë të alpinizmit tonë u hodhën me ngjitjet modeste që u kryhen në prag të viteve 50. Në shkurtin e vitit 1956 u mposht në stinën e dimrit Korabi, maja më e lartë e Atdheut tonë. Pas kësaj “nxemjeje”, në korrik të vitit 1956 në Theth u zhvillua zbori i parë, ku 13 të rinj të ardhur nga rrethe të ndryshëm mësuan *abc*-ën e teknikës së alpinizmit nga instruktori Minella Kapo.

Me kalimin e viteve alpinizmi ynë hodhi shtat dhe u masivizua.. Në rast se për vite me radhë klubi sportiv “Studenti” ishte e vetmja bazë për zhvillimin e këtij sporti, me kalimin e viteve u krijuan dhe u konsoliduan një sërë ekipesh të tjerë. Përmendim midis tyre “Tomorrin”, “17 Nëntorin”, “Partizanin”, “Korabin”, “Skënderbeun”, “Flamurtarin” etj. Alpinizmi ynë hodhi themelet e cilësisë sportive, nisëm të bënim ngjitje në stinën e dimrit në parete shkëmborë.

Arritjet e këtij sporti dëshmojnë për kujdesin e shoqërisë së atyre viteve, dëshmojnë për dashurinë e madhe të të rinjve tanë për të ushtruar këtë sport, ku rival nuk kanë një individ apo një ekip të një klubi tjetër, por një kundërshtar shumë më të fuqishëm dhe shumë herë më të madh. Për të mposhtur vështirësitë, për të mbërritur në majë të malit, si duke u kacavjerrur në shkëmbinj apo duke shtegtuar mbi dëborë apo akull, duhen forca të mëdha fizike. Këto forca nevojiten jo vetëm për të mposhtur vështirësitë e “aktivitetit sportiv”, por edhe ato të terrenit, të motit, dhe për sigurimin e jetesës.

E nisëm këtë sport me pak njerëz dhe pa bazën e nevojshme materiale; ngjiteshim në mal me litar prej lini dhe u kishim zili

alpinistëve të huaj pajisjet. E nisëm këtë sport duke mësuar shtigjet që të shpien në majë të malit që “të miqësoheshim me ta”. Vitet rrodhën. Shoqëria socialiste na vuri në dispozicion bazën e nevojshme materiale. Për organizimin dhe drejtimin më të mirë u krijua Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit. U rrit shumë numri i alpinistëve. Disa nga fëmijët e atyre që morën pjesë në zborin e parë në Theth u bënë alpinistë të kualifikuar. Më mirë le të lëmë të tregojnë për alpinizmin tonë 4 nga ata që e kanë ushtruar vetë.

SI FUNKSIONONTE FEDERATA

E quaj të nevojshme që, para se të tregojë për veprimtarinë time si sekretar i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit (vitet 1970- 1974) t’i referohem tangjent historisë së deriatëhershme të këtij sporti.

Alpinizmi si sport në vendin tonë deri në fillimin e viteve 50 të shekullit të kaluar ka qënë fare pak i njohur, për të mos thënë aspak. Kjo nuk do të thotë që nuk janë zhvilluar ekskursione nga grupe nxënësish, mësuesish dhe intelektualë, të cilët drejtoheshin në pllajet dhe malet pranë qyteteve të tyre. Në këtë trashëgimi nuk duhen harruar edhe marshimet turistike në zonën e Alpeve.

E gjithë kjo ka ndikuar fuqimisht në njohjen e truallit, bukurisë dhe traditave patriotike e kulturore të të parëve tanë, në rritjen e dashurisë për Shqipërinë, në përgatitjen fizike të atyre të rinjve.

Në vitin 1956, Zoti Minella Kapo punonte në Sektorin e Arsimit të Komitetit të Fizkulturës e Sporteve. Me iniciativën e tij, në bashkëpunim me sektorin e sporteve masive, arriti të organizoi zborin e parë alpinistik veror në Theth. Në të morën pjesë 13 vetë. Pas mbarimit të zborit dyjavor këta ishin 13 alpinistët e parë, që përfaqësonin rrethet administrative të vendit tonë.

Qëllimi i këtij zbori nuk reduktohej vetëm në përgatitjen e pjesëmarrësve si sportistë, por edhe në dhënien e elementëve fillestarë si tranjerë të ekipeve të alpinizmit, si aktivistë shoqërorë.

Në vitin 1957 u hap Universiteti i parë (në Tiranë) në vendin tonë. Shef i katedrës të edukimit fizik u emërua Minalla Kapo. Gjatë viteve të studimit në BRSS ai kishte fituar distinktivin “Alpinist i BRSS” dhe instruktor i alpinizmit. Duke përfituar nga statusi i shefit të katedrës, iniciativës dhe aftësive të tij organizative, atij iu krijuan mundësi të vazhdonte punën e nisur në zborin e Thethit. Ishte i vetëdijshëm për domosdoshmërinë e një zbori, ku të jepeshin njohuritë për ngjitjet alpinistike në stinën e dimrit.

Ky zbor nisi më 28 janar 1958 në kampin e punëtorëve në malin e Dajtit (sot King Park). U rrealizua falë dashamirësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet rektoratit, Bashkimeve Profesionale dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Në atë tubim morën pjesë 80 studentë e pedagogë. Komandat i zborit ishte Minella. Komandatë toge (që kryenin rolin e trajnerit) ishin studentët Vasil Stambuli, Kozma Grillo, pedagogu Andon Tapia dhe punëtori nga Berati Petraq Kule. Theksoj se këto veprimtari ndikuan së tepërmi në tërheqjen dhe përgatitjen e alpinistëve femra.

Ngjitja e parë e klubit sportiv të universitetit u bë në malin e Tomorrit në marsin e 1958-ës.

Pas vitit 1958, u krijua tradita që në pushimet dimërore të studentëve të zhvilloheshin zборе të kësaj natyre. Kam bindjen se këto veprimtari ndikuan fuqimisht në socializimin e studentëve, në përvetësimin e *abc*-ës së alpinizmit, në përhapjen e këtij sporti në qytetet ku ata do të punonin si kuadro të lartë.

Nisën të krijohen ekipet e alpinistëve në rrethe. Kështu ndodhi në Korçë me trajner Koço Qafëzezi, Gjorkastër (Eqerem Reso), Vlorë (Vangjel Ristani), Lushnjë (Llazar Pupi), Fier (Aleksandër Bojaxhi), Durrës (Ilija Berberi), Klubi Sportiv "Studenti" (Andon Tapia), Shkodër (Vehbi Seiti), Peshkopi (Taxhedin Shehu) etj.

Pavarësisht se vëmendja u përqëndrua në masivizimin e këtij sporti, u shënuan edhe rezultatet e para në rritjen e cilësisë së ngjitjes. Në këtë drejtim një ndihmesë të madhe dha Olimpiada e Parë Shqiptare e Alpinizmit (kështu e quajtëm), e cila u zhvillua në korrik të vitit 1959 në Alpe. Në të u aktivizuan 15 sportistë nga Gjermania Lindore, 3 nga Çekosllovakia dhe 10 shqiptarë.

Takimi i parë me alpinistë të huaj na bëri të vetëdijshëm se edhe brenda tre vjetëve të parë ne kishim hedhur hapat e parë edhe në kacavarjet shkëmbore. Ishte fat për ne që secili, çdo ditë, punoi në të njëjtin litar me alpinistë të huaj. Përfitua shumë nga ana teknike.

Ne e mirëpritëm dhe e miratuam plotësisht vlerësimin që ata na bënë:

- Keni faqe shkëmbore dhe male të mrekullueshëm;
- fizikisht jeni të përgatitur shumë mirë, por
- duhet të punoni shumë për rritjen e nivelit teknik.

Në të njëjtin vit 5 alpinistë tanë (Luigj Shala, Petraq Kule, Kozma Grillo, Koço Qafëzezi dhe Thanas Vasili) shkuan dhe realizuan ngjitje në Kaukazin Perëndimor (BRSS).

Më 1960 u “kthyen vizitat”. 3 alpinistë (Minella Kapo, Tefta Zguro dhe Vasil Vreto) realizuan ngjitje në Gjermaninë Lindore.

Në Çekoslovakia vajti alpinisti Andon Tapia.

Në Alpe erdhën dhe punuan 4 alpinistë sovjetikë.

Fatkeqësisht veprimtari të tilla nuk u përsëritën më.

Masivizimi, shtrirja e kësaj lëvizje diktonte nevojën e organizimit dhe drejtimit në një nivel më të lartë. Si rrjedhojë, u krijua Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit. Kryesia përbëhej nga 7 anëtarë, kryetar i shoqatës (onorifik) u zgjodh Kiço Ngjela (ish ministër i Tregtisë), sekretar (funksionar) Muharem Sinoimeri dhe kryetar i Komisionit Teknik Minella Kapo.

Shoqata e përuroi veprimtarinë e saj me ekspeditën (nisi në Vermosh, morën pjesë 12 alpinistët më të mirë) për njohjen dhe skicimin e itinerarëve në malet e zonës Kelmend – Bjeshkët e Namuna.

Kuptohet që para saj shtroheshin për zgjidhje shumë probleme, si, për shembull, sigurimi i burimeve financiare për ekipet, sigurimi i literaturës së huaj dhe përkthimi i saj, i pajisjeve teknike dhe i veshmbathjes verore dhe dimërore, sigurimi i automjeteve për lëvizjen e alpinistëve për në veprimtaritë kombëtare etj., etj.

Frutet nuk vonuan. Filluan të vinin pajisje alpinistike nga jashtë - këpucë alpine, çadra, dyshekë, kthetra, çelësa, kazma, çekiçë e gozhdë alpine. Me kalimin e kohës, për të siguruar të gjithë alpinistët me pajisjet teknike nisi prodhimi i tyre edhe në vendin tonë, në punishte të thjeshta dhe në Kombinatin e Autotraktorëve.

Unë u ngarkova me detyrën e sekretarit të kësaj shoqate kur ajo sapo kishte mbushur 6 vjeç. Ekipet e të rriturve kishin filluar të konsolidoheshin. Nisi krijimi i ekipeve zinxhirë në çdo rreth dhe klub sportiv:

- ekipi i pionierëve;
- ekipi i paratërinjve, nga mosha 15 deri më 18 vjeç dhe
- ekipi i të rriturve.

Në periudhën që unë isha sekretar i shoqatës, vëmendja u përqëndrua në:

§ Skicimin e itinerarëve, jo vetëm nëpërmjet përkthimit me fjalë, por edhe ngjyrosjes në shkëmb të tij. Krahas kësaj nisi edhe fotografimi i itinerarëve. Ky material u lidh në një bllok, të cilin e merrte komandati i ngjitjes. I gjithë ky material përbënte një ndihmë të madhe konkrete për ngjitjet që do të ndërmerreshin. E filluam me zonën e Shtegut të Dhëneve.

* Zgjedhjen e kuadrit trajner të ekipeve zinxhirë me arsimin e duhur. Nisja e punës konkrete për kualifikimin e tyre nëpërmjet dërgimit të literaturës sportive-metodike dhe seminareve kombëtare.

* Shtimin dhe ruajtjen e inventarit sportiv, duke ngritur magazinë në çdo klub apo rreth.

* Ideatimin, modelimin dhe botimin e: “Kartelë kategorizimi sportiv”. Mbas përfundimit të veprimtarisë kombëtare, në zyrën time vinte materiali i përgatitur nga drejtuesit e aktivitetit, ku krahas evidentimit të numrit të ngjitjeve të secilit alpinist, kujdes i veçantë tregohej në vlerësimin e shkallës së vështirësisë. Kjo e fundit pasqyrohej edhe në skicën e itinerarit që alpinisti kishte përshkuar, duke përfshirë këtu edhe numrin dhe vendet e nguljes së gozhdëve.

* Kategoria e ngjitjes shkëmbore vlerësohej konform kërkesave së vështirësisë në gjashtë shkallë: I, II, III, IV, V, VI dhe super VI.

* Komisioni teknik i paraqiste në muajin tetor sekretarit të shoqatës projektplanin e veprimtarive kombëtare të vitit të ardhshëm kalendarik, duke mos lejuar që i njëjti ekip apo drejtues të shkonte vitin e ardhshëm në të njëjtën zonë dhe në të njëjtën stinë. Ishte detyrë e sekretarit të paraqiste në organet përkatëse argumentet e nevojshëm që veprimtaritë të mishëroheshin në Kalendarin Sportiv të RPSH-ës.

* Çdo veprimtari drejtohej nga komandati, i dërguari i shoqatës dhe komandatët e togave. Të gjithë këta caktoheshin në bazë të propozimeve të komisionit teknik dhe miratimit nga ana e sekretarit, dy muaj para se të niste aktiviteti.

* Komisioni teknik hidhte emrat e pjesëmarrësve në aktivitetin kombëtar në *Librin përkatës* dhe në *kartelën e kategorizimit sportiv*.

* Mbi bazën e të dhënave të kartelës, shoqata merrte në shqyrtim kërkesën e drejtuar nga trajneri i ekipit dhe klubi sportiv për t’i dhënë alpinistit kategorinë sportive: III, II, I, mjeshtër sporti dhe mjeshtër i merituar.

Nga ajo kohë kanë kaluar 35 vjet. Vazhdoj të jetoj me alpinizmin tonë, jo në atë brenda zyrës, por me ngjitjet verore e dimërore, me entuziazmin e dashurinë e madhe të qindra e qindra të rinjve për malin. Ne ishim autorët dhe aktorët e asaj lëvizje të papërsëritshme. Po mbushen 20 vjet që në Alpe nuk po bëhet asnjë e katërta e asaj që bëhej atëherë. Ka ardhur koha të rifillojmë, të rifillojmë qoftë dhe nga e para në kushtet konkrete ekonomiko-sociale që jetojmë.

KOMISIONI TEKNIK

Shoqata e Alpinizmit dhe Turizmit Shqiptar u krijua në Qershor të vitit 1964 me vendim të Këshillit të Ministrave. Krijimi i Shoqatës shënoi edhe formatimin e krijimit të ekipeve alpinistike në bazë klubesh dhe rrethesh, përjashtuar Klubin Sportiv "Studenti", i cili tashmë ishte qendra e alpinizmit shqiptar.

Kryetari i parë i shoqatës ka qenë Kiço Ngjela, i cili ndihmoi mjaft në sigurimin e bazës së parë materiale për përhapjen e veprimtarive alpinistike, i cili u pasua në këtë funksion nga Kristo Papajani, njeri shumë aktiv. Sekretari i parë i emëruar i shoqatës ishte Muharrem Sinoimeri, i cili ndenji në këtë detyrë deri më 1970. Sekretarët që e pasuan atë ishin Andon Tapia, Seit Veseli, Eqerem Shaba dhe Agim Tabaku. Shoqata kishte Kryesinë e saj që zgjidhej nga mbledhjet që bëheshin në instanca të caktuara të lëvizjes sportive. Shoqata kishte Komisionin Teknik të saj, të cilin e zgjidhte kryesia e shoqatës. Ky komision merrej me anën teknike të sportit dhe luante rolin e këshilltarit për kryesinë. Komisioni teknik ishte vendimmarrës për çështjet teknike.

Që nga viti 1967 kam qënë vazhdimisht anëtar i Komisionit Teknik të Alpinizmit. Kam qenë i rregullt në mbledhjet e këtij komisioni pasi u rivendosa në Tiranë në vjeshtë të vitit 1971. Përjashtimi im nga ky komision ndodhi në periudhën vjeshtë 1975 - vjeshtë të vitit 1977, kohë kur mbi mua u ushtrua lufta e klasave. Kur vala e luftës së klasave ndaj meje ra dhe rifillova të marrë pjesë në veprimtari m'u ofrua përsëri pjesëmarrja në komisionin teknik.

Një ditë nga fundi i vitit 1977 Sekretari i Federatës për kohën, Eqerem Shaba, i cili vinte nga klasa puntore (sikundër doli termi n'atë kohë), më takoi. Atij i parapëlqenin bisedat dhe konsultimet për alpinizmin si dhe shërbimet për të inspektuar ekipet e alpinizmit.

Ushtrimi më tipik i luftës së klasave për të nxjerrë në lëvizjen alpinistike rolin pararojë të klasës puntore ishte "Tomorri" i Beratit. Kjo ndodhi kryesisht falë koincurrencës që Petraç Kule e Vangjel Melëngu, alpinistë që bënë emër, ishin të dy punëtorë. Edhe në vitet kur ekipi i alpinistëve të Beratit ishte në nivele të ulta cilësore, vlerësimi

i tij nuk binte poshtë, propaganda nuk e uli tonin për ekipin e Beratit.

KT (komisioni teknik) deri nga fundi i viteve 60-të më shumë merrej më sugjerime që lidheshin me shtrirjen e alpinizmit në Shqipëri dhe me organizimin e veprimtarive alpinistike dimërore e verore. Kurset dyjavore, një në dimër e një në verë, për përgatitjen e alpinistëve të rinj mbeteshin burimet nga ushqeheshin ekipet me alpinistë. KT hartonte programet mësimore për këto kurse si dhe caktonte drejtuesit dhe instruktorët (komandantët e togave) në kampet ku ushtroheshin alpinistët.

Më pas, në fund të viteve 60-të por edhe në fillimet e viteve 70-të, rëndësi mori gjetja dhe hapja e zonave të reja për kacavarje. Si rregull në verë, nga drejtuesit e togave, alpinistët e rinj dërgoheshin në qendër të fshatit Theth. Tek shkëmbinjtë aty rrotull kryheshin demonstrime e stërvitje të karakterit kryesisht teknik. Më i parapëlqyer ka qenë një shkëmb në buzë të rrugës automobilistike, në anën nga lumi, kur erdhi një ditë që “mbahej rradhë” për t’u stërvitur. Në Okol më e përshtatëshme doli një masë shkëmbore e madhe në ngjyrë tulle, por e pamjaftueshme për atë që e donim. Kjo bëri që të shtyhemish më tej, në zallishtën në rrëzë të majës së Radohimës. Këtu gjetëm faqe shkëmbore të përshtatshme (madje edhe për kacavarje të shkallëve të ndryshme të vështirësisë), të pafundme në gjërësi e lartësi, që u emërtua “Muri i Radohinës.”

Fillimisht klubet sportive kishin një numër të vogël alpinistësh, jo më shumë se tetë. Me rritjen e numrit të alpinistëve në çdo ekip (12 vetë ishte norma për ekip të plotë për çdo klub) si dhe me shtimin e klubeve me ekipe alpinizmi (ky ishte një orientim e zhvillim deri nga viti 1971), nevoja për hapësira të reja për veprimtaritë alpinistike u ndie edhe për sezonin dimëror. Kjo për alpinistët të cilët nuk kishin kategori të larta sportive. Ata organizoheshin me kampime në qendër të fshatit Bogë dhe shtrirja e tyre me kampime në Okol të Bogës dhe Ducaj ndeshi në pengesa mentaliteti në KT. Por, më së fundi, u vendos zhvillimi i veprimtarive kombëtare në gjithë luginën dhe majat përreth saj.

Në fillim të viteve 70-të me Andon Tapinë, sekretar i federatës, u diskutua dhe u vendos të krijoheshin kartela për të regjistruar ngjitjet e çdo alpinisti. Më parë ato regjistroheshin në një “libër” të madh, që shërbente edhe si arkiv i veprimtarive kombëtare. Erdhi koha që diçka të ndryshonte. Mbasi u modelua, u botuan kartelat dhe në to hidheshin ngjitjet e secilit.

Koha diktoi nevojën që edhe itinerarët e ngjitjeve që njiheshin, të shënoheshin me ngjyrë dhe të përshkruheshin me foto e me fjalë. Shënimi me ngjyrë i itinerarëve të kacavarjes në pikat ku ata fillonin vlejti për orientimin e alpinistëve për të shkuar në itinerarët me kategori të caktuar vështirësie si dhe për organizimin e shpërndarjen e tyre në zonat e veprimtarive për kacavarje.

Kartela për regjistrimin e ngjitjeve të alpinistit ishte e domosdoshme për kohën. Ajo vlejti për të nxjerrë kategorinë sportive të arritur. Kategorizimi i alpinistëve n'atë kohë lidhej me përfitime të tilla si orar i thjeshtuar (pesë orë) në punë dhe trajtim ushqimor. Këto për ca kohë herë jipeshin e herë hiqeshin; herë shtoheshin e herë thjeshtoheshin, në vartësi se si formuloheshin shkresat, e lidhur kjo edhe me buxhetin për sportin.

Përvoja e Andon Tapisë në Çekosllovakia nuk e bëri dyshë idenë e ndërtimit të një udhëzuesi për itinerarët e mundshëm të ngjitjeve në Bjeshkët e Namuna e në malet kryesorë të vendit ku ne kryenim veprimtari alpinistike. Për këtë filloi fotografimi i itinerarëve. Zyra e federatës "u mbush" me fotografi, ku spikatnin ato të Mit'hat Fagut.

Më pas u modelua përshkruesi i itinerarit, i vlefshëm për kacavarje dhe për ngjitje dimërore. Në të kërkohej që çdo grup që ngjiste një itinerar ta përshkruante atë mbi bazën e një standardi kërkesash, për të cilat trajnerët e ekipeve morrën udhëzime të veçanta në seminare. Ideja e këtyre përshkrimeve ishte që ato të grupoheshin sipas maleve dhe, mbi këtë lëndë, të ndërtohej udhëzuesi i itinerarëve të ngjitjes për çdo mal me vlera alpinistike. Mirëpo ideja për ndërtimin e udhëzuesit ngeci se duhej të paktën një person të merrej me të si dhe nga mungesa e mjeteve financiare. Ne donim që me fotot që kishim dhe me përshkrimet e itinerarëve (nga ata që ishin ngjitur) të bënim një libër (udhëzues), për kacavarjet shkëmbore dhe ngjitjet dimërore. E gjithë ajo fillësë entuziaste përfundoi me një "libër bllok" ku u vendosën fotot e zonës së Shtegut të Dhënëve (të ngjitura në të), përshkruhej ana teknike e kacavarjes dhe inventari i pajimeve që duheshin për të realizuar secilën ngjitje. Ky libër merrej në veprimtaritë tek zona e Shtegut dhe përdorej, por pas dy tre vjetësh librin dikush e zhduku.

Në fund të viteve 70 koha diktoi përgatitjen e programit unik të stërvitjes së ekipeve të alpinizmit. Kjo kërkesë ishte për të gjithë llojet e sporteve. Mario Trinkera kishte marrë përsipër dhe kishte përgatitur materialin. Po kërkohej gjithnjë e më shumë, në të gjitha sportet, për të patur diçka që t'i përgjigjej kohës. Mora në konsideratë atë pak gjë

që ekzistonte për stërvitjen e alpinistit në literaturën në rusisht si dhe atë që ishte botuar për sportet e tjera në shqip. Në vitin 1980 u ripunua programi për vitin 1981. Një vit më vonë u botua “Stërvitja e ekipeve të alpinizmit”, “Program unik i stërvitjes së ekipeve të alpinizmit për të rritur”.




Foto: ALPINIZËM, Kozma Grillo

Ky botim si dhe botimi me Kozma Grillon "Alpinizëm" mendoj se janë dy arritje të mëdha të alpinizmit tonë në drejtim të literaturës, për të cilat kam bindjen që edhe sot mund të përdoren si materiale bazë për një shkollë alpinizmi.

KT botonte Rregulloren e Brendshme të Alpinizmit. Fillimisht në të u vendosën udhëzime lidhur me rregullat e sigurimit në mal, kalendari i veprimtarive vjetore, etj. Kur u hoqën kurset e përgatitjes së alpinistëve fillestarë (tashmë supozohej se ajo realizohej nëpërmjet stërvitjes në ekipe) dhe në kalendar u caktuan vetëm veprimtari me alpinistë të "kategorive të ulta" e të "kualifikuar", mangësitë e përgatitjes së alpinistëve në rrethe dolën në pah në veprimtaritë kombëtare. Kjo bëri që në Rregulloren e Brendshme të Alpinizmit të botoheshin edhe materiale teknike dhe metodike në ndihmë të trajnerëve për përgatitjen e fillestarëve.

Fakti që sporti ynë nuk kishte një revistë ku të shkruhej për alpinizmin bëri që nga broshura e rregullores të kalohej në një buletin, në të cilin hidheshin të gjiththa ngjitjet që kryenin ekipet, rregullorja, gjithçka që referohej në seminarët kualifikuese me trajnerët. Fillimisht ndihmoi shumë Minella Kapo që buletini të botohej, por dikur erdhi një moment që puna e daljes së tij ngeci për mungesë herë të mundësive intelektuale e herë të mundësive në kohë.

KT kishte detyrë të organizonte seminare kualifikimi me trajnerët. Në to shpesh kishte materiale interesante, por erdhi një kohë dhe aty dolën njerëz që referonin vetëm për fitoret e Partisë së Punës. Jo se mundej të bëhej seminar pa treguar meritat e Partisë, por kishte nga ato referime që nuk kishin fare sport brenda. Ndër seminarët e organizuara kanë qënë mbresëlënës ai i organizuar për të parën herë në Korçë, me vend tubimesh teorike në mjediset e kabinetit pedagogjik, ai i Vlorës ku na strehuan tek kampi i puntorëve, dy të organizuar në malin e Dajtit dhe ai i Tiranës.

Kategoritë sportive

KT ishte hallka e federatës që u jepte alpinistëve kategori sportive deri tek titulli Kandidat Mjeshtër Sporti si dhe i propozonte kryesisht emrat për mjeshtër sporti kur këta arrinin normat. Ky ishte rregulli, por që shpesh nuk ndiqej për titujt.

Meqë kategoritë sportive të alpinistëve lidheshin me përfitime në orar pune të reduktuar e trajtim ushqimor, kujdesi që të mos "futeshin duart" në kartela ishte bërë i madh.

Me hapjen e kartelave për çdo alpinist dhënia e kategorisë erdhi nga viti në vit duke u stabilizuar. Kam bindjen se nga viti 1978 kategoria sportive e alpinistit jepej vetëm sipas standardeve të klasifikimit unik sportiv për alpinizmin.

Por ndërsa dhënia e kategorive sportive erdhi dhe u stabilizua, nuk ndodhi kështu me titullin mjeshtër sporti. Për ilustrim po sjell rastin e ekipit të Tiranës të cilin e drejtova në periudhën 1971-92.

Nga viti 1970 e më tej, kur diskutohej në KT për titullin mjeshtër sporti, nga kryeqyteti Qazim Liço dhe Kristaq Korçari ishin alpinistët më të njohur. Në KT këta emra nuk kaluan kurrë. Rasti i fundit që u diskutua emri i Kristaqit ishte kur u diskutua për këtë titull Koço Ziso i Korçës. Koço "kaloi" me justifikimin se "Korça nuk ka asnjë mjeshtër në alpinizëm" kurse Kristaqi nuk "kaloi", ndërsa Qazimi nuk u përmend më.

Më 1972 ose 1973 iu dha titulli mjeshtër sporti Astrit Omerit. Nuk e morrëm vesh kurrë si ndodhi, as si ekip e as si klub. Madje ne e morrëm vesh me vonesë që ai e kishte këtë titull megjithëse formalisht ai egzistonte dhe egzistoi në regjistrin e ekipit tim prej disa vitesh, por nuk vinte kurrë në stërvitje. U desh të vinte shkurti i vitit 2009 që Andon Tapia të më tregonte historinë e dhënies së titullit. Andon Tapia ka qënë sekretar i federatës në ato vite. Andoni më tregoi: "Astriti më ngeli mbas derës dhe më kërkonte titullin. M'u mërrzit dhe një ditë i kërkova të bënim një ujdi: unë t'i jepja titullin ai të bënte propagandë televizive (punonte ndihmës operator në rubrikën sportive të TVSH). Mirëpo ndodhi që unë i dhashë titullin dhe ai nuk bëri propagandë."

Për titullin Mjeshtër Sporti i plotësonin kërkesat edhe Sokol Doko e Ilir Tapia. Tre herë janë bërë dokumentet e tyre (kërkesa) sipas rregullave që kërkonte koha nga Klubi "17 Nëntori". Këta nuk e morën këtë titull. Dhe këta nuk ishin kushdo. Nëse kacavarja tek ne pati një kulm deri në fillim të viteve 90-të, mendoj se ndër alpinistët të cilët duhen vlerësuar si më rezultativë ishin Iliri e Sokoli. Në vitet 80-të pati dy raste që alpinistë të ekipeve të tjera ngelën në shkëmb dhe ishin në rrezik të humbisnin jetën. Në të dy rastet ishin Ilir Tapia e Sokol Doko që u thirrën dhe vajtën e nxorrën njerëzit nga rreziku. KT më pas aprovoi emra të tjerë për titullin mjeshtër sporti, individë të cilët nuk i kishin plotësuar kërkesat. Kurrë nuk e mora vesh se ku ngecete e drejta e tyre. (Siç duket, sundonte mendësia: *titulli jepet dhe nuk fitohet!*).

Në kohën kur enverizmi po binte, u hapën edhe mundësitë për të dalë jashtë vendit në veprimtari ndërkombëtare. Mbjaj mend që

mbledhjet e kësaj kohe në KT ishin hera herës me “bërryla.” Sekush nga gjenerata më e vjetër ishte në krye të dëshirës për të dalë jashtë shtetit (sigurisht jo për sport, por besoj për mundësi sado të pakta për të ngritur nivelin e ekonomisë familjare) dhe e ndjente të arsyeshme që shoqata dhe KT duhej ta përfillte në listë për veprimtari ndërkombëtare. Ishte koha kur dikush mburrej se kishte ekipin më të mirë të vendit tonë, dikush që kishte patur vlera e kishte dhënë e sakrifikuar shumë për alpinizmin, etj.

Ndërkohë edhe veprimtaritë alpinistike po vdisnin: në verën e vitit 1991 ekipi ynë arriti në Theth, vendi ku ishte caktuar për veprimtarinë verore të ngjitjeve të kualifikuara. Në Theth nuk erdhi asnjë ekip...

Aleksandër Bojaxhi



SI ME LINDI DHE U ZHVILLUA PASIONI PER ALPINIZMIN

Ishte vjeshte e vitit 1955. Pasi mbarova lojen e futbollit me moshataret e mi 15 - vjeçare, ne nje fushe te Pallatit te Pioniereve, duke fshire djersen me cepat e bluzes, po ecja neper rrugicat e ngushta te oborrit, te mbuluara me gjethet e pemeve te rena asaj vjeshte. Nga larg degjoheshin zera femijesh, nga ku degjohej thirrja: "Zik-zak, zik-zak hej-hej-hej, pioniere turista jemi ne".

Ne nje qoshe te oborrit, ne hijen e nje peme te madhe, ishte ngritur nje çader ushtarake. Prane saj ishte nje zjarr i madh ku mbi te rrinte varur nje tenxhere me çaj. I u afrova. Duke trazuar urat e zjarrit me nje shkop, m'u afrua nje burre i gjate me trup te holle e me floket pake te gjate dhe te thinjura, i cili me ofroi nje gote alumini me çaj duke me pyetur:

- He, si po te duket, a po te pelqen?

Une nuk fola. Burri perseri me pyeti:

-Ne cilin rreth je regjistruar"?

Iu pergjigja se nuk isha i regjistruar ne asnje rreth.

Aty mesova se burri qe me foli me aq shume dashuri per rrethin

e turizmit, ishte profesori i rrethit, mjeshtri i sportit Luigj Shala.

U regjistrova ne rrethin e turizmit, ku tre here ne jave shkoja pasditeve. Atje gjeta shoket: Astrit Omeri, Petrit Omeri, Ali Ago, Qazim Lico etj.

Ne fund te vitit 1968 SHNUM-i organizoi nje marshim alpinistik 10- ditor ne veri, me itinerar: Bajram Curri-Dragobi-Valbone-Rragam-Maje e Hekurave-Maje e Jezerces-Theth, kalim ne Shtegun e Dhenëve, ngjitje ne Radohime, zbritje ne Boge. Perfaqesuesi i SHNUM-it ishte ushtaraku Tafil Merdaliu, ndersa per anen sportive marshimin e drejtonte prof. Luigj Shala. Profesor Luigji duke pare fizikun tim te zhvilluar, me mori ne kete marshim. Per moshen time ky marshim qe mjaftte i rende, perveç rruges se gjate, here pas here me binte rradha te mbaja çadren e madhe ushtarake, ndersa per te fjetur shtronim mbi debore dega pishe. Mbi to shtronim gjysmen e batanijes dhe me gjysmen tjetër mbuloheshim. Shpesh here kur me dilte gjumi naten, shihja prof. Luigjin qe e kalonte naten duke mbajtur zjarrin ndezur.

Ky marshim, duke lene menjane lodhjen, me dha nje kenaqesi qe nuk e kisha ndiere ndonjehere. S'kisha shkelur male kaq te larte te mbuluar me debore....

Rreth viteve 1960, u inkuadrova ne Klubin Sportiv "17 Nentori", tani jo me pionier, por si alpinist. Ne ate kohe prane Ministrise se Arsimit ishte krijuar Federata e Turizmit e Alpinizmit, ku ne perberjen e saj kishte komisionin teknik i perbere nga alpinistet me te vjeter dhe me me pervoje, qe hartonin programet dhe kalendarin vjetor per aktivitetet alpinistike ne vendin tone. Ky komision vendoste llojin e aktivitetit, itineraret e tij, kohen dhe drejtuesin e aktivitetit e shume e shume detyra dhe pune mjaft te mira dhe i jepte gjalleri masivizmit te alpinizmit. Kështu, për shembull, zboret qe zhvilloheshin ne kohen e beharit apo te dimrit, paten frute mjaft te mira si nga ana teorike, teknike dhe organizative per levizjen alpinistike ne vendin tone. Ne keto zборе kultivoheshin tek te rinjte dashuria per shokun, uniteti, vendosmeria, sakrifica me e vogel deri tek e madhja per shokun dhe per te gjithë kolektivin, dashuria per natyren, per malin etj. Ne ato kohera alpinizmi kishte nje disipline pak a shume te ngjashme me ate ushtaraken. Nje merite te madhe ne ato kohera i takon mjeshtrit te sportit prof. Minella Kapos, i cili mbasi organizoi zborin e pare alpinistik me 1956 ne Theth, vuri bazat e alpinizmit modern, per konditat dhe kushtet e vendit tone te asaj kohe. Ne gjithë kete levizje alpinistike, nuk mund te mos permendesh mundin, sakrificat,

vendosmerine e alpinistëve të pare të kesaj levizjeje, siç janë: Vasil Stambuli, Petraq Kule, Kozma Grillo, Vangjel Ristani, etj.

Alpinizmi me mesoi të dua natyren e vendit tim, ta shkel sa me shume ate, t'i buzeqesh sa me shume asaj për t'u kthyer pa rreshtur tek ajo, t'i dua njerezit në menyre të veçante ata të malit, shokun e litarit e të mos i trembem anje sakrifice për shokun e shoket e malit... Kjo më ka krijuar bindjen që alpinizmit dhe vetem alpinizmit mund t'i thuash sport burreror. Çiklistit në aksident e siper i rri mbrapa makina dhe dhjetëra njerez që e shoqërojnë ate, po kështu në sportin e boksit ndihmen e ke në moment e kështu më rradhë për çdo disiplinë tjetër të sportit, ndërsa në alpinizem shokun e semurë apo të demtuar duhet ta marrësh në krah dhe të ecësh ore e ore të tera neper debore, akull apo të zbresësh në shkëmbinj....

Dekadat e jetës time alpinistike më pajisën me mjaftë virtyte të mira, që u kultivuan gjatë jetës, por e veçanta e kesaj kohe dhe bukuria e sportit ishte se më mesuan të shkruaj jo vetem gjuhen e nënes, por edhe gjuhen e ditarit që në ditët e para të jetës time në mal. Ditarin e shkruaja jo vetëm në mot të mirë por edhe në ditët e dimrit të madh neper male, në zhurmen e eger të tufaneve, nën dritën e qiriut në çader që më bene të perulem më dashuri dhe respekt përpara ditarit tim. U kërkoj ndjesë bashkëkohësve që në këte shkrim nuk mund të permend të gjithë emrat e tyre, që janë në këtë ditë. Kujtimet e jetës sime alpinistike janë të shumta. Do të tregoj dy prej tyre:

Ngjitja e janarit e vitit 1968

Janar 1968. Nuk e kisha pare ndonjëherë Tiranën të mbuluar më aq shume debore. Më pjesëmarrjen e alpinistëve të klubeve të kryeqytetit do bëhej ngjitje në kuadrin e 500-vjetorit të Skenderbeut, në majën e Shnikut. Në përberjen e grupit ishin: komandati i ngjitjes Kozma Grillo, Aleksander Bojaxhi, Astrit Omeri, Kristaq Korçari, Niko Stamo, Mariodon Hito, Qazim Liço, Kujtim Dobrolishti, Ali Ago, si dhe studentet Janaq Ziso e Flamur Milova.

6 janar. Mbas një rrugë të gjatë dhe teper të lodhshme arritem në fshatin Boge - qendra e fundit nga ku do të sulmonim majën e Shnikut. Asnjëherë nuk e kishim pare këte fshat të mbuluar kaq shume më debore. Nuk i kishim degjuar ndonjëherë fshataret të na thonin: "Për bese, as të zalli i Okolit s'mundeni më dale!".

8 janar. Në mëngjes, kur grupi u rreshtua tek kroni i Boges, komandanti i ngjitjes, mbasi kontrolloi bazën materiale dhe si u

sigurua për gjendjen morale dhe shëndetësore të grupit, na dha të drejtën të niseshim drejt Thethit, rruge e cila në kohe të mire nuk do me teper se 4-5 ore. Sa me teper i ngjiteshim malit aq me e veshtire dhe e lodhshme behej rruga, ku vende-vende fundoseshim deri në mes. Mbas nente ore e njezet e pese minuta, në erresirën e natës ngritem çadrat.

9 janar. Ate mëngjes, kur dolem nga çadra pame që debora kishte mbuluar krejt plaçkat që kishim lënë jashtë. Gjatë kohës kur po benim plaçkat gati, Kozmai ra në një fjalë me Aleksander Bojaxhiun që një pjesë e grupit të nisëj për të Shtegu i Dheneve. Në rast se ai kalohej do të na sinjalizonin për t'ua nisur dhe ne. Ishim gati...Si kaloi kohe, degjuam sinjalin. U nisem menjehere. Grupi ynë përbehej nga: Kozma Grillo, Niko Stamo, Ali Ago, Mariodon Hito dhe Janaq Ziso. U nisem për t'ua bashkuar me grupin e parë. Ecnim njeri pas tjetrit në mes të një tufani që rralle alpinistët e hasin në male, që sa të beheshe gati të vendosje kembën në gjurmen e shokut atë e mbulonte debora menjehere, ndërsa kazma alpine në dorën pa doreza të ngjiste nga akulli. E pamundur të ecej. Tufani të merrte frymen, debora e ngjitur neper qerpikë të veshtiresonte shikimin. Ecnim njeri pas tjetrit...Për prituri pash një dallgë që vinte drejt nesh. U përpoqa të ngrihesha mbi dallgën, por brenda sekondës e ndjeva veten nën deborë...I thashe vetes: „Qenka ortek!“ Po shokët? A ka mbetur njeri jashtë? Duke shtyre sa më duar dhe më këmbë deborën e shkrifet si miell dola mbi sipërfaqe. Hedh sytë përreth, pak metra afër meje shoh Kozmain, ndërsa të tjerët i shoh larg njeri-tjetrit. I u drejtova Kozmait: „Kozma, ortek..., ortek, shpejt të ikim!“ Ai ishte më gjakftohtë se unë. I hodhi një shikim të shpejtë orës, dhe duke ngritur kokën psherëtiu: „3.45“... dhe menjehere pyeti: „A jemi të gjithë?“ Unë pa i dhënë përgjigje i hodha një sy shokeve të cilet orteku i kishte shpërndarë larg njeri-tjetrit. Mbas dolën të gjithë nga debora, Kozmai në moment pyeti: „Po Aliu ku është?“ Trupi i tij nuk dukej. Filluam të zbrisnim për ta gjetur. Më në fund, një dorashkë më gishtat lart. Më të shpejtë u afroam të gjithë, duke i hequr deborën me duar e liruam atë.

Duke tërhequr zvarrë çantat mbi boren e shkrifet zbritem poshtë. Ndalua për të ngritur çadrën por ishte e pamundur. Tufani i përzier më deborën si miell të merrte frymen, sa që pese veta për minuta të tera mezi arriam të ngrinin vetëm një çader. Pa u vonuar, duke lënë çantat dhe çdo gjë jashtë, u futëm brenda. I vetmi Kozmai që i rezistoi tufanit më teper se ne, nxorri nga çanta dyshekun alpin, ku u shtrime

te gjithë. Me te hyre ne çader thame se shpetuam, por jo. Tufani duke e rrotulluar deboren si ciklon e perplaste ate mbi çader dhe pesha e saj e zvogeloi hapësirën brenda çadres, sa qe shpesh here duhet te hapnim deren per te marre pak ajer se na merrej fryma. Qe teper e veshtire qe pese veta te rrinim ne nje meter e gjysem vend. Te strukur prane njeri-tjetrit, degjoj Niko Stamon qe pyeti sa shte ora. Dikush u pergjigj : « 12.15 ». Niko vazhdoi : « O vellezer, nuk rrihet dot ketu. Une po dal jashte ». Me te u bashkua dhe Janaq Ziso.

10 janar. Sa zbardhi dita dolem nga çadra. Jo shume larg nga ne dukej çadra e grupit tjetër me Aleksander Bojaxhiun. Filluam te nxirrnim plaçkat nga debora dhe ndezem lecka me vajguri per te shkrire kepuçet qe kishin qene tere naten jashte. Rreth ores 14.15 u nisem ne drejtim te Boges. Debora mezi çahej. Qe kur u nisem nga Boga pothuaj ishim pa futur gje ne goje. Oret kalonin. Rraskapitja qe e madhe. Kishte pjesetare te grupit qe po humbisnin kurajon. Pak metra me larg degjoj Flamur Miloven qe i thoshte shokeve: “Une nuk vazhdoj dot me”. U afrova prane tij per t’i dhene kurajo qe te ecte sado pak. Ai perseri vazhdonte duke thene: “Nuk mundem. Me lini ketu dhe une do te vij neser vetem”. Pa humbur kohe i them dikujt: “Merr çanten time” dhe i afrohem Flamurit duke i thene: “Afrohu, afrohu, hip mbi mua”. Mbase e mora mbi kurriz mendova qe do te ecja avash-avash, por e pamundur. Ruga tashme ishte bere kanal deri ne mes. Eca dy hapa dhe u rrezova bashke me te. Atehere, bashke me shoket, duke e terhequr here zvarre dhe here per krahu mezi arritem tek shtepia e pare e Boges.

11 janar. Mengjesi i sotem ishte i qete. Po beheshim gati t’i bashkoheshim grupit tjetër, por na pengonte per te levizur Alpinisti Ali Ago dhe Flamur Milova, sepse kembet e tyre kishin filluar te ngrinin. Ne kete kohe vjen komandanti i grupit Kozma Grillo, se bashku me dy fshatare dhe Niko Stamon. Me vete ata kishin prure nje slite me te cilen transportuam shoket deri tek shtepia e Gjekes ku ishte grupi tjetër dhe e kaluam ate nate se bashku.

12 janar. Sot u larguam nga shtepia e Gjekes dhe zume vend ne nje banese tjetër larg qendres se fshatit, duke pritur ndonje ndihme ose mundesi per te levizur.

13 janar. Duke pare nga dritarja e odes shikoj ne oborr disa fshatare qe bisedonin me Kozmain dhe pak me vone drejt shtepise po vinin disa ushtare dhe nje oficer per te na ndihmuar, duke na thene se ju keni alarmuar qeverine. Per te marre ndihmen e tyre ne na duhej

te ecnim rreth dy ore deri tek makinat e tyre qe ishin bllokuar ne debore. Mbas nje ore pregatitjesh per t'u nisur, duke mbajtur barrelen ku ishte vendosur Ali Ago, nga qielli degjojme nje zhurme. Me te ngritur kokat lart shikojme helikopterin qe po ulej mbi ne. Me te shpejt i u afrova barreles ku kishim vendosur alpinistin e demtuar dhe me cepin e xhupit i mbulova fytyren. Ushtaraku qe hapi deren e elikopterit tha: "Tete veta merr helikopteri". Menjehere hipen te demtuarit dhe ne u nisem drejt Tiranes duke lene pas Kozma Grillon dhe Niko Stamon.

Me te mberritur ne Tirane, se bashku me mjafta njerez qe kishin dale per te na pritur, na priste ambulanca qe na shpuri drejt e ne spital. Ndersa ne vazhdonim te rrinim ne spital me ngrirje te grades se dyte dhe te trete, nje grup tjetër alpinistesh i perbere nga mjeshtri i merituar i sportit Minella Kapo, Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Andon Tapia dhe Myftar Marku u nisen menjehere per pushtimin e majes se Shnikut nga nje tjetër itinerar, nga ana e Tamares.

Nje tjetër e veçante per mua ne kete ngjitje ishte se, ditën qe do niseshim familja ime po nderronte shtepine, te cilen une s'pata kohe ta mesoja se ku ndodhej, pasi dashurine per alpinizmin dhe per kete ngjitje i vura ne plan te pare. **Shtepine time e mesova kur dola nga spitali.**

Ngjitja në faqen e Arapit

Kampingun per ngjitjet verore te ketij viti (1978) e ngritem tek Kroni i Shtrazes, qe ndodhet ne luginen e Thethit, pikerisht aty ku buron lumi i Shales. Ne pjesen veriore te saj ngrihet si gjigand Mali i Arapit – 2.217 m. Perbri tij jane dy qafa, ajo e Pejës dhe e Vishjes ne lartesine 1800 m.

Gjate viteve alpinistet e kane shkelur majen e Arapit ne shume drejtime per te kryer ngjitje shkembore sa te veshtira aq dhe te bukura. Te tilla kane qene ngjitjet te bera nga alpinistet tane, ne menyre te vecante nga ata gjermane.

Sa here qe na binte rruga per te kaluar ne Qafe Peje, pushimin e benim tek kroni, tek qershia. Pernjehere perqendrimi im ishte per te pare faqen shkembore te Arapit, ne pjesen jug-lindore. Shpesh here me Aleksander Bojaxhiun e shihnim nga larg me dylbi se ku mund te gjenim shtigje per të ngjitur ate masiv shkembor, qe ngrihet rreth 500 m perpendikular me nje faqe mjaft negative nga rreza e tij. Sa e sa here enderroja te perballesha me kete faqe shkembore. Here pas here

kur merrja ndonje mendim nga alpinistet me te vjeter dhe me pervoje si nga Kozmai, Aleksandri etj., me thonin: "Behet, por do shume pune".

Dhe ja. Ishte mengjesi i 7 korrikut. Duke levizur prane çadrave, me afrohet Kozma Grillo, qe ishte drejtues i ngjitjeve, e me thote: "Mario, tani sa ishim ne mbledhjen e shtabit. Une shtrova nje mendim timin me qe ndodhemi ne kete zone dhe me qene se eshte dhe 35 vjetori i ushtrise, u thashe shokeve te sulmojme Majen e Arapit, dhe ata ma perkrahen mendimin. Kur me pyeten se cili nga alpinistet do ta sulmoje, une i dhash emrin tend. Ti çfare mendimi ke"? Une ne pak sekonda ula syte pertoke, instiktivisht e ktheva koken nga Mali i Arapit duke pare Kozmain ne sy te cilit asnjehere nuk i a kisha bere fjalen dy, pasi ai per ne ishte shume e shume. Atehere duke nxjerre frymen qe kisha marre thelle i thashe: "Dakord". "Atehere shokun e litarit zgjidhe vete"- me tha. Menjehere i thashe : "Azem Hyka". "Dakort"- me tha.

Ajo dite plot emocione kaloi duke u pergatitur per ditën e neserme. Mjaft shoke na ofruan ndonje baze materiale te nevojshme. Jo shpejt me zuri gjumi ate nate. Emocionet me ngarkonin me mendime se si do te shkoje neser puna ne kete shkemb gjigand qe siç e thekson Kozma Grillo ne nje artikull gjate 22 vjeteve kjo ngjitje nuk ishte realizuar ndonjehere.

8 Korrik 1978. U zgjuam heret ne mengjes. Beme gati bazen materiale. Une dhe Azemi bashke me Kozmain mbas nje ore rruge jemi ne rreze te Arapit atje ku duhet të lidheshim në litar. Mbas nje pushimi te shkurter mbasi u lidhem Azemi me pyeti : »Kush do te eci perpara ?» Une i u pergjigja : per te mos u lodhur te ecim me rradhe.

Pa u vonuar filluam ngjitjen. Oret kalonin perballe shihnim shoket mbi një shkëmb që ndiqnin nga larg levizjet tona. Mbas 7 ore ngjitje na doli perpara nje traverse e gjate rreth 4 m. Shkembali qe plotesisht i shpelare. Asnje shenje per te mbeshtetur majen e kepuces. Mbi lartesine e shpatullave gjendeshin dy faqe shkembali qe vetem koken mezi pranonin ne mes tyre. Me shputat e duarve dhe me kembet e varura ne ajer me dy ndalesa dolem nga traversa duke pare poshte lumin i cili dukej si nje rruge kembesoresh ndersa çadrat si lodra me ngjyra te kopshtit te femijeve.

Ngjitemi dhe veten ngjitemi pa folur me njeri-tjetrin. Qetesine e ketij masivi shkembor e prish vetem zhurma e çekiçit. Rreth ores 14 filloi shiu i cili na veshtiresonte me teper punen por qe na dha dhe

kohe për të ngrene diçka. Mbas 8 ore pune me shkëmbin na dukej sikur sa më lart të ngjiteshim aq më të veshtira dilnin faqet shkëmbore. Dhe ja pa prituri del dhe një pllakë që i kalonte të tre metrat e bardhe sikur të ishte e lyster me gelqere pa asnjë vend për të ngulur një gozhde dhe tek-tuk ndonjë vend për të mbështetur mollezat e gishtave. E dinim që pengesa të tilla duhen kaluar me shpejtesë për të mos u tensionuar parakrahët. Pak më lart arrijmë në rreze të dy faqeve shkëmbore që formonin një L faqet e tyre të shplara i kalonin pese metrat dhe në rreze të saj ishte një shesh pushim ku mund ta kaloje edhe naten. Ketu bashkohem me Azemin. Ora tregon 6.10. Bejmë një pushim të shkurtër shohim me kujdes shkëmbin që kishim përballë i cili në fillimin e tij nuk kishte asnjë vend për t'u kapur dhe për të ngulur një gozhde. Pa humbur kohe unë ulem në gjunjë Azemi hipen mbi shpatullat e mija dhe ngjitet lart. Kjo që dhe etapa e fundit e ngjitjes. Gjate rrugës lamë shumë gozhde ngulura.

Mbas 12 ore e 45 minuta pune me shkëmbin dolem në majën e Arapit për të takuar njeri-tjetrin pa fjale dhe i dhame shokeve që prisnin poshtë sinjalin me parrullen tone. Nga kjo ngjitje mesuam shumë. Të tjerë alpinistë me përgatitje të mirë fizike dhe teknike mund të realizojnë jo vetëm këto ngjitje por dhe të tjera më të veshtira se kjo.

Edhe pse bëmë një ngjitje të shkallës së lartë të veshtiresisë, që nuk ishte bërë asnjehere gjatë 22 vjetëve, që për sportet e tjera përbente thyerjen e një rekordi, kur u kthyem në Tiranë mendonim që federata do të na jepte ndonjë stimul moral. Por jo!

Mariodon Hito, mjeshter sporti

UNË, XHIM BEGEJA, DHE ALPINIZMI

Sot e kuptoj që shumë vite më parë nuk kam qenë i vetdijshëm se cila duhej të ishte rruga që të bëhesha dikushi në jetë. Sigurisht që kam patur ëndrra, madje edhe disa fillesa për realizimin e disave prej tyre, të cilat diku në rragat e jetës janë ndërprerë duke i lënë rradhën fillesës së një ëndrre tjetër. Ëndrrat e mija "sulmonin" edhe fushën e sportit. Dhe për këtë kisha jo vetëm shtysat e mija rinore por edhe dëshirën dhe mbështetjen e "menduar" të prindërve. Them të

menduar ngaqë unë isha djali i vetëm i familjes me dy motrat më të reja se unë. E fillova hobin sportiv me pingpongun, por nuk zgjati shumë sepse hyri në mes basketbolli dhe ëndrra e parë u venit ngaqë një Xhimi i dytë brenda vetes time u ngjiz me dëshirën që të bëhej basketbollist. Mos vallë ishte niveli i këtij sporti në vitet 70-të që më dha këtë shtysë? Ndoshta....

Fati e rastësia bashkë e sollën që një ditë të jem, në shkollën ku mësoja, në klasën sportive të volejbolit dhe shpejt u dhashë pas këtij sporti, por ja që në ekipin e klasës unë nuk arrita të jem lojtar i gjashtëshes së parë. Nuk kaloi shumë kohë dhe m'u dha rasti të jem anëtar i një ekipi futbollit. E ndonëse deri këtë ditë prindërit e mi më mbështesnin për sportet në të cilat kisha "kullotur" nga pak, tani nuk më mbështetën...

Një ditë tetori të vitit 1979, pasi dola nga rrugisca e shtëpisë hipur në biçikletë dhe futem në rrugën e Dibrës, rastësisht pas meje vinte Z.Shefki Juma i cili pasi më arriti, në lëvizje e sipër më pyet se ku po shkoja. I them "Askund". Kam dalë sa për të kaluar kohën." "Atëhere, më tha, eja pas meje."

E ndoqa nga pas dhe u futëm në rrugën e Kavajës. Këmbyem pak fjalë gjatë rrugës dhe nga ato mësova se miku i familjes time po më drejtonte për tek vendi i grumbullimit të alpinsitave të Tiranës.

Me të arritur aty, dëgjoj Shefkiun: "Ac (Aleksandër Bojaxhi), të kam sjellë një çun të mirë. Është djali i një miku të familjes sime. Merre e provoje." Pas kësaj m'u drejtua mua:

-A do të bëhesh alpinist?

I hutuar, si një i ri para një të rrituri, i them instiktivisht një "po", por jo e llojit të një dëshire të paramenduar. Shtoj se i ati i Z. Shefki dhe të parët e mi njiheshin jo vetëm si tiranas të vjetër por edhe si tregtarë që dikur i lidhte puna.

Po atë ditë unë u prezantova me zotërinjtë Aleksandër Bojaxhi, që drejtonte ekipin e alpinistëve të rritur, dhe Andon Tapia që drejtonte ekipin në formim të të rinjve ku, që atë javë fillova stërvitjen.

Atë mbasdite "si me dorë të Zotit" isha në mjediset e një Klubi të mirëfilltë sportiv, atë të zemrës sime, dhe me ofertën për një sport që unë nuk e kisha menduar më parë. Kujtesa ime shkon deri tek mosha 7 vjeçare lidhur me tregimet në familjen time për malin. Duke qenë se im atë në rini të tij ka pas probleme shëndetësore, në moshën 20 vjeçare ka kaluar ca kohë për kurim në Cortino Dampezzo, e famshme me skipista, etj., të Italisë. Tregimet e tim eti për bukuritë e

atyre maleve dhe vlerat e klimës malore e të sporteve malore sillëshin hera herës në bisedat familjare. Dhe ja, unë isha në “derën sportive” të malit.

Pasi ndenja pak tek dhoma e alpinistëve dhe plotësova disa formalitete vajta me një frymë në shtëpi që të ndaja me prindërit këtë gëzim të madh, gëzimin e një gjimnazisti të vitit të pare.

Atë mbasdite të vonë i gjeta prindërit në humor të mirë, madje si rrallë ndonjherë në një falmilje si imja ku pesha e luftës së klasave ndaj shtresës së ish tregtarëve ishte gjakprishëse. U thash se çfarë me kishte ndodhur pasi kisha dalë nga shtëpia. Ata u interesuan për Shefkium dhe bisedën time me të, por sa për alpinizmin mora një “ç’të duhet ty ky sport”, kurse nga im atë nuk mora as aprovim e as mosaprovim. Për mua n’atë moshë ishte e rëndësishme që asnjëri prej tyre nuk tha “jo!”

Të nesërmen fillova stërvitjen me ekipin e të rinjve nën drejtimin e Andon Tapisë dhe pas një jave u njoftova që do të pajissha me materiale sportivë. Kjo ishte habi dhe kënaqësi e madhe. Vite më vonë mësova se Aleksandër Bojaxhi kishte si parim të mblidhte të rinj që ai i quante njerëz të mirë. Për të kishte rëndësi që njerëzit të ishin të mbarë, kurse që të merrej vesht nëse ata do të bëheshin ose jo alpinistë, sipas tij, duhej ca kohë, ndoshta edhe dy vjet. Mirëpo pajisja me materiale alpinizmi për klubin e Tiranës ishte jo vetëm bluze, tuta e cantë shporti, por edhe pulovër, këpucë me qafa, doreza, çorape, kokore etj., gjë që për gjendjen ekonomike që kishim n’atë kohë ishte edhe ndihmë për veshjen time dimërore. Nganjëherë e kam ngacmuar veten duke e pyetur se mos ndoshta këto pajime më “gënjyen” që mbeta në ekip dhe u bëra alpinist...

Pas një muaji, në nëntor, u organizua një veprimtari kombëtare me të rinjtë në Selishtë të Peshkopisë. Ishte argëtim mbresëlënës për mua: ishte hera e parë që largohesha i vetëm e pa të afërmit e mij nga shtëpia, që flija me shokë krejt të rinj në tendë dhe shtëpi fshati, që ngjitesha me një grup moshatarësh edhe të rretheve të tjerë në male të panjohurë më parë... Çdo gjë ishte mbresëlënëse!

Pas kësaj veprimtarie pasuan stërvitje të tjera e ngjitje në Dajt. Me kalimin e kohës po kuptoja se po dashurohesha me sportin e alpinizmit. Kjo dashuri rritej vazhdimisht me fitimin e njohurive për malin, reliefin e kapërcimin e tij, me parashikimin e motit e shumë njohuri të tjera për natyrën.

Në gusht të vitit 1980 ekipi ynë i të rinjve vajti për kacavarje

shkëmbore në zonën Qukës (Librazhd), ku unë për të parën herë u njoha me kacavarjen përtej poligonit tonë stërvitor në malin e Dajtit. Në këtë veprimtari mbaj mend që ngjitjet i bëja me Aleksandër Tapinë dhe në mbyllje, profesor Andoni na çoi në plazhin e Durrësit ku ne ngritëm kampin me tenda dhe kaluam disa ditë.

Nuk kaloi shumë kohë dhe profesor Acì më mori në ekipin e parë. Kjo bëri që të më jepej rasti të "takohesha" me Alpet. Të parën herë në veprimtarinë e ngjitjeve dimërore në zonën Ducaj, dhe fill pas kësaj në sezonin veror me kacavarjet në zonën e Shtegut të Dhenëve. Dhe kështu, duke u ngjitur maleve, një ditë arrita që në malin e Shtegut të ngjtesha në të famëshmen I-8, që brezi ynë i kishte vënë nofkën intinerari "vrasës." Kjo ndoshta ngaqë aty u rëzua shumëkush, apo ngase ai ishte hallka më e vështirë e rezultateve që ne duhej të arrinim për të marë kategorinë e parë sportive. Këtë nuk di ta them, por di që në litar kemi qenë unë, Sokol Doko (i cili na jepte siguri me praninë e tij në litarin e ngjitjes) dhe Artur Shehu. Kam qenë mjaft i ri kur mora kategorinë e parë dhe kjo ishte meritë jo vetëm e imja (sikundër mund të them për çdo anëtar të ekipit) por edhe atyre që ne na drejtonin: ne bënim një stërvitje të tillë që të ishim në gjendje të realizonim në mal atë që duhej të bënim gjatë veprimtarisë për të siguruar rritje në kategorinë sportive. Madje ne e dinim pa u nisur në veprimtari se cilat duhej të ishin shkallët e vështirësisë së intinerarëve që duhej të ndërmerrnim.

Tek mendoj për alpinizmin e viteve 80 e ndjej se pata fat që në stërvitje dhe veprimtaritë kombëtare ne, djemtë e Tiranës, të kishim trajnërë e drejtues veprimtarishë nga të cilët mësonim jo vetëm se si t'i ngjiteshim malit. Gjatë stërvitjeve apo ngjitjeve me raste ne na mësohej për bimësinë, gjeologjinë, reliefin, etj. dhe kjo na bënte të ndjeheshim të ditur lidhur me mjedisin ku kalonim dhe të përjetonim bukuritë natyrore që shoqërojnë alpinistin. Kështu, për shembull, ka qenë me mbresa të veçanta një mbrëmje vere në Shtegun e Dhenëve ku profesor Acì na mblodhi e na shtriu përreth tij dhe na tha të drejtonim sytë nga qielli. Na bëri një leksion se si të vëzhgonim qiellin për të parë konstelacionet yjore, gjetjen e tyre, kuptimin parahistork të emërtesave të tyre, si dhe ndihmën e tyre për tu orjentuar në natyrë, etj. Koha kalonte dhe e kuptoja se alpinizmi për mua u bë dashuri. Dhe kjo dashuri ka autorësi trajnerët e drejtuesit e mi të atyre viteve si Aleksandër Bojaxhi, Andon Tapia, Shefki Juma, Kozma Grillo, Dashamir Fejzo si dhe shokët e ekipit tim ku më të spikatur për mua

mбетën dhe janë edhe sot e kësaj dite Sokol Doko, Ilir Tapia, Romeo Manxhari, Aleksandër Tapia, Foti Taçi, Ardian Kurti.

Në ekipin tonë i jepej rëndësi harmonisë midis anëtarëve dhe hera herës në grup shkonim dhe vizitonim familjet e njëri-tjetrit duke ndjekur ditëlindjet tona. Kështu na mundësohej edhe njohja familjare e ndoshta kjo bënte që ne ta respektonim më shumë njëri-tjetrin dhe të ishim më të kujdesshëm në marrëdhëniet brenda ekipit. Nuk kanë munguar edhe vajtje si ekip në veprimtari artistike. Kjo lloj jete kolektive jashtë stërvitjes besoj se ka ndikuar për mirë në një edukim pozitiv që të paktën unë e ndjej se më ka vlejtur për vitet e mëpasme në jetë, madje them se ky që jam sot jam për më mirë nga sa mundet të isha bërë ngase më ka ndihmuar dhe ndikuar jeta si alpinist i viteve 80-të.

Mbresëlënëse për mua në jetën alpinistike ka qenë ngjitja e faqes jugore të malit të Arapit nga Iliri e Sokoli. Unë e profesor Aci kemi ndjekur me emocion ngjiten e tyre nga rrëza e malit nëpër një brinjë që kishte caktuar për intinerar profesori. Ne të dy u përqëndruam në afërsi të qafës tek Rreth i Vishnjës dhe hera herës komunikonim (me vështirësi) me ta si dhe mbanim shënime. Dita e parë e ngjitjes i nxorri ata në krye të asaj brinje (në fakt një dyfaqësh i jashtëm) e prej ku ata panë një shteg të mundëshëm për të dalë në Rreth të Vishnjës e për të kaluar natën në tendë. Pjesa e dytë e ngjitjes i nxorri në majë. Ishte gëzim i madh në kampin tonë dhe këmbimi i emocioneve të tyre me ne kulmoi me thënien e tyre: “ky intinerar bohet” gjë që u bë një synim për t’u kthyer aty përseri vitin pasardhës e për ta realizuar atë disa alpinistë të qytetit tonë. Më ka mbetur një “ah” në jetën time që rrethanat e sollën që unë të mos jem në ndonjë litar ngjitje në atë intinerar Në vitet më pas fati bëri që ne të mos kthehemi më në rrëzën jugore të Arapit. Po të isha edhe unë një ngjiftës i atij intinerari sot do ndjeja se kam një Medalje Ari për merita në kacavarje!

Mbresëlënëse ka qënë edhe ngjitja në majat e Popllukës dhe Alisë nga një shteg (në fakt është si korridor) që fillon menjëherë sapo lë kroit tek q ershiat (Kroni i Shtrazës) e që të nxjerr direkt në qafën midis dy majave. Kam qënë në këto ngjitje me profesor Acin dhe Sokol Dokon.

Jeta e solli që pjesa më e madhe e ekipit tonë të marrë rrugën e emigracionit me fillimin e viteve 90-të. Unë shkova në Greqi por u ktheva më 1994, profesor Aci iku në Amerikë dhe u duk në Tiranë në

vitin 2003; Arben Qato iku në Itali, Mazllum Feka në Itali, Artur Shehu në Amerikë, Sokol Doko në Greqi sikundër edhe Foti Taçi. Por nuk dua te harrojme se për shume vite ne kemi bere bashke stervitje dhe aktivitete me djemtë e ekipit të "Dajtit" të drejtuar nga Z. Kozma Grillo.

Çfare ndodhi me alpinizmin gjate viteve 90

Për mua ne ato vite cdo gje mori tatëpjetën për sportin. Në situatat politike që erdhen me ndërrimin e sistemit, u nisem pothuajse të gjithë ekipi për ne emigrim.

Më ra për pjesë Greqia, ku për një periudhë 4-5 vjetesh nuk pata mundesine për t'u marrë me sport. Në vitin 94 kthehem për herë të parë në Shqipëri për të respektuar fjalën e babait, i cili kerkonte nga unë që të merresha me administrimin e pronave të familjes sime. Shkova edhe një herë për arsye shendetësore në Greqi, nga ku u ktheva në nëntor të 1996, kur fillova të merresha me perkushtim por pa "pasion" me biznesin e familjes, por e edukova veten ta konsideroja si pjesë të punës rutine të perditshme .

Menjehere pasi fillova të sistemoja veten dhe familjen me stabilizimin e ekonomisë personale, fillova ta ktheja kokën perseri nga stervitja nga liqeni, pra nga alpinizmi. Vazhdoja me profesor Shefkiun, që vazhdonte të ishte tranjer i alpinizmit të Tiranës. Filluam të benim aktivitete soditese me atë pjesë mjerrane të sportistëve që kishin ngelur këtu, por asgjë me rendesi, vetëm bënin sikur ngjiteshin në mal.

Krijimi i shoqates

Një ditë të bukur takoj Z. Ibrahim Hacka, i cili vazhdonte të bente krosin e tij prej shume vitesh tek liqeni artificial i Tiranës. Ashtu të djersitur, filluam të pyesnim për miqtë tane të sportit. Dhe nga ky moment filluam të benim aktivitete të ndryshme për qejfin tonë. Në grupin tonë në fillim ishin Shefkiu, Iliri, Beneti, Dolf Zaharia etj. Për vintë fundi i mijevjecarit dhe e gjithë bota po ziente për të festuar ardhjen e mijevjecarit të ri, me menyra nga me të ndryshmet. Më lindi një ide bashkë me Ilir Tapinë për ta festuar këtë festë në menyren që na takonte si alpinistë. Ashtu dhe bëmë. E festuam në Majë të Korabit.

Kur kaluam periudhën e vështirë të tranzicionit 97-99, menduam me Bimin dhe Shefkiun ta kthenim këtë shoqatë në një grupim legal të licensuar. Kështu formuam Shoqatën Alpino-Turistike "Dajti", në shtator të vitit 2000.

Biznesi im - fole e rigrumbullimit të alpinistëve

Ne shtepine time tek rruga e Dibres hapa lokalin bar-kafe, që shumë shpejtë u bë qendra e shoqates sone. I vumë emrin "Alpin". Më vonë, mbas 3 vjetësh hapa restorantin "Begeja", po ne pronat e familjes. Jo v vetem kaq. Më 2006 bleva bashke me tre ortakët e mi Hotel Turizmin dhe nje fabrike birre ne qytetin e Pukes. Ishte nje deshire per te bere nje investim ne vendin tim, ne zonen malore dhe ne nje vend te varfer.

Megjithese eshte disi e parakoshme mendoj qe ja vlejti. Nga pasuria e tim eti kam nje pjese prone tek Klubi "Partizani", ku me te drejten e zotit dhe me ligjet e ketij shteti, tashmë u bëmë te zotët. Tani shoqata jonë ka nje vend te mrekullueshem ku ne bejme stervitje, kemi edhe nje mur artificial për kacavarje.

Jam munduar qe një pjesë të pasurisë që kam t'i vë ne dispozicion te sportit dhe te shoqates.

Himalajat

Një ëndërr e cila u realizua me 23 prill te 2003-shit, me vajtjen në Kampin Bazë Everest 5.350 m dhe në majën Kalapatar 5560 m. Na nxiti një amerikan qe punonte ne nje projekt të UPND. Ai ja shtiu ndërmend Bimit, dhe së bashku organizuam te paren ekspedite shqiptare ne Himalaja.

Profesori përsëri midis nesh

Shtyse per ne, per te bere akoma me shume per sportin tone, është edhe kthimi në atdhe i Zotit Aleksandër Bojaxhi. Tashmë ai është Kryetar i shoqates sonë, e cila ka si qëllim konsolidimin dhe vazhdimin e suksesit, si sfidë për të ardhmen.

Monblani

Në analizën vjetore të shoqatës sonë (Shoqata "Dajti" Alpino-Turistik) v endosëm që në vitin 2008 të ngjiteshim në Malin e Bardhë – 4.808 m, Francë. Kjo majë nuk është vetëm pullazi i Europës, por edhe djepi, simboli i sportit të alpinizmit. Ndjenim detyrimin moralo-sportiv që edhe shqiparët të ngjiteshin në të.

Në qershor të 2008-ës, në veprimtarinë alpinistike që kishim organizuar në Valbonë, pas stërvitjes dhe testimit, vendosëm të niseshim. Në Tiranë nisi puna që synimi ynë të shndërrohej në stërvitje intensive, hartim planesh dhe projekte. Falë internetit siguroam që aventura jonë të zgjaste 5 ditë.

Ekipi ynë u përbë nga Aleksandër Bojaxhi, Ibrahim Hackaj, Gjergji Bojaxhi, Florijon Hackaj, Marenglen Laci, Mateo Begeja dhe unë. Grupi mbërriti në majë të Malit të Bardhë në orën 7 e 20' të 29 gushtit. E përjetova gjatë dëshpërimit që nuk arrita në majë. Gjurin e kisha dëmtuar dhe caloja fare pak. Nuk e dija që kisha meniskun të dëmtuar. Me gjithë kundërshtimin dhe lutjet e mia dhe të shokëve guida nuk më dha të drejtën të shkoja me ata. Në raste të kësaj natyre vura re që francezët që shërbenin në mal ishin sa korrekt aq dhe skrupuloz në zbatimin e rregulloreve. Unë e profesor Aci, që qëndroi për mua, u ulëm në strehimin aty pranë, në lartësinë 3.160 m. Aty kaluam natën dhe pritëm deri të nesërmen. Në orën 11 përqafuam fitimtarët. Unë nuk hipa në majë, por atje hipi djali im – Mateo Begeja dhe shokët e mi.

Po për të ardhmen?

Kryesore për mua mbetet përkushtimi për familjen. Kam prindërit tashmë në moshë të thyer, bashkëshorten – Luljetën, që aq shumë i do dhe punon për edukimin e dy djemve tan: Mateo dhe Marin. Ushtrij me ndershmëri biznesin tim. Gjithnjë do të kem bashkudhëtar alpinizmin. Me meniskun “do të merrem vesh”. Kam ëndrrat e mia që harmonizohen me ato të shoqatës. Një ndër to është të ngjitemi në majën më të lartë të cdo kontinenti. Do stërvitem dhe do të ndihmojë shoqatën për realizimin e ngjitjeve sa më cilësore...

Tiranë, shtator 2009

- Më duket se dalëngadalë po fute në botën e alpinizmit. Ju do të bëheni alpinist?Përse buzëqeshni, e kam me gjithë mend. Ashtu si çdo ndjenjë tjetër edhe dashuria për malin e pasioni për turizëm nuk lindin bashkë me njeriun, por krijohen, zhvillohen e lulëzojnë gjatë jetës.

- Po krijoj bindjen se është sport i bukur, por më duket i vështirë. Cilat do të ishin disa nga karakteristikat e alpinizmit tonë?

- Në vitet e parë alpinizmi tek ne u zhvillua në formën e alpinizmit klasik. Synimi i ngjitjes ishte marrja e majës, pavarësisht nga shkalla e vështirësisë. U veprua mirë se nuk i njihnim malet dhe majat e tyre, shtigjet që të drejtojnë për atje.

Kjo u kushtëzua edhe me faktin që ato vite pajisjet për ushtrimin e këtij sporti ishin të pakta dhe primitive. Edhe në rast se do të ishim

në gjendje nuk mund të bësh ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë me litar prej lini, me të njëjtët që lidhnin kafshët. Kacavarjet shkëmbore u mësuan dhe u realizuan gjatë stinës së verës.

Jo vetëm në periudhën fillestare por edhe më 1992 në vendin tonë nuk kishte asnjë poligon artificial, as për qëllime sportive as për kënaqësi personale. Ishte kjo arsyeja që shumë nga orët e stërvitjes në stinën e pranverës, në prag të aktivitetit kombëtar, ngjitjeve verore - kacavarjes në shkëmb - ne i bënim në murin e godinës qëndrore të universitetit të Tiranës, të stadiumit e kështu me radhë. Kuptohet që stërvitje të tilla nuk të përgatitin sa dhe si duhet, ato vetëm ndihmojnë në zhvillimin dhe forcimin e muskujve të duarve dhe të këmbëve që aktivizohen me shumë ne realizimin e ngjitjeve në shkëmb.

Alpinistët e kryeqytetit, të inkuadruar në tre ekipe: "Partizani", "17 Nëntori" dhe "Dajti", stërvitjen për kacavarjet e realizonin në poligonin e Dajtit. Ditën e shtunë ose të diel herët në mëngjes shkonim në Dajt, aty ku nis e përpjeta për të dalë në Fushën e Dajtit, pranë "shtëpisë së Salës", (nuk e kam fjalën për kryeministrin tonë) dhe zhvillonim stërvitje deri nga dreka në itinnerarë shkëmborë shumë të mirë.

Në male dhe Alpe nuk u ndërtua asnjë "kasolle" për alpinistët, nuk kishim të tilla. Alpinistët tanë e kalonin natën në cadra dhe ndonjë natë në stinën e dimrit në shtëpitë e malësorëve. Më komod e ndjenim veten në dimër kur punonim në zonën e Qafës së Pejës se atje futeshim në godinën e postës verore të kufitarëve, të cilët në dimër ishin orë të tëra larg dhe patrullat më të avancuara kontrollonin në zonën e kronit të Shtrazës.

Ishte e natyrshme që federata jonë nuk ishte as anëtare as vëzhguese në ndonjë federatë apo forum alpinistik ndërkombëtar apo european. Deri më 1992 nuk hyri asnjë botim apo revistë alpinistike e huaj.

- Gjatë bisedës sonë dhe kujtimeve të shokëve tuaj flitet shumë për masivitetin. Mund të na flisni më gjerë?

- Para se të flaës për këtë, duhet theksuar se themelet e krijimit, organizimit dhe të masivizimit të alpinizmit nga viti 1956 deri në krijimin e Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit u hodhën në Universitetin e Tiranës. Katedra e edukimit fizik, e drejtuar nga mjeshtri i merituar Minella Kapo, bëri një punë të mrekullueshme për përgatitjen e instruktorëve të alpinizmit, nëpërmjet zboreve verorë dhe dimërorë.

- Ja disa tregues: Viti 1992 na gjeti me 22 ekipe alpinistësh. Në klubet sportive apo në rrethet ku funksiononin ekipet e alpinistëve të rritur funksiononin edhe ekipet e pionierëve dhe të rinjve. Cdo ekip përbëhej nga 12 sportistë. Sic shihet, gjatë gjithë vitit stërviteshin dhe merrnin pjesë në veprimtari sportive thuajse 800 vetë. Është një shifër e madhe në raport me popullsinë tonë.

Këto ekipe u krijuan dhe u mbushën jo me një urdhër nga lart për të rekrutuar njerëz. Puna e gjithanshme propagandistike dhe organizimi i shëtitjeve, ekskursioneve, marshimeve, pikniqeve dhe ngjitjeve malore u ngrit në një shkallë shumë më të lartë me krijimin e Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit më 1964. Ajo u ngrit dhe funksionoi brenda një kuadri ligjor të caktuar.

Është thelbësore të vëmë në dukje se me këto veprimtari, që me të drejtë konsideroheshin si mjete të rëndësishme për edukimin patriotik, fizik dhe ushtarak të masave punonjëse dhe në mënyrë të vecantë të brezit të ri, merreshin seriozisht edhe organizata e pionierit, e rinisë, e bashkimeve profesionale (që kishte gjithë ato kampe pushimi për punëtorë dhe pionierë edhe në zona malore), SHNUMI etj., kuptohet gjithnjë nën udhëheqjen e Partisë. Kështu, një nga funksionet e federatës sonë ishte edhe koordinimi i veprimtarive të gjithë organizatave të masave. Për kujdesin që tregonte shoqëria jonë për këtë lëvizje të gjerë dëshmon edhe fakti që një herë u mbledh Komiteti Qendror i Partisë që trajtoi këtë problem, shtroi detyra për masivizimin dhe rritjen cilësore të saj. Kuptohet që në shtypin e atyre ditëve shkruhej për zberthimin e detyrave që shtroi Partia dhe mësimet që dilnin "...nga fjala historike e shokut Enver".

Ky problem u shtrua edhe në rrafshin psiko-pedagogjik. Janë majft shkrime në "arkivin" tonë që shtjellojnë se një ndër tiparet e njeriut të emancipuar dhe të kulturuar është edhe aftësia e tij për të përdorur në mënyrë racionale kohën e lirë, për t'i dhënë një pjesë të konsiderueshme të saj ushtrimit të fizkulturës e të sportit, duke mos harruar për asnjë çast ekskursionet e marshimet turistike, ngjitjet malore, rrëshqitjet me ski dhe ecje-rendjet në terren të thyer, të cilat jo vetëm që të japin kënaqësi, por, në të njëjtën kohë, janë edhe mjete të pazëvendësueshme të qytetërimit.

Kënaqësia e papërsëritshme që shkakton kalimi i një terreni të thyer e të mbuluar me dëborë të ngrirë, emocionet që e shoqërojnë atë që shtegton kur tufani shfryn, forcojnë shëndetin, kalitin organizmin dhe e zhvillojnë atë në mënyrë harmonike, zhvillojnë qëndrue-

shmërinë, cilësitë e vullnetit, të karakterit e personalitetin në tërësi.

Gjithë këtë lëvizje, në vecanti ngjalljen e interesimit dhe ndjenjës së dashurisë për natyrën te fëmijët dhe të rinjtë, e ngriti në një nivel më të lartë futja në planet mësimorë të shkollës të *Busullës turistike*. Në varësi të moshës së fëmijëve, të ciklit shkollor në arsimin e përgjithshëm dhe të detyruar duhet që brenda vitit shkollor të organizonin një numër të caktuar ekskursionesh dhe një marshim me fjetje jashtë shtëpisë.

Në disa shkolla të zonave malore u ngritën klasat sportive të alpinizmit, ku nxënësit mësonin sipas planit dhe programit mësimor të Mimistrisë së Arsimit.

Të gjitha këto bënë të kalohej shpejt gjendja e fillimit të viteve 60, kur një numër i vogël studentësh e intelektualësh ngjiteshin në malin e Dajtit, prishnin qetësinë e tij. Me kalimin e viteve u bë e vështirë të siguroje mundësinë për të kaluar një natë dimri në kampin e Dajtit. Erdhi ajo ditë, dhe do të vinte patjetër, që grupe të rinjsh bënin ç'ishte e mundur të siguronin fjetjen në kampin e pionierve që të nesërmen të rrëshqisnin me ski e t'u drejtoheshin majave....Gjallëria e veçantë e pikave turistike në malin e Dajtit, në Moravë e Voskopojë të Korçës, në Razëm të Shkodrës dhe Kapinovë të Beratit, dëshmojnë për pasionin e të rinjve për të ushtruar turizmin malor.

Në arritjet e kësaj lëvizje një ndihmesë të konsiderueshme dhanë alpinistët. Cdo alpinist ishte "i detyruar" që brenda një viti të udhëhiqte shokët e shoqet e qëndrës së punës apo të fakultetit ku studionte. Ne e kryem me dinjitet këtë obligim moral.

- Lexuesi është i interesuar të na tregoni dicka edhe për cilësinë e këtij sporti. Cfarë mund të na thoni.

- Pyetja është me vend. Përgjigjja është pak e vështirë. Në kuptimin e përgjithshëm, përsosmëria nuk arrihet në asnjë fushë të veprimtarisë njëzëore. Kush është më i ndjeshëm ndaj statistikave, në "hipotekë" mund të numrojë ngjitjet e shkallës së lartë të vështirësisë, kryesisht ato të shkallës VI verore e dimërore.

Për vitalitetin e alpinizmit tonë dëshmon cilësia. Arritëm tregues të konsiderueshëm, të cilët janë të kapshëm për lexuesin në rast se iu referohemi disa prej ngjitjeve cilësore. Ndër to, po përmend 4:

1. Ngjitjen në itinerarin jugor të murit të Arapit nga 16 alpinistë. Ngjitjet e disa itinerarëve të tjerë në këtë mal që nga ana teknike janë edhe më të vështirë, por janë më të shkurtër se itinerari jugor.

2. Marrja e Majës së Rinisë (Jezerca) në stinën e dimrit nëpërmjet itinerarit verior.

3. Mbërritja në majën e masivit qëndror të malit të Boshit, etj.

4. Nisja më 1991 nga alpinistët e kryeqytetit të përshkimit të itinerarëve shkëmborë (që bëhen në verë) edhe në stinën e dimrit, kur muri shkëmbor është i mbuluar me dëborë të ngrirë dhe vende-vende me akull. E nisëm në Shtegun e Dhënëve.

Më duket se nuk mund të bëhej më tepër. E them këtë se arritjet e cdo ekipi sportiv kushtëzohen edhe nga niveli akademik i trajnerit. Nga 22 trajnerë vetëm 4 prej tyre kishim diplomën e arsimit të lartë, baras me 18 për qid. Ende më i ulët ishte ky tregues për alpinistët...

Më ka tërhequr vëmendjen shprehja juaj "kujdesi i shoqërisë".

Hera e parë që nuk po ju lë të mbaroni së shprehuri mendimin. E ndjej si obligim të madh dhe nder të falenderoj shoqërinë që na krijojë të gjitha kushtet që ne të ushtronim sportin tonë të preferuar. Shpreh bindjen që, në kushtet ekonomike të vendit tonë ato vite, shoqëria bëri më tepër se kishte fuqinë. Mos harroni që alpinizmi ka qënë dhe mbetet në cdo shtet një ndër sportet më të kushtueshëm dhe që financiarisht nuk inkason asgjë.

1. Nga fundi i viteve 60 në Theth u ndërta godina më e madhe dhe më e bukur. Ishte një dhuratë, do të thosha një luks i vërtetë, që shoqëria bëri për alpinistët. Ne kishim për disa vite shtëpinë tonë në Theth. Atë ne nuk mund ta shfrytëzonim gjithë vitin. U bë mirë që e morën Bashkimet Profesionale dhe e përdorën për kampin e punëtorëve.

2. Është e vërtetë që ne nuk kishim alpinistë profesionistë, por po kaq e vërtetë është edhe fakti që ishin gjysëm profesionistë. Secili nga ata (them kështu se natyra e punës sime nuk më lejonte të shfrytëzoja këtë të drejtë me ligj) punonte vetëm 5 orë në ditë, tre orët e tjera paguhej nga shteti për të bërë stërvitje. Sic e përmenda më sipër këta ishin me qindra.

3. Kjo "faturë" fryhej gjithnjë e më shumë se alpinistët e të gjithë ekipeve pajiseshin jo vetëm me materialin teknik, por edhe me veshmbathjen për të bërë stërvitje dhe për aktivitetin.

4. Është e vërtetë që e nisëm me litarë lini dhe me veshmbathje ushtarake, por si kaluan disa vite shoqëria na pajisi me litarë importi të dimensioneve të ndryshme, celësa gjoksi, cadra cilësorë të lartësive të mëdha, dyshekë alpin, këpucë sportive Adidas, ski, radjo transmentuese për distance të vogël, e tjera e tjera.

5. Ishte i vogël numri i vajtjeve të alpinistëve tanë për ngjitje jashtë shtetit dhe pritja e alpinistëve të huaj (që atë periudhë kohore priteshin si princa, sa edhe ata habiteshin), por shpenzimet ishin të konsiderueshme.

6. Alpinistët dhe ciklistët (vec futbollistëve të kategorisë së parë) kishin dietën më të madhe, në rast se nuk gabohem 280 lekë në ditë.

7. Alpinistët e ekipeve të të rriturve pranë klubeve sportivë të fuqishëm përfitonin edhe ushqimin e drekës gjatë vitit.

8. Si mësuan fjalën sherp (hamall në mal) arritën të thyenin mentalitetin se alpinisti gjithnjë duhet të jetë i ngarkuar. Na u dha e drejta që nga zona e banuar deri ku ngrihej kapingu të merrnim kafshë me para, etj.

Në rritjen e personalitetit të alpinistit si individ dhe si sport ndikuan dhe dekoratat e medaljet që Presidium i Kuvendit Popullor akordoi për alpinistët më cilësorë.

Tregues i këtij kujdesi është edhe nisja nga reparti ushtarak i pesë helikopterëve për të gjetur dhe për të transportuar alpinistët e lënduar.

Nuk do të harrojë asnjëherë mikëpritjen dhe kujdesin e malësorëve. Personalisht falenderoj për herë të fundit me shkrim, në mënyrë të vecantë, Lulash Markun dhe familjen e tij në Theth, Gjekën, të parin e shtëpisë të kroni i fshatit, Rrok Lleshin, Mirashin dhe Prelën, Kolë Nikën në Bogë, Luigj Pjeshkën, Xha Bajramin në Zallin e Motinës e shumë e shumë të tjerë.

Të njëjtin respekt ruaj për kufitarët e zonës së Thethit dhe të Valbonës. Si mund ta harrojmë komandat Muharrem Lleshin. Ai ishte nga Cërriku. U emërua në këtë detyrë. U martua, lindi fëmijë që kur u rritën duhet që cdo ditë për të vajtur dhe kthyer nga shkolla të bënin dy orë rrugë (edhe në dimër). Muharremin e "harruan" në Theth edhe kur fëmijet e tij mbaruan shkollën 8-vjecare. Do të vazhdoja me shprehjen e mirënjohjes për kujdestarin e postës, por fatkeqësisht nuk më kujtohet emri.

Të gjitha këto nuk do të thotë se gjithcka shkonte vaj. Kishtë raste që në nisjen nga Shkodra e bënim 4-5 orë me vonesë se furrat nuk na jepnin bukë pa marrë një shkresë këtu apo atje. (Alpinistët e Tiranës furnizoheshin në qytetin e tyre).

Më sipër u përmenda për godinën tonë që e morën Bashkimet Profesionale. Por c'ndodhi me ne. Po marrë nga arkivi një pasazh të një shkrimi tim:

“...Nga larg duket “Qendra Turistike” - godina më e madhe e këtij fshati, që për vite me radhë ishte e alpinistëve. Sapo u futëm në territorin e “Qendrës turistike”, bashkë me një kolegun tim, m’u afrua një burrë:

- Alpinistë jeni ju?

- Po.

- Na falni atëhere, është e ndaluar të futeni këtu!

Kërkesa jonë nuk u muar parasysh edhe kur i thamë se ne nuk nuk do të hyjmë në godinë, por do të bëjmë një fotografi dhe do të sodisim malet. Vendosa të luaj “kartën” e fundit:

- Nga këto anë je, mor shok?

- Po.

- A ka ba vaki në Dukagjin të vijë miku dhe të mos e lejojnë të futet tek oborri i shtëpisë?..

Më pa drejt në sy, mbeti pak kohë pa folur dhe m’u përgjigj:

- Kjo nuk është shtëpia ime, mor shok. Më ka thanë drejtor Idriz Xhura që miqtë të futen në territorin e “Qendrës Turistike”, por alpinistët në asnjë mënyrë!

Kur mori vesh se nuk kisha vajtur për ngjitje alpinistike, por me shërbim si gazetar, i qeshi fytyra dhe më tha:

- Mirë se vini!

Pas kësaj bisede të “ngrohtë”, nuk hymë brenda, por pamë se në vendin ku alpinistët ngrinin çadrat alpine po ndërtoheshin disa baraka?!

- E çuditshme, më tha bashkudhëtari, jo vetëm që u nxorrën nga “shtëpia”, por nuk u lënë as ta shihni atë”.

Në këtë vazhdë pos jell edhe një pjesë nga dokumenti i fundit i “arkivit”, shkruar nga Zenel Kokomiri:

• Është sporti më i vështirë, më i rrezikshëm dhe, sipas mendimit të atyre që e aplikojnë, është sporti më i bukur. Por duhet të kihet parasysh, që këto vështirësi të mos u krijohen atyre në mënyrë artificiale. Edhe sukseset e këtyre alpinistëve janë të niveleve të mira si edhe tek disa sporte të tjerë. Por pak dihet për rezultatet e tyre. Nuk është parë asnjë gazetar sportiv mbi 2000 metra lartësi, si edhe nga TV-ja. Ndoshta mund të bëhet më tepër.

• Alpinisti është sportist, atij nuk mund t’i thuhet kur të mbarojë aktiviteti në malin e Boshit: “je i lirë, veprimtaria mbaroi”. Ju kujtojmë se sportistët e tjerë dërgohen në vendin e ndeshjes me kujdesin më të madh, ndërsa alpinistët mund ta konsiderojnë eveniment, në qoftë se

gjejnë një vend në karrocerinë e ndonjë kamioni në mal (ndoshta në të njëjtën kohë që autobusët e klubeve sportive mund të jenë duke cuar sportistët nëpër plazhe ku vendet e para i zënë familjarët).

• Alpinizmi është sport i vështirë. Në çdo çast ka rrezik. Ndihma mjekësore këtu ka domosdoshmërinë e vet, dhe jo të jetë spontane, sipas dëshirës të ndonjë mjeku të pasionuar. Ju kujtojmë se në një ndeshje volejbolli apo basketbolli, në pallatin e sportit “Partizani”, ka personel mjekësor (6 deri 7 vetë), ndoshta më tepër se personeli mjekësor që bën një operacion në zemër.

• Në ILKF “Vojo Kushi” nuk ka asnjë leksion ose praktikë për sportin e alpinizmit, siç ka, për shembull, program të rregullt për skitë ose notin, pavarësisht nga specialiteti që ka studenti.

- Në këtë sport, sa të bukur aq dhe të vështirë për ta ushtruar, kanë marrë pjesë femra?

- Po. Shumë vajza studente vinin në zboret dimërore në malin e “Dajtit” dhe e përballonin me sukses. Disa prej tyre vinin për të kaluar këndshëm pushimet midis dy simestrave. E vërteta është se me gjithë propagandën që u bë ato vite për të ardhur sa më shumë femra në alpinizëm, rezultati ishte i vogël. Ato që e vazhduan rregullisht u bënë alpiniste të mira. Ndërmjet tyre kujtoj *Tefta Zguron*. Kishte një konstitucion fizik për t’u patur zili. Ajo u bë alpiniste cilësore. Realizoi shumë ngjitje shkëmbore edhe në Gjermaninë Lindore, si pjesëtare e ekipit tonë që shkoi atje. Me pasion vazhduan të aktivizoheshin në ngjitjet verore dhe dimërore shumë vajza, si *Xhuliana Bakrina*, *Mira Hysenaj*, *Pranvera Verzivolli* dhe *Roza Gjergji*. Roza erdhi tek ne nga Elbasani si ndihmës mjekë dhe më vonë si studente e fakultetit të mjekësisë. Më kujtohet se ishte e fortë fizikisht dhe në shoqërinë tonë në mal e ngacmonim të këpuste ndonjë të sharë “vendce”. Kur thoshte ndonjë nga ato dhe ishte edhe im vëlla pjesëmarrës, ndonjë hidhej dhe i thoshte se Stefani është vëllai i komandatit dhe do t’i themi atij që shave edhe atë. Përgjigjja e saj ishte gati - “unë shava vetëm për pjesën e Stefanit...”.

- Po për alpinizmin mbas vitit 1992 çfarë mund të na thoni?

- Përse ma bëni këtë pyetje, keni informacion që ai ekziston? Fakeqësisht, për mua dhe brezin tim kanë mbetur vetëm kujtimet e lëvizjes alpinistike. Të jeni të bindur se ky përfundim nuk është pjellë e nostalgjisë sonë.

- Masmmedia ka dhënë informacion që tek ne zhvillohen edhe kampionate të kacavarjes artificiale.

- Kam bindjen se kacavarja artificiale nuk është sinonim i alpinizmit, i alpinizmit klasik, i ngjitjes së malit. Është e vërtetë që sot zhvillohen edhe veprimtari botërore në salla të mbyllura. Po kaq e vërtetë është se edhe kampionët në këto veprimtari nuk ushtrojnë alpinizmin e vërtetë; me fjalë të tjera, nuk sulmojnë majat e larta të rruzullit tokësor, paretet shkëmborë të vështirësisë shumë të lartë etj. Kacavarjet artificiale janë një shpikje e mendjes njerëzore për ta larguar disa orë njeriun e ditëve tona nga rutina dhe stresi i jetës së përditshme. Po ju tregoj një kuriozitet. Kryebashkiaku i sotëm i Romës e fillon ditën e punës duke u përpjekur të ngjitet në poligonin e ngjitjeve artificiale. Ai deklaroi publikisht se pas kësaj e ndjen veten mirë. Mos vallë kjo do të thotë se ai është alpinist? “Ruajna Zot mend e kresë” thonë malësorët. Sigurisht që edhe unë i shoh me vëmendje këto lloj ngjitjesh, që edhe vetë emërtimi e thotë që janë artificiale.

Gëzohem që edhe në Tiranë është ndërtuar një poligon i tillë. Dyshoj për rivalitetin midis pjesëmarrësve në veprimtaritë që organizon federata, për faktin se vështirë të ketë poligone të tillë në rrethet nga vijnë konkurentët.

- Vec këtyre bëhen edhe ngjitje kombëtare.

- Para tre vjetësh, në muajin korrik, Aci më tha të shkonim në Theth. E pranova me kënaqësi, pa më thënë që do të isha pjesëmarrës i një veprimtarie të shoqatës së tyre - “Dajti”. Midis atyre pa tjetër ishte edhe Xhim Begeja. Në muajin gusht rastësisht takova përsëri Xhimin. Midis të tjerave më tha: Dje u kthyem nga Thethi, nga ngjitjet verore kombëtare. I bëra vetëm dy pyetje: a)Ku i ngritët cadrat dhe b)Sa ditë vazhdoi aktiviteti? Përgjigjet e tij ishin: Tek kampi. Kishim vetëm 3 ditë në dispozicion. Informacioni që mora nga ai dëshmon se ishte vetëm një takim i një grupi njerëzish, që i quajnë alpinistë. Më tha dhe një hollësi - bëjmë ngjitje te katarakti. Kurrë alpinistët nuk kanë bërë ngjitje te katarakti, duke përjashtuar ato që bëheshin në zborë për qëllim mësimor. Në rast se gjendja vazhdon të jetë e njëjtë, më vjen shumë keq. Qoftë për ata që shkojnë, qoftë për “paratë e shtetit”, më saktë të taksapaguesve.

- Si janë marrëdhëniet tuaja me federatën.

- Në fillim po hap një parantezë. Më 1990 u dha orientimi që kryetari i federatës së alpinizmit nuk do të jetë më onorifik. Atë vit më zgjodhën mua. Sipas orientimit të dhënë, në majin e vitit 1994 u bënë zgjedhjet e reja. Cuditërisht, vec meje dhe sekretarit A.T., kishin ardhur 5 vetë, të gjithë trajnerë. Më kujtohen: Sh.T. Z.K, M.L, R.L dhe një tjetër. Mbjakta raportin, që për sa i takon veprimtarive ishte i mjerueshëm. Pa tjetër që fola edhe për vajtjet në Rumani, ardhjen e alpinistëve italianë, që po përktheja librin autobiografik të Mesnerit etj. E kuptova që më ndiqnin pa interes. Diskutime nuk pati. Sipas rendit të ditës kaluam në zgjedhjet. Nga pesë që ishim tre propozuan: Sh.T. tha emrin e një biznesmeni të qytetit të tij që do të ndihmonte shumë financiarisht alpinizmin, ndërsa M.L. propozoi një alpinist (Z.J.) që punonte në doganën e Rinasit. Pas votimit të fshehtë rezultoi se të gjithë ne i kishim dhënë votat për doganierin, ndërsa biznesmeni i atij qyteti verilindor nuk ishte marrë asnjë vot, as nga ai që e propozoi. Sic e shihni, pa u vendosur tamam ekonomia e tregut, ne me intuitë e kishim kuptuar që doganierët do të pasuroheshin...E mira e asaj mbledhje ishte se nuk vazhdoi as 20 minuta.

Marrëdhëniet e mia me federatën e këtyre 16 viteve të fundit permbliidhen në termin *shpërfillje*, që sipas Fjalorit të Gjuhës së sotme Shqipe (botim i vitit 1980. Shënimi ynë - K.G.) do të thotë: *“Mosvlerësim ose nënvlerësim për dikë a për dicka, qëndrim mospërfillës ndaj dikujt a ndaj dickaje, mungesë vëmendjeje, mospërfillje”*.

Këtë qëndrim nuk e lëkundim as edhe një telefonatë në nëntorin e vitit 2006. Me kulturë m’u prezantua sekretari i federatës. Më tha që pas dy ditësh do të festohet 50-vjetori i lindjes së alpinizmit në Shqipëri. I thash. “Juve personalisht u falenderoj që më morët në telefon. Të lutem, i thuaj atij që të ka dhënë emrin tim për të më lajmëruar se unë nuk vij. 50-vjetori ishte në korrik. Unë vajta në Theth, qëndrova disa minuta edhe tek pllaka për këtë eveniment kombëtar, e vendosur tek muri i shkollës. M’u bë zemra mal që edhe në vitin e mbrapshtë 1997 thethianët, që bënë gjithë ato zullume, nuk e kishin cënuar”. Jo shumë kohë më parë, tërë mllef, Andon Tapia më tregoi për atë “festë”, më tregoi që edhe “babanë” e alpinizmit - Minella Kapon, nuk e vunë në presidium. Nuk ia vlen të flasësh për ata. Turp e faqja e zezë!

E ndjej që nga përgjigjja e pyetjes tuaj jam nën ndikimin e emocioneve negative. Si rrjedhojë, shtoj se kam marrë vesh që kanë shpërndarë edhe tituj Mjeshtër i Merituar. Theksoj se asnjë nga këta përfitues abuzivë nuk meriton as kategorinë e parë sportive. Nuk më besoni? Hapni “arkivin” dhe “hipotekën”. Nuk më shkon në mendje të futem në jetën e tyre private, por si alpinistë ata janë vetëm legenë që pranojnë atë që nuk e meritojnë, nuk u takon. Më kanë ardhur fjalë që mua më ka mbetur hatri se “nuk më kanë propozuar të fitoja “pension të vecantë”. Debilët nuk e kuptojnë se më kanë bërë nderin më të madh. Unë jam Profesor doktor dhe do të ishte fyerja më e madhe publike në rast se do të gëzoja një pension të tillë. Alpinizmi ishte, është dhe do të jetë për mua vetëm pasion. BOLL!.

Kam një propozim. Vazhdim i bisedës sonë të jenë “arkivi” dhe “hipoteka” jonë. Faqet e fundit të librit i mbushim me vazhdimin e kësaj bisede. Me siguri që jeni për një kafe!



1936

Gazeta : “SPORTI SHQIPTAR”.

Drejtor : Anton Mazreku

Konferenca mbi turizmin në Shqipëri

Të dielën në ora 10 e 30, në kinema “Gloria”, zoti Petraq Pepo, profesor në liceun e Korçës mbajti një konferencë interesante mbi turizmin në Shqipëri.

...Ai tregoi rëndësinë e turizmit jo vetëm në pikëpamje

ekonomike, por kryesisht kombëtare, historike, qytetëronjëse, shëndetësore dhe sportive.

“Konferencierit të shquar dhe kryetarit të K.T.A.M-it, zotit Dr. Mihal Sherko, gazeta jonë i dërgon përgëzimet më të përzemërta”.

“...është mëkat të mbetet i pavizituar ky vend an’e kand, jo vetëm prej turistëve të huaj, por kryesisht prej neve, vetë shqiptarëve që, si turistë, në vendin tonë do të dijmë ta njohim e t’a çmojmë më mirë e më bukur njëri-tjetrin...”.

Nr. 6. e shtundë, 11 kallnduer

Ekskursion alpinizmi në formë ndeshje

“Sot (12. I. 1936) filloi prova e parë e ekskursioneve në formë alpinizmi të zhvilluara si ndeshje ndërmjet grupit të shoqërisë jashtëshkollore “Bashkimi Elbasgues” dhe shkollës normale. Numri i ekskursionistëve nxënës ishte 67. Kjo garë u ba nga qëndra e qytetit deri në majë të Krastës, vetëm të shkuem rruga ka qenë 1.200 metra shesh dhe 300 metra përpjetsinë. I pari doli Gani Çela me 10’ e 30”.

Nr. 6, e shtundë, 11 kallnduer

“Kështu do të jemi të bindur se do të përgatitet një rini e shëndoshë dhe e disiplinueme për një qëllim : GATI PËR ATDHE E PËR MBRET.”

Nr. 8, 25 kallnduer

Prova e dytë e ekskursionit në formë gare : Elbasan-Pertresh

Kjo ndeshje ishte caktue m’u zhvillue që më datën 19. I, por nga koha e keqe u shtye për ma vonë.

Dje më datën 29. I, ora 10 e 25 u ba nisja në Urën e Zaranikës. Ishin regjistruar 85 konkurentë, ndër të cilët u paraqitën vetëm 76. Startin e dha instruktori Alush Leshanaku, i cili edhe i ndoqi vetë në kambë, për me u dhanë ndihmat e rastit”.

Nr. 10, 8 fruer

Turizmi

- Flet për dobinë e turizmit dhe llojet e tij në botë Avni Zajmi-

“...Dihet fare mirë se edhe alpinizmi është një degë e turizmit bashkë me lundrimin nëpër detna...Turizmi në dimër nga pikëpamja klasifikimi është shumë ma i mirë se në stinën e verës, sepse natyra asht e mbulueme me borë, mund të bahet ski dhe të tjera lojëra sporti...”

“...Shqiptarët nuk e njohin vendin e vet, kurse të huajt e njohin shumë ma mirë se sa ne...”

...Si do që të jetë, turizmi në Shqipëri ka pasë fillue qysh me kohë prej gjurmësisë shqiptare (boy-scout).

Nr. 17, 28 mars

Turizmi

“Në Shqypni e drejta asht se turizmi ka fillue të parën herë në vitin 1920, prej ish organizatës së gjurmësisë shqiptare. Kjo organizatë, me qenë se ishte pranue zyrtarisht prej shtetit, ka pasë fillue aktivitetin e vet tue ba vit për vit udhëtime për të njoftë sa ma mirë atdheun tonë. Organizata në fjalë ka pasë parim me mësue fëmijët që të marrin pjesë praktikisht në jetë. Për këtë shkak turizma ka qenë një faktor i madh për të shijue bukurinë e natyrës. Gjurrasit shqiptarë qysh atëherë, për me pa s’afërmi malet dhe qytetet tona, shpesh herë shkojshin në kambë nëpër ato vende tue ba kamping...”

“...Djemnia e jonë krenohet se kanë pa Vjenën, Parisin ose ndonjë kryeqytet të fqinjës sonë, por mjerisht na mungon në zemrën e djelmnisë sonë vullneti t’udhëtojë për të pa Korçën plakë ose Tomorrin madhështuer...”

“Në vitin 1930 Enti Kombëtar i Djelmnisë Shqiptare dërgoi në Itali ma se 150 djelm shqiptarë për me pa malet e Alpeve dhe ndënjën ndër ato vende ma se një muaj. Por ajo organizatë nuk mendoi kurrë me organizue një shëtitje për të njoftë Shqipninë. Deri kur vendi ynë do t’i ngeli gjithnjë në harresë?”

Nr. 20, 16 prill

Maja e Ndreut
- Reportazh për bjeshkët e Rrjollit -

“...Një pamje e hapët na shtrohet para. Në të tana anët të përland syni Bjeshkët e Dukagjinit prej Rrshellit e deri në Jezerë; lugu i Bogës me male për rreth që nuk mrrijnë me i mlue pamjen Bjeshkëve të Vermoshit : Veleçiku, liqeni, dedi, viset jugosllave, etj”.

“...Mjerisht te na nuk i asht dhanë randsija sa duhet këtij sporti kaq të nevojshëm : Turizmi të fisnikon shpirtin, të ngjallë ndjesi të reja, të mbushë me guxim e të mson me përballue nevojët e ndryshme që jeta të paraqet”.

Rrok Zojzi, Numri 25, 21 maj

1937

“Vrapimi podistik prej oborrit të gjymnazit e deri në Rozafat u fitue prej Sami Barbullushit”

...Vrapimi podistik u ba më 24 dhjetuer (1936) në mes të nxanësve të gjymnazit për kampionatin e klasave...Shumë të interesuar drejtori i gjymnazit Anton Dede dhe profesorët. Flisnin me simpati për profesorin aktiv Alush Leshanaku.

Megjithëse dyqanet mbas dreke ishin të hapuna, publiku dëftoj një interes të madh për këtë garë kaq të bukur, se i tërhiqte vrejten ngritja e flamurit në majë të kalasë. Që në orën 1 e gysmë tregtarët e shegertët kishin dalë mbas dugajesh me pa vrapuesit dhe me i inkurrajtue ata.

Në orën e 2 e 30 minuta u nisën 50 e ca djelm për në kalanë e Rozafës. Qysh në Parucë u ndanë në 3 grupe...Afër kalasë u shpërndanë djelmët malit si dhi të egra...

Sapo hyri në derë të kalasë, F. Bushati i lodhun e i këputun nga përpjetësina, merr flamurin për ta çue në maj por s’mundet; këmbët s’e mbajnë dhe bie...Sami Barbullushi, kur mbërrin tek dera, shikon shokun e shtrirë, i merr flamurin dhe vazhdon me mundime të mëdhaja.

E përshkoi distancën në 13 minuta e 10 sekonda.

Nr. 56, 2 kallnuer

**Stafeta e madhe
rreth Tiranës për kupën e N.T.Mbretnore**

- Asiston princi Tati -

...Gazeta jonë e ka përshkue me të gjitha hollësitë dhe fazat e ndryshme udhëtimit triumfant të Flakës së shenjt Olimpikë që u krye me rastin e Olimpiadës së Berlinit...I tërhequn prej këtij shembulli fantastik, gjimnazi i shtetit mori guximin të marrë përsipër organizimin e kryemjen e një stafete të një formati me të vërtetë të madh...Duhej kurorëzuar me sukses një stafetë prej 14,4 kilometra rreth Tiranës.

...Porsa mori vesh një iniciativë të tillë, princi Tati, vetë sportist aktiv, denjoi me vu një kupë shumë të çmueshme për grupin triumfues në vrapimin e stafetës rreth kryeqytetit...

Princi dha startin, pasi profesorët Gaqo Goga dhe Adem Karapici i paraqitën forcën princit...

Nisja u ba më 11 e 15 minuta, para bashkisë...Rreth orës 12 u shfaq në krye të bulevardit "Zog I" vrapuesi ngadhnjyes, nxënësi i klasës V Fiqiri Tartari.

Rrethi i Tiranës është 14,4 kilometra. Çdo atlet ishte i detyruar me vrapu 400 metra. Pra, duheshin 36 vrapues për çdo grup. Ishin 6 grupe (klasa), gjithsej 200 pjesëmrrës...".

Anton Mazreku, Nr. 56, 2 kallnduer

***Ekskursioni alpinistik**
për në majë të Taraboshit u fitue
*nga Faik Boriçi, i cili ngriti flamurin në majë për 30'***

...Më 11 prill, ora 9 e 30, 62 nxanës u lëshun nga Ura e Bunës drejt majës së Galishit për vrapimin e ekskursionit për kampionatin e klasave të gjymnazit shtetruer. Rrugës i ndoqi ata kambë për kambë profesori i palodhun Zotni Leshanaku.

...Një mosmarrëveshje maje shkaktoi ngritjen e flamurit nga

*Eshhtë hera e parë që del termi alpinizëm.(Shënimi ynë : Kozma Grillo.)

Faik Bronxi dhe humbjes së vendit të parë të atletit të palodhur Lefter Kasneci.

...Asht interesante se konkuruesit kishin fillue provat tash një muaj, tue studjue rrugën dhe tue përmirësue kohën e ngjitjes deri në 38 minuta. Dhe prej 62 konkurentëve nuk mbeti asnjë mbrapa 53 minutave. Meriton të shënohet mbërritja e freskët e Kasnecit, thujse nuk ishte lodhun fare.

Nr. 72. 17 prill

• Në muajin gusht vizituen Shkodrën 155 turista jugosllavë, 110 francezë, 59 gjermanë, 57 çekoslovakë, 45 anglezë, 39 italianë, 22 amerikanë, 1 rus dhe 1 zviceran.

Nr. 92, 11 shtator

*Kampionati i përgjithshëm ndërmjet klasave të gjymnazit
shtetruer Shkodër për vitin shkollor 1937-1938*

Programi i garave :

- Kampionati i mirësjelljes sportive.
- “ i atletikës së lehtë.
- “ i konkursit gjimnastikuer.
- “ i futbollit.
- “ i basketbollit.
- “ i hendbollit.
- “ i çiklizmit.
- “ i stafetave nëpër qytet.
- “ i alpinizmit.
- “ i volejbollit.
- “ i notit dhe i tërheqjes së litarit.

Vrejtisi, 18 dhjetor

1938

Stina e skive

...Skija ndër ne nuk është ndjekur me atë pasion sikurse ndiqen lojërat e tjera sportive...Skija është sport dimëror, ke të bësh me dëborën e maleve...

Vendi ynë ka male dhe pllaja të bukura..., rinia jonë mund të ushtrohet fare mirë në këtë sport.

Sidomos Korça është një vend në të cilin sporti i skisë mund të shënojë përparime të mëdha. Këtu ky sport ka shumë dashamirës, por mungojnë veglat dhe mjetet e duhura.

Rako G. Saro, Nr. 106, 8 kallnuer

...Edhe këtë vit u zhvillua kampionati sportiv ndërmjet klasave të gjymnazit shtetëror të Shkodrës për vitin shkollor 1937-1938.

...Ku një vënd të veçantë kishte edhe stafeta rreth qytetit si dhe ekskursioni në majën e Taraboshit.

Nr. 106, 8 kallnuer

Rëndësia e sporteve dimërore

(Ky shkrim është vënë në vendin e kryeartikullit. Një shkrim i gjatë për dobinë e ushtrimit të sporteve dimërore në rrafshin biologjik, kulturor dhe social-ekonomik. Autori e fokuson mendimin tek skitë dhe lë pa përmendur qoftë si terma ekskursionet dhe ngjitjet në male. (Shënimi ynë : Kozma Grillo).

Vetëm në fund të artikullit, autori shkruan: "Në arritjen e qëllimit (skitë) mund të shërbejnë fare bukur degët alpinistike të shoqërive jashtëshkolllore, Enti Kombëtar i Turizmit dhe Klubi Turistik Automobilistik mbretëror.

Luigj Shala, Nr. 109, 29 kallnuer

“Në palcë të dimrit, nxënësit në Maranaj”

“...Profesori i edukatës fizike, i simpatizuar prej nxënësve, duke përfituar prej pushimeve të bajramit, organizoi një shëtitje për Maranaj, mali verior i Shkodrës që është 1.700 m i naltë.

...Ai u shoqërua nga 45 nxënës, ndër ta bëri pjesë edhe profesori i mirënjohur zviceran Goujon.

U nisën nga shkolla në orën 5 të mëngjesit...Në orën 12 mbërritën në majën e dëshiruar. Të gjithë u gëzuem se patëm mbaruar detyrën...Neve na pret shëtitja në Cukal – 2.000 metra mbi nivelin e detit.

(Në fund të shkrimit është vënë lista e emrave që mbërritën në majë, ku I njëzetëdyti është Minella Kapo (Shënimi ynë: Kozma Grillo).

Rustem Buzo, Nr. 112, 18 fruer

Libri për sportin dimnuer të skive

Këto ditë del në qarkullim libri aq i dobishëm për sportin dimnuer të skive, i hartuem me shumë kujdes e kompetencë prej zotit Luigj Shala, sekretar i Federatës sonë “Vllaznia shqiptare”.

Libri është i pajisur me fotografi të viseve tona ma piktoreske dhe me 30 skica shpjeguese për të kryemit e ushtrimeve të ndryshme.

Nr. 114, 5 mars

*Alpinizëm**

Shëtitje për në Cukal

Malet arbërorë na thëresin

“...Profesori i palodhshëm i gjymnazit të Shkodrës zoti Leshanaku, pat lajmëruar se shëtitja e gjatë, më se 30 kilometra për arritjen në majë të malit, duhej organizuar.

Duke përfituar nga pushimet shkollore, ditët e bukura të prillit, 20 nxënës u regjistruan për të marrë lejen e drejtorit.

* Për herë të parë termi alpinizëm vihet si ochielo. (Shënimi ynë : Kozma Grillo).

Në orën 5 të mëngjesit të datës 15 prill u nisëm...Kaluam fushën e Shtoit. Në orën 4 mbërritëm në Vukaj, ku kaluam natën te bamirësi Mhill Pjetri.

Me t'u gdhirë u nisëm. Binte dëborë, por pas pak pushoi. Si kaluam shumë vështirësi, më në fund mbërritëm në majë ku përsëritëm thirrjen : "Ju thërresin malet arbërorë për t'iu thithur ajrin e pastër e për t'iu pirë ujin e kulluar të burimeve të ftohta, për të shijuar jetën, për të fituar shëndetin, ato që nuk fitohen kurrë në qytete!".

Rustem Buzo, Nr. 128, 9 korrik

Në shërbim të turizmit malor. Shëtitje nëpër male

-Një javë mbi majat e Nemërçkës-

"...Siç dihet, në vëndin tonë ka munguar në mënyrë sistematike praktikimi i ekskursioneve nëpër maja malesh të lartë.


Pak vjet më parë, një grup i formuar nga djemtë e këtij qyteti (Përmeti) shkoi në majën e Papingut nga ku u kthye me përshtypje të veçanta. Po kjo punë u përsërit edhe vjet prej një grupi tjetër nga gjiri i shoqërisë jashtëshkolllore të këtij qyteti, i cili caktoi të shkonte nga një rrugë tjetër në majë të malit, por nuk e arriti qëllimin, se rruga nuk ishte adapte për t'u shkelur nga këmba e njeriut.

Për arsye se nuk u arrit qëllimi, grupi mendoj që këtë vit të vinte në majë të Papingut nga një rrugë më e lehtë. Grupi u nis më 18 korrik, i kryesuar nga zoti Pano Vasili.

Grupi mori drejtimin nga ana Magallarit...Mbërritën në majë. Kurzbritën qëndruan disa ditë në qafë.

Me nxënësit kishte dhe disa të moshuar që e duan natyrën.

Nr. 133, 13 gusht



RROK SHYTI, alpinist

1956

Në majën e Korabit

Të ngjitemi në majën më të lartë të Atdheut! Kjo ishte dëshira e të gjithëve.

Për të gjithë anëtarët e ekipit mali i Korabit sidomos drejtimi dhe rruga për t'iu ngjitur majës ishin fare të panjohura. Një ngjitje e tillë ishte e vështirë edhe nga fakti se bëhej në stinën e dimrit ku gjendja atmosferike ndryshon shpesh. Dëbora e dëndur binte vazhdimisht dhe rruga nga Peshkopia për në fshatin Radomirë ishte e zënë me një shtresë të trashë dëbore.

Një tjetër vështirësi jo më e vogël se të tjerat ishte edhe mendimi i disa shokëve të cilët e paraqitnin ngjitjen në majën e Korabit si të pamundur. Ata shpreheshin në formë të prerë : "Atje ka 8 metra dëborë!" ose "Korabi nuk luan nga vendi pra mund të ngjitemi edhe në verë!" dhe shumë fjalë të tilla. Jo më pak e vështirë ishte edhe përbërja heterogjene e ekipit. Njëri me tjetrin pothuajse nuk njiheshim. Përgatitja teknike për këtë aksion të vështirë ishte e ulët dhe në përgjithësi mungonte eksperiencia.

Por duke lënë mënjanë vështirësitë ekipi ishte i vendosur që ta kryente me sukses këtë aksion të rëndësishëm. Atij nuk i mungonte dëshira e vullneti dhe ishte i bindur në eksperiencën sovjetike. Mbi këto baza ekipi u përgatit dhe u nis.

Mbas përgatitjeve të para (kontrolli mjekësor personal përdorimi i litarëve mënyrat e ecjes etj.) filloi ngjitja. Rruga nga Peshkopia deri në një lagje të fshatit Radomirë ishte e mbushur me dëborë. Ekipit iu desh ta përshkojë këtë distancë për 13 orë (dy ditë). Një pritje e përzemërtë iu bë ekipit nga kufitarët dhe fshatarët.

21 mars. Ora 3 e mëngjesit. Filloi ngjitja. Ekipi i përbërë nga 15 vetë u nda në katër grupe me nga një përgjegjës. Koha është e keqe - dëborë mjegull e madhe erë e ftohtë. Njëra pas tjetrës skuadrat çajnë dëborën e thellë dhe të butë e cila të lodh mjaft. Kodrat kalohen me radhë dhe ngjitja vazhdon gjithnjë e më lart në drejtimin jug-lindje.

Megjithëse i sëmurë Shaban Zeneli arrin mbi lartësinë 2000 metra por detyrohet nga shokët që të kthehet.

Ecja vazhdon... Ora 8 e mëngjesit pastaj 9 por asgjë nuk dallohet. Koha sa vjen e keqësohet. Megjithatë të gjithë shpresojmë se gjëndja atmosferike do të përmirësohet dhe se Korabi do të na presë me kohë të bukur. Por më kot. Dallohet vetëm dëbora mjegulla dhe majat e shkëmbinjve. Për një çast orientohemi dhe nuk i mbetemi besnik itinerarit të caktuar. Me ndihmën dhe bindjen e kufitarit Asllan Bici filluam të rregullojmë drejtimin për të dalë në faqe të malit dhe pastaj në drejtim të lindjes dhe të veriut për të arritur në majë. Por në vend të qafës nga e majta na del përpara një rrëpirë e thepisur e mbuluar me shtresë akulli. Të gjithë lidhemi me litar tre nga tre. Rrugën e çan Behluli. Në këto çaste të vështira secilin e përshkojnë shumë mendime. Dhe kishim të drejtë. Ku përfundonte ajo rrëpirë? Poshtë nën 5 metra nuk dallohej asgjë. Këtë situatë të vështirë e kuptoi edhe Behluli dhe kërkoi të sigurohej duke përdorur kalimin e dyfishtë të litarit në kazmë në mënyrë që edhe në rast rrëshqitjeje ndalesa të bëhej më e lehtë.

Edhe kjo pengesë kaloi. U kalua një qafë dhe pas saj një tjetër por qafa e dëshiruar nuk duket. Aty ekipi vërtitet për një orë rresht me shpresë se koha do të përmirësohej në mënyrë që të gjenim orientimin e drejtë. Pritje e kotë. Orët kalojnë dhe koha vjen gjithnjë duke u keqësuar. Në pamundësi që të kalohet përpara u vendos që ekipi të kthehet! Dëshira e të gjithëve është që të vazhdohet ngjitja por në raste të tilla është më mirë që t'i lihet rrugë logjikës.

Jemi prap në vendin e nisjes. Nga çdo drejtim na rrethojnë mlalet dhe ndërmjet tyre më lartë nga të gjithë qëndron maja e Korabit. Mbas gjimnastikës së mëngjesit grupi fillon të përgatitet për të marrë rrugën e kthimit për në Peshkopi. Pa pritmas një nga shokët propozon që të provohet edhe një herë ngjitja. Mbas shumë diskutimesh propozimi pranohet nga të gjithë. Së bashku me tre kufitarë ekipi tani përbëhet nga 10 vetë mbasi të tjerët janë të sëmurë. Gjatë gjithë ditës vazhdojmë përgatitjet.

23 mars. Në orën 2 pas mesit të natës alpinistët janë gati për t'u nisur drejt majës. Të ndarë në tre grupe nis marshimi. Nata është e ftohtë ka mjegull dhe toka është e mbuluar nga dëbora e ngrirë. Ecim në gjurmët që hapëm dy ditë më parë të cilat na i zbusin vështirësitë e para të ngjitjes. Shumë shpejt arrijmë lartësinë 2000 metra. Retë janë posht nesh. Kjo na lejon të shijojmë bukurinë magjepse të kësaj

nate dimri me një qiell ku ndriçojnë yjet dhe hëna e plotë.

Agon. Majat fillojnë të zbardhen. Pak më vonë akullnajat skuqen nga rrezet e diellit dhe marrin një ngjyrë qelibari. Vështirësitë e rrugës nuk na pengojnë që të admirojmë këtë bukuri të rrallë madhështinë e Korabit i cili qëndron krenar mbi malet e tjerë. Jemi afër qafës. Pak më tutje shohim shtyllën që ishte vendosur dy ditë më parë për të na ndihmuar në itinerarin e ngjitjes. Të gjithë brohorasim për kufitarin që na kishte udhëhequr aq mirë.

Arrijmë në qafë. Qëndrojmë. Hamë mëngjesin dhe përgatitemi për të kaluar vështirësinë më të madhe - ngjitjen në majë. Pengesa e parë që duhet të kalojmë është një shkëmb i veshur me akull. Na u deshën 30 minuta për ta kaluar. Kalojmë nga një vështirësi në tjetrën. Ja dhe një shkëmb tjetër por ky është më shumë i thepisur dhe po ashtu i mbuluar me akull. Për të vendosur këmbët tani nuk mjafton gërmimi i akullit me këpucë por nevojitet edhe kazma dhe një punë delikate për të ruajtur ekuilibrin. Ngjitja sa vete e vështirësohet. Secili duhet të përqëndrojë vëmendjen në pozicionin e shokut në mbajtjen e litarit e të shkopit në vendosjen e këmbëve në vend të sigurt. Lodhja bën të sajën. Kalojnë dy orë... edhe gjysëm orë tjetër dhe më në fund arrijmë qëllimin. Ndodhemi në majën e vogël. Ky është një çast gëzimi për të gjithë por asnjeri nuk e çfaq mbasi duhet ngjitur akoma më lart; të kalohen edhe ato 150-200 metra që ndajnë këtë qafë nga maja më e lartë.

Duke ecur kurrizit të majës me ngadalë grupi afrohet... Ora 10 e 10. Ne ndodhemi në majë të Korabit 2.751 m. Jemi në majën e Korabit në pikën më të lartë të Atdheut tonë. Gëzimi ynë është i papërshkrueshëm. Përqafohemi brohorasim këndojmë....

Në këto aste gëzimi dhe kënaqësi të patreguar duke shikuar nga maja e Korabit madhështor bukuritë e truallit tonë secili nga ne mendon edhe për detyrat e reja që u dalin alpinistëve.

Minella Kapo 11 dhe 26 prill

Telegram nga alpinistët

“Theth. Më 18 korrik, buzë lumit të Thethit, u zhvillua ceremonia zyrtare e çeljes së kampit të parë alpinistik në vendin tonë. Përveç 18 alpinistëve, ishin të pranishëm mbi 100 fshatarë dhe nxënës.

Pas ceremonisë filloi mësimi teorik mbi alpinizmin. Në radhë të parë u fol për ecjet, përdorimin e kazmës, përdorimin e litarëve, sigurimin në ngjitje e zbritje shkëmbore, etj.

Dje, sipas programit, alpinistët kanë filluar udhëtimin për të vajtur në Shtegun e Dhënëve, Radohimë, Qafë Pejë e kthim. Gjatë këtij itinerari ata do të mësojnë ecjen në dëborë dhe në akull.

Alpinistët gëzojnë shëndet të plotë”.

Korresp. i “Sportit Popullor”, 25 korrik

*“O vite rinore,
O ditë plot gëzim,
Si ujrat pranverore ,
Ç’më ikët me rrëmbim”*

(Vargje nga një romancë e vjetër)



Me alpinistët -Në theth-

Jeta e rregullt në kamp filloi më 19 korrik. Që në mëngjes, grupi iu drejtua një bregoreje, ku instruktori i zborit, shoku Minella Kapo, dha mësimin e parë. Mbase mësojmë përdorimin e kazmës alpine, me vëmendje shikojmë mënyrën e ngjitjes dhe të zbritjes, mënyrën e kthimit gjatë ecjes dhe përdorimin e kazmës për sigurim në rast rrëshqitje.

Në ditën e dytë e të tretë mësuam mënyrat e ndryshme të lidhjes

së litarit, sigurimin me anë të litarit dhe kacavarrjen në shkëmb. Alpinistët e rinj, pothuajse të panjohur më parë me njëri-tjetrin, qysh në ditët e para po bëhen miq të vërtetë. Ata i besojnë jetën shoku-shokut dhe i lidh një qëllim i përbashkët : ngjitja në malet e shumtë të vendit tonë.

...23 korrik. Shpejt në mëngjes marrim rrugën për të bërë marshimin e parë dyditor. Drejtohem i për në Shtegun e Dhënëve. Rruga është ca e vështirë. Ndoshta këtë e ndjejmë se është ngjitja e parë që bëjmë. Të gjitha pajimet që kemi marrë na duken të rënda dhe të tepërta, madje edhe ushqimet. Asnjë nuk shkëputet nga grupi, megjithëse shiu vazhdon të bjerë. Altometri shënon 1.600 m. Arrijmë në Shtegun e Dhënëve. Ditën e parë vuajtëm shumë për shkak të mungesës së ujit. Aq e madhe ishte kjo vuajtje sa asnjëri nuk do t'i dhimbsej të shkëmbente të gjitha ushqimet që kishte në çantë vetëm me një pagur me ujë.

...Ora 16. Para nesh ndodhet maja e Markut dhe e Zagorës. Të dyja skuadrat nuk mund të punojnë, në të njëjtën kohë, në të njëjtin mal. Ishte kjo arsyeja që njëra skuadër i drejtohet Zagorës dhe tjetra Markut.

Arrijmë në grykën e Radomirës (2.000 m). Mbas shumë peripecish, të shkaktuara edhe nga mjegulla dhe era, hypim në majat e synuara. Megjithëse të lodhur, të gjithë jemi të gëzuar që ngjitja jonë e parë përfundoi me sukses. Të gjithë e kalojmë natën në Shpellën e Arushës, në lartësinë 1.500 m.

Në majën e Jezercës

...27 korrik. Nisemi për ngjitjen zyrtare në majën e Jezercës. Mbase kalojmë Kronin e Shtrazës, shpellën dhe Qafën e Pejës, çadrat i ngrejmë tek Gropat e Bukura.

Të nesërmen, në orën 2 të natës marrim rrugën në drejtim të Jezercës. Lindja e diellit na gjeti në qafën e sipërme të Valbonës për në Selimaj. Tani sigurohem i me litar. Fillojmë ngjitjen e majës së parë. Këtu nuk ka veçse shkëmb, ndërsa poshtë nesh shtrihet dëbora e përhershme. Mbase zbresim mjën e parë, fillojmë ngjitjen e majës së Pabllugës (rrtëh 2.400 m). Këtu terreni vështirësohet. Për të bërë një lëvizje të këmbës ose të dorës kalojmë minuta të tëra. E ngjitura më e vogël të jep mundësi të shkosh përpara vetëm disa centimetra. Në orën 9 ngjitemi në majën e Pabllugës. Fillon zbritja që është etapa më e vështirë e itinerarit tonë. Ne jemi të parët që kemi hipur dhe zbritur nga kjo majë.

...Më në fund, jemi në rrëzë të majës së Jezercës. Vazhdojmë kacavarrjen e rreth 200 metrave të fundit. Altometri shënon 2.674 m. Jemi në majën e këtij mali të lartë, nga ku shohim Alpet tona, ndërsa më tutje, në jug-lindje shohim majën e Korabit. Nuk gjejmë dot fjalët për të shprehur gëzimin dhe kënaqësinë e papërshekrueshme. Dhe kishim të drejtë të gëzoheshim : ne hapëm një rrugë të re, mbërritëm të gjithë në majë dhe nuk pësuam as gërvishtjen më të vogël.

Si mbaruam edhe pjesën e fundit të programit, më 30 korrik iu nënështruam provimit për të fituar titullin ; "Instruktor i alpinizmit".

Kozma Grillo, 8 gusht

"Turisti i Ri"

Kështu titullohet libri i Minella Kapos, që doli në qarkullim këto ditë. Autori shtjellon mjaft probleme në dobi të mësuesve, udhëheqësve të pionierëve etj.

Krahas trajtimit të çështjeve në rrafshin teorik, në këtë libër lexuesi njihet me këshillat për ruajtjen e tempit dhe frymëmarrjen, mënyrën e të ecurit, regjimin e marshimit, mënyrën e kapërcimit të pengesave, kalimin e natës jashtë, orientimin dhe dhënien e ndihmës së shpejtë.

Autori thekson se "...turizmi është një nga mjetet kryesorë për zhvillimin e gjithanshëm të aftësive fizike dhe morale të çdo qytetari që ushtron këtë lloj sporti. Turizmi i jep mundësi të mëdha rinisë të njohë Atdheun, historinë shekullore të luftrave të popullit tonë, veprat e ndërtimit të socializmit, natyrën e bukur të vendit tone".

Korresp. i "Sportit Popullor", 26 shtator

Përshëndetje nga Dajti

"...Salla e Kongresit të 3-të të BRPSH-ës (rinisë - shënimi ynë : K.G.) u lidh me anë të radios me alpinistët e qytetit të Tiranës, të cilët kishin shkuar në majën më të lartë të Dajtit dhe që andej i dërguan kongresit përshëndetje të zjarrta dhe punë të mbarë".

Korresp. i "Sportit Popullor", 28 nëntor

1957

Për të dytën herë në Korab

Pas 11 muajve, një grup alpinistësh ndërmori një tjetër aksion të rëndësishëm, duke u ngjitur për të dytën herë në majën e Korabit. Duke u mbështetur në eksperiencën e vitit të kaluar, përpara ngjitjes shoqëria "Studenti" organizoi një zbor teoriko-praktik në qytetin e Peshkopisë.

Këtë vit ngjitja nuk u bë nga Radomira, por në drejtim të veriut, nga fshati Zimur. Përgatitjet në zbor u bënë të rregullta dhe grupi i përbërë nga alpinistë të Shkodrës, Tiranës, Beratit, Korçës, Elbasanit, Vlorës e Peshkopisë, gjithsej 18 veta iu drejtuan Zimurit në mbrëmjen e 22 shkurtit.

Nga sharrat e Gramës në drejtim të...

Të nesërmen, nga Zimuri, i ndarë në tri skuadra, grupi zbriti në fshatin Bahutaj e prej këtej në Brenjë, duke marrë rrugën e maleve të Gramës. E bukur paraqitej rruga malore ku, për së dyti herë, alpinistët shkelën në zonat me dëborë. Arritëm në sharrat e Gramës. Ato ndodhen bri përroit dhe nga të dya anët rrethohen nga faqe malore të thepisura të malit të Gramës i mbuluar me pyje pishe. Ndërmjet pishave dalloheshin luginat e ngushta të thepisura, nga ku lëshoheshin trungjet e prerë. Përgjegjësi i sharrës, një plak i moçëm, na orientoi mirë mbi zonën rreth e qark dhe mbas krahasimit me hartën, grupi u nis për në stanet e kooperativës blegtorale të Suhadollit.

...Staneve të kooperativës blegtorale të Suhadollit

Rruga ishte gjithnjë e përpjetë. Në fillim fituam një lartësi rreth 400 metra dhe arritëm në livadhet plot dëborë të staneve. Përshendetjen e parë, ashtu si gjithmonë pranë staneve, na e dhanë qentë me lehjet e tyre, duke vrapuar drejt nesh. Kolona u ndal, por në këtë kohë dolën barinjte për të na hapur rrugën. Stani ishte i vogël, me tre kasolle : një për bar e kashtë, tjetra e hapur, pak nëndhe, nga ku dëgjohehin blegërimat e qingjave dhe, bri saj, vathi plot dele që

ushqeheshin. Afër gjëndeje kasollja e tretë për banimin e barinjve, me një derë të vogël që zbriste nëntokë.

Orët e mbasditës në stan kaluan me lëvizje e punë të ndryshme. Shtabi studionte itinerarët e mundshëm, një pjesë e alpinistëve rregullonte e pastronte kasollen e banimit, ndërsa të tjerët prisnin dhe sillnin dru.

Orët e mbrëmjes kaluan me sistemimin e pajisjeve, pajimeve dhe ushqimeve në çanta. Barinjtë na ndihmuan për gjithçka, bile edhe për fjetje, duke na liruar vendin e tyre deri në mesin e natës.

Dimri i këtij viti ishte më i butë se ai i vitit të kaluar. Nata nuk ishte aq e ftohtë, megjithëse gjëndeshim në lartësinë 2.000 m. Në orën 21 u shtrimë bri njëri-tjetrit për të fjetur, por gjumi nuk na zuri. Madje Dhimitër Banushi e Vasil Stambuli filluan të pëshpërisnin.

Zgjimi u bë në mesnatë. Gjatë natës, megjithëse barinjtë qëndruan pa fjetur dhe e mbajtën stufën ndezur, disa shokë ishin kollur, midis tyre dhe Grigor Perikliu, i cili dukej i lodhur. Si dha udhëzimet e nevojshme, përgjegjësi i grupit pyeti në rast se ndonjeri nuk e ndjente veten mirë. Të gjithë u përgjigjën - jemi shumë mirë. U dëgjua më shumë zëri i Grigor Perikliut. Por, mbas kontrollit, u pa se ai kishte rrahje të forta në zemër për shkak të kollës që e kishte lodhur gjithë natën. Ishte shumë e vështirë ta bindje Grigorin të qëndronte, të mos vinte me ne. Më në fund, u desh urdhëri i komandatit që ai të qëndronte.

Drejt Korabit

Nata ishte shumë e qetë. Yjet ndrisnin, Pas paraqitjes së forcës nga skuadërkomandatët, komandati i ngjitjes, mjeshtri i sportit Minella Kapo, dha urdhërin për t'u nisur. Malësori na drejtoi shumë mirë deri te Guri i Kuq, në lartësinë 2.000 m...

Megjithëse dëbora shndriste, ajo na "gënjente" në evidentimin e gropave, në distancën për të dalë në ndonjë çukë apo në qafë; të gjitha na dukeshin më afër se ishin në realitet...

Ishte ora 4 e mëngjesit kur majat e Gurit të Kuq filluan të zbardheshin. Nga veriu pamë vargmalet e Korabit. Ndodhemi në lartësinë 2.400 m. Krijuaam bindjen se në drejtimin veri-lindje ishte maja më e lartë. Shikimi u bë akoma më i qartë kur rrezet e diellit shndëritën shkëmbin Shala e Kalit. U orientuam shumë më mirë se vitin e kaluar.

Në orët e para të mëngjesit mbërritëm në qafën e Korabit. Pushojmë. Hamë diçka dhe nisemi drejt majës.

Prap në orën 10.

Ngjitjen për në majë e udhëhoqi skuadra e dytë me komandat Petraq Kulen. Sa më shumë afroheshim aq më shumë shtoheshin vështirësitë. Më shumë na pengonte era e fortë e veriut. Kur terreni dhe kushtet atmosferike u bënë më të vështira, në krye të kolonës doli mjeshtri Minella Kapo.

Ora 10. Në të njëjtën orë si vitin e kaluar, grupi mbërriti në majë. U mbajt fjalimi i rastit dhe u dha përshëndetja për 23 shkurtin, ditën e themelimit të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, për Festivalin VI botëror të rinisë e studentëve, për nder të të cilave u bë kjo ngjitje alpinistike.

...Kthimi u bë në të njëjtën rrugë, në drejtim të bazës - stanet e kooperativës blegtorale të Suhadollit.

Behlul Hatibi, 6 mars

Alpinistët u ngjitën në Shpellën e Kllezve

Gjatë ditëve që u zhvillua zbori në Peshkopi me alpinistët që do të sulmonin majën e Korabit, ata dëgjuan për Shpellën e Kllezve, që ndodhet në bregun e majtë të Drinit të Zi. Faqja e shkëmbit është krejt gur i rrafshët, pak i kthyer si hark në mes, 120 metra lart mbi shtratin e lumit. Gojëdhanat tregojnë se atje kanë banuar kllëzët, të cilët ishin njerës me krahë dhe fluturonin.

Në krahinat e Dibrës është e dëgjuar kjo shpellë dhe, siç tregojnë të moshuarit, nuk mbahet mend të ketë hipur ndokush në të. Është e pamundur. Alpinistët vendosën që ta provonin ditën që do të bënin praktikën para nisjes për në Korab.

Pasi bënë studimin e vendit, alpinisti Luigj Shala mori përsipër të fillojë ngjitjen i pari në këtë vend të vështirë dhe plot rrezik. Duke patur edhe inkurajimin e shokëve nga poshtë, ai e kreu ngjitjen me sukses dhe, me t' u futur në shpellë, bërtiti me sa zë që kishte : "Çerdhe e madhe shqiponjash".

Pas tij filluan ngjitjen edhe alpinistët e tjerë si dhe dy barinj të fshatit : Sabedin e Kamber Murrja, të cilët shoqëronin alpinistët.

Kjo shpellë është e madhe sa një dhomë mesatare, ku mund të qëndrojnë rreth 20 vetë. Frëngjia e vrojtimit si dhe një dollap i vogël provojnë se atje dikur do të ketë qenë vendosur ndonjë top i periudhës së mesjetës.

Shpella e Kllezve është përballë kështjellës së Sfetigradit dhe kjo të jep të kuptosh se mund të kenë luftuar trimat e Skënderbeut. Ky ishte një zbulim që bënë alpinistët në këtë shpellë.

Korresp. i "Sportit Popullor", 6 mars

Aktivitet i gjerë i rrethit të turizmit

Qendra turistike e Pallatit të Pionierëve të Tiranës, që ndodhet nën hijen e ullishtes pranë hidrocentralit "Lenin", prej 2 deri më 24 gusht u bë qendër e rëndësishme dëfrimi dhe grumbullimi për 1.500 pionierë kryeqytetas.

Pionierët e rrethit të turizmit i kryen vetë të gjitha punimet për ta pajisur qendrën turistike me tenda, instalimin e dritave dhe një sërë gjërash të tjera të nevojshme.

Nëpërmjet programeve të radios dhe aparatit kinematografik, kjo qendër kënaqi jo vetëm pjesëmarrësit, por edhe fshatarët afër saj që vinin dhe kalonin orë të paharruara kënaqësie.

Përveç 30 pionierëve të pallatit, qendrën turistike e vizitonin çdo ditë edhe 50 pionierë të kampeve ditore. Me pjesëmarrësit në këtë qendër është zbatuar një plan pune mësimi dhe argëtimi nëpërmjet ekskursioneve turistike dhe gjithë programit ditor, duke filluar nga gjimnastika e mëngjesit, pastrimi personal, lojërat e ndryshme e deri në shërbimin e rojes natën.

Ekskursionet turistike që u organizuan çdo ditë i pajisën turistët e vegjël me njohuri elementare të turizmit dhe u rritën dëshirën për të ushtruar këtë sport të bukur. Ata morën pjesë edhe në ekskursionin njëditor duke arritur në fushën e Dajtit, ku po ndërtohet një pallat katërkatësh, që do të shërbejë si kamp për pionierët.

Në qendrën turistike ka patur gjithashtu edhe nga një grup pionierësh të rrethit të natyralistëve të rinj, të cilët kanë mbledhur materiale të ndryshme në lidhje me përgatitjet për takimin kombëtar të natyralistëve të rinj, i cili do të organizohet më 7 dhe 8 nëntor.

Luigj Shala, mjeshtër sporti, 3 shtator

1958

Ku shkojnë këta pionierë?

Ditë e shtunë. Koha shumë e mirë, me diell që ngroh si në pranverë. Në mëngjes, pranë Pallatit të Pionierëve të kryeqytetit, një grup pionierësh të rrethit të alpinizmit, janë rreshtuar për t'u nisur për në Kalanë e Petrelës. Në orën 8, komandati i këtij rrethi Ali Ago dha komandën për nisje. Shkojnë tek maqina që po i priste pak më tutje për t'i çuar tek Ura e Erzenit.

Me të mbërritur tek ura, të ndarë në tre skuadra, në kolonë për një, marrin drejtimin për në kala. Mbas një orë ecje, afërsisht nga ora 10, ekskursionistët e vegjël gjenden në kala. Këtu instruktori Luigj Shala u foli mbi historikun e kësaj kalaje.

Në kohën që filluan të hanin drekë, vjen aty edhe një grup tjetër ekskursionistësh të Shkollës Ushtarake "Skënderbeg".

Me të vegjëlit u organizuan lojëra të ndryshme, kurse me ushtarakët gara qitjeje sportive.

Si dëfryen dhe shijuan bukuritë, nga ora 14 pionierët morën drejtimin për nga erdhën dhe pas 3-4 orësh me këmbë mbërritën në qytet.

Korresp. i "Sportit Popullor", 26 mars

18 alpinistë në zbor në Alpe

Secili prej nesh ka dëgjuar ose ka parë në fotografi ose në ekranet e kinemave bukuritë e Alpeve tona. Madhështia dhe lartësia e tyre, veshja e tyre ku me pyje dhe ku me livadhe, kullota dhe stane, burime me ujë të kulluar dhe ajër të freskët, të gjitha këto përbëjnë një burim kënaqësie për njerëzit që kanë fatin e mirë të kalojnë sado pak ditë në këto vise.

Gëzim të madh solli tek mua lajmi që Komiteti i Kulturës Fizike e Sporteve pranë Ministrisë së Arsimit e Kulturës kishte vendosur të

organizonte një zbor tjetër alpinistik...Që në fillim, në shkëmbinjtë e egër të Thethit ne demonstruam guximin tonë, duke aplikuar gjithçka që kishim mësuar në teori. Në garat që u zhvilluan vendin e parë e zuri V. Vrata, të dytin G. Perikliu.

Për t'u bërë alpinistë neve na u desh që të mësonim gjërat më elementare si lidhjet dhe përdorimin e litarit, përdorimin e kazmës alpine, etj., duke i aplikuar këto në praktikë, natyrisht në fillim në vende jo shumë të vështira. Sipas programit të studiuar dhe të udhëhequr nga instruktorët Kozma Grillo, Vasil Stambuli dhe Petraq Kule, ndëmorëm ekskursione të vështira, që kërkonin guxim dhe aftësi teknike.

Udhëtimi ynë i parë ishte mjaft i bukur dhe kishte si itinerar : Theth - Shtegu i Dhënëve-Maja e Radohimës - 2.750 m. Të parët që mbëritën në majë ishin G. Perikliu, M. Deliallisi, F. Gjinia, V. Meleqi.

Udhëtimi i dytë ishte në drejtim të Jezercës. 6 vetë u nisën drejt majës, ndërsa të tjerën u drejtuan për tek stanet e Jezercës. Në mëngjesin e 26 gushtit, të dy grupet iu ngjitën majës më të lartë të Alpeve të veriut.

Zenulla Strazimiri, 3 shtator

Sukses i alpinistëve sovjetikë

-U kaluan të gjitha majat me lartësi 7.000 m-

Moskë (TASS).

Mjeshtri i dëgjuar i alpinizmit në Bashkimin Sovjetik Kiril Kuzmin i njoftoi korrespondentit të TASS-it se gjatë vitit 1958, 67 alpinistë sovjetikë, janë ngjitur në majat, të cilat kanë një lartësi prej 7.000 m.

Ngjitjen më të vështirë dhe të ndërlikuar e kryen sivjet 13 studentë të Moskës nën drejtimin e Igor Erokik. Në malet e Tian-Shanit ata u ngjtën në majën më veriore 7.000 metërshe dhe në atë të Fitores (7.439 m).

Në majën më të lartë të Bashkimit Sovjetik "Stalin", në Pamir, u ngjitën sportistët turkmenë dhe uzbekë me në krye alpinistin e dëgjuar uzbek Nagel. Ata bënë po atë rrugë që përshkuan ngjitësit e parë me në krye Jevgenij Aballakovin 20 vjet më parë.

Në majën "Lenin" (7.134 m) sivjet u ngjitën 8 sportistë sovjetikë dhe kinezë.

Një sukses të shkëlqyeshëm patën sivjet alpinisti i Moskës Vadim Nikolajenko dhe rjazanasi Lev Mishlajev, të cilët u ngjitën nëpër anën e pjerrët të malit Ushba (vargmali kryesor i Kaukazit). Për vështirësitë e tij ky itinerar i kalon të gjitha itineraret e njohura europiane, midis të cilëve edhe ngjitjen në malin Eiger në Alpe.

Alpinistët sovjetikë kanë ngjitur tani të gjitha majat 7.000 metërshe në Bashkimin Sovjetik, kurse majat 8.000 metërshe ndodhen jashtë kufijve të Bashkimit Sovjetik. Të parët që do të sulmojnë një majë 8.000 metra të lartë do të jenë në vitin 1959 alpinistët gjeorgjianë që do të shkojnë në Nepal me ftesën e mbretit Mahendra Bir Bikram Shah Deva.

(ATSH), 19 nëntor

1959

60 studentë dhe pedagogë në zborin alpinistik

Ditët e fundit të janarit ishin nga më të ftohtat, por kjo nuk i pengoi 60 studentë dhe pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës të shkojnë në Dajt për të kryer një zbor alpinistik.

Ditën e parë të gjithë ndjejnë ftohtë, shumë ftohtë, edhe objekt bisede për atë ditë ishte gjumi jo i rehatshëm i natës së parë. Njerëzit akoma nuk qenë ambientuar me gjëndjen e re. Të nesërmen në mëngjes pjesëmarrësit u ndanë në katër toga dhe filluan mësimin për kazmën alpine.

Ky është zbori i dytë alpinistik që ngrihet në Dajt me iniciativën e KQ të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Numri i alpinistëve, pjesëmarrës në zbor këtë vit, ishte shumë më i madh se vitin e kaluar.

*2 shkurt...*Zgjimi bëhet në orën 4 të mëngjesit. Alpinistët e ardhshëm, mbasi kanë marrë njohuritë e nevojshme, nisen për ekskursionin njëditor. Koha është shumë e keqe. Megjithëkëtë u vendos që ngjitja të bëhet duke marrë parasysh se itinerari ishte i njohur.

Pa kaluar 10 minuta ecje, fillon një shi i madh, vendin e të cilit pas gjysëm ore e zë dëborë.

...Rreth një zjarri të madh, që kemi ndezur në kamp, secili flet i gëzuar për përshtypjet e udhëtimit të parë. Të gjithë ndjejnë pak lodhje, por janë të entuziazmuar për kalimin me sukses të kësaj prove të vështirë.

Ora po kalon dhe toga e katërt ende nuk po duket. Koha sa vete keqësohet dhe secili mendon për fatin e shokëve. Presim deri në orën 23, por më kot...

Të nesërmen herët në mëngjes, një grup alpinistësh, nën udhëheqjen e mjeshtrit të sportit Minella Kapo, u nis për të kërkuar shokët e humbur. Ky fakt shënoi një faqe të re në historinë e alpinizmit tonë : për herë të parë krijohet skuadra e shpëtimit. Pjesëtarët e kësaj

skuadre kur u kthyen na dhanë lajmin se toga e katërt ishte mirë. Anëtarët e kësaj të fundit u kthyen vonë. Të detyruar nga terreni i vështirë dhe koha e keqe udhëtuan deri në orën 24 dhe orët e mbetura të natës i kaluan në një kasolle pa zjarr.

...Mbas plotësimit të programit, u organizua ngjitja zaçiot në majën e Dajtit në një itinerar të ri, duke përdorur ngjitjen sportive dhe zbritjen Dulfer.

Në përfundim, pjesëmarrësit në zbor fituan 3 kategori të para sportive, dy tituj "Instruktur i ri i alpinizmit", 9 kandidatë për instrukturë e 3 "Turist i RPSH" dhe pjesa tjetër "Alpinist i RPSH".

Kozma Grillo, instruktur alpinizmi, 15 shkurt

Nga Thethi na njoftojnë...

Në bazë të Kalendarit Sportiv Kombëtar, Komiteti i Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH-së dhe Këshilli Qëndror i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë organizuan në kampin alpinistik të Thethit ngjitje alpinistike shumëditore me pjesëmarrjen e 8 alpinistëve të vendit tonë, 10 alpinistë nga RD Gjermane dhe 3 alpinistë nga Republika Çekosllovaqe. Midis alpinistëve miq bëjnë pjesë edhe dy femra - një gjermane dhe një çekosllovaqe.

Aktiviteti mbyllet sot. Gjatë këtyre ditëve alpinistët tanë dhe miqtë gjermanë e çekosllovakë kanë bërë shumë ngjitje në drejtime të ndryshme të zonave malore të Thethit, si në majën e Radohimës, Vishnjës, në majën e Arapit, në Jezercë, në malet e Valbonës, etj., duke kaluar vështirësi të shumta me ndihmën e një pjese të madhe të pajimeve alpinistike.

Për t'u theksuar është sidomos teknika e lartë e alpinistëve miq. Ata vepruan shumë mirë e me siguri, sidomos në ngjitjet shkëmbore. Edhe alpinistët tanë, megjithëse të rinj, treguan përparime të kënaqshme.

Bukuritë e zonës malore të Thethit, klima dhe konditat mjaft të mira të krijuara gjatë këtij aktiviteti, u kanë pëlqyer jashtëzakonisht shumë miqve gjermanë dhe çekosllovakë, të cilët kanë mbetur shumë të kënaqur nga kjo veprimtari alpinistike në Thethin tonë të bukur.

Korresp. i "Sportit Popullor", 25 gusht

Kujtime të paharruara

Më datën 2 gusht u kthye në Atdhe grupi I alpinistëve shqiptarë, që kreu zborin alpinistik në kampin "Alibeg", në Kaukazin Perëndimor. Alpinistët tanë (Luigj Shala, Petraç Kule, Kozma Grillo, Koço Qafzezi dhe Thanas Vasili) krahas kryerjes së programit teorik, realizuan edhe dy ngjitje : në majën e malit Sufrixhu (3.785 m) dhe në Mallij Dombaj 3800 metra mbi nivelin e detit (e dyta nga lartësia në këtë zonë të Kaukazit).

Të shumta janë përshtypjet nga ditët që kaluam bashkë me alpinistët sovjetikë. Ne, asnjëherë nuk do të harrojmë kujdesin e dashurinë që treguan ata për ne. Përfituam shumë nga eksperiencia e alpinistëve sovjetikë, e alpinistëve më të përparuar në botë.

Për alpinistët tanë, që nuk patën mundësi të ishin me ne, dhe për ata që dashurojnë këtë sport burrëror, po u tregoj për QKSH-ën (qendra e kontrollit dhe e shpëtimit) dhe ngjitjen tonë më të vështirë - në Mallij Dombaj.

Në zonën e Kaukazit Perëndimor funksionojnë katër kampe alpinizmi, 3 olimpiada dhe një bazë turistike, të vendosura afër njëra tjetrës. Të gjitha këto kishin një qendër kontrolli e shpëtimit. Qenë të shumtë grupet që niseshin për në mal brenda një dite. Pavarësisht nga përbërja e grupit, alpinistë të rinj apo me kategori të larta sportive, përpara se të fillonin ngjitjen duhet të përgatitnin marshutin (itinerarin që do të ndiqnin në ngjitje dhe në zbritje). Në librin e marshutit, instruktori, duke u mbështetur tek fotografia e malit, përpilonte skemën e ngjitjes, shkruante emrat e pjesëmarrësve, etj. dhe mbasi e kishte njohur gjithë grupin me marshutin ia dorëzonte komisionit. Çdo kamp kishte një komision. Në kampin tonë, kryetar i këtij komisioni ishte Mjeshtri i merituar Gallustov - anëtar i skuadrës përfaqësuese të Bashkimit Sovjetik, që do të kryejë vitin që vjen ngjitje në Everest (maja më e lartë e Himalajave).

Në rast se ky komision e shikonte të arsyeshme marshutin e aprovonte atë dhe i caktonte grupit orën që duhej të kthehej në kamp. Mbas marrjes së këtij miratimi, grupi nisej për në mal vetëm mbasi secili të kishte marrë aprovimin e mjekut të kampit.

Për të treguar më konkretisht se çfarë është QKSH-ja po ju vë në dijeni për një ngjarje që ndodhi më 29 korrik. Në zonën tonë kishte ardhur nga Moska një grup kineastësh për të realizuar një film alpinistik. Çadrat i kishin ngritur në një lartësi rreth 3.000 metra, kundrejt "Sheshit të Arinjve", ku kalonin natën alpinistët që të nesërmen do të kryenin ngjitje. Kineastët, pa dashur, në mes të natës dhanë me elektrik dore 6 sinjale në minute - SOS-i i malit. Grupi që kalonte natën te "Sheshi i Arinjve" e kapën këtë sinjal dhe me radio njoftuan QKSH-ën. Ishte ora 1 e natës, menjëherë në kamp u dha alarmi. Grupi i shpëtimit u nis menjëherë në ndihmë. E gjithë kjo zgjati vetëm 10 minuta. Detyra e këtij grupi është jo vetëm fisnike e bujare, por edhe shumë e lodhëshme. Atyre u duhet të ngjiten në mal me temp shumë të shpejtë për të ndihmuar ata që kanë rënë nga shkëmbi ose i ka mbuluar orteku : sa më shpejt t'i shkosh tjetrit në ndihmë aq më e madhe është mundësia për t'i shpëtuar jetën. Atë natë asnjëri nuk fjeti në kamp. Fatmirësisht nuk kishte ndodhur asgjë, veçse artistët pa dashur kishin bërë një "shaka".

Parimi themelor i alpinizmit sovjetik, që ndryshon rrënjësisht nga ai i botës perëndimore, është kujdesi për jetën e alpinistit në mal. Dhe këtë e realizon kryesisht QKSH-ja. Kjo qendër kontrollon për herë të fundit alpinistët që nisen për në mal dhe nis skuadrat e shpëtimit jo vetëm atëherë kur njoftohet me sinjale apo me radio, por edhe kur grupi nuk kthehet në kamp në orën e caktuar .

Nga jeta jonë kamp po shkëputim disa rreshta nga fletët e ditarit të datës 30 korrik.

...Sot nisemi për ngjitjen e fundit. Ditët në kamp kaluan shumë shpejt. Mbas dy ditësh nisemi për në Atdhe. Në këtë ngjitje nuk do të vijë me ne Spirua (përkthyes i ekipit) dhe Ljubov Sergejevna, mjeshtre e sportit që nga viti 1945, që shoqëroi vazhdimisht ekipin tonë.

Natën e kalojmë te "Sheshi i Shpendëve". Na është dhënë leja të ngjitemi në majë vetëm po të jetë kohë e mirë. Është ora 2 pas mesit të natës kur vihemi në rrugë. Moti është i bukur. Mbas dy orë udhëtimi mbërrijmë para një muri shkëmbor. Në krye ecën instruktori ynë i nderuar Vadim Pollustovski. Mbas tij Luigji e me radhë të tjerët. Me ndihmën e litarëve dhe të gozhdëve alpine kalojmë të dy muret dhe në orën 10 ndodhemi në majën e malit Mallij Dombaj - 3.800 m mbi nivelin e detit. Megjithëse e ndjejmë lodhjen, gëzimi ynë është shumë i madh për suksesin e arritur. "U ngjitëm më shumë se 1.100 metra më lart se Korabi ynë" – tha Petraqi.

Kur po bëheshim gati për zbritur, një mjegull e dëndur mbuloi gjithçka. Veç kësaj, vështirësinë e zbritjes e shton më shumë dëbora që nisi pa prituri dhe bie si në dimër në vendin tonë. "Të gjithave ua bëjmë hallall, po rrufeve si t'ua bëjmë" - tha Koçua dhe, pa e mbaruar mirë fjalën, një rrufe ra 50-60 metra larg nesh duke hedhur në humnerë një shkëmb të madh. Mbas dy tre sekondash pamë se ishim shtrirë nga forca e rrufesë afër njëri-tjetrit.

Por, ne nuk e humbëm gjakftohtësinë. Madje Luigji pyeti se çfarë duhet të bëjmë më kazmat, gozhdët dhe çelësat, të cilat i mblodhi Vadimi, i cili nguli një gozhdë dhe i vari atje tej, larg nesh.

Mbas katër orësh ecje me ritëm thuajse të lartë mbërritëm në "Sheshin e Shpendëve", ku jo vetëm që nuk bie dëborë si në majë, por bëjmë edhe banjo dielli.

Nuk qëndrojmë shumë se me radio kemi njoftuar kohën e keqe të papritur gjatë zbritjes. Ata na u përgjigjën vetëm me këto fjalë: "Ju urojmë kohë të mirë!". Në afërsi të kampit shohim tufa me lule mali dhe letra ku shkruhej: "Mirë se erdhët vëllezër shqiptarë!". Jemi tejet të lodhur. I themi njëri-tjetrit të buzëqeshim për të fshehur lodhjen. Në orën 7 futemi në kamp. Të 200 alpinistët janë të rreshtuar. Pasi dëgjoji raportin e instruktorit tonë, komandati i kampit na përshëndeti, iu përgjigjëm me zigzagun tonë, dhe dha komandën:

- Të lirë!

Të gjithë u hodhën mbi ne, na përqafojnë, na morën çantat dhe kazmat, na morën në krah dhe na shpunë në bujtinën tonë.

Pas dushit dhe ngrënies së darkës, çuditërisht po ne vajtëm në mbrëmjen e vallëzimit ku qeshnim dhe kërcenim sikur nuk ishim ne që para dy orësh mezi qëndronim në këmbë.

Me këtë ngjitje, ne mbyllëm programin praktik. Para kësaj kishim plotësuar normën dhe na u dha distinktivi "Alpinist i shkallës së parë i BRSS".

Ju faleminderit, miq!

Shënim : Ekipi përbëhej nga 5 alpinistë :

**Luigj Shala, Petraç Kule, Kozma Grillo, Koço Qafzezi
dhe Thanas Vasili.**

Kozma Grillo, alpinist i kategorisë së parë, 19 gusht

Parajsë për alpinistët

“Më 13 korrik, 10 alpinistë të Republikës Demokratike Gjermane fluturuan me avion nga Berlina, në drejtim të Tiranës për të marrë pjesë si të parët alpinistë të huaj në ngjitjen e maleve të Shqipërisë.

Në Republikën Popullore të Shqipërisë punohet shumë për zhvillimin e fizkulturës me baza socialiste. Fëmija më i ri i sportit shqiptar është alpinizmi. Detyra jonë ishte që t'i ndihmonim miqtë dhe shokët shqiptarë në zhvillimin e këtij lloji sporti shumë të ri.

Një miqësi e përzemërtë na lidhi menjëherë, që nga çasti i parë i njohjes me alpinistët shqiptarë. Ata qenë shokë të shkëlqyer, si natën pranë zjarrit, para çadrave, ashtu edhe ditën, në luftë me shkëmbinjtë e vështirë.

Mund të kuptohet lehtë gjëndja shpirtërore e ne, 10 alpinistëve gjermanë, kur autobusi ynë po u thonte udhë e mbarë serpentinave të fundit dhe kur përpara nesh u shtri madhështore pamja e maleve të larta. Për çdo gjë ne ishim të përgatitur, por kurrë nuk mund ta merrnim me mend se ç'panoramë e mahnitëshme do të na dilte përpara sysh. Male të lartë, pjesërisht me rafshnalta plot dëborë, mure thikë. Një parajsë për alpinistët. Janë malet e fundit në Evropë që ngjiten në qiell krejtësisht të paprekur. Ka 30 vjet që ngjit male të larta në Zvicër, në Austri, në Franëë, në Itali, por asnjëherë nuk kam parë kaq bukurira të paprekura si tani në malet veriore të Shqipërisë. Miqtë tanë shqiptarë të maleve meritojnë përgëzimet më të sinqerta.

Trajtimi ynë, në kampin bazë të Thethit, ka qënë i shkëlqyer.

Çadrat tona qëndruan tri ditë poshtë majës së Arapit. Që këtu, bëmë ngjitje në malet e Vishnjës, Radohimës, Shtegut të Dhënëve dhe Arapit. U zhvilluan nëntë ngjitje në muret deri atëherë të paarritura. Miqtë tanë shqiptarë ngjitën me sukses për të parën herë murin jugperëndimor të Arapit.

Ne kishim vendosur qysh më parë që ngjitjet të bëheshin gjithmonë duke qënë dy alpinistë gjermanë dhe një shqiptar. Kjo u respektua shumë mirë dhe me sukses të plotë. Kur zbritëm, gjetëm në kampin tonë të Thethit tre shokë alpinistë çekoslovakë, të cilët porsa kishin ardhur. Nuk qëndruam më shumë se një ditë në çadrat. Në ngjitjet e para shpëmë shumë ushqime dhe pajisje në kampin e sipërm. Gjashtë ditë që jetuam atje patëm punë vetëm me ngjitje, prandaj

gjatë kësaj kohe nuk mund të transportohej asgjë. Këtu, na ndihmuan shumë rojet e kufirit, të cilët na vunë në dispozicion kafshë bartëse. Ne i falenderojmë këta shokë, jo vetëm për ndihmën që na dhanë, por edhe për përpjekjet e tyre për sigurimin tonë.

Kampi i dytë ishte në rrëzë të Jezercës. Që këtu u ngjitëm në malet e Jezercës, Papllugës dhe Prozhmit. Mbasi në këtë zonë nuk kishte male të lartë, u shpërngulëm në luginën e Valbonës. Prej këtej u bë ngjitja në majën e Alisë, duke kaluar nëpër qafën plot dëborë dhe duke patur si ngarkesë çanta të rënda. Nga ky kamp u nisëm dhe kryem ngjitjen në murin e parë të madh të maleve shqiptare. Murin perëndimor, 1.000 metra të lartë, të Beshitit e ngjitëm në rregull me kacavarrje të rëndë shkëmbore. Të nesërmen, bëmë një ngjitje tjetër të re të murit perëndimor të Valit. Pastaj u kthyem në Theth.

Rezultatet e shokëve shqiptarë kanë qenë të mira. Natyrisht, atyreve u mungon akoma eksperiencia e veprimeve për ngjitje në shkëmbinj si dhe teknika e kacavjerrjes dhe e sigurimit. Vullneti dhe energjia e tyre do të bëjnë që së shpejti ata të arrijnë përparime të mëdha.

Ne u urojmë shokëve shqiptarë sukseset më të mira. Sporti i alpinizmit në RD Gjermane dhe në atdheun e shqiptonjave është edhe një mjet i fuqishëm për kalitjen e njërëzve të shëndoshë dhe të fortë, të gatshëm për të kontribuar në ndërtimin e socializmit dhe në luftën për mbrojtjen e paqes.

**Harry Duriëhen, përgjegjësi i grupit të alpinistëve
të RD Gjermane, 9 shtator**

“Përshëndetje majave që nuk i harrojmë”

Për herë të fundit ne shtrënguam duart e alpinistëve shqiptarë në aerodrom, kur po largoheshim nga Shqipëria.

Dyert e aeroplanit u mbyllën dhe “zogu i hekurt” filloi të fluturojë mbi Tiranë. Ne e ndiem veten të mallëngjyer kur u larguam nga toka e bukur dhe miqtë tanë shqiptarë.

Mendja jonë shkon në Theth ku qe vendosur kampi i alpinistëve. Pastaj u zhvendosëm afër Jezercës, që është një nga bukuritë më mahnitëshme të kësaj krahine. Gjatë ngjitjes për në majë u çfaq përpara nesh panorama e bukur rreth maleve. Vazhdimi i rrugës na çoi në

luginën e Valbonës. Këto maja janë akoma më tërheqëse për alpinistët. Dy ditët e fundit filluam ngjitjen në majën vigane të Briasetit (2.567 m). Dihet se alpinistët kujtojnë më tepër majën më të lartë që arrijnë. Por megjithëse nuk mundëm të arrijmë në majën e saj, prap se prap ajo la shumë kujtime tek ne.

Në vendin tonë thuhet : “Alpinisti duhet të dijë gjithmonë të kthehet”. Këtë të vërtetë të thjeshtë ne e provuam edhe një herë kur filluam rrugën e ngjitjes për në majën e Briasetit.

Mbasi koha që kishim në dispozicion ishte e shkurtër ne e filluam ngjitjen shpejt. Ishim 3 alpinistë çekoslovakë dhe 2 shqiptarë. Për të realizuar misionin tonë qemë pajisur me të gjitha mjetet që i nevojiten një alpinisti për të kaluar vështirësi të shumta malore. Rruga e ngjitjes karakterizohet nga faqe të mprehta dhe hipje e zbritje të ndryshme, që përmbahen në katëgorinë e katërt. Vështirësitë që hasnim na forconin vullnetin dhe asgjë nuk na dukej e pakalueshme. Pa ngrënë dhe pa pushuar ne ecnim gjithmonë përpara. Nuk na durohej deri sa të arrinim sipër, në majë. Pa vënë re dielli, që na shoqëroi në këtë udhëtim të vështirë aq interesant, perëndoi. Alpinistët shqiptarë Andoni dhe Angjeli ndodhen gjithashtu së bashku me ne.

Mëngjesi i ditës së dytë na gjenë në rrugë. Mbas pak i afrohem majës, por atje nuk u ngjitëm sepse qe jashtëzakonisht e vështirë. Pati nga alpinistët që, duke mos pasur besim në provën e parë, e përsëritën edhe herën e dytë, të tretë, bile edhe të katërt, por pa rezultat. U detyruam të heqim dorë. Duke qënë afër majës ne shikojmë faqet e bukura gëlqerore që ngjitëm për dy ditë me radhë...

Alpinizmi është një sport i ri në Shqipëri. Ai i ka të gjitha mundësitë që të zhvillohet. Ky vend i bukur ka maja të mrekullueshme. Jemi të bindur se me bashkëpunimin ndërmjet alpinistëve shqiptarë e çekoslovakë ky sport në vendin tuaj të bukur do të ecë mjaft përpara.

Me këtë rast falënderojmë miqtë tanë shqiptarë për kujdesin e veçantë që treguan për ne gjatë zborit alpinistik. Ne i presim alpinistët shqiptarë në majat e larta të Tatrave tona dhe mbas kësaj përsëri do të jemi midis jush.

Përrshëndetje majave që nuk i harojmë!

Ing. Milan Lasak, përgjegjës i grupit të alpinistëve çekoslovakë, 16 shtator

1960

Fund tragjik i një ekspedite alpinistike

Para pak kohe në Francë u përgatit një ekspeditë alpinistike e përbërë vetëm nga gra, për ngjitjen në një nga Himalajet tetëmijëshe : Ço Oju - 8.183 m, e shtata sipas radhës në tabelën e majave më të larta në botë.

Grupi u nis nga Katmandu, kryeqytet i Nepalit, në fund të shtatorit dhe me gjithë që kishte disa shtrëngata të forta mundi të vendosej në kampin numër 3. Më 1 tetor udhëheqësja e grupit Klod Kogan (Francë) dhe shoqëruesja e saj Klodin Van der Straten (Belgjikë), bashkë me dy shoqërues të tjerë, ishin nisur drejt majës. Ato u panë për herë të fundit më 1 tetor në mbrëmje kur kishin ngritur çadrat në lartësinë 6.900 m. Për fatin e tyre mund të gjykohet nga letra e njërës prej pjesëmarrëseve, Zhan Franko, e cila midis të tjerash shkruan :

“Që në mbrëmje të 1 tetorit filloi shtrëngata e tmerrshmë. Të strehuar në çadrat tona, të cilat ishin ngritur thellë në dëborë, në vazhdim të disa ditëve, ne nuk mundëm të nxirrnim kokën përjashta. Kur koha u qetësua u ngjitëm në pikën 4 ku kishim parë të vendoseshin Kogan dhe shoqëruesit e saj. Kur arritëm në vendin e caktuar nuk gjetëm asnjë gjurmë njeriu. Shtrëngata e tmerrshme kishte zhdukur gjithçka. Nuk na mbetej asgjë tjetër për veçse të ktheheshim nga kishim ardhur, por pa Kogan dhe Van der Stratin si dhe dy shoqëruesit, të cilët u bënë viktima të perëndeshës Tjurkoaza (gur i çmueshëm blu në të gjelbërt sikurse quhet maja ku gjendet kampi numër 4).

Klod Kogan ka shëtitur me burrin e saj Zhorzh (i cili ka vdekur me kohë) shumë male dhe maja të larta. Ajo ka marrë pjesë në këto ekspedita : Kordilierët, Andet, Grelandë, Kaukaz, Himalajë dhe është njohur me emërin “Gruaja më e lartë në botë”.

6 janar

Ngjitje alpinistike

Për nder të takimit të rinisë së vendeve të Ballkanit dhe të Adriatikut për shndërrimin e zonës së Ballkanit në zonë paqeje e miqësie, pa armë atomike, që do të zhvillohet në Bukuresht prej 30 janarit deri më 4 shkurt të këtij viti, Komiteti Qëndror i BRPSH-së dhe Klubi Sportiv "Universiteti" organizuan një ngjitje të madhe alpinistike në majën e Jezercës.

Grupi i alpinistëve, që u nis të premten e kaluar, përbëhet nga punëtorë, inxhinierë e nëpunës. Midis tyre ndodhen alpinistët V. Stambuli, K. Bukuroshi, A. Tapia, F. Harito, T. Zguro, P. Kule, V. Seiti, V. Vreto, K. Grillo, etj. Ngjitjen do ta udhëheqë mjeshtri i sportit Minella Kapo.

Grupi u nis për në Shkodër. Në nisje qenë të pranishëm sekretarët e KQ të BRPSH-së Jorgjia Premti e Hamdi Sollaku, zëvendëskryetari i Komitetit të KP të BFSSH-së Pandi Allabashi, etj.

Përpara nisjes, mjeshtri i sportit Minella Kapo i deklaroi korrespondentit të gazetës sonë :

"Iniciativa për organizimin e kësaj ngjitjeje alpinistike u muar nga KQ i BRPSH-së dhe Klubi Sportiv "Universiteti" për nder të takimit të rinisë së vendeve të Ballkanit dhe të Adriatikut në zonë paqeje e miqësie, pa armë atomike, si dhe me rastin e 14 - vjetorit të shpalljes së Republikës. Në këtë takim përfaqësuesit e rinisë paqedaqshëse shqiptare do të thonë fjalën e tyre, do të çojnë atje dëshirën e rinisë sonë për të jetuar në paqe e fqinjësi të mirë me të gjithë shtetet ballkanike dhe të zonës së Adriatikut. Edhe sportistët e vendit tonë e mirëpritën këtë takim. Për të shprehur kënaqësinë e tyre për këtë takim grupi ynë alpinistik do të ngjitet në majën e Jezercës. Ngjitjen shpresojmë ta përfundojmë me sukses".

Korresp. i "Sportit Popullor", 13 janar

Alpinistët e KS "Universiteti" në Tomorricë

Alpinistë, studentë e pedagogë, për të pestin vit me radhë po festojnë 23 shkurtin, ditën e Ushtrisë Sovjetike, me ngjitje alpinistike në majat më të larta të vendit tonë.

Ngjitja e parë alpinistike nga ana e studentëve dhe pedagogëve

kushtuar kësaj dite të shënuar u bë në vitin 1957 në majën e Korabit, maja më e lartë e vendit tone - 2.751 m. Një vit më vonë ata u ngjitën në Nemërçkë, në majën e Papingut - 2.492 m dhe në Tomorr - në Çukën Partizani - 2.397 m. Më 1959 alpinistët universitarë u ngjitën në malin e Tomorricës.

Këtë vit, 10 alpinistë universitarë dhe 3 të Beratit u ngjitën për herë të parë në periudhën dimërore në majën e Tomorricës – 2.417 m, e cila është 20 metra më e lartë se maja e Tomorrit.

Grupi i alpinistëve drejtohej nga instruktori i ri i alpinizmit, studenti i Fakultetit të Mjekësisë, Mustafa Xhakia. Në grup bënte pjesë edhe alpinistia e re Pranvera Verzivolli. Grupin e Beratit e shoqëronte instruktori i alpinizmit Petraq Kule.

Ngjitja ishte mjaft e vështirë, alpinistëve iu është dashur të flenë dy netë në mal në çadra, por çdo gjë u krye me sukses. Sipas klasifikimit të ri sportiv kjo ngjitje konsiderohet e shkallës së katërt të vështirësisë.

Korresp. i “Sportit Popullor”, 2 mars



Alpinistët ia arritën qëllimit

E shtunë, 5 mars. Për nder të 50-vjetorit të Ditës Ndërkombëtare të Grave nisët një grup alpinistësh nga Tirana. Grupi përbëhet nga 14 alpinistë dhe udhëhiqet nga instrukturja e re e alpinizmit, sportistja e kategorisë së parë, Tefta Zguro. Objektivi ynë është shkëlja e majës së Papllugës (2.569 m), që është një nga majat dominonjëse në zemër të Alpeve shqiptare.

Alpet...Dikujt i shkon mendja te Alpet e famëshme zvicerane, të cilat i ka parë vetëm nëpër kartolina, përfytyron bukurinë e tyre mahnitëse. Dhe me të vërtetë të pakët janë ata, që i kanë shijuar këto bukuri në thellësi të Alpeve tona, sidomos në dimër.

Nisemi nga Tirana mbasdite. Secili ndjen emocionin e zakonshëm të sportistit para garës. Për ne kjo ngjitje është një aksion sportiv dhe politik, është një çështje nderi.

E djel, 6 mars. Nisemi nga Shkodra në mëngjes herët. Maqina na çon deri në Bogë, mbasi rruga automobilistike e Thethit hapet vetëm në verë. Rruga shkëmbore më e shkurtër, por njëkohësisht më e vështirë për në Theth kalon nëpër Shtegun e Dhënëve (1.712 m). Nga

kjo qafë shikojmë më mirë rrugën që do të përshkojmë : do zbresim poshtë në luginën e Thethit, pastaj do të ngjitemi në Qafën e Pejës dhe prej këndeje në Gropat e Bukura, mbi të cilat ngrihet Paplluga.

Dëbora e ngrirë, që ishte e favorshme për ngjitje, na e vështirëson zbritjen nga Shtegu i Dhënëve. Në Theth na presin me përzemërsi kufitarët, që na ftojnë ta kalojmë natën tek ata.

E hënë, 7 mars. Dimëri vendosi që edhe një herë të pengojë alpinistët. Në mëngjes u gdhimë me borë të shumtë, që kish rënë për tërë natën. Me qëllim që t'i afrohemi sa më shumë majës së Papllugës nisemi për në Qafën e Pejës (1.700 m). Rruga është e gjatë dhe të lodh. Këtë na e vështirëson edhe dëbora, që vazhdon të bjerë. Vendosëm ta kalojmë natën në shpellëm e kësaj qafe, një shkëmb i lartë më se 50 metra, që formon një gjysëm harku në formë çatije. Ndezim zjarr dhe përgatitim darkën. Rreth zjarrit thahemi dhe bisedojmë, deri sa komandatja jep urdhërin për fjetje. Era e fortë e përplas me zhurmë dëborën mbi çadër. Por brënda është ngrohtë dhe ne na zë shpejt gjumi.

E martë, 8 mars. Ngrihemi pa gdhirë dhe ndezim përsëri zjarrin. Pasi përgatitemi nisemi përsëri për rrugë. Bora, që ka rënë vazhdimisht gjithë natën, na pengon rrugën dhe paraqet rrezik ortekësh. Të lidhur me litar kalojmë zonën e rrezikshme të Qafës së Pejës, tek e cila të çon vetëm një shteg, që nga të dyja anët ka gremina. Në qafë bëjmë një pushim të gjatë dhe njëkohësisht studiojmë rrugën për më tej. Dëbora dhe mjegulla, që dëndësohen, nuk na lejon të shikojmë agimin e diellit. Vazhdojmë rrugën dhe pas gjysëm ore udhëtimi jemi tek Gropat e Bukura. Herë pas here koha hapet dhe ne shikojmë pamje mahnitëse. Jo më kot malësori i rritur në mes të bukurive të natyrës e ka quajtur këtë vend Gropat e Bukura.

Ecim anës gropave. Nga e majta kemi vargun bojë kafe të Kolajt. Më tej Jezercën, kurse përballë si piramide ngrihet Paplluga.

Pranë brigjeve të malevet, që janë rënduar nga dëbora e re, shkëputen ortiqe, që nga lart duken si ujvarë dhe atëhere :

**“Ushtojnë malet prej ortiqesh,
prej ortiqesh kah po bijnë ndër gropa”.**

Ecja shpesh ngadalësohet nga dëbora, që herë herë arrin gjer në gjoks. Punën më të lodhshme e ka i pari, i cili ndërohet herë pas here. Kështu dëborën e çajmë me radhë : Gaqua, Petraqi, Vangjeli,

Tefta, Dhimitra, etj. Vazhdojmë ngjitjen në rrëzë të kreshtës së Papllukës, nga e cila herë pas here shkëputen ortiqe të vogla. Njëri nga këta shtyn 10 metra poshtë Ligorin, Dhuratën, Vasilin, por pa rrezik.

Grupi i afrohet majës shumë ngadalë për shkak të vështirësive, prandaj pas 12 orësh ngjitjeje ndjehet nevoja që një pjesë të kthehet pa arritur majën. Pjesa tjetër vazhdon rrugën, pa marrë parasysh erën e fortë dhe natën që po afrohet. Më në fund, maja arrihet në orën 18 nga 8 alpinistë me në krye komandaten Tefta Zguro.

Grupi e pagëzoi këtë majë me emërin "8 Marsi". Koha është e hapur pjesërisht dhe nga maja duket një pjesë e Alpeve shqiptare. Tani alpinisti ndjen kënaqësinë e fitores dhe shijon bukurinë që shtrihet nën këmbë.

Kthimi është më i lehtë, se ecim nëpër gjurmët e hapura. Nata na zë tek Gropat e Bukura, por kjo nuk na tremb sepse rrugën e dimë mirë. Pasi kalojmë pjesën e rrezikëshme të Qafës së Pejës arrijmë tek çadrat, ku na pret zjarri që kanë ndezur shokët. Biem për të fjetur. Të tëra mendimet dhe bisedat sillen rreth fjalës : Fituam!

E mërkurë, 9 mars. Vetëm sot në mëngjes pushoi dëbora. Grykat e Arapit dhe Radohimës gjëmojnë nga ortiqet. Kur po hanim bukë, që sipër shkëmbit u shkëput një ortek dhe ne u gjendëm midis shkëmbit dhe ujvarës prej dëbore.

I tërë grupi zbriti në Theth përveç Minellës, Vasilit dhe Mustafajt, që ndejtën për të bërë ngjitjen në Jezerëë. Në Theth fjetëm tek shtëpia e Kolës. Atje ndjemë përzemërsinë e pritjes malësore.

E enjte, 10 mars. Tërë natën kanë rënë ortiqe dhe Shtegu i Dhënëvet është liruuar, prandaj nisemi për Bogë. Kalimi u bë me lehtësi, duke mënjanuar rrezikun e rrëshqitjes. Ky shteg ishte vështirësia e fundit që kaluam, prandaj përqafohemi dhe përsëndesim me parullën "Zig-zag, zig-zag; hej, hej, hej, hej; alpinista jemi ne!". Shpejt zbresim në Bogë dhe kalojmë natën tek miku ynë Frani.

E premte, 11 mars. Presim grupin e Jezercës deri në drekë. U gëzuam shumë kur morëm vesh prej tyre, që e realizuan ngjitjen. Dy fitore me njëherë, ose dy zogj me një gur!. I hipim maqinës dhe u nisëm për në Shkodër. Tërë rrugës kënga nuk u pre për asnjë çast.

Kishim përse të ishim krenarë!

**Neritan Ceka, student në Universitetin
Shtetëror të Tiranës, 16 mars**

* * *

Me rastin e ngjitjes në majën e Papllukës, një grup prej tre alpinistësh, i kryesuar nga mjeshtri i sportit Minella Kapo, u ngjit në majën më të lartë të Alpeve të veriut, në Jezercë, e cila me rastin e takimit të rinisë se vendeve ballkanike dhe të zonës së Adriatikut në Bukuresht u pagëzua me emërin Maja e Rinisë. Kjo ishte tentativa e katërt për t'iu ngjitur kësaj maje gjatë dirit. Dhe alpinistët, ashtu si në majën e Papllukës, ia arritën qëllimit.

Ekskursion studimi me pionierët

Para disa ditësh, klubi i turizmit i Pallatit të Pionierëve të kryeqytetit organizoi një ekskursion studimi me pionierët në zonën e Shkëmbit të Skënderbeut dhe në pyjet e Mbasdejës të rrethit të Matit. Në këtë ekskursion morën pjesë 55 vetë, nga të cilët 13 vajza.

Një interesim të veçantë ngallën tek të vegjëlit mbeturinat e mureve të qytetit-kështjellë e vjetër, Shkëmbi i Skënderbeut, guri i tij, kureshtja për gjetjen e shpellës së "amaneteve" dhe fytyra e Skënderbeut e skalitur në shkëmb. Në këtë zonë çdo shteg, gur ose shkëmb lidhet me gojëdhana interesante të kohës së lavdishme të heroit tonë legjendar. Turistët e vegjël pasuruan shumë njohuritë e tyre për historinë e Skënderbeut. Duke vizituar këtë zonë pionierët u njohën me vise shumë të bukura. Në këtë drejtim ndihmoi ekskursionin malor në Veri të sharrave të pyjeve të Mbasdejës, pyjet plot pisha të mbuluara me dëborë dhe shumë të përshtatëshme për zhvillimin e skive. Kalimi me litar nga një pishë në tjetrën, provat e ngjitjes dhe zbritjes së shpejtë si dhe shumë lojëra të tjera do të mbeten të paharruara për pjesëmarrësit në ekskursion.

Në bazë të planit që ka klubi një ekspeditë studimi e zbulimi do të vizitojë përsëri Shkëmbin e Skënderbeut, ku do të bëhen tentativa për zbulimin e shpellës së "amaneteve" si dhe do të organizohet një ngjitje në lartësinë e liqenit malor të Mbasdejës.

Luigj Shala, mjeshtrë sporti, 23 mars

Në "polin e tretë" të globit tokësor

Suksesi i shkëlqyer që arritën kohët e fundit alpinistët kinezë ka ngjallur interesim të madh në opinionin sportiv botëror. Ata iu ngjitën majës më të lartë të botës Xhomolungma (Everesti) 8.882 m mbi nivelin e detit.

Suksesi i alpinistëve kinezë qëndron në radhë të parë në faktin se ata qenë të parët në botë që iu ngjitën kësaj maje nga pjesa veriore, gjë që më parë konsiderohej e pamundur për shkak të tufaneve të egëra, erërave të furishme, ndryshimeve të shpeshta të motit, ortiqeve të shumta të dëborës dhe akullnajave të thepisura. Përveç kësaj, kjo ngjitje u bë nga alpinistë të rinj të një vendi që vetëm para pak vjetësh filloi të praktikojë këtë sport të vështirë malor. Bile dy nga alpinistët (Van Fu Çou dhe Çiu In Hua) ngjitjen e parë të rëndësishme e bënë vetëm në vitin 1955 në majën "Lenin" së bashku me alpinistët sovjetikë.

Për lartësinë dhe vështirësitë alpinistike majën Xhomolungma e quajnë prej kohësh "Poli i tretë" i globit tokësor. Grupi i alpinistëve kinezë, i drejtuar nga mjeshtri i sportit i RP të Kinës Shi Çau Çun, e filloi ngjitjen më 25 mars të vitit 1960 dhe e përfundoi me sukses më 25 maj...

15 qershor

Ngjitja përfundoi me sukses

Pishat e gjata, pllajajat plot dëborë, shkëmbinjtë e thepisur dhe ujët e ftohtë e kanë bërë Tomorrit një vend të dashur për rininë e qytetit të Beratit. Si në dimër ashtu dhe në verë, dhjetra të rinj marrin rrugën në drejtim të majave të këtij mali madhështor.

Disa ditë më parë, komiteti i fizkulturës për qytetin e Beratit, organizoi një ekskursion shumëditor në Tomorr, ku morën pjesë 11 të rinj nga qendra pune dhe shkolla. Itinerari, që iu caktua grupit, ishte i gjatë. Ai kalonte nëpër vende të bukura, por njëkohësisht ishte edhe i vështirë.

Natën e parë të rinjtë e kaluan në fshatin Dardhë, buzë Tomorrit. Aty ngritën çadrat dhe përpara se të flinin, alpinistët kaluan disa orë të gëzuara me këngë e valle.

Me të zbardhur drita grupi mori rrugën në drejtim të majës më

të lartë të Tomorrit. Ndryshe nga dita e parë, udhëtimi ishte i lodhshëm dhe me shtigje të rrezikshme. Mbas disa orësh rrugë të 11 vetët u ngjitën në majë. Prej andej filloi kalimi për në Çukën Partizani. Të rinjtë kaluan me sukses pjesën shkëmbore me dëborë dhe akull. Ata natë çadrat i ngritën në mes të Tomorrit dhe alpinistët për të përshëndetur qytetin e tyre të dashur, ndezën një zjarr të madh, i cili u pa edhe nga shumë banorë të Beratit.

Në mëngjesin e ditës së tretë grupi vazhdoi rrugën për tek Çuka Partizani. Itinerari nga kaluan alpinistët e rinj ishte i panjohur. Nëpër të nuk kishin shkelur as barinjte, të cilët janë miq të përhershëm të këtyre anëve. Dhe këtu s'ka asgjë për t'u çuditur. Alpinistët e kanë zakon të shkelin atje ku nuk kanë vënë këmbë të tjerët.

Mbas një udhëtimi të gjatë e të vështirë grupi arriti në Çukën Partizani. Në këtë mënyrë të 11 vetët, që morën pjesë në ngjitje, e përfunduan atë me sukses.

Udhëtimi ngjalli interesim të veçantë tek të rinjtë që të tilla ngjitje i kryejnë për herë të parë. Ibrahim, Kujtimi, Pirua dhe Vlasi qenë më të gëzuar për arsye se u ngjitën në dy maja nëpër rrugë të pashkelura nga të tjerët.

Petra Kule, instruktur alpinizmi, 22 qershor

Ne përfituam shumë nga eksperiencia e miqve gjermanë

Më 11 qershor, u nis për në RD Gjermane një grup alpinistësh i vendit tonë, për të marrë pjesë në një zbor alpinistik. Alpinistët gjermanë na rezervuan një pritje shumë të përzemërt.

Në RD Gjermane nuk ka male të lartë si tek ne. Atje ka vetëm shkëmbinj të lartësisë 30-120 metra. Ngjitja në to bëhet nëpërmjet dy rrugëve : turistike dhe alpinistike. Mijëra të rinj e të reja, burra e gra, pleq dhe fëmijë qenë vizitorë të përhershëm të këtyre shkëmbinjve si turistë. Rrugët alpinistike të shkëmbinjve ku funksiononte zbori ynë (zona Bad-Shandao) përfshinte vështirësi të kategorisë së parë deri në të shtatën.

Më 13 qershor grupi ynë, që shoqërohej nga trajneri shtetëror, mjeshtri i sportit Alfred Barth, bëri ngjitjen e parë tek Shkëmbi i Petritave (Falkenshtajn). Kjo ngjitje ishte e vështirësisë së tretë. Ngjitja

nuk na u duk aq e vështirë, por për mungesë së teknikës patëm vështirësi në zbritje.

Ngjitjen e dytë dhe të tretë e bëmë të kategorisë së katërt. Ishin ngjitje të vështira për shkak të relievit, mosnjohjes së mirë të teknikës dhe të mungesës së stërvitjes paraprake.

Ditën e katërt ne kryem 5 ngjitje, prej të cilave një ishte e kategorisë së parë, tri të së tretës dhe një e të katërtës. Tefta Zguro e Vasil Vreto udhëhoqën dy ngjitje të kategorisë së dytë, ndërsa unë drejtova një ngjitje të kategorisë së tretë.

Në fazën e dytë të zborit ne filluam të aplikojmë mirë teknikën, sodomos atë të zbritjeve. Disa ditë më vonë me grupin tonë u bashkuan edhe alpinistë të tjerë. Së bashku me ta kryem ngjitje të kategorisë së shtatë në shkëmbinjtë Anbos. Ngjitje të kategorisë së shtatë bëmë edhe ditët e tjera. Përgjithësisht grupi ynë kreu 60 ngjitje, nga të cilat 23 Vasil Vreto e unë dhe 14 Tefta Zguro.

Gjatë qëndrimit tonë në RD Gjermane ne përfituam shumë nga eksperiencia e alpinistëve gjermanë, forcuam besimin në forcat tona për ngjitje në faqet shkëmbore, përvetësuam ngjitjen e zbritjen nëpër oxhaqe (të çara të shkëmbinjve në formë oxhaku), mënyrën e sigurimit me litar, bëmë ngjitje të cdo kategorie.

Përveç ngjitjeve, ne vizituam qytetin e Berlinit, Drezdenit, Laipcigut, etj. Vizita jonë në RD Gjermane dhe ardhja e alpinistëve gjermanë në vendin tonë, ndihmoi për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të ngushta miqësore midis sportistëve të të dy vendeve tona.

**Minella Kapo, mjeshtër sporti,
përgjegjës i grupit, 6 korrik**

Alpinistët miq u larguan nga vendi ynë

Para disa ditëve, u largua nga vendi ynë grupi i alpinistëve të Bashkimit Sovjetik, RD Gjermane dhe ai i Republikës Socialiste të Çekosllovakisë.

Alpinistët miq qëndruan në vendin tonë rreth dy javë. Ata, së bashku me disa nga alpinistët tanë më të mirë, morën pjesë në kampin ndërkombëtar të alpinizmit dhe në një zbor kombëtar alpinizmi, që u organizua në Theth me rastin e Kongresit të 4-t të Partisë.

Gjatë qëndrimit në Theth, alpinistët miq, në bazë të një programi të posaçëm, kryen ngjitje të kategorive të ndryshme, të cilat ishin nga më të vështirat të kryera deri tani në vendin tonë.

Në mbarim të programit alpinistik, ata kaluan disa ditë edhe në plazhin e Durrësit.

Korresp. i "Sportit Popullor", 27 korrik

Ekspedita e parë alpinistike*

"...u ul në grupin që isha unë edhe Mustafa Selenica –Xhkja, student i vitit të fundit në mjekësi, i cili na tregoi historinë e një veprimtarie alpinistike :

- Ishim katër : Kozma Grillo, Vasil Stambuli (Shili), Petraq Kule dhe unë. Kishim bërë stërvitje më mirë se herët e tjera dhe ishim pajisur me materiale aq mirë sa mundeshim, ngaqë do të kryenim një veprimtari më të avancuar se më parë. Në fund të nëntorit të vitit 1960 u nisëm për në Theth. Udhëtimi për atje është i bukur, veçanërisht kur shkon nëpërmjet Qafë Thores. Me "thore" malësorët kuptojnë diçka që vjen rrotull e rrotull.

...Qëlloi që ishte vjeshtë e thatë dhe makina na çoi deri në lagjen më veriore të Thethit, në Okol. Ishte një lehtësi e madhe për ne. Nuk e prisnim që të gjenim alpet pa dëborën e nëntorit. U ndamë me shoferin. Bujtëm në shtëpinë e një fshatari. Tre orë pasi u futëm në shtëpi nisi dëborra. Bisedonim me të zotët e shtëpisë rreth oxhakut. Sipas zakonit, për të na nderuar ne (miqtë) kishte ftuar edhe tre fqinjë. Ishte një bisedë e përzemërt, ku ne flisnim më shumë se malësorët na drejtonin shumë pyetje që kishin të bënin me jetën në Tiranë.

Kur pa pritur, pamë që Shili u ngrit, vajti tek çanta, nxorri ditarin për të shkruar, mirëpo nuk po gjente stilografin. U kujtua se e kshihte vendosur në xhepin e xhakoventos, por nuk e gjeti.

- Do të më ketë rënë afër Qafës së Thores, atje ku zbritëm dhe shtymë makinën.

- Je i sigurt që e more stilografin, pyeti Petraqi.

- Si ta zë goja, o Petraq! Ku vjen Shili në këto anë pa stilograf, ironizoi Kozmai.

- Rri Kozhma. Unë mbeta pa stilograf, kurse ti...Me se do i marr leksionet tani?

- E po na marrtë të keqen stilografi, o Vasil, ndërhyri Petraqi. Gëzuar juve-iu drejtua ai të gjithëve, duke ngritur gotën.

Të nesërmen, të ngarkuar rëndë u nisëm herët për në Gropat e Bukura. Dëborë nuk binte, por agjë nuk premtonte mot të mirë.

Në më pak se dy orë mbërritëm tek Shpella e Pejës. Kozmai i mori dylbitë Shilit dhe po sodiste. Pa pritur, ai tha :

- Shili, po shoh një shtilograf!

Shili brofi në këmbë, i mori dylbinë Kozmait dhe nisi të vrojtonte...

Kozmai e ngacmon hera-herës Shilin, dhe duke marrë shkas nga çiltërsia e tij. Ata janë shokë e miq të vjetër.

Rinisëm marshimin. Si arritëm sipër në qafë, morëm djathtas për tek Gropat e Bukura. Në njërën nga ato ngritëm çadrat. Të nesërmen, herët, me dyshe, u nisëm drejt Majës së Kolajve. Zgjedhëm një korridor, i cili për disa qindra metra alternohej edhe me oxhakë. Thuajse të gjithë itinerarin, i shkallës së pestë të vështirësisë, e udhëhoqi Shili. Kur mbërritëm në majë, u përqafluam dhe uruam njëri-tjetrin. Për zbritje gjetëm një itinerar të thuajse të lehtë...

Të nesërmen u nisën për në Majën e Papllugës, e cila para pak kohe është emërtuar Maja 8 Marsi. Arritëm nëpërmjet një itinerari të lehtë.

Ditën e tretë u ndamë në dy grupe. Kozmai dhe Shili u nisën për në majën e Alisë, kuse unë me Petraqin për në atë të Arapit. Kozmai dhe Shili u sorollatën për një kohë shumë të gjatë nëpër mjegull rrëze msajës dhe pas katër orësh ecjesh dolën në gjurmët e tyre të fillimit. Të dëshpëruar nga kjo sorollatje, u kthyen dhe zbritën tek Shpella e Pejës, ku kishim lënë takimin. As unë me Petraqin nuk arritëm të ngjitemi në Majën e Arapit.

...Në etapën e dytë të programit, ne do të kryenim ngjitje në zonën e Valbonës. Pajtuam dy mushka, me kafshar Kol Prekën, për çantat dhe u nisëm herët në mëngjes. Kur filluam të përpjetën e lagjes Gjellaj, Shili iu drejtua komandatit - Kozmait :

- Kozhma, unë them të shkoj e të kërkoj shtilograf.

Kërkesa e tij ishte krejt e pabazë për secilin nga ne, por këmbëngulja e Shilit nuk hante logjikë. Më në fund ne i uruam udhë të mbarë. U nis i gëzuar në të kundërtën e drejtimit tonë....

...Sa zbritëm nga qafa, tek Buni i Valbonës, Kozmai e Petraqi u

nisën për në Majën e Alisë. Me Kolën dhe dy mushkat qëndruam tek shtëpia e Shpendit. Kur po ngrysej erdhi Shili. E gjithë qenia e Shilit futi në dhomë ajrin e ftohtë dhe gjallërinë. Pyetjet që i drejtuan malësorët nuk kishin të sosur se e njihnin atë. Kur gjallëria e bisedës nisi pak e nga pak të fashitej, e pyeta nëse e gjeti stilografin.

- Jo, nuk e gjeta. Më vajti kot tërë ajo rrugë, më tha duke thartur fytyrën

- Shili, tek të shoh këtu në këtë orë, nuk po më besohet të kesh vajtur deri atje, - i shpreha habinë, duke u munduar t'i japë zërit tonë zbutës ngaqë druhesha se mos i mbetej hatëri për mosbesimin.

- Vajta, si nuk vajta! – tha ai tërë seriozitet e gaz. Madje u ngjita edhe në majën e Alisë, - shtoi tërë shënd e verë, duke e ngritur dorën lart si për të treguar majën.

- Shili, tani vërtet nuk pot ë besoj! Më duket si shumë për t'u bërë brenda një periudhe kohore...

- Në daç besojë e në daç mos e beso, por unë vajta në Thore, aky ku mendoja se më kishte rënë stilografi dhe nuk e gjeta, por Majën e Alisë unë e ngjita. Madje jo pa peripeci : ndërsa poi zbrisja nga korridorin verior, kur arrita në rrëzë të tij, desh e pësova nga një ortek gurësh e akulli që ranë afër meje.

Ndoshta do të ketë qënë ndonjë masë e hedhur nga Kozmai e Petraqi, se ata u nisën për në Majën e Alisë. Habitem si nuk jeni takuar. Tani vërtet që po shqetësohem për vonesën e tyre.

- Jo more! – tha i habitur Shili. Mendoja se po flenë kur nuk i pashë këtu.

- Jo, jo. Nuk po flenë. Pres çdo minutë që të shfaqen në derë.

- Ngrehu të shkojmë e t'u dalim përpara a ndoshta t'i kërkojmë. Ti, Shpend, në rast se nuk kthehem për dy orë, shko njofto në postën e kufirit dhe u thuaj që disa kufitarë të na ndihmojnë në kërkimin e tyre. Ne do të ecim në këtë drejtim...

Kish kaluar mesnata. Morëm dy elektrikë dore, pajisjet alpine, ca ushqime dhe ujë dhe dolëm jashtë, duke u mbushur mendjen njerëzve të shtëpisë që donin të vinin me ne.

Ishte natë e ftohtë, por e bukur. Hëna në qiellin pa re i jepte ngjyën e argjendtë majave. Ecnim përpjetë luginës me temp mjaft të lartë. Më habiste freskia fizike e Shilit, i cili kishte kaluar një ditë shumë të lodhshme. Si ecëm një copë rrugë, m'u drejtua :

- Mustafa! Ia marrim një kënge? Mbase na dëgjojnë shokët e na kthejnë përgjigje.

- Arsyeya që më tha nuk ishte kryesoria. Në zonat kufitare, natën nuk lejohej që të lëviznin njerëz, ishte një lloj shtetrrethimi, për të mos lejuar diversantët që mund të hynin në Shqipëri, ose për të mos lejuar arratisjen e ndonjë malësori. Kjo ishte shumë rigorozë në vitet pesëdhjetë. Malësorët për t'u larguar disa qindra metra larg shtëpisë duhet të merrnin pa tjetër një fener dhe ta mbanin afër fytyrës, që të identifikoheshin nga kufitarët që patrullonin. Ishte kjo arsyeja kryesore që ai tha t'ia marrim një kënge. Dhe ia nisëm, kur as unë as ai nuk dinim të këndonim.

Në atë bukuri e qetësi përrallore, si kishim ecur më shumë se një orë, pa pritur dëgjuam një thirrje tepër të ashpër :

- Ndaaal!

Ndalëm menjëherë këngën dhe ecjen.

- Duart lart! Urdhëroi i njëjti zë. Drejtimin nga vinte zëri e kuptonim por njeri nuk shihnim.

Unë i ngriti duart, ndërsa Shili tha me ton dashamirës :

- Jemi alpinistë e kemi dalë të kërkojmë dy shokët tanë.

- Për herë të fundit, duart lart!

Duke turfulluar, edhe Shili i ngriti duart.

- Hidhni poshtë armët!

- Nuk janë pushka, por kazhma alpine, sqaroi Shili me zë që përcillte inat.

- Pa fjalë! Armët poshtë!

Unë e hodha menjëherë kazmën, kurse Shili liroi togzën e rripit të saj dhe kazma i rrëshqiti e i mbeti e varur në trup. Nuk dorëzohej kollaj Shili.

- Të shqarohemi more shokë kufitarë!

- Pa fjalë se t'i hodha trutë në erë! Zëri gjithnjë e më i ashpër u shoqërua me një kërcitje që të kujtonte mbushjen e armës.

- Ndriçoni fytyrat!

Ndriçuam fytyrat.

- Përgjegjësi, pesë hapa para!

Sapo Shili hodhi hapin e pestë, nga një kaçube aty afër shpërthyen të qeshura të forta. Ishin Kozmai e Petraqi, të cilët ishin shtrirë barkas mbi dëborën e ngrirë. U hodha mbi ta në

dëborë dhe i përqafova. Deri sa bënin shaka të tilla, ishin mirë.

Pranë zjarrit, duke u gdhirë ata na treguan se kishin vuajtur në kurrizin që të nxjerrë në majë. Majën nuk e kishin marrë. Në t'u ngrysur vendosën të zbrisnin. Ishte një zbritje që ata të dy do ta mbajnë mend për shumë vjet....

Qëllimi i kësaj ekspedite ishte të studiohej mundësia sa alpinistët janë në gjendje të përballonin qëndrimin larg qëndrave të banuara dhe të bëhej kalimi nga një zonë malore në një zonë tjetër. Kështu, u bë kalimi nga Lugina e Valbonës në Zhabore, prej këtej në Curraj, Majën e Hekurave, liqenin e Ponareve. (Shënimi ynë : Kozma Grillo).

* **Ky shkrim është marrë nga libri i Aleksandër Bojaxhi : Nëpër Bjeshkët e Namuna.**



1961

Kalendari Sportiv Kombëtar

Alpinizëm

1. Janar-qershor : Ngjitje malore lokale.
2. 11 janar : Ngjitje kombëtare në majën e Jezercës.
3. 8 mars : Ngjitje kombëtare në majën "8 Mars" (Papllugë).
4. 16-30 korrik : Ngjitje kombëtare në zonën Theth-Valbonë.
5. 7 nëntor : Ngjitje kombëtare në Grykat e Hapura.
6. 23 nëntor : Ngjitje kombëtare në majën e Rinisë (Jezercë).
7. 28-29 nëntor : Ngjitje kombëtare në 4 majat më të larta :
Korab, maja e Paqes, Paping dhe Tomorricë.
8. Shtator-nëntor : Ngjitje malore lokale.

18 janar

Alpinistët në Jezercë

Me rastin e 15-vjetorit të shpalljes së Republikës dhe në kuadrin e aktiviteteve për nder të kongresit të 4-t të Partisë, më 11 janar një grup alpinistësh që përfaqësonin rrethet e Korçës, Lushnjës, Shkodrës, Peshkopisë dhe Universitetin Shtetëror të Tiranës u ngjit në majën e Jezercës.

Nisja u bë nga Tirana më 8 janar. Mbasi mbërritëm në Shkodër u nisëm për në Bogë, ku kaluam natën. Dëbora ishte aq e shumtë sa që kishte zënë edhe fshatin. Tentativat e shoferit për të vazhduar rrugën nuk dhanë sukses dhe ne u detyruam ta vazhdonim rrugën me këmbë.

Dëbora që sa vinte e shtohet dhe pesha 25-30 kg. e çantës së shpinës, e bënin udhëtimin edhe më të vështirë. Por megjithëkëtë alpinistët vazhdojnë rrugën, duke çarë dëborën dhe duke kaluar vështirësi pas vështirësish. Arritja në qafën e Thores shton edhe më tepër mobilizimin e pjesëmarësve. Vazhdojmë rrugën drejt Kaprejt. Në Kaprej pushojmë për të ngrënë drekën. Kur arritëm në Theth ishte natë, të cilën e kalojmë shtëpinë e një fshatari.

Të nesërmen vazhduam rrugën, e cila deri tek 5 çezmat nuk paraqiste ndonjë vështirësi. Këtu na pritën kufitarët. Ne i vumë si detyrë vetes të ruajmë më tepër forcat për udhëtimin që do të bënim më 11 janar. Në Shpellën e Pejës vendosim kampin. Filloi prerja e druve dhe ujët e dëborës valonte në kusinë e vendosur në zjarr. Biem për të fjetur.

Aty nga ora 1 mbas mesnate dëgjohet zëri i Teftës që lajmëron se koha është shumë e bukur. Mbas një ore e gjysëm fillojmë përsëri rrugën. Vehbi Seiti i Shkodrës çan i pari dëborën që arrin deri në mes. Pas shumë përpjekjesh, më në fund shohim Jezercën. Vazhdojmë rrugën. Dëbora që ka mbuluar gjithçka na i afron objektet, na gënjen, sa kalojmë një pengesë na del një tjetër më e vështirë dhe më e gjatë.

Detyrohemi të bëjmë ecje kurrizore dhe mbas ca arrijmë në një luginë mbi të cilën qëndron maja e Jezerës. Për të evituar rrezikun e ortekut të mundshëm ndahemi në grupe. Mbas gjithë atyre peripecive arrijmë faqen jugore të majës, pjerrësia e së cilës është 70-80 gradë. Duart i kemi pak të ngrira, por vazhdojmë të ecim dhe të afrohem gjithnjë e më tepër majës. Më në fund, ja dhe maja e Jezercës, maja më e lartë e Alpeve.

Gëzimi ynë ishte i madh. Kjo më tepër për faktin se ne ishim alpinistët e parë që iu ngjitëm kësaj maje në muajin janar. Era e fortë nuk na lejon të shijojmë një panoramë me të vërtetë të mrekullueshme. Marrim rrugën e zbritjes, që tani ka më pak vështirësi.

Nisemi herët nga Thethi. Si kalojmë Shtegun e Dhënëve zbresim në Bogë, ku qëndrojmë në shtëpinë e Fran Pjetrit, ku alpinistët kanë bujtur sa herë që kanë marrë rrugën drejt majave. Më 14 janar mbërritëm në Tiranë.

Me këtë rast, në Komitetin Qëndror të BRPSH-së, u organizua një takim me alpinistët, në të cilin ishte i pranishëm edhe shoku Sami Baholli, sekretar i Presidiumit të Kuvendit Popullor. Në këtë takim ne u përgëzua për suksesin e arritur dhe na u dhanë fletë-lavdërimi.

Andon Tapia, udhëheqës i grupit, 18 janar

Në majën "8 Marsi"

Për nder të 8 marsit, një grup alpinistësh, i përbërë prej 5 vetësh, u nis nga Tirana për në majën 8 Marsi (Papllugë). Grupi drejtohej nga alpinisti i kategorisë së parë Petraq Kule dhe përbëhej nga Taxhedin Shehu, Themistokli Garuli, Gjyljana Bakrina dhe unë.

Deri në Bogë rrugën e bëmë me makinë. Prej andej shkuam në Theth ku mbërritëm natën vonë. Mbasi pushuam atje, si mysafirë tek kufitarët, të nesërmen u nisëm për tek shpella e Qafës së Pejës me qëllim që të ishim sa më afër majës dhe të përgatiteshim sa më mirë për ngjitjen.

Duke aguar 8 marsi, filluam ngjitjen. Në majë arritëm pas 7 orësh. Të gjithë ishim të gëzuar pa masë për suksesin e arritur. Ndonëse dimri nuk ka dalë dhe malet janë me dëborë, koha që shumë e bukur, gjë që na lejoi të kalonim një ditë të gëzuar. Mbasi pushuam pak morëm rrugën e kthimit...

**Eleni Isak, pedagoge,
alpiniste e kategorisë së tretë, 15 mars**

Alpinistët në Theth

Sipas kalendarit sportiv kombëtar, të dielën e kaluar, u nis për në Theth një grup alpinistësh prej 45 vetësh, midis të cilëve edhe 5 femra, të 10 rretheve.

Gjatë 15 ditëve, me fillestarët do të organizohet zbori alpinistik, ndërsa ata me kategori, të ndarë në dy grupe, do të kryejnë 20 ngjitje për njohjen e itinerarëve që do të sulmohen në nëntor me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë.

Udhëheqës i grupit është Kozma Grillo, alpinist i kategorisë së parë.

Korresp. i "Sportit Popullor", 19 korrik

1962

Kalendari Sportiv Kombëtar *Alpinizëm*

1. Janar: Zbore alpinistike me sportistët alpinistë e turistë më të mirë, sipas udhëzimeve të KKFS.
2. 8 mars: Ngjitje kombëtare në Majën 8 Marsi.
3. 16-30 korrik: Ngjitje kombëtare në zonën Theth-Valbonë.
4. 28-29 nëntor: Ngjitje kombëtare në 4 majat më të larta.

Pjesëmarrja:

Në të katra ngjitjet me elementë të caktuar nga qendra.

6 janar

Vizitoni Dajtin!

“Shokë!...u bë traditë që studentët të kalojnë pushimet në zborin alpinistik të Dajtit...”. Dikush qeshi nga fundi i sallës, pastaj filluan të qeshin të gjithë me fjalët e Shilit (Vasil Stambuli, shënimi im : K.G.), deri sa Osmani u hodh e tha :

“Ç’traditë është kjo, kur ne e dimë se sivjet ky është zbori i dytë?!”.

Kjo ndodhi më 1958. Prej atëhere kane kaluar 4 vjet. Por në rast se unë do të them tashti se po bëhet traditë që më 15 janar me dhjetra studentë, pedagogë dhe mjekë, me çanta në shpinë, nisen nga Kinostudio për në Dajti, për të kaluar pushimet në zborin alpinistik, të cilin e organizon Klubi Sportiv “Universiteti” dhe Këshilli Qëndror i BPSH-së, asnjëri nuk do të qeshi me mua.

Sivjet në dispozicionin tonë është vënë pallati i madh i kampit të pionierëve, kështu barangave të vjetra, ku na priste xha Faslliu, ua zunë vendin dhomat e mobiluara mirë, kaloriferët dhe dushet e ngrohta, që disa vjet më parë për ne ishin ëndërr.

Ne qëndruam këtu vetëm 12 ditë, që për ne do të jenë të paharruara. Orët kalonin çuditërisht shpejt - paradite duke punuar me kazmën alpine, dëborën apo shkëmbin, ndërsa mbasdite me

aktivitetet e spartakiadës ndërmjet togave dhe skitë. Është e vërtetë që 15 palë ski ishin gjithsej, por asnjëri nuk mbeti pa i provuar ato dhe asnjëri nuk mbeti pa u rrëzuar ditën e parë.

Por si mund të flasësh për jetën tonë në Dajt pa kujtuar Latifin, xhezbanistin tonë të famshëm, që u përgjigjej komplimentave tona duke thënë : “A thua?...”. Si mund ta harrojmë ne Luanin kur e mendojmë në mbrëmjet e vallëzimit të veshur si vajzë...

12 ditë që kaluam në Dajt nuk ishin vetëm 12 ditë që kaluan duke qeshur e plot hare. Ato qenë edhe 12 ditë pune. Pothuajse të gjithë erdhën këtu pa ditur se ç’është kazma alpine, por ata mësuan plot gjëra për alpinizmin, bile një pjesë e tyre edhe zbritjen Dulfer jo vetëm në shkëmbinjtë mësimorë, por edhe nga taraca e kampit deri në katin e parë.

2 *shkurt*. Qetësinë e Dajtit të veshur me të bardha e prishi bilbili i dezturnit. Në dhomat e gjumit njerëzit filluan të lëvizin. Lëvizjet e tyre janë të shpejta ca nga të ftohtit e një mëngjezi dimri, që rritet kur shikon që nga dëborë të ndan vetëm një xham dhe ca nga që nuk duhet vonuar në rresht. Të veshur me tuta, sot të katër togat nuk dolën për të bërë gjimnastikën e mëngjesit, mbasi sipas urdhërit të ditës do të zhvillojnë ekskursion njëditor.

Herët në mëngjes, kur thellimi të çpon hundën, drejtohem nga shkalla e Tujanit duke ecur mbi dëborën e butë që kishte rënë gjatë natës. Por mos pandehni se ne ishim të parët që kaluam mbi dëborën e re. Ne pamë gjurma kafshësh të egra, bile nuk është çudi të ishin edhe gjurma të një ujku që takoi Shili në rrugë...

Në fund të fushës së Dajtit u ndamë në dy drejtime. Toga speciale (“caracat” – siç u thonin me pak zili) filloi të zbriste poshtë. Itinerari i saj është më i gjatë dhe më i vështirë. 3 togat e tjera filluan t’i ngjiten shpatit të majtë për të hipur në majën e 20-vjetorit dhe prej andej në majën më të lartë të Dajtit.

Çdo rrugë ka peripecitë e veta, por këto bëhen akoma më të shumta kur ecën mbi dëborë ose mbi shkëmbinj të mbuluar me një shtresë të hollë akulli, kur aq shumë e do litarin dhe kazmën.

* * *

12 ditët e qëndrimit në Dajt kaluan. U ndamë nga Dajti mikpritës me një ndjenjë mallëngjimi, por njëkohësisht edhe të gëzuar.

Të gëzuar për ditët e bukura që jetuam atje dhe po aq të gëzuar sepse prapë do të kthehemi tek ai. Prandaj s'na mbetet të themi gjë tjetër vetëm t'u drejtohemi me thirrjen : "Vizitoni Dajtin!".

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 10 shkurt

Detyra u plotësua

Disa ditë më parë, Klubi Sportiv "Universiteti" organizoi një ngjitje alpinistike në majën e Tomorrit.

Rruga që do të përshkonim ishte sa e gjatë aq dhe e vështirë. Atë e bënte më të lodhëshme edhe dëborë e madhe që ra një ditë më parë. Në mesditën e 23 shkurtit u ndodhëm në lartësinë 2.000 m. Për t'ia arritur qëllimit duheshin përshkuar edhe rreth 500 metra. Por këto metra përbënin pjesën më të vështirë të ngjitjes. Më e shumta e kësaj distance u kalua duke përdorur litarët. Më së fundi, rreth orës 17 arritëm në majë. Detyra e caktuar u plotësua.

Mbas një pushimi të shkurtër, filloi zbritja. Ishin minutat që muzgu i mbrëmjes po i lëshonte vendin errësirës së natës. Koha u prish pa pritje dhe nisi furtuna - erë e dëborë. Ecëm edhe pak, por më tutje nuk mund të shkohej. U vendos të qëndronim sa të mekej pak furtuna. Jemi në lartësinë 2.303 metra. Qëndrojmë më kot se koha nuk ka ndërmend të përmirësohet sado pak. Mbas shumë përpjekjesh, dhe në sajë të vendosmërisë dhe guximit të udhëheqësit të grupit - Mustafa Selenica, u gjet shtegu për të zbritur në fshat.

Megjithëse vështirësitë qenë shumë të mëdha : rruga e gjatë dhe e lodhëshme, qëndrimi një natë në dëborë pa zjarr, shqetësimet nga egërsirat etj., morali i pjesëmarrësve në këtë ngjitje ishte i lartë dhe vullneti i tyre për t'ia arritur qëllimit i madh.

Stefan Grillo, 28 shkurt

Tre ngjitje të paparashikuara në Kalendarin Kombëtar Sportiv

Ishin ditët e fundit të verës të vitit 1962. Minella Kapo, Vasil Stambuli dhe unë (Kozma Grillo) hipur në një Gaz-69 të vjetër, si ai, u nisëm për në jug. Ishte hera e parë, (fatkeqësisht dhe e fundit)

që fluturonim nga gëzimi, se ishim me kuptimin e plotë të fjalës miq. Kuptohet që këto ngjitje në rrugë shtetërore i kishte rregulluar Minella.

1. Faqja shkëmbore e Nemërçkës

Me atë makinë, aq të moshuar por që nuk donte “të vdiste”, mbërritëm në Çarshovë (rrethi i Përmetit). Para se të sistemoheshim në hotel, me sy dhe dylbi, vështruam për një kohë të gjatë masivin shkëmbor të Nemërçkës. Pas kësaj nisën bisedat me vendasit, nga të cilët mësuam që asnjërit nuk i kishte shkuar në mendje të kalonte mes për me këtij masivi me përmasa gjigante, pa lëre të ngjitej për të vajtur në rrehtin e Gjirokastrës. Me dashamirësi na thanë:

- Kur e keni punën kështu, çfarë ju duhet të rrezikoni jetën, dilni në Gjrokastrë nga Qafa e Gomares. Pavarësisht që është zonë kufitare, ju keni leje. Këto leje nuk u duhen po t’i futeni malit përpjetë se jo vetëm që nuk do të ndeshni me kufitarë, por as me njeri të gjallë.

Të nesërmen, mbasi kishim shtegtuar disa orë, mbërritëm në rrëzë të tij. Ditë vere...Sistemua pajisjet. Kishim marrë me vete çantat e vogla.

U nisëm... Ishim të lidhur në të njëjtin litar. Gozhdë dhe çekiçë kishim me tepri. Por, për të fituar lartësi, nuk na u deshën, se kjo faqe shkëmbore ishte me gur të thyer dhe të mbuluar me bar. Kështu i vetmi rrezik mund të na vinte vetëm nga rrëshqitja. Muzgu dhe orët e para të natës na gjetën duke u ngjitur. Kur nuk na ndriçonte më hëna dhe elektriku i dorës i Shilit, vendosëm ta kalonim natën në gjirin e këtij masivi.

Ky masiv u tregua bujar me ne se nuk na detyroi të ngulnim dhe të hiqnim gozhdët alpine. Por nuk na dha kënaqësinë që të gjenim qoftë edhe vetëm dy metra katrorë të shtriheshim. Kështu, duke ndjerë pak edhe të ftohtin e natës në atë lartësi, filluam të punonim më gozhdët. Na u desh të ngulnim shumë gozhdë afër njëra tjetrës, se futeshin shpejt në ata gur të thyer të veshur me bar. Me fjalë të tjera, nuk kishim besim në to. Pas kësaj nisi etapa e dytë. Secili kaloi litarin e lidhjes personale në çelësat e gozhdëve të ngulura. Filluam të hanim diçka, por a u zu “në grykë”, se moti ndryshoi aq shpejt sa plasja e një shashke. Me kapriço të tilla ishim mësuar në dimër, por tani mësuam se ato mund të jenë të pranishme edhe në verë. Shkrepëtimat dhe bubullimat nisën avazin e vjetër. Ishin aq të padurueshme sa filluan të na trembnin.

E dinim që nuk kishim çfarë t'u bënim, por nuk harruam të vinim në jetë rregullin, që Minella na e kishte mësuar ne të dyve, dhe unë e Shili ua kishim mësuar dhjetra e qindra të tjerëve. Për të pasur "ndërgjegjen e pastër" mblodhëm atë grumbull të madh objektesh metalike (kazma, gozhdë, çekiçë, çelësa), i lidhëm midis tyre dhe Shili i shpuri rreth 100 metra larg nesh, ku i lidhi në gozhdët alpine që nguli në mesnatë.

Kur u kthye, të tre ishim bërë qull. Nuk mjafton që lageshim nga shiu, por edhe nga uji i shpatit të malit që zbriste poshtë. Secili në një pozicion as në këmbë, as ulur, as shtrirë, të kapur në litarin e sigurimit prisnim...Më e lodhshmja ishte kur duhet të ndryshonim sado pak pozicionin për të shpëtuar nga mpirja...Për të fjetur atë natë as që bëhet fjalë, por edhe ajo gjendja "as zgjuar as në gjumë" nuk vazhdonte gjatë se e prishnin rrufetë.

Rrinim të tulatur. Kur rrezet e diellit nisën të na ngronin sado pak, u ngritëm, mblodhëm të gjitha pajisjet, edhe çadrën, duke siguruar njëri-tjetrin, mbërritëm në kurriz, shumë afër majës. Aty u shtrimë sa gjerë-gjatë për të mbledhur veten. Pas 24 orësh dëgjuam lehje qënsh. E kuptuam që ishim pranë një stani, por krijuam bindjen kur dëgjuam çobanët që i thërrisnin se kishin marrë rrugën përpjetë për të na "takuar" neve.

Sa mbërritëm tek stani, ku shihej se edhe ata nuk e kishin kaluar mirë atë natë, njëri na u drejtua me pyetjen :

- E morët vesh se ç'ndodhi dje?

Kishim dy ditë që i kishim prerë lidhjet me qytetërimin. Ku nuk na shkoi mendja...E mësuam nga fjalët e tij :

- Natën rrufeja vrau shokun tonë (fatkeqësisht emri nuk më kujtohet: K.G.). Ishte deli djalë. Nuk i kishte mbushur të njëzetepesat.

Por edhe gjëmë, ata na sejdisen, na dhanë nga një çanak me qumësht. Duke pirë qumësht, pamë që dy çobanë po zbrisnin duke tërhequr një mushk me kufomën të ngarkuar mbi të...Kishin rrugë të gjatë deri tek shtëpia e tij, në fermën blegtorale "Asim Zeneli" në Gjirokastër...

Nga ajo natë-ditë kanë kaluar 47 vjet. Ai i shkreti nuk ka qenë as 200 metra në vijë të drejtë larg nesh. Ai kishte një kërrabë në dorë, ndërsa ne kishim me dhjetra kilogram objekte metalike. Nga ato që më kanë mbetur në mendje nga lënda e fizikës, ajo rrufe duhet të kishte rënë mbi ne dhe jo të vriste atë fukanë.

Mos vallë ngjarje kaq të mëdha "janë të shkruara"?

2. Guri i Capit

Të nesërmen, në Çarshovë na priste Enveri, i cili nuk lejonte që atë makinë aq të lodhur ta varrosnin. U nisëm për në Korçë. Nuk e kuptoj përse nuk më është fshirë nga kujtesa fakti që te "Turizmi" hëngrëm një akullore aq të shijshme. Madje pa mbaruar mirë njërën morrëm edhe nga një tjetër. Si duket janë lojëra të kujtesës njerëzore...

Pa mbaruar mirë, erdhi të na takojë alpinistia Tefta Zguro. Opinionet, pyetjet përgjigjet - biseda që vazhdoi orë të tëra, u fokusua tek Guri i Capit. Dija nga alpinistët korçarë, që është një shkëmb rreth 100 metra i lartë, është shumë i vështirë për t'u ngjitur. Asnjëri nuk është ngjitur në të. E mësuam që Guri i Capit ishte i virgjër.

Të nesërmen në mëngjes, morëm edhe Teftën me vete, nëpër një rrugë të bukur turistike, pas dy tre orësh, mbërritëm tek Guri i Capit. Është një shkëmb mbresëlënës. Nisëm të vrojtonim mundësinë për të hipur në majë të tij.

Menduar dhe vendosëm si do të vepronim. U shkëputëm nga toka, morëm një tranvers në të djathtë dhe pa vështirësi mbërritëm aty ku ajo mbaronte. Është një platformë shumë e vogël, poshtë saj është humnerë, filluam të vetësiguroheshim.

Veshëm pajisjet. Segmenti që do të kacavirreshim i ngjante një grumbulli tejet të madh betoni me gurë të mëdhenj. I pari në litar u lidh Shili, Tefta në mes dhe unë i treti.

Shili nisi nguljen e gozhdëve. Gozhdët e zakonshme, pas dy tre goditjeve me çekiç, shtrëmbëroheshin. Më të fortat nguleshin më tepër, por tingulli i mbytur që dëgjonim nuk na pëlqente, nuk kishim besim në to. Është kjo arsyeja që në atë paret u ngulën më shumë gozhdë se zakonisht. Së fundi mbërritëm të tre në majë.

Nga maja nisëm të vrojtonim peisazhin. U habitëm kur pamë, rreth 300 metra larg nesh, të ulur në monopatën që zbret në fshatrat e Devollit këmbësorë, që shihnin aventurën tonë... Lajmi u hap shpejt në Devoll...

Si bëmë ritet "e zanatit", në ekstremin e një litari personal varëm një kuti, ndërsa ekstremin tjetër e fiksuam në majë. Edhe atë ditë që frynte pak erë, kutia lëvizte majtas-djathtas-majtas si

një pendul sahati. Qëndroi atje e varur vite e vite derisa u kalb litari.

Nisëm zbritjen. Në fillim sigurova Shilin dhe pastaj Teftën. Më erdhi radha. Për shkak të gozhdëve, përjetova emocione të mëdha, ndoshta jo frikë. Aty ku fillon zbritja thuhet se 90 gradëshe, qëndrova. Pashë që litarin, që vinte nga Shili që më siguronte, mund ta kaloja në një të ngritur të rrumbullakosur. Në rast se litari nuk do "të dilte" nga ajo formë e rrumbullaktë, duke lëshuar nga fare pak unë isha i siguruar nga lart. Gjithçka përfundoi mirë.

3. Kanioni i malit të Çikës

Po me atë me makinë që nuk donte t'i "dilte shpirti", të nesërmen u nisëm në drejtim të Himarës.

Të treve na u mbush mendja se unë duhet të kthehesha. Mësova nëpërmjet telefonit, se eprorët e mi, si kishte kaluar një javë që unë isha "i sëmurë", donin që kolegët e mi (P. Papalilo dhe V. Vreto), që u kishin dhënë këtë lajm, të vinin të më vizitonin në spital...

Kur Minella dhe Shili u kthyen, mësova se ata respektuan planin që kishim hartuar para se të niseshim: Do të nisnin ngjitjen e kanionit në afërsi të Urës së Palasës. Pastaj, çfarë të dilte përpara. Ishte një ngjitje e vështirë. Çdo çast nën kërcënimin e gurëve që binin nga lart.

Ata mbërritën në majë të Çikës kur ishte errësuar. Nisëm zbritjen për të gjetur një shesh të kalonin natën. Kur, pa pritje dëgjuan një zë të egërsuar që bërtiste:

- Ndal!

Si dëgjoi këtë urdhër, Shili iu përgjigj me "shqipen" e tij :
" Ti shoku, ne alpinishta!".

Çobanëve u kishin thënë ata të organizatës-bazë të partisë, jini vigjilentë se tani diversantët i hedhin edhe me parashutë. Si dëgjoi fjalët e Shilit, ai lëvizi llozin e pushkës...

Nisi Minella me gjithë fuqinë e zërit t'i bënte autobiografinë...

Edhe kur u ulën pranë zjarrit me çobanët, Shili vazhdonte të turfullonte.

Një aksident alpinistik

DUSHANBA, (TASS).

“Ishte thjesht një aksident dhe për këtë fatkeqësi askush nuk ka faj. Kjo mund t’u ndodhte edhe alpinistëve të tjerë” - deklaroi përgjegjësi i delegacionit të alpinistëve anglezë, Xhon Hant, lidhur me vdekjen e dy shokëve të tij. Ai tregoi, kur arriti në Dushanba, se si u bë ngjitja dhe si vdiqën dy alpinistët anglezë.

Më 14 korrik, tha Hanti, ekspedita alpinistike sovjeta-angleze vajti në jugperëndim të Pamirit, në bazën alpinistike rrëzë majës Garmo. Atje u ndamë në tri grupe. Çdo grup përbëhej nga katër alpinistë anglezë dhe dy sovjetikë. Grupi i parë, në të cilin bënte pjesë një nga alpinistët më të fortë anglezë - Uilfrid Nojs, filloi ngjitjen nëpër një shteg të panjohur për në majën “Patriot” nga ana e perëndimit. Nga ana tjetër u nisën drejt kësaj maje alpinistët e grupit të dytë.


Grupi i tretë, të cilin e drejtoja unë, u nis nëpër një rrugë të re për në majën e panjohur në një lartësi 5.600 m. Kur u ngjitëm në këtë majë, me propozimin e anëtarëve të ekspeditës, asaj iu dha emëri “Miqësia”.

Ndërsa po ktheheshim prej kësaj maje, unë shkova në grupin e parë e të dytë që t’i pyesja se mos kishin nevojë për ndonjë ndihmë. Të dy grupet nuk kërkuan asnjë ndihmë dhe unë u ktheva në bazë, ku duhet të takoheshim më 25 korrik të gjithë. Po në bazë zbritën vetëm katër vetë nga grupi i dytë. Ata na treguan për fatkeqësinë që u kish ndodhur gjatë rrugës dy anëtarëve të tjerë të grupit - alpinistëve anglezë Uilfrid Nojs dhe Robin Smitit, ky i fundit ishte pjesëmarrësi më i ri i ekspeditës.

Më 26 korrik u nisëm të gjithë të gjenim Nojsin dhe Smitin. Ata i gjetëm në lartësinë 5.200 m dhe i varrosëm në akullnajat “Vavilov”.

Kjo fatkeqësi kishte ndodhur kështu, vazhdoi Hant. Pas ngjitjes në majën “Patriot” grupi u nis të kthehej në bazë. Ecnin dy e nga dy. Përpara tyre ishin Nojsi dhe Smiti, pas tyre, pak më prapa, vinin dy alpinistët sovjetikë Sevastjanov e Ovçiniko. Në akullnajën, ku po ecnin ata, doli pa prituri një shtresë e hollë debore, që po shkrihej dhe Nojsi e Smiti ranë në një të çarë 900 metra të thellë. Kjo fatkeqësi u ndodhi Nojsit dhe Smitit në orën 18 e 15 minuta të datës 24 korrik.

(ATSH), 4 gusht



1963

Kalendari Sportiv Kombëtar

Alpinizëm

1. Gjatë janarit : Zbore alpinistike dhe turistike në kampet e Bashkimeve Profesionale, sipas udhëzimeve të dërguara nga komiteti i fizkulturës.

2. 11 janar : Ngjitje kombëtare në Majën e Rinisë.

Pjesëmarrja : Alpinistë të klubeve sportive e rretheve, që do të caktohen nga Klubi Sportiv "Universiteti", i cili ngarkohet me organizimin e këtij aksioni.

3. 1-8 mars : Ngjitje kombëtare në Majën 8 Marsi.

4. 16-30 korrik : Ngjitje kombëtare në zonën Theth-Valbonë.

Pjesëmarrja : Në ngjitjet e lartpërmendura : të gjithë rrethet me nga 1 deri më 2 alpinistë.

5. 1-15 gusht : Ngjitje në majat më të vështira të Shqipërisë.

6. 28-29 nëntor : Ngjitje kombëtare në Alpe.

Krijimin e Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit ta presim me aksione konkrete

Dy ditë gëzimi në gjirin e Dajtit plak

Qindra nxënës e kuadro të rinisë punëtore të kryeqytetit kaluan dy ditë të bukura në gjirin e malit të Dajtit. Me të nisi në fakt për tيرانasit sezoni i sporteve masive të njerëzve të guximshëm - alpinizmit e turizmit dimëror. Plazhi i la përfundimisht vendin malit.

Të shtunën pasdite kolona e gjatë u nis në drejtim të Dajtit. Rruga është e vështirë, veçanërisht për të vegjëlit e ata që ngjiten për të parën herë.

- A ka dhe shumë or shok? – pyesin të rinjtë.

- Edhe një vrap pele! Ua kthejnë pak me kapadaillek "veteranët".

Por sapo në sallën e mencës së kampit të punëtorëve (në kamp

u kalua nata) dëgjohen tingujt e fizarmonikës, nis vallëzimi rinor. I shihje çiftet tek vërtitëshin dhe pyesje veten ç'u bë gjithë ajo lodhje, ç'u bënë tërë ato "mallkime" për të përpjetën e tubave.

Por s'kish vetëm vallëzim. Tangos e rumbas ia zuri vendin muzika e Mozartit, Haçaturianit e Kajzerit, egzekutuar me mjeshtëri nga orkestra e harqeve e Liceut Artistik dhe nga vogëlushja Zisha Kumbaro. Besnikë të së ardhmes së tyre, liceistët nuk ishin ndarë nga violina as edhe nga rrugët e vështira të Dajtit.

E bukur e plot variacion ishte ajo mbrëmje me ato lojëra mjaft të bukura, me recitime, me skeçe të lezetshme të diletantëve të NTLUS-it, etj.

Të nesërmen, në mëngjes herët, u sulmuan dy majat më të larta të malit. Të lodhur, por të gëzuar, u kthyen ekskursionistët në shtëpitë e tyre duke i premtuar mikpritësit Dajt se javët e tjera do ta vizitojnë rregullisht....

Napolon Roshi, 15 tetor



**Alpinistë në qytetin
Bajram Curri**

1964

Kalendari Sportiv Kombëtar

Alpinizëm

1. Janar: Zbore alpinistike dhe turistike në kampet e Bashkimeve Profesionale, sipas udhëzimeve të KKFS.

2. 11 janar: Ngjitje kombëtare në Majën e Rinisë, me pjesëmarrjen e alpinistëve të rretheve e klubeve sportive, organizuar nga Klubi Sportiv "Universiteti".

3. 1-8 mars: Ngjitje kombëtare në Majën 8 Marsi.

4. 16-30 korrik: Ngjitje kombëtare në zonën Theth-Valbonë. Marrin pjesë të gjitha rrethet e klubet, me nga 1-2 alpinistë, sipas programit të KKFS.

5. 28-29 nëntor: Ngjitje kombëtare në 5 majat më të larta për nder të 20-vjetorit të Çlirimit. Programi dhe pjesëmarrësit do të caktohen nga KKFS.

Konferenca e parë kombëtare

Njëzëri për zhvillimin masiv të turizmit dhe alpinizmit

Konferenca e parë kombëtare e turizmit, që u mbledh në Tiranë, arriti në konkluzionin e drejtë se vendi ynë me natyrën e tij të bukur ka mundësi të mëdha për një zhvillim të gjerë të turizmit dhe alpinizmit.

Për një fillim të turizmit dhe alpinizmit në vendin tonë, thuhej në raportin : "Mbi zhvillimin e turizmit dhe alpinizmit në Shqipëri dhe detyrat për të ardhmen", të mbajtur nga kryetari i Komitetit të Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH-së Vasil Konomi, mund të flitet aty nga dekadat e para të shekullit tonë, kur nxënësit e shkollave, të prirë nga mësuesit e tyre, filluan të shëtisnin në kodrat e malet për

rreth qyteteve. Megjithatë, deri para çlirimit, ishin të rrallë ata të rinj tiranas që kishin shkelur Petrelën, Krujën, Dajtin apo Sarisalltëkun dhe numëroheshin me gishta ata që mund t'i ngjiteshin Tomorrit apo ndonjë maje tjetër të lartë. Vetëm mbas çlirimit u krijuan konditat për zhvillimin e turizmit dhe alpinizmit. Kështu, vitet e fundit tek ne janë rritur radhët e ekskursionistëve e alpinistëve. Djetra mijëra të rinj e të reja, pionierë e punonjës i kanë rënë anë e kënd Atdheut. Iniciativa të mira ka patur në qytetin e Tiranës, ku janë organizuar mjaft ekskursionë në malin e Dajtit, në Linzë, Petrelë, Sauk, etj.; në rrethin e Korçës ku janë organizuar dhjetra ekskursionë në vënde historike e piktoreske, si në Çardhak, Bozdoveë, Dardhë, etj., në atë të Vlorës ku janë organizuar ekskursionë në rrugën e çetës së rinisë, në ujët e ftohtë, etj., në atë të Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Gjirokastrës, Përmetit, etj. Meriton të vihet veçanërisht në dukje puna e mirë që kanë bërë shokët e Universitetit Shtetëror të Tiranës, Pallatit të Pionierëve dhe ai i punëtorëve në Tiranë, shtëpitë e pionierëve në Shkodër, Durrës, Elbasan si dhe grupi i alpinistëve në Berat. Vetëm nga KS "Universiteti", që nga krijimi i tij e këndej, janë organizuar 7 zbore alpinistike prej nga kanë dalë mbi 500 alpinistë të kategorizuar, të cilët në nbarim të studimeve, duke u shpërndarë në të katër anët e atdheut janë bërë pionierët e një përhapje masive të turizmit dhe alpinizmit në vendin tonë. Në raste festash e kohë të përshtatshme janë organizuar ngjitje alpinistike në majat më të larta të maleve, si në malin e Tomorrit, në Korab, në majën e Hekurave, në Paping, në Majën 8 Marsi, etj.

Sot nuk ka asnjë majë të rëndësishme të Alpeve tona ku të mos ketë shkelur këmba e alpinistëve tanë gjatë dimrit apo verës. Këto ekskursionë e ngjitje alpinistike i kanë shërbyer kalitjes fizike të rinisë, njohjes së traditave të lashta patriotike dhe objekteve historike e kulture, të bukurive të mëdha natyrore si dhe njohjes së punës kolosale të ndërtonjësve tanë të socializmit, transformimeve rrënjësore që janë bërë në vendin tonë gjatë viteve të pushtetit popullor nën udhëheqjen e partisë.

Por konferenca arriti në konkluzionin se me gjithë dobitë e mëdha të turizmit dhe alpinizmit dhe mundësitë e mëdha natyrore që ka vëndi ynë për zhvillimin e tyre, ne jemi akoma në fillimin e punës dhe në këtë drejtim ka dobësi e mungesa. Kështu organizimi i ekskursionëve dhe ngjitjeve alpinistike bëhet përgjithësisht në raste

festash. Kjo ka bërë që interesimi i zgjuar gjatë një ose dy ekskursioneve apo ngjitjeve alpinistike të shuhet, efekti i tyre të jetë i pamjaftueshëm. Nuk është siguruar akoma një lëvizje e mirë masive. Kjo sepse nuk aktivizohen të gjithë nxënësit e shkollave, punonjësit e qëndrave të punës, të rinjtë dhe të rejtat e kooperativave bujqësore, etj. Në shumë rreth ndodh që të njëjtët pjesëmarrës aktivizohen në të gjitha aktivitetet turistike dhe alpinistike, kurse dhjetra mijëra të tjerë qëndrojnë larg tyre. Kjo sepse shumë drejtori shkollash, qëndra pune, kryesi kooperativash bujqësore e komitete fizkulture, nuk tregojnë kujdesin e duhur për turizmin dhe alpinizmin. Me këtë të fundit është i lidhur edhe fakti që ekskursionet shpesh janë bërë monotone, pa ndonjë objektiv të caktuar, pa programe e variacione tërheqëse dhe përta i përket shkollave, aty ku shkojnë nxënësit e klasave të para shkojnë edhe ata të të shtatave, etj. "Përgjithësisht, tha midis të tjerave në diskutimin e tij shoku Kozma Grillo, ekskursionet kanë marrë karakter shëtitje, pikniku e jo sportiv. Ato duhet të tërheqin interesimin e pjesëmarrësve, t'i emocionojnë ata, t'u lënë kujtime e mbresa, t'i shërbejnë formimit fizik të rinisë".

Për sa i përket alpinizmit konferenca konstatoi se këtu duhet punuar akoma më shumë, mbasi me përjashtim të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe rrethit të Beratit, ku është punuar mjaft mirë, në rrethet e klubit e tjera sportive akoma nuk është krijuar një lëvizje e gjërë alpinistike. E këtu burimi është në kujdesin e pakët që është treguar për këtë lloj sporti burrëror dhe mjaft të bukur nga ana e komiteteve të fizkulturës. "Për ta bërë alpinizmin sa më masiv - tha midis të tjerave në diskutimin e tij shoku Minella Kapo, është e domosdoshme të tregohet kujdes për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm vullnetar dhe para çdo ngjitjeje alpinistike të bëhen përgatitjet e nevojshme, për të bërë të mundur që ngjitjet të përfundojnë me sukses nga ana e të gjithë pjesëmarrësve".

Karakteristika kryesore e diskutimeve që u bënë nga pjesëmarrësit ishte dëshira e tyre për ta bërë turizmin dhe alpinizmin sa më masiv. Krahas kushteve mjaft të favorëshme të vendit tonë për zhvillimin e këtyre dy sporteve, ata bënë edhe mjaft propozime konkrete.

Konferenca mori një sërë vendimesh të rëndësishme dhe aprovoi statutin e Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit. Në fund ajo zgjodhi këshillin e shoqatës dhe kryesinë.

Kryetar i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit u zgjodh Kiço Ngjela, nënkryetarë Jorgjia Peçini, Pasko Milo dhe Qemal Bylyku, sekretar Muharrem Sinoimeri dhe anëtarë: Engjëll Kolaneci, Minella Kapo, Dhori Hanxhari, Osman Palushi, Nadide Dinazi, Merdali Tafili, Kozma Grillo, Luigj Shala, Petrit Kamba dhe Thanas Nika.

Nga konferenca iu dërgua një telegram përshëndetjeje Komitetit Qëndror të Partisë.

Korresp. i "Sportit Popullor", 9 maj

Turzmi - mjet përgatitjeje me aftësi dhe cilësi të larta fiziko-morale

"Përhapja dhe zhvillimi i mëtejshëm i fizkulturës dhe sportit, gjallërimi më i madh i jetës sportive nëpërmjet lojërave popullore, zhvillimi i gjimnastikës në kuptimin e gjërë, shfrytëzimi i faktorëve natyralë dhe higjienikë – diellit, ajrit, ujit, përhapja e sporteve në masë dhe sidomos i turizmit të brendshëm, i cili luan një rol të madh edukativ e patriotik, - të gjitha këto kërkojnë sot që t'u kushtohet një vëmendje e posaçme jo vetëm nga organizatat e fizkulturës, por edhe nga organizatat e partisë, të rinisë dhe nga organet e pushtetit. Krijta e aftësisë fizike, edukimi i gjithanshëm dhe harmonik i popullit, sidomos i brezit tonë të ri, është problem kombëtar, problem i Partisë dhe i pushtetit tonë popullor".

(Nga vendimi i Komitetit Qëndror të PPSH : "Mbi zhvillimin e mëtejshëm të fizkulturës dhe sportit").

Vëndi ynë ka një natyrë shumë të bukur. Riviera jonë e jugut, alpet tona legjendare, Thethi i mahnitshëm, Lura - perla e maleve tona, lugina e Valbonës me kanionet e saj magjepse e shumë bukuri të tjera të tërheqin e të bëjnë për vete që në shikimin e parë.

Në bregdet, në jug, ku në klimën e palmave dhe agrumeve ngrihen malet e mbuluara me dëborë apo Alpet tona në veri, ku fryn gjithnjë flladi pranveror, ta ka ënda të kalosh disa orë e ditë.

Ja pra ku mund të drejtohen njerëzit tanë, të rinjtë e të rejtat, në ditët e nxehta të verës.

Dobitë e turizmit

Turizmi është një nga mjetet kryesore për përgatitjen e punonjësve dhe të rinjve tanë me aftësi dhe cilësi të larta fiziko-morale. Ai ka një rëndësi të madhe edukative, arsimore, shëndetësore dhe praktike.

Turizmi është një nga mjetet më aktivë për edukimin e punonjësve dhe të rinisë sonë me frymën e patriotizmit. Frymëzimi i jep rinisë mundësinë që të njohë Atdheun, historinë e popullit tonë dhe të luftës së tij të lavdishme, veprat e mëdha të socializmit, kulturën e popullit dhe natyrën e Atdheut me të gjitha pasuritë e saj.

Turizmi i bën njerëzit të fortë fizikisht, të qëndrueshëm, guximtarë dhe me iniciativë; ai i pajisë ata me shprehitë e nevojshme për jetën praktike; i edukon me burrëri, disiplinë e vendosmëri, me këmbëngulje për arritjen e qëllimit të caktuar dhe me dashuri për njëri-tjetrin. Të jetuarit në gjirin e natyrës, bisedimet e përzemërta rreth zjarrit, gatimi i gjellës, kujdesi për të tjerët, të ndarët e punës dhe vrojtimi i natyrës - janë disa nga karakteristikat kryesore të turistit, të nevojshme për çdo qytetar të RP të Shqipërisë.

Vetë konditat dhe përmbajtja e udhëtimeve turistike e venë njeriun në kontakt me tre faktorët kryesorë natyralë dhe higjienikë - diellin, ajrin dhe ujin, të cilët ndikojnë aq shumë në kalitjen e organizmit të njeriut dhe ndihmojnë në forcimin e shëndetit të tij.

Turistët gjatë udhëtimeve mund të frymëzohen për poezi e këngë, piktura e përshkrime, të mbledhin materiale nga folklori ynë, insekte, bimë e të tjera objekte interesante për të pasuruar muzeumet e qyteteve dhe të shkollave. Nga kjo lind tek i riu prirja për profesionin e tij të ardhshëm : gjeolog, gjeograf, historian, piktor, poet, etj.

Organizimi

Një nga karakteristikat kryesore të turizmit është se atë mund ta zhvillojnë të gjithë njerëzit, pa përjashtim, të çfarëdo moshe e seksi qofshin, nga 3-80 vjeç e lart.

Iniciativën e udhëtimeve turistike nëpër vënde të ndryshme piktoreske, apo në afërsitë e qytetit e fshatit, duhet ta marrin në radhë të parë të rinjtë. Udhëtimet turistike, kur janë të shkurtëra, organizohen ditëve të pushimit dhe, kur janë të gjata, gjatë pushimeve verore.

Për të organizuar sa më mirë lëvizjen turistike, është mirë që në kolektivat e fizkulturës të qëndrave të punës e prodhimit, të kooperativave bujqësore, shkollave, shtëpive të pushimit e kampeve të pionierëve të krijohen rrethet e turizmit.

Për krijimin e rrethit të turizmit janë të mjaftueshëm 3-6 vetë që kanë dëshirë të ushtrojnë turizmin dhe të bëhen përhapësit e tij. Puna fillestare e rrethit është që të organizojë shëtitje turistike në kohën e lirë.

Llojet e turizmit

Turizmi mund të ushtrohet në forma nga më të ndryshmet, duke filluar nga ekskursionet familjare e shoqërore për disa orë e deri në ekskursionet masive të shkollave e qendrave të punës për disa ditë me radhë.

Llojet kryesore të turizmit janë ato që bëhen me këmbë, me biçikletë, me motoçikletë, varka, etj. Sigurisht që më të dobishme për kalitjen fizike, më të thjeshta dhe më të lehta janë shëtitjet me këmbë.

Edhe format e aksioneve turistike janë të shumta. Më kryesoret janë:

1. **Shëtitjet ose ekskursionet turistike**, që bëhen në ditë pushimi, jashtë qytetit dhe në vënde të bukura. Ato kanë për qëllim çlodhjen aktive të pjesëmarrësve dhe, në përgjithësi, kanë karakter shëndetësor. Shëtitja është forma turistike më e lehtë për t'u organizuar edhe kur në të marrin pjesë masa të gjëra të rinjsh e të rejash.

2. **Udhëtimet (marshimet) turistike**. Janë më të gjata nga shëtitjet dhe bëhen me grupe të vogla. Grupi është i organizuar dhe i përgatitur dhe i vë për detyrë vetes që të arrijë disa objektiva : çfarë do të shohë, ç'loj koleksionesh do të mbledhë, etj. Kjo formë është shumë e përshtatshme për fillestarët dhe përdoret për të njohur vëndin.

3. **Kampet turistike stacionarë**. Ngrihen si kampe pushimi në vëndet më të bukura dhe më interesante. Turistët jetojnë në kamp, ku kanë edhe pikënisje udhëtimesh të ndryshme rreth e rrotull zonës së kampit.

4. **Kampet turistike shëtitës**, që mbajnë grupe turistësh të zgjedhur, të cilët qëndrojnë 2-3 ditë në një vënd, pastaj shpërngulen në një vënd tjetër. Jeta turistike kështu bëhet me variante tërheqëse.

5. **Ekspeditat turistike**. Bëhen me qëllime studimi. Kuptohet vetvetiu se grupi që përbën ekspeditën duhet të ketë njohuri të mjaftueshme mbi qëllimin për të cilin është krijuar.

Ç'duhet të kenë parasysh turistët

Secila formë e praktikimit të turizmit, sado e thjeshtë qoftë, kërkon që të merren disa masa me kohë, me qëllim që të realizohet objektivi i caktuar.

Sa më mirë të bëhet përgatitja për aksionin turistik, duke bërë në radhë të parë të njohur itinerarin e tij, duke caktuar vëndet më të bukura ku janë shënuar ngjarje të rëndësishme të luftës e ku janë ngritur vepra të rëndësishme të socializmit, aq më mirë do të dalë aksioni.

Duhet bërë çmos që udhëtimi të jetë interesant e tërheqës dhe të lërë mbresa të thella tek çdo pjesëmarrës. Për këtë, grupi duhet kompletuar me njerëzit e nevojshëm, të zgjidhet tema e udhëtimit, të studiohet historia dhe gjeografia e zonës, të zgjidhet rruga dhe të sigurohen sendet e nevojshme.

Është e domosdoshme që midis pjesëmarrësve të bëhet ndarja e punëve, të bëhet kontrolli mjekësor paraprak dhe të respektohen të gjitha rregullat e caktuara nga përgjegjësi i grupit turistik për ecjen dhe qëndrimin, për zbatimin e orarit dhe të regjimit ditor, etj.

25 korrik

Alpinistët u nisën për në Alpe

Sot, në kuadrin e aktiviteteve për nder të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe në bazë të kalendarit sportiv kombëtar, alpinistët më të mirë të vendit, fillojnë ngjitjet në Alpe, në zonën e Vermoshit, Thethit dhe Valbonës.

Këto ngjitje, që do të zgjasin 15 ditë, kanë karakter studimi dhe përshkimi të majave të panjohura në zonën e Vermoshit si dhe pushtimin e majave nga rrugë të reja në zonën e Valbonës e Thethit, për një kualifikim më të mirë të alpinistëve. Në ngjitje do të synohet kalimi i rrugëve dhe i itinerarëve më të vështirë si dhe arritja e rezultateve më të larta teknike në ngjitjet shkëmbore, të cilat janë më pak të njohura nga alpinistët tanë.

Me qëllim që të kapen sa më shumë maja, grupi i alpinistëve do të ndahet në disa nëngrupe të vogla, në formë ekspeditash, të përbërë nga 2-3 alpinistë. Si pikënisje ata do të kenë Vermoshin dhe do të përfundojnë në qendrën stacionare në Theth.

Grupi i alpinistëve udhëhiqet nga mjeshtri i sportit Minella Kapo.

Korresp. i "Sportit Popullor", 1 gusht

Në Theth

...Thethi është një luginëz me bukuri të rrallë, i rrethuar me male të lartë me pamje madhështore, që turistin e lë me gojë hapur dhe alpinistit i shton dëshirën të ngjitet nëpër to.

Fshati ka 150 shtëpi të ndërtuara sipas stilit alpin, me mure përj guri, me çati të larta dërrasash pishë, përgjithësisht njëkatëshe, që duken sikur lundrojnë midis gjelbërimit të luleve dhe shkëlqejnë nga bardhësia e gëlqeres. Ato janë shpërndarë grupe-grupe nëpër faqet e ulëta e më të buta të luginës, në të dy anët e lumit të Shalës.

Këtij fshati po i krijohen dalëngadalë dy qendra : njëra në pjesën e poshtme me shkollën 8-vjeçare, me tregtoret e kooperativës së konsumit, zyrat, depot, etj. dhe tjetra lart, me shtëpinë e pushimit, centralin elektrik, furrën, zyrën e pyjeve, etj.

Banorët e kësaj krahine janë punëtorë të fortë e të palodhur dhe jetojnë me blektori e bujqësi. Kohët e fundit kanë zhvilluar me sukses edhe apikulturën. Por njëkohësisht ata janë mjeshtra në ndërtimet me dru dhe me gurë. Vetë e presin lëndën në pyje, vetë e bëjnë gëlqeren dhe latojnë gurët, vetë i projektojnë dhe i ndërtojnë shtëpitë e bukura, mullinjtë dhe çdo gjë tjetër. Me punën e tyre të palodhur e kanë bërë fshatin një nga kooperativat bujqësore malore më të mira të vëndit. Edhe jeta kulturele ka filluar të marrë hov. Patëm kënaqësinë të shikonim një çfaqje artistike të grupit diletant të të rinjve të fshatit, që drejtohet nga mësuesi i ri Xhevat Anamali.

Thethi do të ketë një të ardhme të shkëlqyer. Ai shpejt ka për t'u bërë qëndër e rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare për turistët e alpinistët dhe për të gjithë ata që do të praktikojnë sportet dimërore. Ai është edhe një qëndër klimaterike me vlerë të madhe. Me vendim të qeverisë, që tani, pyjet e tij, që veshin faqet e maleve, janë kthyer në park kombëtar. Një rrugë e re automobilistike po hapet edhe nga ana e Shoshit.

Deri tani në këtë vend të bukur kanë shkuar me dhjetra dhe me qindra vizitorë; tani që u krijua Shoqata e Turizmit dhe e Alpinizmit do të shkojnë me qindra e me mijëra turistë e alpinistë.

Ishte ora 6. Gjëndeshim akoma në shtrat, kur dëgjuam të buçasë thirrja "zig-zag, zig-zag....".

- Ç'është kështu?

- Kjo është parulla e alpinistëve. Duket se kanë ardhur natën.

Kur zbritëm në oborrin e shtëpisë së pushimit, në lëndinën pranë saj ishin ngritur 20 çadra alpine. Alpinistët të veshur me tuta bojëkafe, po bënin gjimnastikën e mëngjesit. Mësuam se ishin fillestarë dhe kishin ardhur në zbor nga të gjitha anët e Shqipërisë.

...Na mbeti si një kujtim i ëmbël mbrëmja që u organizua një natë para se alpinistët të bënin ngjijen e tyre të parë. Aty na foli për alpinizmin dhe mbi zhvillimin e tij në Shqipëri, mjeshtri i sportit Petraç Kule.

Të nesërmen ata ishin nisur herët, por të pasnesërmen në shtëpinë e pushimit priteshin me padurim, sepse nja dy orë rresht kishte rënë një shi i rreptë.

Ishte ora 17.

- Erdhën, erdhën - u dëgjuan zëra.

Dolëm të gjithë për t'i pritur.

Vargu i alpinistëve po i afrohej kampit. Në shpinë kishin çantat, çadrat, litarët dhe bataniet. Dukeshin shumë të lodhur, por përpiqeshin të mos e tregonin veten. Ishin lagur e bërë qull. Na përshëndetën me parullën e tyre energjike dhe ne u derdhëm e i përqafluam, duke u lëshuar në dorë nga një tufë me lule.

Provën e parë e kaluan me sukses të plotë.

Në mbrëmje rrëfimet e tyre ishin të këndshme...

Dragush Çabej, 11 gusht

*Ekspeditë alpinistike**

"...Meqënëse grupi ishte i madh, u ndamë në katër grupe :

Zona më veriore e Vermoshit do të studiohej nga grupi i udhëhequr nga Minella Kapo; zona lindore nga grupi me komandat Andon Tapia; zona qëndrore nga grupi i udhëhequr nga Vasil Vreto dhe zona perëndimore nga grupi i Vangjel Melengut.

Vermoshi ngrihet në lartësinë mbi 1.070 m. nga niveli i detit, është një vend shumë piktoresk. Nga malet lëshohen përrenj që bashkohen dhe krijojnë lumin e Vermoshit. Në jug të tij shtrihet Grebeni. Ky është një stadium i vërtetë natyror, i rrethuar me kodra të gjelbëruara. Është terren shumë i përshtatshëm për ski.

Pas përfundimit të etapës së parë në Vermosh, u nisëm në drejtim të Bjeshkëve të Namuna. Udhëtuam me pajisjet mbi kafshë rreth 6 orë, deri në fshatin Mrizë. Kësaj radhe moti nuk na ndihmoi. Pothuajse gjithë kohën shteguam nën një shi të imët, që na lagu deri në kockë. Natën e kaluam në stanet e çobanëve, në një mjedis të ngrohtë dhe bujar.

Të nesërmen filluam ngjitjet. Është një kompleks i tërë malesh me lartësi 2.000-2.600 m. Ka një mori majash, shumë prej të cilave nuk janë shkelur kurrë nga këmba e njeriut, madje shumë prej tyre nuk kanë as emra. Ka shkëmbinj me lartësi të ndryshme - nga 70 në 400 m, disa prej tyre me pjerrësi thuajse 90 gradë.

Emocionant ishte çasti kur, më 13 gusht, rreth orës 12.30, të katër grupet ndodheshin në majat më të larta dhe, megjithëse na ndanin kilometra të tërë, me përsëritje tonë : "Zik-zak, zik-zak, zik-zak, hej, hej, hej - alpinista jemi ne!" njoftonim njëri-tjetrin për suksesin e arritur.

Sipas porosisë, ditën e katërt të gjithë grupet u bashkuam në Theth. Në analizë, që zgjati disa orë, rezultoi se programi i parashikuar u realizua me cilësi, madje dhe u tejkalua. Asnjë alpinist nuk u lëndua; çantat e ndihmës së shpejtë nuk u hapën.

Itinerari :

- Tiranë - Shkodër.
- Shkodër – Koplík - Razëm.
- Razëm - Brojë.
- Selcë - Tamarë - Leshnicë.
- Leshnicë - Vermosh, (çadrat i ngritëm tek posta e kufirit).
- Vermosh - Lëpushkë - Berizhdol - Bjeshkët e Namuna.
- Bjeshkët e Namuna - Theth.
- Theth - Bogë - Koplík (me këmbë).
- Koplík - Shkodër - Tiranë.

Si përfundim:

Udhëtuam 9 ditë; bëmë 6 ditë ngjitje dhe pushuam 4 ditë.

Të shprehura në orë: udhëtuam 50 orë, nga këto 14 orë me kafshë.

Rruga që përshkuam ishte 200 km.

U realizuan 38 ngjitje, ndër të cilat 6 ishin të kategorisë së lartë.

* Ky shkrim është marrë nga punimi i ilustruar i Zotit Andon Tapia.

Alpinistët i përfunduan me sukses ngjitjet në Alpe

Prej 1-15 gusht, në bazë të kalendarit sportiv kombëtar dhe për nder të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, alpinistët më të mirë të vendit kryen me sukses një sërë ngjitjesh të vështira në Alpet e Veriut.

Të dielën në mbrëmje Klubi Sportiv "Vllaznia" dhe ai i rinisë "Herojt e Vigut" në Shkodër organizuan një takim inrteresant me grupin e alpinistëve të kryesuar nga mjeshtri i sportit Minella Kapo.

Mbas përshëndetjes së rastit, të pranishmëve u foli shoku Minella Kapo.

Ai tregoi rrugën që përshkoi grupi i përbërë nga 12 alpinistë të zgjedhur... Ata kaluan fushën e Zezë, Brojën, Tamarën, Selcën dhe Vermoshin. Këtu grupi u nda në katër skuadra. Alpinistët zhvilluan gjithesej 111 ngjitje, duke kaluar në këmbë 200 km.

Mbas kësaj bisede interesante, kryeinspektori i fizkulturës për rrethin e Shkodrës Mustafa Smaja, u zotua se në të ardhmen alpinizmit e turizmit do t'i kushtohet më shumë kujdes në rrethin e Shkodrës.

Në fund u dha një program artistik

Dje alpinistët arritën në kryeqytet.

Me këtë rast Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit organizoi një takim me alpinistët, në të cilën ishte i pranishëm edhe kryetari i Komitetit të Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH-së, shoku Vasil Konomi, i cili i përgëzoi alpinistët për suksesin e arritur.

Korresp. i "Sportit Popullor", 18 gusht

1965

Në Korabin e mbuluar me dëborë

- Përshkrim -

“Në bazë të kalendarit sportiv kombëtar dhe në kuadrin e festës së 20-vjetorit të shpalljes së Republikës, më 10 janar një grup alpinistësh prej 31 vetash “sulmoi” majën më të lartë të Korabit (2.751 m). Alpinistët përfaqësonin rrethet Tropojë, Peshkopi, Shkodër, Tiranë (qytet dhe rreth), Elbasan, Berat, Vlorë dhe Klubet sportive “Universiteti” dhe “Partizani”.

Kanë kaluar 20 vjet nga dita që, ulur në një bangë të vjetër në shkollën fillore, për herë të parë mësova nga mësuesi ynë plak se mali më i lartë në Atdheun tonë është Korabi, se ai ndodhet në kufi, se banborët që jetojnë në këmbët e tij quhen lumjanë. Në verë banorët rreth e qark dalin me bagëti në bjeshkët e Korabit ku ka shumë burime uji të ftohtë, ndërsa në dimër atje gjithçka mbulohet me një rrobë të trashë prej dëbore dhe akulli, fryn përherë një erë shumë e fortë në atë shkretëtirë të bardhë. Herë mbas here duken gjurmët e ndonjë kafshe të egër që ulurin nga uria dhe zbret poshtë afër qëndrave të banuara për të gjetur ushqim, por shpesh nuk e merr rugën për t’u futur përsëri në gjirin e Korabit plak, se lumjanët, të veshur me petkat e tyre karakteristike, gjuajnë për bukuri.

Gjatë netëve të gjata të dimrit ata, të mbledhur rreth zjarrit, bisedojnë për punët e moçme, për ashpërsinë që silllet me ta në dimër Korabi, për hallet dhe gëzimet e jetës së përditëshme, për të afërmit e tyre që, për të siguruar bukën, zbrisnin në qytete me një sharrë dhe një sopatë në krah dhe bërtisnin nëpër rrugë dhe rrugica :

Hajde, dru me pre!

Këto mbaj mend nga ajo orë mësimi. Prej asaj kohe Korabi 20 herë ka ndryshuar veshjen e tij të bardhë, veshjen që e tregon atë më

të plakur dhe më të thinjur seç është vetë. Shumë ngjarje ndodhën që ndryshuan jetën dhe gjëndjen shpirtërore të lumjanëve. Atëherë Republika jonë ishte foshnjë, ndërsa këto ditë ajo mbushi 20 vjet. Shumë gjëra ndodhën edhe në jetën time. Mësova shumë gjëra për Korabin, pashë dhe një zhurnal, ku para 10 vjetësh një grup alpinistësh sulmuan Korabin në dimër, dhe këto ditë për të tretën herë, bashkë me 30 të tjerë unë mora rrugën për t'u ngjitur në majën e Korabit plak. Gjithçka ka ndryshuar brenda kësaj periudhe në Republikën tonë, veëse Korabi nuk do që t'ia dijë, është indifferent. Mbi majën e tij përherë era ngre cikla akulli lart drejt qiellit të kaltërt dhe Korabi të duket si një gjigand me flokë dhe mjekër të thinjur që thith dhe nxjerr tym nga një llullë tejet e madhe.

* * *

Si kaluam Milotin, ndodhi diçka jo e zakonshme. Nga temperatura e ulët krisi xhami i autobusit. Në Peshkopi na thanë se temperatura ishte 12 gradë nën zero. Bënte shumë ftohtë. Të gjithë na thonin se ishte e pamundur të ngjiteni në Korab në një kohë të tillë që nuk mbahej mend prej disa vjetësh, ndërsa ne ishim të gjithë të vendosur për realizimin e kësaj detyre. Qetësinë e ditës së pushimit në qytetin mikpritës të Peshkopisë e prishi thirrja jonë "Zig-zag, zig-zag, hej-hej-hej, alpinista jemi ne!". Në sheshin qëndror të qytetit u bë ceremonia e nisjes. Në të ftohtë, herët në mëngjez kishin dalë mjaft banorë të këtij qyteti për të na përcjellë, midis të cilëve dhe autoritetet e vendit. Në ceremoninë e nisjes, alpinistët e ngarkuar me çantat në shpinë, i përshëndeti sekretari i parë i Komitetit të Partisë së rrethit shoku Hajri Hoxha.

Nisemi për rrugë. Rradhët tona shtohen nga Ferhati, Basriu dhe Zabiti. 31 vetë udhëtojmë drejt Korabit, 31 njerëz të moshave dhe profesioneve të ndryshme, por që na lidh pasioni i përbashkët : ushtrimi i sportit burrëror të alpinizmit dhe qëllimi i njëjtë. Mbas disa orë udhëtimi mbi tokën e ngrirë, mbërrijmë në Shumbat. Ky fshat i bukur nuk na priti me vallen e tij të njohur për të gjithë ne, por me flokët e para të dëborës. Koha filloi të prishet. Mbas pak minutash gjithçka u vesh me të bardha. 4-5 orë rrugëtim.

Lamë Vleshën, ndonëse banorët e saj na ftuan që të kalojmë natën tek ata. Zbritja në Veleshicë ishte e rrezikshme, se i gjithë

monopati i pjerrët ishte i mbuluar me një shtresë akulli. Perëndimi i diellit na zë tek mulliri i bukur i Veleshicës. Dhe një orë tjetër rrugë për të mbërritur në lagjen teze të Radomirës.

Fillon e përpjeta. Çanta, mbas 6-7 orë udhëtimi, duket sikur na rëndon më tepër, duhet të ecim pranë njëri-tjetrit jo vetëm se errësira mbuloi gjithçka, por dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin për të ecur mbi akull.

Qetësinë e rëndë të kësaj nate dimri e prish vetëm zhurma që bëjnë kazmat tona alpine mbi akull dhe lehja e shurdhër e ndonjë qeni. Nëpër rrugët e fshatit na drejtojnë rojet kufitare dhe miku ynë i vjetër, toger Faslliu, që ka dalë përpara për të na pritur.

Teza është lagja më e largët në Radomirë, nuk është e madhe, por bujaria dhe mikpritja e këtyre malësorëve nuk ka kufi. Ne e provuam edhe njëherë këtë këto ditë. "Bujrum"- ishin fjalët e çdo fshatari që na priste në pragun e shtëpisë. Mbas disa minutash të gjithë u ndamë nëpër shtëpitë e këtyre malësorëve.

* * *

- *Shokë alpinistë, ju përshëndes!*

- *Shëndet paç shoku komandat!*

Përgjigjen me një gojë të gjithë alpinistët gati për t'u nisur drejt majës.

Jehona e përshëndetjes përhapet nga një qafë në tjetrën dhe përzihet me lehjen e qenve të përgjumur. Pa zbardhur mirë, nën kupolën e qiellit të mbuluar me mjegull të dendur, të ndarë në dy toga me në krye A. Bojaxhi dhe G. Perikliu nisemi. Në Radomirë lëmë Hysniun dhe Basriun në pamundësi për të marrë pjesë në ngjitje.

29 vetë nisim ngjitjen nëpër një itinerar krejtësisht të ri. Deri më sot Korabi është mposhtur në dy drejtime : nga Zimuri dhe posta verore, ndërsa këtë radhë ne e sulmuam nga ana e Rrafshës.

Dielli lindi kur ne kishim lënë prapa fshatin e përgjumur, nga ndonjë shtëpi e të cilit dilte ndonjë shtëllungë tymi. Hapat e parë janë të ngadalshëm dhe të lodhshëm. Si ecim nja tre orë, sipër nesh shtrihet një qiell i kaltërt pa mbarim, ndërsa poshtë nuk duket asgjë nga mjegulla që ka fshehur gjithçka. Kjo është shenjë e mirë. Majën e kemi në krahun e djathtë, por atë ende nuk e shohim. Para nesh shtrihet një rrafshinë e gjatë pa mbarim, e zhytur në një heshtje të

thellë. Gjithçka duket sikur është e vdekur, syri sheh vetëm konture prej dëbore. Ecja vazhdon e bashkë me të edhe biseda me zë të çjerrë e nisur qysh më parë midis të rinjve që, nga entuziazmi, duan të tregojnë se nuk janë lodhur dhe se nuk duan t'ia dijnë nga asgjë - bisedë që vazhdon deri sa dëgjojen fjalët e komandatit: "Ndalohet të folurit gjatë ecjes!".

Ecim mbi fushën e Panaritit. Ecja bëhet gjithnjë e më e vështirë, se duhet çarë dëbora e re që vënde-vënde arrin deri në brez. Tani përpara ecën toga e Grigor Perikliut. Herë mbas here këtë heshtje të rëndë e prish vetëm Mitati (Mitat Fagu – shënimi im: K.G.) që i bërtet (ashtu si di ai) ndonjërit që kthen kokën nga kamera kur ai xhiron, apo "ndihmësve" të tij që nuk i kryejnë në kohë porositë.

Lodhja dhe monotonia e ecjes mbi këtë fushë na bënë që herë pas here të kthejmë kokën nga e djathta me shpresën se do të shohim majën, por ajo nuk duket. Ora, kundër dëshirës sonë vazhdon, vazhdon të ecë, ndërsa dielli u fsheh pas reve.

Pushim. Mbështetur mbi kazmat alpine, të ngulura në dëborë, hamë ndonjë send ushqimor të marrë me vete. Pyetjet që drejtohen janë ato që na shqetësojnë më shumë: "Sa larg është maja, kur do të mbërrijmë?". Mas 10 minutash kolona rinisë ecjen. Dëborën e çajmë me radhë. Akrepat e sahatit tregojnë orën 13 dhe për herë të parë ne shohim majën e Korabit. Vetëm të rinjtë në këtë sport mendojnë se ajo është afër dhe se për disa minuta do të mbërrijnë, por, në të vërtetë, maja është akoma mjaft larg.

Fillon etapa më e vështirë e ngjitjes. Veçanërisht në dimër, sa më tepër t'ia afroresh majës, duket sikur mali reziston më shumë dhe nuk do që të jepet. Kjo etapë është përherë më e lodhëshme dhe më e rrezikshme. Pakujdesia më e vogël këtu nuk dënohet si në llojet e tjera të sporteve me faull, këtu çdo gabim rrezikon jetën e secilit dhe të gjithë shokëve që janë të lidhur në të njëjtin litar. Vështirësitë e ngjitjes shtohen nga era e fortë që na përplas në fytyrë copa të vogla akulli apo dëborë të ngrirë. Fjalët kanë kohë që kanë pushuar, të gjithë kanë lidhur mirë kokoren dhe herë pas here mbështeten pranë kazmës së ngulur për t'u mbrojtur nga era sa e fortë aq dhe e ftohtë. Në këtë lartësi, në dimër, kur temperatura është e ulët, vetullat dhe flokët, që kanë mbetur jashtë kokores, shndërrohen në shufra të holla akulli, të cilat bien në pah në ngjyrën mavi që ka marrë fytyra nga të ftohtit.

Më në fund, dolëm në kurriz. Tani maja nuk është veçse disa

metra larg. Shenjë e protestës së maleve për të mos lejuar që të ngjitesh në to, është era e furishme që fryn në kurriz, që shpesh herë të detyron që gjithë mundi të shkojë kot. Kjo gjë nuk ndodhi më 10 janar. Ne të gjithë ishim të vendosur të mbërrijmë në majë.

Mbas 9 orë ecjeje ne ndodhemi në majën më të lartë të Korabit: 2.751 metra. Shkopi që vendosim flamurin në të është një copë dru i zakonshëm, por flamuri që kishte sjellë me vete Myftari nga Tirana valëvitet fuqishëm në duart tona. E ngritëm atë me rastin e 20-vjetorit të shpalljes së Republikës. Me gjithë kënaqësinë për fitoren e arritur, në majë nuk qëndrojmë shumë mbasi era e fortë na bën që mos të presim me kënaqësi fjalët e Mitatit, që përpiqet të rregullojë kameran e bllokuar nga të ftohtit. Mbas disa minutash fillojmë zbritjen. Mbas 3 orë ecjeje, ngadhnjimitarë, futemi nëpër shtëpitë e Radomirës, ku malësorët me përzemërsi na përshëndesin të parët për suksesin e arritur, për realizimin me sukses të ngjitjes së parë të këtij viti.

* * *

Vështirë është të ngjitesh në mal në mes të dimërit, por nuk është e lehtë dhe të përshkruash forcat e mëdha fizike dhe morale të sportistëve që ushtrojnë sportin burror të alpinizmit.

Duke mbyllur këto shënime, në emër të të gjithë pjesëmarrësve, falenderojmë nëpërmjet gazetës "Sporti Popullor", për pritjen bujare dhe ndihmën që na ofruan banorët e lagjes Tezë në Radomirë, fshatarët e Sllatinës, postën e kufirit dhe qytetarët e Peshkopisë.

Kozma Grillo, 18 janar

NDODHIN NË SPORT

Alpinistët zbresin nga qielli

Si, mund të pyesni të habitur ju, alpinistët zbrtikan nga qielli në male? Mos u habitni para se të na dëgjoni.

Alpinistët që “zbritën” në majat e maleve, për të cilët flitet më poshtë, nuk ishin të parët që guxuan të luftojnë me majat e maleve nga larg dhe jo nga poshtë, siç bëjnë të gjithë alpinistët. Në shtatorin e vitit 1961 tre vetë u hodhën me parashutë mbi Monblan (4.810 m), që është maja më e lartë në Europë. Në verën e vitit 1962 tre alpinistë të tjerë sulmuan nga qielli Kilimanxharon (5.895 m), maja më e lartë e Afrikës. Njëri prej tyre, gjatë zbritjes, nxorri një fotografi unike të kësaj maje me kraterin e vullkanit.

Ndonjë nga lexonjësit e këtyre rreshtave mund të mendojë se “alpinizmi” nga lart, siç e kanë quajtur këtë mënyrë të re për ngadhjimin e majave më të larta, është një punë e lehtë e zbavitëse, një lojë fëmijësh. Por nuk është kështu. Parashutistin e kërcënojnë humnerat, thepat e shkëmbinjve, ortekët e dëborës, akullnajat rrëshqitëse. Veç kësaj, është tmeri i rënies së vetëtimtë, deri sa të hapet parashuta, por edhe pas hapjes së kësaj alpinisti-parashutist duhet të bëjë përpjekje heroike për ta drejtuar rënien me parashutë, shpejtësia e sëcilës është 5 metra në sekondë (baras me 18 km. në orë), në një vënd të sigurt dhe jo atje ku e pret vdekja : në thepa shkëmborë, në humnerë, në vrullin e ortekut...

...Ata ishin pesë vetë : Zh. Rade, kampion i Francës në sportin e parashutizmit, Zh. Grive, K. Treve, Zh. Katleni dhe H. Lekapieni - parashutistë të sprovuar, “snajperë” të zbritjes së përpiktë. Aeroplanin e drejtonte një mjeshtër i fluturimeve të larta.

Në lartësinë e 5.000 metrave ata u hodhën, me radhë, njëri pas tjetrit : I pari Lekapieni i lehtë dhe i fundit Katleni i rëndë. 46 sekonda rënie e vrullshme në një temperaturë minus 30 gradë celsius dhe shpejtësia 250 km. në orë! Ato pesë pika të vogla dhe të zeza në oqeanin e pasosur të atmosferës herë afroheshin, herë largoheshin, duke bërë

rrathë, lakë e tetshe, që ta drejtonin trupin për atje ku duhej të zbrisnin në tokë. Dhe zbritja e tyre e rrufeshme bëhet nëpër një erë therëse, të ftohtë akull.

Griveja, "kronisti" i ekspeditës, në rënie e sipër, nuk harron të marrë në fotografi shokët që bien dhe tokën që afrohet me shpejtësi. Dhe kur kjo u afrua alpinistëve 600 metra, ata hapën përnjëherë parashutat. Rënia e lirë mbaroi, shpejtësia zbriti deri në 18 km. në orë. Tani ata ndjenë acarin e temperaturës minus 30 gradë celsius. Me gjithë kombinezonet e tyre të ngrohta, kaskat e dorezat, faqet u janë zbardhur dhe gishtërinjtë të skuqur nga të ftohtit.

Njëri pas tjetrit të pestë bien në dëborë. Qeshin, bëjnë shaka, ndihmohen, i fërkojnë njëri tjetrit faqet. Mbi kokat e tyre, midis mjegullës dhe pluhurit të dëborës, është maja. Deri atje duhet të ngjiten disa dhjetra metra. Parashutistët bëhen alpinistë...

16 shkurt

ENCIKLOPEDIA JONË

Vetëm me luftë kundër vështirësive

Alpinizmi - sporti i ngjitjeve malore ka veçoritë e tij karakteristike në krahasim me sportet e tjerë. Ai nuk ka aktivitete ku të konkurojnë shumë sportistë në të njëjtën kohë dhe që të vihen në garë midis tyre. Alpinisti mbetet vetëm, në luftë kundër malit, kundër gjithçkaje që është më e madhe, më e fortë se ai. Pra, kundërshtari i tij është mali, kundër të cilit duhet luftuar për ta mposhtur. Çdo hap përpara që bëhet për t'u ngjitur është një fitore, por një fitore pa spektatorë. Vetë natyra që të rrethon është spektatore, herë e bukur e tërheqëse, herë e vrazhdë dhe e frikëshme, por që të nxit gjithmonë të luftosh me vështirësitë, me itinerarin, me shkëmbin, erën, dëborën, shiun, akullin. Këto të gjitha e bëjnë sportistin më të fortë, më të apasionuar për sportin që ai ushtron.

Si sport, alpinizmi është i ri. Ngjitjet me karakter thjeshtë sportiv filluan në shekullin e 19-të dhe sidomos në shekullin e 20-të. Edhe në shekujt e kaluar malet admiroheshin, por nga larg. Njerëzit admironin, por ua kishin frikën majave, shtigjeve, mungesës së

njerëzve në këto vënde. Në mesjetë janë zhvilluar ngjitje në maja të larta, por jo me qëllime sportive. Historia përmend ngjitje të tilla, si ajo e bërë nga poeti Petrarka në majën Vantu (1.919 m), nga Diego de Ortaz në malin Popokatepetl (5.452 m), etj.

Më vonë lindi dëshira për t'u njohur më tepër me malin. Të shtyrë nga kureshtja dhe për të ditur më tepër, si sportisti ashtu dhe dijetari u munduan të ngjiten sa më lart. Shohim se mali e tërheq botanistin, gjeologun, gjeografin, mjekun - me një fjalë gjithë shkencëtarët, që kërkojnë të dijnë më tepër. Por me vështirësitë që paraqet mali kërkon të luftojnë edhe sportistët. Ngjitjet e para të vështira në Europë u bënë në drejtim të Alpeve, sidomos në pushtimin e majës më të lart Mon Blan. Më 1786 një malësor nga Shamoni, Zhak Balma, së bashku me doktor Pakard, bënë ngjitjen e parë në majën Mon Blan. Që nga ajo kohë Alpet u bënë qëndër e ngjitjeve në formë të organizuar dhe në formë ekspeditash. Pas Alpeve, u erdhi radha vargmaleve të tjerë të njohur si ato të Pirenejve, Kaukazit, Uralit, Karpateve, Andeve, Himalajës. Alpinistët u mësuan shpejt me vështirësitë e ngjitjes dhe me kalimin e kohës ata filluan të zgjedhin shtigjet më të vështira, më të rrezikshme, për ta bërë akoma më interesant sportin e tyre.

Fill pas ngjitjes në majat e vështira të Europës filloi edhe dëshira e njerëzve të apasionuar për ngjitjen në majat më të larta të botës. Më 1874 u arrit maja Kalimanaxharo (6.010 m) - më e larta në Afrikë; më 1880 një grup u ngjit në majën Këmborazos, që është 6.310 m e lartë në Ekuador. Krijimi i veglave dhe i mjeteve ndihmëse më moderne u dha mundësi alpinistëve që të marrin rrugën drejt majave më të larta të botës, duke organizuar ekspedita të ndryshme alpinistike drejt Himalajës, majës së Everestit, Tibetit, etj....

23 shkurt

Ngjitje në majën "8 Mars"

Është bërë traditë tashmë që çdo vit, më 8 mars, alpinistë të rretheve dhe klubeve sportive, të ngjiten në majën 8 Mars (Papllugë), me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave.

Kështu ngjau edhe këtë vit. Një grup alpinistësh prej 20 vetësh, i udhëhequr nga mjeshtri i sportit Petraq Kule, kreu një ngjitje në

këtë majë, në verilindje të Thethit – 2.569 m. Kësaj radhe grupi ishte më i madh se çdo herë tjetër, ndonëse koha ishte e ftohtë.

7 mars. Grupi i alpinistëve, i cili kishte kaluar natën e 6 marsit nëpër shtëpitë e fshatarëve të Bogës, mblidhet të bëhet gati për të filluar rrugën në drejtim të Thethit. Natën kishte rënë dëborë e, megjithatë, asnjëri nuk do t’ia dijë. Bisedat vazhdojnë e ne ecim. I drejtohemi Shtegut të Dhënëve. Bukuritë e natyrës magjepse të Alpeve sikur na heqin lodhjen dhe na bëjnë shpejt për vete. Pas 6 orësh udhëtimit, arrijmë në kampin veror të Thethit, të pushtuar nga ndjenja e gëzimit.

8 mars. Është dita që do të kryejmë ngjitjen. Nisemi shpejt, që në orët e para të mëngjezit. Koha është e bukur dhe shumë e përshtatëshme. Gjatë rrugës, në pjesën e sipërme të Thethit, na tërheq vëmendjen një ortek vigan që kishte rënë. Rruga për në mal kalon nga Qafa e Pejës. Shpejt arrijmë në qafë dhe i drejtohemi Gropave të Bukura, duke kaluar hera-herës edhe nëpër zona të ngrira e duke përdorur edhe litarët.

Para nesh mbetet etapa përfundimtare. Majën e kemi përpara dhe ne ecim me forcat e fundit, ashtu si vrapuesi para finishit. Maja që kishim përpara sikur na tërhiqte e na jepte kurajo.

Më në fund, ja dhe fitorja. Në orën 12 e 25 minuta ndodhemi në majë. Përqafohemi e përgëzojmë njëri-tjetrin.

Aleksandër Bojaxhi, 16 mars

Nga do të kalojnë ekskursionistët?

Në bazë të kalendarit sportiv kombëtar të këtij viti, në dhjetëditëshin e parë të muajit korrik, do të zhvillohet një ekskursion i madh turistik-alpinistik në zonën e Veriut, me pjesëmarrjen e grupeve të ekskursionistëve të zgjedhur nga rrethet e klubet sportive të vendit.

Ky ekskursion i madh do të zgjasë 10 ditë, ai ka për qëllim hedhjen e bazave të shëndosha organizative dhe teknike në drejtim të organizimit të ekskursioneve turistike me itinerarë të gjatë, njohjen e natyrës sonë të Veriut, objektet dhe ndërtime të reja si dhe t’i japë hov rritjes së mëtejshme të lëvizjes turistike në vendin tonë.

Ekskursionistët do të nisen nga kryeqyteti më 1 korrik dhe do të kalojnë nëpër hidrocentralet “Frederik Engels” e “Karl Marks” mbi

lumin e Matit dhe do të arrijnë në minierën e Kurbneshit, ku do të njihen me këto vepra të mëdha të ndërtimit socialist.

Të nesërmen ekskursionistët do të ndodhen në gjirin e natyrës së bukur të Lurës. Në liqejt e Lurës do të bëhet edhe ngritja e qendrës stacionare turistike.

Më 3, 4 dhe 5 korrik pjesëmarrësit do të kalojnë nëpër qytetin e Peshkopisë, Kukësit dhe Bajram Currit, ku do të vizitojnë kuriozitetet e ndryshme të këtyre qyteteve.

Ekskursionistët do të vizitojnë shpellën e Dragobisë, do të kalojnë në Valbonë dhe pastaj në Theth.

Më 9 korrik ekskursionistët do të kthehen në Shkodër dhe më 10 korrik ata do t'i japin fund aksionit të tyre të madh, duke u kthyer në Tiranë.

24 qershor

Ngjitje në majat e larta

Për nder të festave të mëdha të nëntorit dhe në bazë të kalendarit sportiv kombëtar, Shoqata e Turizmit dhe Alpinizmit, organizoi ngjitje në majat më të larta të Atdheut, në të cilat morën pjesë alpinistët më të mirë.

Me gjithë kohën e papërshtatshme dhe kushtet e vështira atmosferike, alpinistët tanë treguan vendosmëri, guxim dhe aftësi, duke i kryer ngjitjet me sukses dhe duke e pasuruar edhe më shumë bilancin e rezultateve të tyre.

8 orë përpjekje

8 alpinistë të zgjedhur, përfaqësues të qytetit të Tiranës dhe Peshkopisë, bashkë me inspektorin e Shoqatës Myftar Marku, iu drejtuan Korabit, pikës më të lartë të Atdheut. Në përpjekjen e parë, për shkak kohës së keqe, grupi u detyrua të kthehet në fshat.

Herën e dytë grupi u nis me vendosmëri për t'u ngjitur në majën e Korabit me çdo kusht. Kësaj radhe alpinistët mposhtën të gjitha vështirësitë dhe pas 8 orësh luftë sportive kundër tufanit, dëborës dhe akullit, u ngjitën me sukses në majë, duke përqafuar njëri-tjetrin për fitoren e arritur.

Gjatë gjithë ngjitjes grupi manifestoi cilësi të larta.

Për të parën herë në dimër

16 alpinistë që përfaqësonin Gjirokastrën, Beratin, Vlorën dhe Korçën, të udhëhequr nga mjeshtri i sportit Petraq Kule, bënë një ngjitje në majën e Papingut : 2.469 m e lartë.

Megjithëse ishte hera e parë që merrej iniciativa për t'u ngjitur në Nemërçkë gjatë dimërit nga një grup alpinistik i organizuar, gjithçka u kurorëzua me sukses. Alpinistët ia arritën plotësisht qëllimit.

22 alpinistë në Tomorr

Një aktivitet i rëndësishëm ishte edhe ngjitja që u krye në Çukën Partizani nga 22 alpinistë të Beratit, Elbasanit, Fierit dhe Gramshit. Është për t'u vënë në dukje se në këtë ngjitje një figurë të mirë bëri ekipi i Elbasanit, i përbërë nga 12 alpinistë dhe i udhëhequr nga alpinisti i njohur Agim Kajanaku.

Ashtu sikurse ngjitjet e kryera në Korab dhe Nemërçkë, edhe ngjitja në Tomorr përfundoi me sukses.

Korresp. i "Sportit Popullor", 7 dhjetor

1966

Kalendari Sportiv Kombëtar

Alpinizëm

1. Janar : Ngjitje kombëtare në Korab.

Pjesëmarrja : Klubi Sportiv "Universiteti", "Partizani", rrethet Tiranë, Shkodër, Kukës, Peshkopi, Tropojë, Elbasan, Berat, Vlorë, qyteti i Tiranës me nga 3 veta çdo grup.

2. 10 mars : Ngjitje në majën e Hekurave (Maja e Paqes).

Pjesëmarrja : "Universiteti", "Partizani", qyteti i Tiranës, Vlora, "Dinamo", Berati, Gjirokastra, Elbasani, Korça, Tirana (rreth), Peshkopia, Kukësi, Tropoja, Shkodra, me 3-6 veta çdo grup.

3. 16-30 korrik : Zbori turistik-alpinistik në Theth i Këshillit Qëndror të B.P.SH. dhe Komitetit Shtetëror të Kulturës Fizike dhe Sporteve.

Pjesëmarrja dhe organizimi: Sipas udhëzimeve të lëshuara nga Këshilli Qëndror i B.P.SH.-së dhe Komiteti Shtetëror i Kulturës Fizike dhe Sporteve.

4. 1-15 gusht : Ngjitje kombëtare të kualifikuara në zonën e Valbonës.

Pjesëmarrja: "Universiteti", "Partizani", qyteti i Tiranës, Vlora, Shkodra, Peshkopia, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Berati me nga 3-6 veta çdo grup.

5. 20 gusht : Ngjitje kombëtare në Gurin e Capit në Korçë.

Pjesëmarrja : nga një grup alpinistësh të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe "Skënderbeut".

6. 6-7 nëntor : Ngjitje kombëtare në 5 maja malesh.

Pjesëmarrja : "Universiteti", "Partizani", "Dinamo", qyteti i Tiranës, Vlora, Fieri, Elbasani, Berati, Korça, Gjirokastra, Shkodra, Kukësi, Peshkopia, Tropoja me nga 3-6 veta çdo grup.

Festë alpinistësh në Thethin piktoresk

Madhështore është pamja e Thethit. Bukuria e rrallë natyrore e Alpeve tona jo më kot ka mahnitur gjithë vizitorët. Këtu, në dimër, majat e larta rreth e rrotull veshin vellon e bardhë të dëborës shekullore. Në verë, poshtë në luginë, jeshilojnë kopshtijet e livadhet e vegjël, ndërsa lumi i Thethit, me ujin e tij të kristaltë dhe të ftohtë, gurgullon pa pushim.

Një grumbull majash të larta e rrethojnë Thethin piktoresk an' e mbanë dhe, si ato selvitë dhe plepat e gjatë që zbukurojnë kopshtet, ia shtojnë hijeshinë këtij "stadiumi" të Alpeve tona. Qafa e Thores, Shtegu i Dhënëve, Maja e Arapit, Radohimës, Drenit, Kakisë, Boshit, etj. janë bërë të njohura e të preferuara tashmë për alpinistët dhe turistët tanë. Këtu këmba e alpinistëve guximtarë ka shkëlur dimër e verë dhe çdo pëllëmbë është lagur me djersën e tyre.

Thethi është bërë qendra kryesore e lëvizjes sonë alpinistike. Këtu janë organizuar dhe organizohen herë pas here kurse për përgatitjen e instruktorëve të alpinizmit si dhe ngjitje të kategorive të ndryshme.

Një mbrëmje e gëzueshme

Një mbrëmje korriku, 45 alpinistë të rretheve e klubeve sportive te vendit tonë, futbollistët e "Vllaznisë" së Shkodrës si dhe mysafirë të tjerë kishin zënë vend në sallë. Midis tyre ishin edhe ministri i shëndetësisë, Ciril Pistoli; kryetari i Komitetit të Kulturës Fizike e Sporteve të RPSH, Rexhep Doda; poeti Llazar Siliqi; sekretari i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit, Muharrem Sinoimeri; shefi i seksionit të arsimit e kulturës për rrethin e Shkodrës Palokë Kraja, kompozitori Albert Paparisto, etj.

Toga e tretë e kursit alpinistik kishte përgatitur një program të thjeshtë artistik. Pjesëtarët e saj, njëri pas tjetrit, dilnin në mes të sallës, këndonin këngë, interpretonin ndonjë kuplet a skeç të thjeshtë, luanin ndonjë lojë zbavitëse dhe përpiqeshin për të kënaqur sado pak mysafirët dhe të pranishmit e tjerë. Midis tyre dallohej alpinisti Viliam Kosturi, një djalë i qeshur dhe i shkathët, që luante me gjallëri e lirshmëri të madhe.

Programi artistik i përgatitur nga alpinistët u duartrokoi nga të pranishmit dhe u pasurua pastaj me këngë nga një grup artistik i shtëpisë së kulturës e krijimtarisë popullore të Shkodrës.



Kremtimi i 10 vjetorit

E diel, 24 korrik. Koha është e vrenjtur, majat janë mbuluar me napën e reve. Gjithçka është organizuar për bukuri dhe kudo veprohet me disiplinë e rregull të vërtetë ushtarak.

Nuk vonon shumë dhe kolona e pjesëmarrësve fillon të gjarpërojë tatëpjetë rrugës, që të shpie poshtë në luginë, në qendër të Thethit. Kalohet lumi dhe njerëzit grumbullohen tek vendi ku 10 vjet më parë u zhvillua zbori i parë alpinistik.

Drejtuesi i zborit të parë alpinistik, mjeshtri i sportit Minella Kapo, fillon të flasë dhe u sjell ndërmend të pranishmëve se si filloi tek ne lëvizja e organizuar alpinistike, si u përgatitën instruktorët e parë dhe si u kryen ngjitjet e para të organizuara alpinistike.

Pas tij fjalën e merr një nga pjesëmarrësit në zborin e parë alpinistik, mjeshtri i sportit Vasil Stambuli. Edhe ai u tregon alpinistëve disa kujtime nga fillimi i jetës së tij alpinistike.

Zbulohet çadra alpine dhe të gjithë shohin një “piramidë” të thjeshtë kushtuar 10-vjetorit të zborit të parë alpinistik.

Në faqen shkëmbore të thepisur

Alpinistët kishin përgatitur një program sportiv për të festuar 10-vjetorin e zborit të parë.

Nuk kishin kaluar veçse disa minuta dhe ne u ndodhëm në rrëzë të një maje të lartë, pranë një shkëmbi të thepisur. Këtu filloi një garë e bukur alpinizmi, e karakterizuar me ngjitje e zbritje të ndryshme dhe që përfundoi me fitoren e togës së parë.

Të gjithë elementët teknikë u kryen mjaft mirë nga pjesëmarrësit. Nëpërmjet tyre ata pasqyruan përfitimet e mëdha gjatë kursit dhe përvetësimin e teknikës së ngjitjeve. Veprimet u kryen me shpejtësi, guxim, gjallëri e kujdes.

Ndërkohë 3 alpinistë, midis të cilëve dhe Roza Gjergji (e vetmja femër në gjithë kursin) me në krye mjeshtrin e sportit Vasil Stambuli, u drejtuan për të kryer një ngjitje shkëmbore. Poshtë te proi nisi një stafetë e bukur turistike me pjesëmarrjen e katër togave. Alpinistët bën vrapim e marshim në bazë toge, demonstruan transportimin e “të plagosurit”, kalimin e lumit dhe ngritjen e çadrës alpine. Gara e

tyre ishte e bukur e interesante dhe u fitua nga përfaqësuesit e togës së katërt.

* * *

Gjatë periudhës së kursit alpinistik pjesëmarrësit kanë kryer një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm. Vendin kryesor këtu e kanë zënë mësimet për përvetësimin e ngjitjeve të ndryshme alpinistike, njohuritë teorike, etj.

2 gusht

THETHI NË VITIN E MADH JUILAR

Ata po bëjnë më tepër mrekullira se kreshnikët e legjendave

Jeta e fshatit është 200-vjeçare. Banori i parë i tij ka qenë Ded Nika, i cili zbuloi këtë vend, dikur plot pyje e shkurre, një ditë që kish dalë për gjah. Gojëdhana vazhdon se, si vdiq i ati, pesë djemtë e tij lanë Shoshin dhe iu desh të luftonin me Kelmendin për të ruajtur këtë truall. Secili nga 'ta ngriti një shtëpi larg njëri-tjetrit. Dhe sot, 5 lagjet e fshatit mbajnë emrat e bijve të Ded Nikës, duke u shtuar prapashtesën - aj.

Netëve të gjata të dimrit, të mbledhur pranë zjarrit, gojëdhanën e tregojnë pleqtë, herë me fjalë dhe herë të shoqëruar me çifteli. Sipas zakonisht, ata nuk i truajnë të parët e tyre, nuk truajnë as Ded Nikën, por në rrudhat e tyre të parakohëshme, në zërin dhe tingujt e trishtueshëm të çiftelisë, dikur ndihej njëfarë mallkimi për atë që themeloi këtë fshat; sipas tyre ai ishte shkaktari i urisë, i dimërit të egër, i sëmundjeve dhe i hasmërisë që bënëin kërdrinë midis tyre.

"...Dhe ishalla pa nafakë s'na ka lanë".

Si gjithë malësorët, edhe thethianët me këto fjalë i fillonin këngët e tyre. Ata lindnin nga prindër të uritur dhe vdisnin të uritur; por shpresën për një të ardhme të bukur ata nuk e mbulonin në dhe bashkë me trupin e njerëzve të afërt. Këtë shpresë ata e trashëguan nga njëri brez në tjetrin.

Dhe nafaka (fati - shënimi im : K.G.) për 'ta lindi jo në shtëpinë e zotit të përdëllyer, por në një shtëpi përdhese në Tiranë, 25 vjet më parë, në ditët që sapo malet dhe vetë Thethin e mbuloi dëbora. Lindjen e "nafakës" më shpejt e mori vesh prifti i fshatit. Natën, kur nga të ftohtit njerëzit strukeshin afër zjarrit, kambana e kishës së Thethit lëshonte ca tinguj të mbytur që lajmëronin shëmbjen e botës së vjetër dhe vuajtjet e lindjes së një bote të re.

Pas pak muajsh mbushen 25 vjet nga dita që, si thonë malësorët,

lindi nafaka e tyre. Ajo u rrit bashkë me 'ta dhe hyri si një transformuese e madhe në jetën dhe në fshatin e tyre, i cili nga dita në ditë po bëhet më i begatë dhe më i bukur.

Thethi shtrihet në të dy brigjet e lumit me ujë të ftohtë dhe të kristaltë, që buron në njërën nga lagjet e tij. Fshati është i rrethuar nga male të thepisur dhe të lartë deri në qiell. Malet në verë kanë njolla të mëdha të bardha, të cilat janë e vetmja dëshmi e ditëve të mëparshme, ku për muaj me radhë gjithëka vishet trashë me rroba të bardha. Besoj që Thethi është i vetmi fshat me horizont aq të ngushtë, ku nuk sheh gjë tjetër veçse male dhe një copë qiell. Por edhe në këtë horizont të ngushtë, megjithëse tërë jetën e kaluan në varfëri dhe në padije, thethianët me intuitë e kuptuan se nafaka e tyre ishte partia. Kanë kaluar vetëm pak vjet dhe brenda kësaj kohe u bë më tepër drejt jetës së lumtur se nga ajo ditë që Ded Nika erdhi për të gjuajtur...dhe zbuloi vendin ku sot është ngritur Kooperativa Bujqësore "Enver Hoxha". Kooperativa është vetëm 8 vjeçe, por ajo është zhvilluar, zbukuruar dhe forcuar sa asnjëri nuk e ve në dyshim shëndetin dhe të ardhmen e saj.

"Ta lumsha, Nik Toma!"

Emrin e fshatit e dinë shumë të huaj që kanë ardhur këtu, megjithëse e kanë shumë të vështirë ta shqiptojnë, në rastin më të mirë e quajnë Fef. Por të gjithë ata mbetën të mahnitur nga bukuria e këtij vendi. Malet kanë mbetur njësoj. Dimrit, kur nuk durojnë peshën e rëndë të dëborës, shpërthejnë dhe lëshojnë orteqe, zhurma ngjethëse e të cilëve jehon nga një grykë në tjetrën.

Natyra nuk ka ndryshuar, ndërsa malësorët po. Ka vite që thethianët nuk vuajnë më nga uria. Për 'ta, gjatë katër muajve të vetëm që punonte rruga automobilistike, vinin çdo ditë makina të ngarkuara rëndë me drithë nga Myzeqeja. Edhe këtë vit kamionët përsëri gulçojnë në rrugët e ngushta dhe të vështira malore, të ngarkuara përsëri rëndë, por tani jo me drithë, por me pajisjet e hidrocentralit të fshatit. Për herë të parë në gjithë historinë e jetës së fshatit drithin do ta prodhojnë në fshatin e tyre. Ç'përkim i bukur! Në 25-vjetorin e themelimit të partisë vendin e apotheozës së misrit e zuri një simfoni e bukur, ajo që më parë ishte një paradoks. Në këtë vend malor u siguria buka për gjithë fshatin gjatë tërë vitit.

Dikur këta malësorë dinin të përdornin pushkën, ata qëllonin në shenjë. Ata edhe tani e mbajnë pushkën, por tani jo si mjet për të trembur të tjerët, por për ta patur atë gati kundër atyre që do të

guxojnë t'u prishin lumturinë. Thethianët sot po aq mirë dinë të përdorin edhe shatin. Gjatë viteve që ata punojnë të bashkuar në kooperativë nuk ia kanë përtuar punës. Por sivjet ndodhi diçka, që asnjëri nuk mund ta kishte parashikuar. Brenda 6 muajve u hapën 22 hektarë tokë e re. Kur Nik Toma, kryetar i kooperativës bujqësore, para disa muajsh shtroi planin e hapjes së tokave të reja, disa nuk besuan në realizimin e tij. Por tek Nik Toma fshatarët shihnin fjalën e partisë, dhe partia përherë i ka nxjerrë ku duhet.



Dimri ishte i egër sivjet. Malësorët në këtë stinë interesohen vetëm për gjënë e gjallë. Dimri ishte i ashpër, por pa ardhur ende gazeta, në Theth u hap fjala : *“Partia ka lëshu letër”*. Në mesin e marsit u dha kushtrimi : 190 burra dhe 95 gra dolën me kazmë dhe shatë në dorë. Filloi puna, një punë e madhe. Toka pastrohej nga dëborat dhe punohej më vrull. Malësorët shkonin në punë herët në mëngjes dhe ktheheshin vetëm atëherë kur rrezet e fundit të diellit ndriçonin zbehtë majat e maleve të mbuluara me dëborë. Tejkalimi i planit i gëzoi të gjithë. Atje, ku nuk kullosnin dot as dhitë, u hapën toka buke. Për gjashtë muaj u hapën më shumë tokë se sa gjatë gjithë jetës së Thethit të çliruar. Ndryshoi pamja e vendit dhe bashkë me të dhe psikologjia e këtyre njerëzve.

Këta malësorë, që janë ngrumbulluar sot në mbledhjen e përgjithshme të kooperativës, dikur trembeshin nga njëri-tjetri, zinin pusi. Ajo kohë tani u duket shumë e largët, ajo nuk do të kthehet më kurrë.

Pak ditë më parë u nis për në punë bashkë me shokët edhe

kooperativisti 20-vjeçar Pal Nikolla. Dita ishte e bukur. Bashkë me shokët këndonte dhe Pali, këndonte për të ardhmen e bukur, këndonte kur e mendonte veten prind. Por, ja atij i rrëshqiti këmba, ra në lumin e rrëmbyer dhe s'doli prej andej. Kjo ngjarje i helmoi të gjithë, por ende më shumë helmoi 70-vjeçarin Nikoll Pjetrin. Dhimbja ishte e madhe; ai shihte tek djali i vetëm edhe pleqërinë e vetë të siguruar. Nikoll Pjetri ka ardhur në mbledhjen e përgjithëshme. Fshatarët diskutojnë për rritjen e planeve dhe njëzëri votojnë që më 16 tetor në shtëpitë e tyre të kenë dritë elektrike. Asambleja flet për të sotmen dhe harton plane të guximshme për të ardhmen. Në mes të diskutimeve ngrihet edhe një kooperativist. Ai kërkon të shikohet çështja e ndihmës që i duhet dhënë Nikoll Pjetrit. Nuk diskutuan të 300 krahët e punës që ka kooperativa, por të gjithë së bashku vendosën : secili nga një normë pune në kooperativë do të punojë për djalin e Nikoll Pjetrit. Kur i vdiq i biri, Nikolla nuk qau. Malësorët qajnë rrallë. Por sot ai ngrihet, do që të fillasë, por lotët bien mbi faqet e tij të rrudhura. Fjalët dhe dashuria për t'i përqaftuar të gjithë me radhë u mblodhën në shprehjen e thënë plot emocion : "Falënderoj Partinë!".

Koha që ata i zinin pusi njëri-tjetrit, vitet e parë të jetës në kooperativë, kur ata interesoheshin më tepër për tre dylmëshin, kanë mbetur si një kujtim i largët...

Mësuesja shkon në kishë

Pushkë në këtë vend është bërë përherë, por ajo kërciti edhe më shumë në kohën e Luftës Nacional Çlirimtare. Atëherë këtu, me përjashtim të priftit, të gjithë ishin analfabetë. I tillë ishte edhe Lulash Marku, kryetari i parë i këshillit të fshatit. Megjithëse analfabet, ai detyrat dhe porosinë e partisë i kreu më së miri.

Këtë vit në Theth ulen çdo ditë në bangat e shkollës 8-vjeçare 113 nxënës. Kuadri arsimor ka arsimin përkatës, shkolla është pajisur më së miri me laboratorët e nevojshëm. Arsimitarja, që ka më shumë kohë në Theth, është Tusha Jubani. Ajo ka 6 vjet që mori dëftesën e pjekurisë dhe erdhi përnjëherësh në Theth. Ishte 18 vjeçe dhe erdhi këtu plot ëndërra rinore. Asaj nuk i shkonte kurrë në mendje se do të bëhej nuse në Dukagjin. Duke punuar në shkollë dhe si aktiviste në fshat, u njoh dhe lidhi jetën me malësorin Lazër Zefi. Këto ditë ajo nuk ishte në Theth. Së shpejti do të bëhet nënë. Fëmijën e parë shkoi ta lindte në Shkodër; në të ardhmen ajo nuk do të marrë më rrugën e

qytetit të vendlindjes për lindur fëmijën e dytë, por do të shkojë tek nxënësja e saj - Gjyste Marashi, që sapo ka mbaruar shkollën dhe u bë mami e fshatit.

Ndërtesa më e madhe, e ngritur në një livadh të bukur, është kisha e fshatit. Atë ende e quajnë kishë, megjithëqë prift nuk ka më atje dhe ka disa muaj që nuk luten më atje ritet fetare...

Në shkollën e Thethit brenda këtyre viteve kanë mësuar shumë nxënës. Këtu mësoi jo vetëm mamia, por edhe kryetari i kooperativës bujqësore Nik Toma në shkollën e mbrëmjes. Po këtu mësuan edhe arsimtarët Lena Prela e Palok Nika, i cili, me korrespondencë, po vazhdon studimet e larta. Në bangot e vjetra të kësaj shkolle mësoi edhe drejtuesi i vatrës së kulturës Gjergj Nikaj. Në pragun e muajit të letërsisë Gjergji organizoi një pasdite tematike. Në vatrën e kulturës u mblodhën 100 vetë. Vendi ishte i ngushtë, por ai u duk ende më i vogël kur të pranishmit filluan të kërcëjnë. Kur pushoi muzika, kovaçi i fshatit, plaku Milan Çuni, bëri një propozim, që çuditi dhe vetë të rinjtë : "Përse të mos e bëjmë kishën shtëpi kulture?. Pas disa ditësh, 50 të rinj shkuan dhe gjithë inventarin e kishës e mbyllën në një dhomë.

Para një muaji qetësinë e përrjetshme të atij vendi e prishën jo tingujt e kabanave, por fizarmonika e Gjergj Nikës. Në kishë u bë mbrëmje. Veç të rinjve erdhën edhe pleq. Ata shihnin të rinjtë duke kërcyer, por shumë prej tyre u mbetën sytë tek fizarmonika. Ajo është fizarmonika e parë në Theth dhe Gjergji ka fatin të jetë i pari të luajë me të. Ndërtesa e madhe dhe e bukur e kishës, ende nuk është vendosur ç'do të bëhet. Por tek qela e priftit është vënë një shënim : "Materniteti".

Thethianët i duan mësuesit jo vetëm pse ata mësojnë fëmijët e tyre, por edhe pse jetojnë bashkë me 'ta. Ata flasin me respekt për mësuesen Hajrije Duro. Ajo ka tre vjet në Theth. Fshatarët e kanë parë thujse të gjithë nëpër shtëpitë e tyre, herë si mësuese kujdestare herë si aktiviste. Kohët e fundit ajo shkonte një orë larg, në lagjen Gjeçaj (ku është qendra turistike), tek shtëpia e nxënësës Drande Noshi, prindët e së cilës nguronin që vajza të vazhdonte arsimin e mesëm. Mësuesja, si rinte orë të tëra duke biseduar me Dranden dhe prindërit e saj, mirrte leckën dhe fillonte të lante dyshemenë. Nga e kaluara, ende dhe sot, në Theth ruhet një zakon i vjetër i Dukagjinit : dyshemeja është pis dhe nuk lahet. Në fillim e ëma e Drandes e shihte me inat mësuesen; më vonë nisën të lanin bashkë, ndërsa tani këtë punë e bën

me kënaqësi vetëm nëna e Drandes, sepse vajza i ndjek shkollën e mesme.

Në shkollën 8-vjeçare verore të Thethit tani u mbyll tremujori i dytë. Rezultatet ishin të kënaqshme, por një punë ende më e madhe i pret mësuesit në tremujorin e tretë. Drejtor i shkollës është Shefik Sokoli. Ai u bë mësues në moshën 15 vjeç. Karrierën e filloi në një fshat 10 orë larg Pukës. Më vonë e transferuan afër qytetit të vendlindjes. Gjatë jetës së tij si mësues ai mori me korrespondencë arsimin e mesëm dhe Institutin 2-vjeçar Pedagogjik. Me thirrjen e komitetit të partisë, ai vullnetarisht shkoi në shkollat verore. Ka tre vjet që punon në Theth. Dimrin e kaluar mori më vete edhe motrën e tij, që sapo mbaroi shkollën pedagogjike. Lumja nuk e harron atë ditë marsi. U nis me vëllanë dhe 5 arsimtarë. Atë ditë në Shkodër binte shi i ftohtë, ndërsa, si kaluan Koplkun, filloi të binte dëborë. Sa të vështirë e kishte Lumja të zbriste për herë të parë Shtegun e Dhënëve. Ajo është aktiviste dhe kujdeset shumë për lulet e shkollës. Fatkeqësisht sot shkolla është e vetmja ndërtesë që ka shumë lule në hyrjen e saj. Dhe sa shumë e hijeshojnë ato atë ndërtesë të vjetër.

Këtë pesëvjeçar në Theth do të ndërtohet një shkollë e re. Ajo do të ishte ndërtuar me kohë, por edhe vetë mësuesit votuan bashkë me malësorët që më parë të ndërtohej hidrocentrali i fshatit. Këtë tremujor mësuesit u zotuan të ngrenë grupet artistike në shkollë, megjithëqë mungesa e një mësueseje të lëndëve estetike i pengon...

* * *

Thethi është i bukur në verë. Por këtë dimër ai do të jetë edhe më i bukur. Në familjet e gëzuara të malësorëve do të ketë dritë elektrike.....

Kozma Grillo, "Mësuesi", 2 shtator

1967

Kalendari Sportiv Kombëtar

Alpinizëm

1. 1-14 shkurt: Kursi kombëtar dimëror i alpinistëve në Razëm.
2. 8 mars: Ngjitje kombëtare në majat Papllugë dhe Jezercë.
3. 1 maj: Ngjitje kombëtare në majat e Nemërçkës, Shkëlzenit dhe Guri i Capit (25 qershor) me pjesëmarrjen e rretheve dhe të klubeve sportive, me 3 deri 6 veta.
4. 16-30 korrik. Kursi kombëtar veror në Theth me kuadro fillestarë.
5. 1-15 gusht: Ngjitje të kualifikuara shkëmbore në Alpe.
6. 28 nëntor: Ngjitje kombëtare në 3 maja malesh: Çikë, Tomorricë, Shebenik.

3 janar

Frymëzim për fitore të reja

Në numrin e kaluar të gazetës sonë, lexonjësit u njohën me suksesin e arritur nga alpinistët tanë, të cilët pushtuan tri majat më të larta të alpeve si dhe me letrën që i dërguan ata udhëheqësit të dashur të partisë e popullit tonë, shokut Enver Hoxha.

Ngjitja me sukses në Majën e Rinisë (Jezercë), në Majën 8 Mars (Papllugë) dhe në Radohimë, letra dhe fjalët e ngrohta që alpinistët i dërguan shokut Enver ishin një gëzim i madh jo vetëm për alpinistët, por për të gjithë fizkulturistët e sportistët tanë, për gjithë lëvizjen tonë fizkulturore-sportive.

Me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, shumë nga alpinistët tanë të dalluar u nderuan edhe me urdhëra e medalje për kontributin e shquar që kanë dhënë në drejtim të përhapjes së lëvizjes alpinistike në vendin tonë.

Veterani i alpinizmit shqiptar Luigj Shala dhe mjeshtri i sportit Minella Kapo, dy nga iniciatorët e lëvizjes sonë alpinistike e turistike, u dekoruan me urdhërin e punës të klasit të dytë (i pari pas vdekjes). Me urdhërin e punës të klasit të dytë u dekoruan gjithashtu edhe Universiteti Shtetëror i Tiranës si dhe Shoqata lokale e turizmit e alpinizmit për rrethin e Beratit.

Mjeshtrat e sportit Petraç Kule, Vasil Stambuli dhe Kozma Grillo, alpinisti Vangjel Melengu, si dhe klubi turistik i Pallatit të Pionierëve të kryeqytetit u dekoruan me urdhërin e punës së klasit të tretë, kurse alpinistët Grigor Perikliu, Agim Kajanaku, Vangjel Ristani, Roza Gjergji dhe Astrit Omeri u dekoruan me medaljen e punës...

28 mars

Nga "Shkëlzeni" në Shkëlzen

Hoteli i qytetit Bajram Curri mban emrin e malit që ka karshi. Si çdo hotel tjetër ai ka parë njerëz të shumtë që hyjnë dhe dalin. Por ai, për mjaft kohë nuk do të harrojë klientët e 22 prillit, që me këpucë të rënda plot gozhdë, me kazma, konopë dhe të ngarkuar rëndë zbritën shkallët e tij. Ndoshta mbresat për këta njerëz u bënë më të forta se lanë rehatinë në dhomat e tij, u ngarkuan dhe dolën në atë kohë aq të keqe...

Kur nëpunësit e këtij qyteti të ri dilnin nga zyrat, dymbëdhjetë vetë u nisën për rrugë. Qazim Liço i paraqiti forcën shokëve që kishin dalë për të na përcjellë. Çudia e ne të gjithëve dhe e Ali Agos që se Qazimi nuk "e tundi" këtë qytet, siç na tha më parë. Sa për atë që alpinistët e Shkodrës dhe të Tropojës kishin ardhur pa kazma alpine, ne nuk u çuditëm, se jemi mësuar me ata. Ne do të provojmë një ndjenjë kënaqësie kur komitetet e fizkulturës së rretheve do t'i nisin alpinistët me pajisjet më të domosdoshme.

Për mendimet dhe ndjenjat tona shiu as nuk desh t'ia dijë. Vazhdonte të binte dhe na hyri në trup pa dalë mirë nga qyteti.

Pas tre orësh arritëm në fshatin Kërrnajë. E kaluam natën në shtëpinë e Brahim dhe Mehmet Brahës, mikpritjen dhe bujarinë e të cilëve nuk do t'i harrojmë.

Nuk ishte hera e parë që lageshim duke u ngjitur në mal. Rrobat e thara pranë zjarrit u bënë qull pa dalë mirë nga shtëpitë e fshatarëve.

Me ne u bashkua dhe Mehmeti. U bëmë 13 vetë. Tek Kroni i Bjeshkës vendin e shiut e zuri dëborë. Na erdhi çudi që në mezin e pranverës të kishim ftohtë dhe të ecnim mbi dëborën e re që e kalonte gjurin. Si çdo ngjitje në mal, ndjemë lodhjen e zakonshme, e cila u bë më e rëndë nga koha e zyrtë. Deri në qafë të malit udhëhoqi Mehmeti që nuk desh t'ia dinte nga armikja më e madhe e alpinistëve - mjegulla. Filluam të çanim dëborën me radhë.

Pas tre orë ngjitjeje dhe pas një të përpjete të thikëshme u ngjitëm në majë. Nga ana teknike ngjitja nuk ishte e vështirë, por e lodhëshme dhe interesante se e shkelëm për herë të parë...

Kozma Grillo, 2 maj

Thethi piktoresk – vatër e kalitjes fizike

Majat madhështore të Alpeve tona - Radohima, Boshi, maja e Drenit, Alisë, Arapit, i qëndrojnë si kurorë Thethit piktoresk dhe ia shtojnë edhe më shumë bukurinë atij. Poshtë prroi i kristaltë me ujën e kulluar e të ftohtë akull dhe më tutje, në një majë të thepisur, katarakti, të ftojnë në gjirin e tyre për të admiruar e soditur. Gjithçka këtu është e mrekullueshme: edhe fshati, edhe malet, edhe qafat, edhe uji. Ngado që të hedhësh shikimin, syri sheh vetëm bukuri, bukuri ngjyrash, që ndryshon orë e çast.

Por Thethi nuk ka më vetëm kuptimin e një vendi turistik me bukuri të rrallë. Bukuria më e madhe e tij qëndron në ndryshimet e thella që kanë bërë dhe në pamjen e re që ka marrë ai. Për herë të parë u prodhua buka në vënd, brënda pak vjetësh u dyfishua sipërfaqja e mbjellë dhe u kthyen në taraca faqet e maleve; u hap shkolla, rrjeti tregtar, rruga automobilistike dhe drita elektrike ndriçoi edhe në këto anë. Partia ka sjellë gëzim e hare në çdo familje dukagjinase.

Vizitorët e përvitshëm

Thethi është bërë një nga qendrat tona më të rëndësishme turistike, vatër e kalitjes fizike. Këtu çdo vit, dimër e verë, vijnë dhjetra turistë e alpinistë. Ata njihen me bukuritë e këtij vëndi, kryejnë ngjitje alpinistike, bëjnë marshime të gjata, kalojnë nga njëra qafë në tjetrën, nga njëri mal në tjetrin.

Edhe sivjet Thethi u bë qendër e një aktiviteti të rëndësishëm

turistik e alpinistik. Lart nga 50 vetë, midis të cilëve punëtorë, arsimtarë, inxhinierë, nxënës, mjekë e studentë nga shumë rrethe të vëndit tonë, kryen për 15 ditë me radhë një kurs kombëtar, duke marrë njohuri fillestare teorike e praktike për turizmin e alpinizmin, duke kryer ngjitje të thjeshta alpinistike dhe duke zhvilluar mësimë rreth këtyre sporteve të dobishëm e të bukur.

Instrukturët e ardhshëm të turizmit e alpinizmit nëpër rrethe e qendra pune kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme sportive e shoqërore gjatë periudhës së kursit. Shpesh herë në tavolinat e shahut e të ping-pongut janë zhvilluar ndeshje të gjalla e të bukura, në kuadrin e kampionatit midis togave, kurse tek fusha e volejbollit kooperativistë e alpinistë kanë asistuar në çfaqje kolektive artistike e kinematografike...

Vajzat alpiniste

Dikur numri i vajzave që ushtronin alpinizmin ishte shumë i kufizuar. Në aktivitetet alpinistike shpesh, sidomos kohët e fundit, shihej vetëm apotistja e apasionuar Roza Gjergji, ndihmës mjeke nga Elbasani.

Këtë herë në Theth Roza nuk mbeti vetëm. Midis alpinistëve erdhën për të marrë pjesë edhe vajza të tjera, instruktore e alpiniste të ardhshme, që do ta përhapin edhe më tej këtë sport të guximit, shëndetit e kalitjes; sportin që edukon tek njerëzit ndjenjën e kolektivitetit e të solidaritetit në një masë, ndoshta më të madhe se disa sporte të tjerë; sportin që zhvillon tek të rinjtë ndjenjën e patriotizmit, dashurinë për Atdheun dhe natyrën e bukur.

Midis alpinistëve, krahas Rozës, ne pamë edhe elbasanaset Adile Xhelili e Bukuroshe Xhaferi si dhe dy studentet e Universitetit Shtetëror të Tiranës: Miranda Vinçani dhe Mira Hyseni.

Të pestë vajzat janë entuziaste e krenare për sportin që kanë zgjedhur.

Edhe alpinistët janë të gëzuar e krenarë që radhët e tyre po shtohen gjithnjë e më shumë, bile edhe me femra...

* * *

Në njërën prej ditëve të javës që kaloi kryetari i shoqatës shqiptare të turizmit e alpinizmit Kristo Papajani dhe sekretari i kësaj shoqate Muharrem Sinoimeri u ndodhën midis alpinistëve. Në një sallë të

godinës së bukur turistike u zhvillua një takim interesant. Pjesëmarrësit në kurs bënë një sërë vërejtje e propozime për përmirësimin e mëtejshëm të punës për zhvillimin e përhapjen në stil të gjërë të turizmit e alpinizmit. Pastaj shoku Kristo Papajani i porositi ata për të punuar në drejtim të zhvillimit masiv të këtyre sporteve si dhe për rritjen e mjeshtërisë sportive....

Ismet Bellova, 1 gusht

Ngjitjet përfunduan

“Në bazë të kalendarit sportiv kombëtar dhe me rastin e 25-vjetorit të shtypit tonë popullor, prej datës 1 deri më 15 gusht në Alpe u bënë ngjitjet e kualifikuara shkëmbore. Në ngjitjet e këtij viti morën pjesë 28 alpinistët më të mire - përfaqësues të Tiranës, Beratit, Vlorës, Peshkopisë, Korçës, Shkodrës, Elbasanit dhe të KS “Studenti”. Për herë të parë në një aktivitet të tillë morën pjesë edhe dy alpinistët të KS “Dinamo”.

Alpinistët, të ndarë në tri toga, i bënë ngjitjet në zonën e Qafës së Pejës, në Bjeshkët e Namuna (Killogjer) dhe në zonën e Bogës. Togat i udhëhoqën mjeshttrat e sportit Kozma Grillo e Petraq Kule dhe alpinisti i kategorisë së parë Vangjel Ristani.

Ngjitjet përfunduan me sukses, duke përkrahur mjaft itinerarë të panjohur. Në të njëjtën kohë, ngjitjet e kualifikuara shkëmbore, shërbyen së tepërmi për rritjen e mjeshtërisë sportive të alpinistëve tanë.

Lësho litar!

- “Jo bre, një ta nuk janë gjeologë! A nuk i sheh se kanë konop?”.

Vite përpara, në qendrat e banuara, ne, alpinistëve, na merrnin për gjeologë. Dhe nuk ishte aq e lehtë t’i mbushje mendjen ndonjë malësori, i cili mendonte se nuk tregonim për “me ruajtë sekretin”. Brënda këtyre 11 vjetëve ne kemi vajtur shumë herë në Alpe dhe kemi zënë miqësi me mjaft vendas.

Litarët janë mjeti i vetëm që i bënë malësorët të mos pyesin më: “A keni gjetë mineral në bjeshkët tona?...”. Megjithatë, shumë prej

tyre ende mendojnë se, me përjashtim të alpinistit, që punon i pari në shkëmb, të tjerët ngjiten “duke u kapë pas konopit”.

Në ngjitjet shkëmbore të organizuara vitet e fundit na kanë parë shumë barinj që dalin me bagëti për të veruar në bjeshkë. Ata, ndoshta, të mbledhur pranë vatrës në netët e ftohta të dimrit, tregojnë edhe për miqtë e tyre - “njerëzit me konop”, që shpesh herë çelin shtigjet gjatë dimrit, apo kur dielli përvëlton, ngjiten nëpër shkëmbinj. Dhe fjala kalon nga një malësor tek tjetri, nga një fshat në fshatin fqinj. Do të jetë kjo arsyeja që, herët në mëngjez, para se të nisemi për t’u kacavjerrë në shkëmb, në çadrat tona vijnë fshatarë të panjohur për të biseduar, për të dëgjuar radion apo për të kërkuar ndihmën tonë. Sivjet, ne, alpinistët e Tiranës, kishim fqinjë çobanët e kooperativës bujqësore të Grizhës (Koplik). Shumë nga ata ne nuk i njihnim, por një ditë disa prej tyre erdhën...Ditën e pushimit Aliu, Qazimi dhe Nikua realizuan një ngjitje të vështirë për të marrë një dhi të tyre që kishte mbetur disa ditë në mes të një shkëmbi.

Jo vetëm malësorët, por edhe disa arsimtarë të shkollës së Thethit mendojnë se forcat, zotësia dhe guximi ynë qëndron tek litari, se litari bën mrekullira. Këtë vit ne ishim pajisur më mirë se çdo vit tjetër. Si çdo herë litarët e rinj dhe shumëngjyrësh tërhoqën vëmendjen e malësorëve, disa prej të cilëve, si i preknin me dorë, u shkante mendja tek kafshët e tyre dhe pyetnin :

- A shiten konop të tillë?

Sivjet ne kishim shumë litarë. Megjithatë ne nuk bëmë mrekullira, se litarët, megjithëse janë prej fijesh sintetike, nuk janë “litarë magjikë”. Ata na ndihmojnë në kuptimin figurativ të shprehjes, na japin forcë. Kur alpinisti është duke u kacavjerrur në shkëmb, sado pisk që ta ketë, kur sheh se lëviz edhe litari, i duket sikur forcat fizike dhe morale i shtohen..., ndërsa në të vërtetë ai vazhdon të ngjitet në shkëmb duke u kacavjerrur me duart dhe këmbët e veta. Përherë i sigurt në vete se nuk është i vetëm, por vetë i tretë, i lidhur në të njëjtin litar kolektiv.

Gjatë ditëve të ngjitjeve shkëmbore të gjithë alpinistët demonstuan përgatitjen e mirë fizike dhe forcën e madhe morale, guximin dhe mjeshtërinë sportive, e cila është duke u rritur nga viti në vit, nga njëra ngjitje në tjetrën.

Për ditë të tëra faqet shkëmbore të Prozhmit dhe të Arapit, të Çardakut dhe shumë majave të tjera u gërvishtën nga gozhdët alpine,

u prish virgjëria e vendeve të pashkelura asnjëherë, u prish qetësia e tyre e rëndë nga parullat tona :

- Sigurimi, gati?
- Gati!
- Po nisem!
- Të ruaj!

Këto fjalë kush e di sa herë i kemi dëgjuar (dhe do t'i dëgjojmë) nga njëri tjetri, kush e di sa herë ato kanë jehuar (dhe do të jehojnë) nga një qafë në tjetrën. Disa herë këto fjalë i dëgjon edhe në...çadër, kur fillestari, duke ëndërruar në gjumë, bërtet :

- Tërhiq, tërhiq litar!....

Sivjet realizuam ngjitje të vështira në shkëmb, por asnjërit nga ne nuk i shkoi në mendje se bëme mrekullira.

* * *

Nga programi, për mungesë organizimi, vetëm një pikë nuk u realizua : mbledhja e përbashkët në Theth për të analizuar ngjitjet. Si komandat i togës së parë të alpinistëve, në atë mbledhje unë do të thoshja, midis të tjerash:

- Ngjitjet u kurorëzuan me sukses. Secili rriti aftësitë e tij teknike dhe kreu ngjitje vështirësie të kategorive të ndryshme; për këtë i përgëzoj të gjithë dhe në veçanti alpinistët : Aleksandër Bojaxhi (boa i togës sonë), Ali Ago, Niko Stamo (trekëndëshi ynë), Qazim Liço dhe Agim Tabaku. Megjithëse herë e parë, që punuan në shkëmb, duhen përgëzuar për ngjitjet e mira Myftar Marku, Maridon Hito (alpinist i palodhur dhe me perspektivë) dhe Vili Kosturi.

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 22 gusht

1968

Kalendari Sportiv Kombëtar

Alpinizëm

1. 10 janar : Ngjitje kombëtare në majën e Shnikut, kushtuar 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.
2. 1-14 shkurt : Kursi kombëtar dimëror i kualifikimit të alpinistëve në Razëm.
3. 4-8 mars : Ngjitjet e kualifikuara dimërore në Alpe.
4. Qershor : Ngjitje kombëtare në Gurin e Capit kushtuar 25-vjetorit të themelimit të Ushtrisë Popullore.
5. 16-30 korrik : Kursi kombëtar i përgatitjes së kuadrove të alpinizmit në Theth.
6. 1-14 gusht : Ngjitjet kombëtare të kualifikuara në Majën e Hekurave,

Korabit dhe Papingut.

2 janar

Majën e Shnikut "e mposhtëm"...

Duke punuar në të njëjtën godinë (në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës), me Muharrem Sinoimerin takoheshim shpesh. Krahas bisedave të rëndomta, kuptohet që një vend të rëndësishëm zinin ato që lidheshin me alpinizmin. Ai si funksionar i vetëm (sekretar i Shoqatës së Turizmit dhe të Alpinizmit) dhe unë si kryetar i komisionit teknik të alpinizmit.

Gjatë vjeshtës së vitit 1967, në prag të hartimit të veprimtarive që do të vendoseshin në kalendarin sportiv kombëtar dhe të festimit të 500-vjetorit të vdekjes të Skënderbeut, zhvilluam disa biseda për ndërmarrjen e një ngjitje alpinistike në muajin janar. Ngula këmbë që të mos sulmonim Jezercën, për arsye se ishte sulmuar disa herë.

Në çdo rrafsh ishte më mirë të sulmonim Shnikun. Shniku, ky mal i lartë që ndan Dukagjinin nga Kelmendi, asnjëherë nuk ishte sulmuar në stinën e dimrit.

Muharrem Sinoimeri nuk ishte alpinist, por ai bëri shumë për alpinizmin shqiptar. "Dobësinë" që nuk ishte alpinist, Muharrem Sinoimeri e kompensonte me tiparet e personalitetit të tij, ndër të cilat do të veçoja: respektin për njerëzit, aftësinë për të biseduar dhe mësuar nga të tjerët, dashamirësinë dhe humanizmin, aftësitë e mëdha organizative, korrektesën dhe konsekuencën, përkushtimin ndaj detyrës që ushtronte (shihni në këtë botim sa artikuj shkroi për t'i dhënë impuls gjithnjë në rritje alpinizmit, shkroi më tepër se tre pasardhësit që vazhduan funksionin e tij të marrë së bashku) dhe qëndrimin larg meskinitetit.

Në muajin dhjetor ai më tha se ishte dakord të sulmonim Shnikun. Për arsye se koha ishte e pakët për të angazhuar edhe alpinistë nga rrethet, më dha të drejtën të merresha konkretisht me organizimin e kësaj ngjitje, të zgjidhja grupin që do të sulmonte Shnikun me alpinistë të kryeqytetit.

Ishte kënaqësi dhe përgjegjësi për mua. Nisa takimin me alpinistë, i ftoja të merrnin pjesë në këtë veprimtari, të vendosnin dhe të më deklaronin në rast se do të vinin. Më erdhi keq (atij më tepër se mua) që nuk mund të vinte Vasil Stambuli. Kuptohet që bisedat me më të kualifikuarit vazhdonin orë e orë të tëra për të skicuar planin e detajuar se si do të vepronim për të arritur suksesin. Fjala u hap. Erdhën dhe më shfaqën dëshirën për të marrë pjesë në këtë ngjitje më tepër se numri që ishte caktuar (i kushtëzuar nga dietat e përcaktuara). Më ngusht e ndjeva veten kur erdhi dhe shfaqti dëshirën për të marrë pjesë në këtë veprimtari alpinistia Xhuliana Bakrina, studente e mjekësisë. Nuk më kujtohet se çfarë i thash konkretisht, por u ndamë dhe mbetëm miq. Unë isha regjizori i kësaj veprimtarie. Kuptohet që hap vendimtar ishte zgjedhja e ekipit. Në krijimin e një ekipi alpinistësh rëndësi të veçantë ka zgjedhja e sportistëve më të kualifikuar. Por kjo nuk është e mjaftueshme. Po kaq e rëndësishme është edhe krijimi i një ekipi ku të gjithë punojnë bashkërisht, ndihmojnë njëri-tjetrin për arritjen e qëllimit. Në mënyrë të veçantë në alpinizëm debutuesit duhet ta respektojnë dhe ta duan njëri-tjetrin.

Kur përgatitjet po i afroheshin fundit, Muharremi më

rekomandoi që pjesëtar i grupit të ishte edhe një jashtë "listës sime". Ky ishte Flamur Milova, student i mjekësisë (më duket në vitin e fundit). Me mirësjellje e kundërshtova. Ky kundërshtim u bë më i ndjeshëm kur mësova se ai ishte nga Berati. Si çdo njeri edhe Muharremi kishte dobësitë e veta. Një ndër to ishte dashuria e veçantë për lëvizjen alpinistike në Berat. Ai nguli këmbë që ne të kishim në këtë ngjitje një që merrte vesh nga mjekësia. Doja apo nuk doja, në fund, u tërhoqa.

Siguruam pajisjet më të mira të mundshme për atë kohë. Do të merrnim edhe dy tenda franceze që sapo kishin ardhur, të përgatitura për lartësitë mbi 5.000 metra. Në këtë atmosferë, një mbrëmje, në vigjilje të nisjes, në një lokal (sot nuk ekziston) në rrugën e Barrikadave u mblodhëm të gjithë: Ali Ago, Kristaq Korçari, Maridon Hito, Qazim Liço, Kujtim Dobrolishti, Aleksandër Bojaxhi (i vetmi që nuk banonte në Tiranë), Astrit Omeri, Janaq Ziso, Niko Stamo, Kozma Grillo dhe Flamur Milova. Erdhën për të na përshëndetur dhe uruar alpinistë tiranas dhe sekretari i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit. Gjithçka si asnjëherë tjetër.

Dita e parë (6 janar). Ao ditë në Tiranë bënte shumë ftohtë, por koha ishte e mirë. Si kaluam Xhain e ndjemë që me dukuritë atmosferike "do të kishim punë". Fjetëm në Bogë.

Dita e dytë (7 janar). Në atë mëngjez të bukur dhe të kthjellët, duke ecur në rrugën e fshatit tërësisht mbuluar nga dëbora shumë e shkrifët, u nisëm për në Theth. Dukej sikur gjithçka punonte për ne. Por, fatkeqësisht, ishte vetëm një iluzion që zgjati më pak se një orë, deri sa mbërritëm në Okol të Bogës. Pa vajtur tek kthesa që ndahesh nga rruga automobilistike vumë re një dukuri të panjohur për ne. Dëbora na fundoste tërësisht. E "studiuam" dhe na rezultoi, se, ajo nuk ishte petashuqe, flokë-flokë dhe e lagësht, por në vend të flokëve ishin kokërriza (të ngjashme me oriz jokokërmadh) të palidhura me njëra-tjetrën, fundoseshim deri në gjoks. Si pasojë, ajo copë rrugë, që të shpie tek Gropa e Shtegut, që edhe në dimër përshkohet për rreth një orë, na mori 6 orë. Kështu, kundër dëshirës dhe vullnetit tonë vendosëm një "rekord" ogurzi.

Vendosëm dhe ngritëm çadrat. Litarin e çadrës "Pamir" e lidhëm në filxhanin e shtyllës telefonike të postës kufitare të Thethit. Në njëfarë mënyre u ndamë një grup në fillim të Gropës së Shtegut dhe tjetri rreth 100 metra më tutje. Murlani vazhdonte të shfrynte

me tërbim. Kur u kthyem në shtëpi mësuam se temperatura në Tiranë kishte zbritur 14 gradë nën zero. Ishte një "rekord". Nuk e di sa do të ishte temperatura atje. Por jam i vetëdijshëm se atë të ftohtë nuk e kishim ndier kurrë. Futemi në çadër. Përpiqemi në atë hapësirë të vogël të nxjerrim ndonjë veshje të thatë, për të hequr ato të ngrirat. Kaluam një natë të keqe, një natë të zezë.

Dita e tretë (8 janar). Mëngjesi kishte kohë që kishte ardhur, por nuk kam guxim të them u zgjuam. Ishim të lodhur dhe kishim ftohtë. Trashësia e asaj dëbore ishte rritur. Afër drekës moti u qetësua. Isha i bindur se nuk mund të arrinim në majën e Shnikut. Në të njëjtën kohë ishim nën ndikimin e ndjenjave, të cilat nuk më lejuan të jepja komandën të ktheheshim. Në ato çaste erdhi Aleksandri, zëvendëskomandat i asaj ngjitje, biseduam. Ai donte të nisej me disa alpinistë në drejtim të Thethit. Ishte një iniciativë adoleshenti. Për të mos i prishur entuziazmin pranova (më saktë duhet thënë - gabova!). E lamë që kur të mbërrinin tek Shtegu i Dhënëve dhe shihej mundësia e zbritjes në Theth, të jepnin parullën... U nisën. Kaloi goxha kohë sa dëgjuam thirrjen e tyre. Me shpejtësi heqim çadrat, ngarkojmë çantat dhe nisemi..

Na u desh rreth një orë që të mbërrinim afër pishës së vetmuar, ku nis tranversa për tek Shtegu i Dhënëve. Na u duk se gjithçka po errësohej me shpejtësi dhe era e lemerishme zhduku ato pak gjurmë që kishin lënë shokët në dëborë. Pas pak çastesh nuk shihnim asnjë shenjë të gjurmëve të tyre.

Ndodheshim fare afër asaj pishë. Vazhdonim përpjekjet e dëshpëruara. Pa prituri, përjetuam ndjenjën se trupi ynë nuk kishte "peshë", dëgjonim vetëm një fëshfërimë në vesh, që një forcë e panjohur, me një lehtësi të çuditshme, herë pas here na rrotullonte dhe na shpinte gjithnjë e më poshtë. E kuptuam që na kishte marrë orteku rrëshqitës i shkëputur nga shpati i malit. Çuditërisht kujtuam në fragment të sekondës që duhej të lëviznim duart para fytyrës për të krijuar një "jastëk ajëri" për frymëmarrjen. Por kjo nuk na vlejti në atë dëborë të palidhur. Desh Zoti që orteku na mori dhe po orteku na nxorri. Merrim frymë thellë dhe shihnim rreth e rrotull të hutuar.

Si morëm pak veten pamë që dikush më poshtë dikush pak më sipër ishim gjallë. Vetëm Ali Agon nuk po e shihnim. Filluam ta thërrisnim më gjithë fuqitë që kishim, por asnjë përgjigje. Duke vërejtur në atë copë shkretëtirë, sa të bardhë aq dhe të ftohtë, nuk na tërhoqën vëmendjen çantat e shpinës të hedhura sa andej këndeje, por maja e një

dorashke. U afruam tek ajo me "vrap". Filluam të rrëmonim në dëborë, por ajo nuk lëvizte. Ishte në dorën e Aliut. I larguam dëborën rreth trupit, e ndihmuam të dilte në sipërfaqe dhe ai e mori shpejt veten. Për mua ai është gjallë falë shtatartësisë.

Si mblodhëm, ato që mundëm, sendet e hedhura tutje e tëhu nisëm të zbrisnim. Asnjë zë nuk dëgjonim në përgjigje të thirrjeve tona. Ngritëm çadrat. U futëm të gjithë (unë, Aliu, Mario, Niko dhe Janaqi) tek çadra franceze, bri saj ngritëm dhe çadrën e pavdekshme (13-vjeçare) "Pamir". Të gjitha ushqimet e konservuara i vendosëm jashtë çadrave. Ishte një "dhuratë" e madhe për blegtorët që do të vinin në verë.

Tufani shfrynte si i tërbuar. Mendja na shkonte tek shokët. Vetëm si kaluan 2-3 orë, në një çast që tufani u mefsh, u lidhëm me shokët - ishin mirë dhe e kishin ngritur çadrën në të njëjtin vend.

Si kaloi ajo natë? Me gjithë të këqijat e saj, dëborë na bëri një "nder": brenda në çadër nuk ishte ftohtë. Kanë kaluar 41 vjet nga ajo natë dhe më duket herë si ëndërr e herë sikur ka ndodhur para pak ditësh...

Dita e katërt (9 janar). Agimi e zboi tufanin. Heshtje që të trembte pas atyre orëve që kishim kaluar. Ishim gjysëm zgjuar dhe nuk na bëhej të dilnim nga çadra, madje dhe të flisnim me njëri-tjetrin. Aty rreth orës 10 dëgjuam zhurmën që bënin hapa mbi dëborën tejet të ngrirë. Hapëm çadrën dhe pamë Aleksandrin. Asnjëherë nuk e kam parë aq të palarë dhe të nxirë. Na tha si e kishin kaluar dhe që nga ngrirja "doktori" (Flamur Milova. Shënimi ynë: K.G.) e kishte keq me këmbët. Nuk mund të vazhdonte më tutje.

Me dhimbje, vendosa që të gjithë të zbrisnim në Bogë, të linim "doktorin" dhe pas një ose dy ditësh t'i drejtoheshim përsëri Shnikut. U thash shokëve të përgatiteshin. Qielli ishte tejet i kaltërt. Dielli ndriçonte por nuk na ngrohte. Kur u kujtuam për çadrën Pamir, mezi e nxorrëm, ishte krejt e ngrirë. As që bëhej fjalë në atë të ftohtë për ta mbështjellë. E terhoqëm zvarrë deri në fshat.

Flamur Milova dukej që vuante shumë nga ngrirja e këmbëve. Duke u mbështetur tek shokët nisi dhe nisëm të zbrisnim. Sot nuk na duheshin aq shumë orë për të mbërritur në Bogë. Edhe të kishje qejf të fundoseshe në dëborë qoftë edhe një hap, "dëshira" nuk të realizohej. Gjithçka ishte shndërruar në akull.

Flamurin bashkë me Aleksandrin dhe Marion i lamë tek shtëpia e parë në lagjen e sipërme të Bogës. Ne vazhduam për në qëndrën e fshatit, për në shtëpinë e mikut të alpinistëve - Gjekës,

tek kroni. U futëm në shtëpi. Në hajat hoqëm çantat. Karshi shihnim zjarrin e madh në oxhak. Çantat i hoqëm me pak mundim, ndërsa këpucët dhe kambalet me shumë vështirësi se ishin krejtësisht të ngrira. Thirrëm disa herë Gjekën. Herë i kërkonim thikë dhe herë kacoren për të prerë ç'mund të pritej që të "shpëtonim" nga këpucët. Më i paduruari ishte Qazimi (Qazim Liço), më i forti fizikisht nga të gjithë ne. I hoqi i pari këpucët dhe, sa hap e mbyll sytë, u ul thujse mbi zjarrin e oxhakat. Fjalët e mia, për të mos iu afruar zjarrit, nuk hynë në vesh të asnjërit.

Si morëm veten dhe hëngrëm, kush më shumë dhe kush më pak deshte të pinte. U ngrita dhe fola në guzhinë me të zotin e shtëpisë të na shiste verë. U betua që nuk kishte. Si ndënji pak më tha se kishte uthull rrushi, e cila po të përzihej me sheqer "bëhej verë". Pranova. E provuan qeflinjtë dhe u pëlqeu. Të gjithë e shihnin që me këmbët dhe gishtërinjtë e duarve puna nuk shkonte mirë. Deri vonë kënduan, veçanërisht Astriti dhe Janaqi me këngën polifonike:

*"...gjithë natën e janarit,
mbeti llamba ndezur-o..."*

Në mëngjes u nisa me Nikon dhe Gjekën, i cili tërhiqte slitën, për të vajtur tek shtëpia ku kishim lënë "doktorin". Me atë fukarallëk dijesh që kisha për mjekësinë, e kuptova që ai duhej kuruar sa më shpejt. Pas dy orësh u mblodhëm të njëmbëdhjetë. Nëntë, jo përse i takon oreksit, ishin të sëmurë. Vetëm unë dhe Niko Stamo kishim shpëtuar paq. Krijova bindjen se as që mund të bëhej fjalë për të sulmuar përsëri Shnikun, ishte e nevojshme që shokët të kuroheshin sa më parë. Vajta tek kisha. Takova Kolë Nikën, përgjegjës in e skuadrës së mirëmbajtjes së rrugës dhe, si i tregova gjendjen, i kërkova të lajmëronte në Shkodër të vinte autubusi sa më shpejt të ishte e mundur. Boga ato vite nuk "e njihte" telefonin.

Kuptohet që dita e sotme nuk e pati gjallërinë e mbrëmjes së djeshme. Nga humori që sa vinte e binte na shkëpuste e qeshura dhe shakatë e ëmbla të Kiçkës (Kristaq Korçari).

Dita e pestë (10 janar). Me çantat thujse të mbyllura prisnim pranë oxhakat (kush e di sa dru u shndërruan në hi ato 40 orë që u nguam pranë tij). Disa e kishin të pamundur të mbathnin këpucët dhe i përdornin ato si papuçe, që të mbeteshin në këmbë i lidhnin

poshtë tabanit me copa litari personal, disa këtë e bënin vetëm me një këmbë. Vëmendja ishte përqëndruar te këmbët (ndoshta me të drejtë se ato na duheshin më shumë) dhe fare pak për ata që kishin probleme me duart. Murlani nisi avazin e tij. Gjithçka kishte marrë ngjyrën gri, mezi shihje pak metra larg.

Aty nga mesdita, pa pritur u fut në dhomën tonë duke gulçuar një malësor i ri, i cili tha :

- Kush ashtë Kozmai?

- Unë jam.

- Makina ka ardh tek kisha. Më tha shoferi (Shënimi im : Dauti), miku ynë, hajdeni sa më shpejt se do të mbetemi këtu.

Dolëm nga shtëpia. Gjeka, si gjithnjë i gatshëm për të na shërbyer sa më shumë e sa më mirë mori përsëri slitën. U ndodhën afër dhe dy malësorë që na ndihmuan sa mundën. U shtymë si mundëm në ato më pak se 200 metra. Por tek kthesa, bri fushës së futbollit, qëndruam pa na thënë njeri. Të gjithë e ndjemë veten ngushtë. Ishte pasoja e lojës së erës me ciflat e dëborës. Nuk mernim dot frymë. Mbuluam fytyrën me çfarë mundëm dhe rrotulloheshim nga të katër anët për të marrë pak frymë. Mbërritëm tek autobusi. Kur u futëm brenda na u duk vetja sikur ndodheshim në një lokal luksoz. Shpëtuam nga era e furishme, nga të ftohtit dhe dëbora.

Ne, shoferi, dy malësorë të mirëmbajtjes së rrugës. Përqaftime, pyetje (shumica për motin) të ndryshme. Prisnim të bënte një "pushim" të vogël, që punëtorët të hiqnin dëborën që kishte mbushur karaxhanë, proces ky i domosdoshëm që autobusi të vihej në lëvizje. Ishim të gëzuar nga mendimi se "nuk i kishim më borxh" natyrës. Do ktheheshim në shtëpi, na shqetësonte mendimi në rast se ata kishin marrë vesh ndonjë gjë për ne.

Pa kaluar as gjysmë ore, era bëri që dëbora të ngrihej deri tek xhami i shoferit. E shihnim me kërshtëri këtë dukuri ndoshta për faktin se ishim ngrohtë, ishim diku "brenda", e ndjenim veten të sigurt se nuk kishte se çfarë të na bënte.

E dija që njeri prej nesh kishte numrin e telefonit të një prej familjarëve të një anëtari të Byrosë Politike. U kërkova të gjithëve qetësi. Iu drejtova "doktorit":

- Po të drejtohem jo si alpinist, por si mjek. Përpiqu të zhvishesh nga ndjenjat e tua në dhënien përgjigje pyetjes sime :

-A është e nevojshme për shëndetin e këtyre djemve të

kërkojmë ndihmë urgjente në udhëheqjen e shtetit, apo me përmirësimin e motit na duhet vetëm të kalojmë 8-9 kilometra të vështira për të mbëritur në qytet. Mendohu dhe më thuaj.

Kaluan pak çaste.

- Po! Është e nevojshme që të gjithë të marrin ndihmën e specializuar në spital.

Kjo ishte e gjithë ndihma që i dha ekipit doktori i ardhshëm. Kaluan disa vite dhe bogianët që e njohën, më saktë që i shërbyen si "djalë të vetëm", më pyesnin për të. Nuk e di përse e ndjeja veten ngushtë. Në të njëjtën kohë nuk mund t'u shprehja mendimin tim : ishte njeri mosmirënjohës. Nuk e pamë më në radhët tona. Më mirë që ndodhi kështu...

Në atë mot të keq doli vullnetar Luigj Pjeshka, punëtor i mirëmbajtjes së rrugës, që me pusullën e letrës me numrin e telefonit, që i dhash, të shkonte në Dedaj (rreth 12 kilometra) për të telefonuar. Si u largua as tre metra nga makina nuk e pamë më, e përpiu reja. Ne vetëm e përfytyronim si luftonte me gjithë ato vështirësi, për më tepër: ai ishte i vetëm. Ai ishte vërtet hero!

Qëndronim në makinë thuajse pa shkëmbyer asnjë fjalë. Në një çast e mori fjalën buri më shtatlartë ndër ne - bogiani Kol Nika, brigadieri i punëtorëve të mirëmbajtjes:

- Burra, çohuni të ikim në shtëpi, se nuk kena çfarë presim!

E kishte shtëpinë në të hyrë të fshatit. "U zvaritëm" deri atje. Dy-tre metra para shtëpisë qëndroi dhe na tha që disa prej nesh të futeshin tek shtëpia përdhese bri kullës së tij. Bashkë me disa i dhash dorën burrit që kishte dalë tek porta e shtëpisë. U prezantuan. Ishte Rrok Rakaj (Lleshi). Thuajse kishte mbaruar vetëm katin e parë. Na futi tek dhoma me oxhak. Bashkë me Raken (gruan) na ndihmuan të sistemoheshim sa më mirë. Hynte e dilte duke na prurë dru dhe ujë. Një herë u fut pa gjë në duar. Qëndroi pak tek pragu dhe na tha:

- Burra, rri si në shtëpinë tuaj. Më vjen keq që nuk mund t'u presim më mirë. Bani si të bani. Për darkë po u përgatitim mish me grosh. Po u pjekim edhe bukë misri.

Pa e mbaruar mirë fjalën, të gjithë koras shprehëm kënaqësinë duke duartrokatur e falenderuar të zotin e shtëpisë. Ishin ndër duartrokitjet e rralla që kam bërë me gjithë shpirt gjatë jetës.

Dita e gjashtë (11 janar). Si kishin kaluar pak orë nga mesnata,

u zgjuam. Në gjysëm errësirën e dritës së një qiriri; megjithëse nuk u zinin besë syve, pamë tek porta Andon Tapinë dhe Myftar Markun. Ishin nisur urgjent nga Tirana në bazë të të njëjtit njoftim që ishte nisur autobusi për të na marrë në Bogë. Në Shkodër morën edhe Gjon Simonin. Si kaluan Koplkun dhe kishin ecur 2-3 orë rrugë me këmbë, takuan një oficer dhe 5 kruta (kështu i quanin ushtarët krejt të ri në ushtri) dhe pjesa më e madhe nga Tirana. Ata u gëzuan kur mësuan se edhe ne ishim nga Tirana. Filluan pyetjet e zakonshme: në cilën lagje banon, ku punon, e njeh filanin, tifoz me cilën skuadër je, etj.

Nga ata mësuan se në repartin e tyre ishte dhënë alarmi ushtarak në mesnatë. U kishin dhënë detyrën - marshoni drej fshatit Bogë, takoni dhe merrni alpinistët deri tek vendi që mund të mbërrijë Diagaçi (makinë e fuqishme ushtarake). Ata që ishin nga Tirana nuk kishin shkelur thujt asnjëherë në dëborë. Ishin vërtet djem të mirë. Si pa gjendjen, komandatit (me vështirësi) iu mbush mendja se ushtarët e tij nuk ishin në gjendje të mbanin alpinistët, pajisjet, çantat etj. Ramë dakord që, duke kërkuar dhe ndihmën e malësorëve, në mëngjez të niseshim.

Doli ditë e bukur. Përgatitëm çantat dhe dolëm në oborr. U futëm në shtëpinë e Kolës. Na u krijua bindja se për Aliun duhej të ndërtonim një barelë. E përgatitëm. Pavarësisht se ai kundërshtonte, e futëm në dyshekun alpin dhe e lidhëm me një litar kolektiv. Kanë kaluar 41 vjet dhe ende nuk e kuptoj si i lejova vetes të bëja atë budallallëk. Kur katër alpinistë ngritën barelën për të dalë jashtë shtëpisë, u thash prisni: mora një qiri të ndezur dhe e vendosa në gjoksin e tij. Ai më pa dhe vetëm buzëqeshi. Ishte djalë i mrekullueshëm, i zgjuar dhe fliste pak.

Kur po dilnim dëgjuam thirrje të gëzuara të shokëve që ishin në oborr. U habitëm se nuk po kuptonim shkakun e atij entuziazmi. Habija na u largua kur dëgjuam që thërrisnin:

- Helikopteri, helikopteri!

Bogianët e shihnin për herë të parë mbi fshatin e tyre. Filluam të nxirrnim tesha me ngjyra të ndezura dhe i tundnim për të na parë pilotët. Në atë ditë të bukur ata nuk u munduan të na fokusonin. U ulën afër shtëpisë. Erdhën mjaft fshatarë për ta përjetuar nga afër këtë ngjarje të panjohur më pare.

Si gjithë pilotët e helikopterëve (që unë kam njohur dhe kam pas të bëjë falë alpinizmit) kërkonin që hipja të bëhej sa më shpejt. Njërin

nuk donin ta lejonin të hipte se kalohej pesha që mund të transportonte, por ne shtymë nga poshtë Marion, deri sa edhe ai hipi...

Bashkë me Niko Stamon u nisëm...Të nesërmen pasdite e gjetëm Tiranën të akulltë nga të ftohtët e atij dimri të paparë.

Oneglia, Itali - janar-prill 2009

* * *

U nisëm për herë të dytë drejt Shnikut (2.554 m), një nga majat më të larta të Alpeveve dhe gjithë Atdheut tonë. Ngjitja në Shnik ishte një sukses i madh për sportin tonë, për arsye se kjo majë pushtohej për herë të parë gjatë stinës së dimrit.

Ishim 8: Niko Stamo, Vasil Stambuli, Minella Kapo, Myftar Marku, Azem Hyka dhe Viliam Kosturi. Pothuajse të gjithë rrugën nëpër leqet e Hotit e bënim për herë të parë. Koha u prish sapo mbërritëm në Tamarë. Gjatë gjithë natës dhe ditës ra shi dhe dëborë. Tamara rrallë i vesh rrobat e bardha dhe, kur vesh ato nuk i mban për shumë kohë, na thanë banorët. Por kësaj radhe nuk ndodhi kështu. Tamarën e lamë dhe e gjetëm të mbuluar me dëborë. "Rrobat e nusërisë" së Tamarës nuk na pëlqyen, duke menduar që rroba të tilla, shumë më të trasha, do të kishin fshatrat më lart dhe aq më tepër majat. Nuk u dekurajua. Qysh ditën e parë udhëtuam drej Vuklit.

Ftohtë, mjegull, dëbora vazhdon të bjerë. Në të hyrë të Vuklit na zuri tufani. Të nesërmen mbërritëm në lagjen e fundit të Nikshit – në Llac.

Ishte hera e dytë që bashkë me alpinistin Niko Stamo brenda një muaji na u desh të bënim me shumë malësorë të Dukagjinit dhe Kelmendit. Ka më se dymbëdhjetë vjet që vete në mal, por bujarinë dhe gadishmërinë e fshatarëve për të na ndihmuar asnjëherë nuk e kam parë të manifestuar si kësaj radhe. Kjo ndihmë e madhe shumëfishoi forcat tona morale. Ajo ishte dëshmi e mrekullueshme e solidaritetit të popullit tonë, që e ka burimin në mësimet jetëdhënëse të partisë, të cilat kanë revolucionarizuar gjithë jetën e Atdheut tonë socialist.

U vendosëm në shtëpinë e kooperativistit Zef Kol Isufaj, i cili veç nesh atë natë kishte miq dhe shumë të tjerë, që vinin të takonin miqtë e tyre të vjetër – alpinistët.

Malet përherë duken sikur mendohen dhe kujtojnë vitet e shumtë

që kanë jetuar. Në dimër dëbora e madhe ata i mbulon me “thinja” të bardha. Ashtu si njerëzve, edhe maleve nuk u pëlqen të plaken, nuk u pëlqen të zbardhen. Dhe kur dëbora i mbulon së tepërmi ata shkundin shpatullat dhe atëherë qindra e mijëra metra kub fije të bardha rrokullisen poshtë, duke marrë me vete çdo gjë që gjejnë përpara. Në ato çaste nga gryka në grykë, nga qafa në qafë, përhapet jehona e një zhurme të madhe. Kur e dëgjojnë këtë malësorët i thonë njëri-tjetrit:

- Ra ortek! Do Zoti të mos ketë qenë njeri pranë!

Në tentativën e parë, para disa javësh në Shtegun e Dhënëve, 6 prej nesh na zuri orteku. Edhe këtë herë, koha e keqe dhe, në veçanti, faqet e maleve të mbuluara me dëborë të shkrifët, na detyruan të prisnim një ditë.

* * *

Duke u gdhirë e diel (28 janar), në orën 12 të natës u zgjuam. Pas pak u nisëm për rrugë. Qielli ishte i pastër, ndërsa termometri do të shënonte shumë gradë nën zero. Si dolëm nga shtëpia, pas disa minutash, çaji nëpër paguret e vendosura në çantat e shpinës ngriu. Errësirën e çan feneri i kooperativistit të Nikshit – Gjokë Zefi.

Ecim...Dëbora është shumë e shkrifët. Për të dalë nga zona e fshatit bashkë me ne kanë ardhur dhe shtatë kelmendas. Dëborën e çajmë me radhë. Ata që janë në fund të kolonës nuk kanë nevojë të dallojnë gjurmat se dëbora e shkrifët, që arrin gjer në gjoks, është hapur si kanal.

Tek stanet e Nenzës filloi të agojë. Ndahemi me miqtë tanë malësorë dhe vazhdojmë rrugën. Për t’u fundosur sa më shumë në dëborë “na ndihmon” edhe çanta ku kemi futur të gjitha pajimet, mbasi i kemi marrë të gjitha masat për të kaluar natën jashtë, në lartësinë mbi 2.000 m.

Vazhdojmë të çajmë dëborën me radhë. Pas shumë përpjekjesh dhe mundi kaluam zonën e dëborës së shkrifët dhe mbërritëm mbi dëborën e ngrirë dhe akullin. Veshim kthetrat. Duke siguruar njëri-tjetrin, metër pas metri, i afrohemi majës, sipër së cilës duket se ndokush ka nderur zjarr dhe një shtëllungë e madhe tymi të bardhë ngjitet drejt qiellit. Në grupin tonë asnjë nuk u çudit për këtë.

“Tymi” në majë të malit na tregonte për erën e fortë që na priste

në kurrizin e malit dhe në majë. Më në fund, pas shumë peripecish dhe njëmbëdhjetë orë rrugë, mbi majën e Shnikut valëvitej flamuri me shkabën dykrenare.

* * *

Si komandat i grupit, e kam të vështirë të tregoj për të dalluarit gjatë dy ngjitjeve që u bënë në drejtim të majës së Shnikut, duke thënë fjalët më të mira për të gjithë pjesëmarrësit, duke filluar nga më i riu dhe duke përfunduar tek më i moshuari.

Duke mbyllur këto shënime, në emër të të gjithë alpinistëve, duke kërkuar ndjesë për shqetësimin që u krijuam, falenderojmë udhëheqjen e shtetit që aq shumë u kujdesën dhe bënë për ne, pa harruar malësorët e Bogës, Nikshit dhe gjithë ata që na u ndodhën afër.

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 6 shkurt

Përfundoi kursi dimëror alpinistik

Gjatë ditëve 1-14 shkurt u zhvillua në Razëm kursi kombëtar dimëror i alpinizmit, me pjesëmarrjen e alpinistëve nga të gjitha rrethet dhe klubet sportive të vendit.

Programi i kursit ishte mjaft i gjerë. Në të përfshiheshin elementë teknikë të alpinizmit dimëror, si mënyrat e ecjes në mal, përdorimi i kazmës alpine në ngjitje e zbritje dhe sigurimi me anë të saj, përdorimi i litarëve, gozhdëve, kthetrave e rrathëve, rrëshqitjet me ski, ngritja e çadrave dhe e guvave prej dëbore, etj.

Në programin e kursit përfshiheshin edhe tema teorike, si orientimi me busull e hartë, përgatitja moralolo-volitive e alpinistëve etj. Duke marrë parasysh se programi i këtij viti ishte më i vështirë se i viteve të kaluar, u vendos që ai të diskutohej nga të gjithë pjesëmarrësit, të cilët bënë vërejtje dhe e aprovuan atë plotësisht.

Në mbrëmjen e 14 shkurtit, pasi pjesëmarrësit iu shtruan edhe kontrollit të njohurive teorike e praktike, u bë mbyllja e kursit. Me këtë rast, sekretari i Shoqatës së Turizmit dhe Alpinizmit, Muharrem Sinoimeri, bëri konkluzionet e kursit. Të gjithë pjesëmarrësit e përfunduan me sukses kursin dhe u nderuan me diploma e çertifikata.

Korresp. i "Sportit Popullor", 20 shkurt

Ekspeditat kombëtare alpinistike, duke kaluar vështirësi të shumta, i përfunduan me sukses ngjitjet

Me rastin dhe për nder të 23-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë, Shoqata e Turizmit dhe e Alpinizmit organizoi tri ekspedita kombëtare alpinistike, të cilat pushtuan disa maja të larta me interes të madh alpinistik, sidomos për sezonin e tanishëm dimëror. Ngjitjet ishin parashikuar edhe në kalendarin sportiv kombëtar të këtij viti.

Ekspedita e parë u nis nga Valbona drejt majës së Grykave të Hapura. Është e para herë në historinë e alpinizmit tonë që kjo majë "pushtohet" në stinën e dimrit. Në grupin që kreu këtë ngjitje të vështirë bënë pjesë alpinistë me përvojë si dhe të tjerë të rinj, përfaqësues të klubeve "Partizani", "Dinamo", "Skënderbeu" dhe "Flamurtari". Grupi u drejtua nga alpinistët e njohur Vasil Stambuli, Minella Kapo, Agim Tabaku dhe Vili Kosturi.

Në planin e ekspeditës së dytë parashikohej ngjitja në majën "11 Shkurti" që bën pjesë në masivin e Tomorrit. Kjo është maja më e lartë e Tomorrit, në pjesën veriore të tij, dhe që paraqet një interes të madh alpinistik. Në këtë ekspeditë bënë pjesë alpinistë nga Berati, Elbasani dhe Gjirokastra. Ajo u drejtua me sukses nga Petraq Kule dhe Agim Kajanaku.

Ekspedita e tretë shkoi në majën më të lartë të Gjallicës së Kukësit. Në këtë grup bënë pjesë sportistë kuksianë, vlonjatë, korçarë dhe fierakë. Në këtë ngjitje të vështirë u dalluan sidomos Vangjo Boboshtica, Ali Pushaj dhe Shkumbin Ramadani.

Ngjitjet e sipërme të të tri ekspeditave, në itinerarë nga më të ndryshëm, me kategori vështirësie të lartë, vështirësi që u shtuan akoma më shumë për shkak të kushteve të këqia atmosferike, përbëjnë një sukses të ri të alpinizmit tonë. Të gjithë pjesëmarrësit treguan zotësi, guxim, shpirt të madh mobilizimi dhe një përgatitje shumë të mirë fiziko-teknike. Këto dëshmojnë se ne kemi sot një numër të mirë alpinistësh, me përvojë dhe të rinj, që janë të gatshëm të kryejnë ngjitje të vështirësive të ndryshme nga më ta lartat...

Turizmi dhe alpinizmi, si mjete të edukimit fizik të punonjësve, duhet të vlerësohen më shumë

...Gjithnjë e më shumë turizmi dhe alpinizmi po bëhen nevojë për jetën e shëndetin e punonjësve dhe në mënyrë të veçantë të rinisë.

Por me gjithë përmirësimet në drejtim të zgjerimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të lëvizjes turistike e alpinistike, në realizimin e objekteve të partisë, vihen re mjaft të meta e dobësi, që dëshmojnë për njëfarë javashllëku dhe kujdes të pakët për këto mjete dhe sporte të kalitjes dhe edukimit fizik të punonjësve.

Kohë më parë, krahas gjithë punës për kalitjen fizike, turizmi në përgjithësi dhe aktivitetet turistike malore morën një hov të paparë. Shpesh ato organizoheshin në kondita të vështira, edhe natën. Bile ato organizoheshin edhe kur kushtet atmosferike nuk ishin të zakonshme. Tashti nuk vihen re ekskursione dhe marshime të gjata në drejtim të rrugëve partizane, bigës lundruese "Adem Reka", të lapidarit të Shkurte Pal Vatës, etj. Në këto u aktivizuan edhe punonjës më të rritur, siç ndodhi me ekskursionet e bëra nga qyteti i Tiranës, duke përfshirë edhe dikasteret. Tani vihet re çvendosje e vëmendjes në aktivitete të lehta, ku ekskursionet në mjaft raste edhe nuk ia arrijnë qëllimit. Kështu shpjegohet organizimi i aktiviteteve turistike me makina nga një qytet në tjetrin, siç janë ato që bëhen në drejtim të Shkodrës, Beratit, Vlorës, Sarandës dhe anasjelltas në Tiranë. Këto në të vërtetë janë shëtitje shumë të mira, që i ndihmojnë qytetarët tanë për njohjen e qyteteve e të objekteve me karakter ekonomik e kultural. Megjithëkëtë, edhe në këtë drejtim puna lë mjaft për të dëshiruar, mbasi shpesh vizitat nëpër ndërmarrje dhe objekte historike thjeshtësohen dhe përfundojnë nëpër dyqanet e shtetit...

...Në alpinizëm, me gjithë sukseset e arritura vërehen të meta. Së pari, duhet thënë se kjo gjë është mbështetur në aktivitetin kombëtar dhe kalendarin sportiv. Por kjo dhe krijimi i disa grupeve alpinistike nuk është gjithçka. Që në fillim duhet të themi se alpinizmi akoma nuk ka dalë nga guaska e aktivizimit të një mase të kufizuar njerëzish. Në të predominon elementi i vjetër. Të rinjtë vërshojnë në një masë relativisht të kënaqëshme me të kaluarën, por problemi megjithatë nuk zgjidhet, lëvizja i nënshtrohet njëfarë zhvillimi spontan dhe njohjes personale. Për rrjedhim ai nuk ka qëndrueshmëri dhe stabilitet. Më

keq paraqitet gjëndja për pjesëmarrjen dhe kualifikimin e femrave, të cilat aktivizohen në një masë akoma të kufizuar. Çështja e stërvitjes dhe e orgnizimit të punës në grupet alpinistike, në interes të rritjes së cilësisë, është njëra anë e dobësisë sonë, kurse dobësia tjetër është se vihet re që në këto grupe nuk bëhet një punë e organizuar dhe me kujdes, në mënyrë që alpinistët në të njëjtën kohë të luajnë edhe rolin e organizatorëve në kolektivat e qëndrave të punës e të prodhimit në rrethe. Pra në to, në shumicën e rasteve, vërehet fenomeni negativ i sportit për sport dhe i përqëndrimit të vëmendjes thjesht në punën dhe aktivizimin në aktivitetet kombëtare. Kjo ka sjellë si pasojë që në to të influencojnë e të çfaqen tendenca negative si “nuk mund të stërvitem, sepse nuk kam 5 orësh”, “nuk kemi trajtim”, “nuk kemi pajisje” dhe pretendime të tjera me vend e pa vend, që e bëjnë sportin e alpinizmit për ta qëllim në vetvete. Kështu ndodh me alpinistët e Shkodrës, Korçës, klubeve sportive të qytetit të Tiranës, ku mungon edhe bashkëpunimi i shëndoshë midis njëri-tjetrit.

...Një e metë tjetër është mungesa e pasionit për këtë sport, gjë që vjen nga vështirësitë e ndryshme edhe nga mungesa e njohjes së specifikës së këtij sporti. Kjo është e lidhur gjithashtu edhe me faktin se përgatitja e kuadrit në Institutin e Kulturës Fizike “Vojo Kushi”, kuadër ky që plotëson nevojat e aparateve të fizkulturës në rrethe dhe për edukimin e kalitjen fizike të rinisë sonë shkollore, nuk u përgjigjet kërkesave me njohuritë më të domosdoshme për turizmin dhe alpinizmin. Dobësitë e këtij kuadri vihen re jo vetëm në mungesën e ndjekjes së problemeve më të rëndësishme që preokupojnë turizmin dhe alpinizmin në masë, por edhe në ndjekjen e realizimin e detyrave për rritjen e cilësisë.

....

Muharrem Sinoimeri, 4 qershor

Me gjithë kohën e keqe, ngjitjet u realizuan me sukses

Qafat dhe majat e maleve, luginat e thella dhe faqet shkëmbore, sivjet nuk na pritën mirë. Ne ishim 27 alpinistë dhe ndenjëm në zonën e Alpeve 15 ditë. Pothuajse çdo ditë ne kishim si bashkëudhëtar të mërziqshëm mjegullën e dendur, të ftohtit e paparë për muajin gusht, shiun që nuk kishte pushuar...

Në kohë të keqe, sipas rregullave të sportit tonë, ndalohet kacavjerrja në shkëmb. Në këtë mënyrë, na duhej të zgjidhnim një ndër alternativat : ose të sorrollateshim nëpër Thethin e bukur, ose të bënim atë që nuk e lejojnë “kanunet” e sportit tonë. Me gjakftohtësi, pa asnjë nuancë aventurizmi, vendosëm njëzëri të kryenim ngjitjet e kualifikuara shkëmbore alpinistike, të ngrejmë më lart aftësitë tona teknike.

Pas pak ditësh, si “ledhatuam” disa herë shkëmbinjtë rreth fshatit të Thethit, u ndamë në dy grupe : alpinistët e Korçës, të Elbasanit, të Peshkopisë, të Vlorës dhe “ambasadori” i klubit sportiv “Vllaznia” nën drejtimin e mjeshtrove të sportit Vangjel Ristani dhe Grigor Perikliu u nisën dhe ngritën çadrat në rrëzë të Çardakut, dhe për shtatë ditë me radhë kryen ngjitje shkëmbore në malet që rrethojnë Bogën.

Alpinistët e klubeve sportive të kryeqytetit morën rrugën që të shpie në Qafën e Pejës, duke lënë në Theth Shilin, i cili kishte për detyrë jo të rregullonte motorrin që prishi, por të priste miqtë anglezë.

Në këtë mënyrë, alpinistët më të mirë, për disa ditë me radhë demonstruan entuziazmin e tyre revolucionar, përgatitjen fizike dhe teknike, forcën e madhe morale. Ishin këto të dhënat që na bënë të ngjiteshim në majat shkëmbore, të lëviznim gurët dhe të gjënim kutitë, të hiqnim letrat e alpinistëve të ngjitur kohë më parë dhe në vendin e tyre të vinim emrat tanë.

Sivjet në ngjitjet shkëmbore morën pjesë jo vetëm alpinistët tashmë të njohur si mjeshtrot e sportit : Vasil Stambuli, Grigor Perikliu, Vangjel Ristani; alpinistët e kualifikuar : Aleksandër Bojaxhi, Azem Hyka, Koço Ziso, Maridon Hito, Agim Tabaku, por edhe alpinistë me moshë të re dhe me të dhëna të mira – si të tillë na lanë mbresë alpinistët e Beratit. Ndryshe nga viti i kaluar, sivjet ne kishim edhe...një vajzë. Mirën e fakultetit të mjekësisë. Shifrën “një” ne alpinistët e përmendim kur na pyet njeri, apo na kujtohet sa femra vijnë në ngjitjet shkëmbore, apo sa alpinistë vijnë në Alpe nga qyteti i Shkodrës. Kemi kaq vjet që themi e shkruajmë, por gjendja nuk ndryshon...

Shkëmbinjtë e lagur, mjegulla e dëndur, mendimi shqetësues nëse do na zërë shiu apo jo duke u kacavjerrur, bënë që faqet e mëdha shkëmbore të Alpeve, që ngrihen mbi humnera, të na dukeshin më të vështirë. Por asnjërin nga ne këpucët prej lastiku nuk e bënë të rrëshqiste shumë metra..., sivjet gozhdët kënduan (kështu e quajmë ne kur gozhdët e ngulura mirë në shkëmb lëshojnë një tingull të mprehtë metalik) dhe litarët kolektivë u tendosën si duhet.

Megjithëse ishte hera e parë që alpinistët e klubit sportiv "Partizani" morën pjesë në të tilla ngjitje ata u paraqitën mirë fizikisht dhe teknikisht, duke arritur të realizojnë dhe itinerarë shkëmborë të kategorisë së pestë të vështirësisë. Një itinerar të vështirë ndërmorën në majën e Arapit edhe Bajrami, Agimi e Maridon Hito. Duke përmendur këto dy ekipe, me ndonjë rezervë për ndonjë klub sportiv, mund të vazhdonim të flisnim me të njëjtën gjuhë edhe për alpinistët e tjerë.

Mbas shumë përpjekjesh, garën e heshtur me faqet shkëmbore ne e fituam, e mposhtëm madhështinë e tyre. Çdo ditë nga majat ne përshëndesnim njëri-tjetrin me parullën tonë, të cilën e kanë mësuar edhe malësorët.

* * *

Dielli po perëndonte...Në fshatin malor të Thethit u ndezën dritat. Alpinistët që kishin mbërritur në kohën e caktuar tek çadrat filluan të rregullonin sërish çantën alpine. Ora kishte kaluar, por alpinistët e USHT-es ende nuk ishin kthyer. Pa ndihmën e asnjë trompete apo fanfare në kamp u dha kushtrimi i heshtur që ngriti peshë gjithë alpinistët. Janë të vetmet momente që alpinistët nuk qeshin me njëri-tjetrin, nuk bëjnë shaka. Natyra e tyre e qeshur ndrydhet nga mendimi : Ç'u ka ndodhur shokëve? Kujt do t'i jepet e drejta t'u shkojë në ndihmë?

Në kohën që errësira nga lugina akoma s'ishte ngjitur plotësisht në majat e maleve u nis Muharremi me disa shokë. Ata që mbeten në shkëmb vuajnë më pak shpirtërisht se shokët e tyre që janë në kamp. Ne i njohim mirë rreziqet e maleve...Në orën 21 Aleksandri dhe Kristaq Korçari u nisën në drejtimin nga duhej të ktheheshin alpinistët e mbetur në mal, ndërsa Vasil Stambuli, Azemi dhe Agroni filluan të ngjiteshin në itinerarin e universitarëve.

Kur në Theth nisën të fiknin dritat dhe ne lidheshim me njëri-tjetrin nëpërmjet "Zig-zag-ut...", dëgjuam që parullën tonë na e kthyen dhe disa miq të vjetër – malësorët e Thethit. Ata ishin gati të na vinin në ndihmë. I falenderuam për gatishmërinë dhe u mbushëm mendjen të ktheheshin...Shokët i gjetëm të lidhur në shkëmb... Agimin, Mirën dhe Zenelin i përqaftuam. Të nesërmen, gjatë analizës së ngjitjes folëm "pak ndryshe"

...

* * *

Ngjitjet e kualifikuara përfunduan. U dalluan në mënyrë të veçantë nga alpinistët që ngritën çadrat në Qafën e Pejës : Azem Hyka, Aleksandër Bojaxhi, Vasil Stambuli (i cili bëri dy ngjitje me dy alpinistë anglezë), Maridon Hito dhe Agim Tabaku.

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 27 gusht



Zbor dhe takim kombëtar

Është viti dhe vera e 13-të që Thethi dhe qendra turistike e tij do të presë alpinistët e rinj, kuadro të ardhshëm për kolektivat dhe rrethet. Sivjet këtu zhvillohet kursi i 13-të veror me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të "Partizanit", "Dinamos", "Dajtit", "Studentit", "Apolonisë", "Flamurtarit", "Tomorrit", "Luftëtarit", "Skënderbeut", "Yllit të Kuq", "Labinotit", "Korabit", "Përparimit", "Valbonës" dhe "Vllaznisë". Rreth 70 pjesëmarrës do të marrin njohuri fillestare për udhëtime dhe ngjitje teknike malore; do të aftësohen si kuadro për drejtimin e grupeve alpinistike dhe turistike në kolektiva e rrethe.

Sipas programit, pjesëmarrësit në zborin alpinistik, që filloi pardje në Theth, do të mësojnë e punojnë për sigurimet në shkëmb, përdorimin e mjeteve teknike, si litarin kolektiv e personal, kazmën, gozhdët etj., mënyrat e kalimit të lumenjve malorë dhe honeve, organizimin e kampingut, transportimin dhe dhënien e ndihmës së shpejt shokut, mënyrat e ecjeve, orientimi në mal etj. Krahas njohurive dhe aftësimit si kuadro, alpinistët e ardhshëm do të njihen me terrenin malor dhe pamjen piktoreske të Thethit dhe të Alpeve.

Në ditët e fundit të zborit, për t'i dhënë impuls të ri lëvizjes turistike e alpinistike të vendit tonë dhe duke patur parasysh mësimet e orientimet e partisë, po në Theth do të organizohet takimi i parë kombëtar i turizmit e alpinizmit, ku do të diskutohen problemet që preokupojnë zhvillimin masiv të këtyre sporteve dhe do të përcaktohen detyrat për përhapjen e zhvillimin e mëtejshëm në të ardhmen. Takimi përbën një ngjarje të rëndësishme për lëvizjen tonë fiziklore-sportive.

Korresp. i "Sportit Popullor", 3 shtator

Alpinistët u ngjitën në 5 majat më të larta

82 alpinistë, të 17 rretheve dhe klubeve sportive, në kuadrin e aktiviteteve fiziklore-sportive për nder të 24-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, bënë një numër ngjitjesh.

Grupet alpinistike, të drejtuar nga mjeshtrat e sportit dhe sportistë të kategorisë së parë: Kozma Grillo, Aleksandër Bojaxhi,

Taxhedin Shehu, Koço Ziso, Petraq Kule, Agim Kajanaku, Vangjel Ristani etj., u ngjitën në pesë maja malesh më të larta të vendit, nga tre që parashikoheshin në kalendar.

Ngjitjet u kryen në Korab, në Majën e Hekurave, në Nemërçkë (nga ana e Përmetit), etj. Në këto ngjitje u aktivizuan edhe 12 vajza, shtatë nga të cilat punonjëse në Kombinatin e Tekstileve "Mao Ce Dun" - Berat.

Karakteristike në këto ngjitje ishte pjesëmarrja e gjërë e elementit të ri. Alpinistët shënuan një sukses në çeljen e sezonit dimëror, i cili sivjet parashikon një numër aksionesh të vështirësive të larta në ngjitje.

Korresp. i "Sportit Popullor", 3 dhjetor

1969

Kalendari Sportiv Kombëtar*Alpinizëm*

1. 9 janar: Ngjitje kombëtare dimërore, me rastin e 11 janarit.
2. 1-14 shkurt: Kurs kombëtar për përgatitjen e kuadrit alpinistik në Razëm.
3. 8-15 mars: Ngjitjet kombëtare dimërore të kualifikuara.
4. 16-30 qershor: Kurs kombëtar i përgatitjes së kuadrove të alpinizmit nga IKF "Vojo Kushi" në Theth.
5. 28-29 qershor: Ngjitje kombëtare shkëmbore.
6. 1-14 korrik: Kurs veror i përgatitjes së kuadrove të universitetit në Theth.
7. 16-30 korrik: Kursi kombëtar veror i përgatitjes së kuadrove të alpinizmit në Theth.
8. 1-14 gusht: Ngjitjet kombëtare të kualifikuara.
9. 7-14 nëntor: Ekspedita kombëtare alpinistike kushtuar 25-vjetorit të Çlirimit.

9 janar

Për herë të parë dimërit në Grykat e Hapura

Në kuadrin e aktiviteteve për nder të vitit jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe fitores së revolucionit popullor, çelëm sezonin e këtij viti me ngjitjet kombëtare, kushtuar 23-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Përpara nisjes alpinistët, përfaqësues të rretheve e klubeve sportive të vendit tonë, u rreshtuan tek Pallati i Sportit "Partizani" dhe i paraqitën forcën të deleguarit të KKF-së të RPSH-së Dervish Lisi. Njëri nga alpinistët mbante në duar një pllakë metalike, në të cilën ishte shkruar: "Ismet Sali Bruçaj – hero i punës socialise, janar 1969". Kjo pllakë do të vendosej në majën e Grykave të Hapura, për

të përjetësuar edhe në sport emërin dhe veprën e komisarit të kuq të dritës së partisë, që dha jetën në krye të detyrës për çështjen e partisë dhe të popullit.

* * *

U larguam nga Tirana me një kohë të bukur; dielli ndriçonte si në një ditë pranvere. Një kohë të tillë ne e pamë pas 11 ditëve, kur u kthyem në kryeqytet. Asnjerit prej nesh nuk i shkonte ndërmend se materialin teknik alpinistik do ta vinim në përdorim qysh gjatë rrugës alpinistike. Në minierën e Kamit disa shoferë i thanë Xhoxhit (shoferit energjik të makinës sonë) se rruga nuk mund të çahet. Por ai, duke e ndjerë veten pjesëtar të grupit alpinistik, iu përgjigj shkurt e me vendosmëri:

- Ne do të çajmë!

Ne vendosëm dhe u nisëm. Në qafën e Luzhës makina mbeti në dëborën e madhe, që kishte mbuluar rrugën. Ishte e para makinë që çante për në Bajram Curri në ato ditë dimri me dëborë.

Ishte ora 20. Frynte një erë e ftohtë dhe e fortë. Zbritëm të gjithë dhe me kazmat alpine largonim dëborën. Pastaj filluam të shtyjmë makinën, e cila, mbasi lëvizte pak, fundosej përsëri. Vumë në veprim litarët kolektivë dhe nisëm ta tërhiqim. Kjo punë vazhdoi gjithë natën. I ftohti të "priste". Vetëm lëvizjet tona gjatë punës na ngrohnin pak. U deshën 9 orë që të kalonim qafën, e cila në ditë të zakonshme nuk kërkon më shumë se 20 minuta.

Në Bajram Curri vazhdonte të binte dëborë. Në mbrëmje shtabi drejtues i ngjitjes vendosi që të nesërmen të fillonte marshimi për në Dragobi. Shumë fshatarë thanë se, në kushte të tilla, nuk mund të vihej në Dragobi. Megjithatë, të ndërgjegjshëm për kryerjen e detyrës, u nisëm. Mbas katër orësh rrugë me dëborë, ku trashësia arrinte gjer në brez, bëmë pushim tek një shpellë. Nën këmbët tona dëgjohej gurgullima e ujit të Valbonës. Komisari i grupit, mjeshtri i sportit Minella Kapo, po fliste për orteqet dhe në çast u dëgjua një zhurmë e madhe, oshëtima e së cilës tronditi malet për rreth. Lart u ngritën shtëllunga tymi prej dëbore. Një llavinë e madhe zbriste nga maja e malit, duke marrë me vete gjithë dëborën.

Në Dragobi, sipas këshillave të mjekut, lamë alpinistin Petrit Omeri, i cili, ndonëse ishte i sëmurë, tregoi vullnet e qëndrueshmëri gjatë gjithë rrugës.

Pas dy ditësh marshimi, duke kaluar nga Valbona arritëm në fshatin Rragam.

Më 12 janar bëmë njohjen e terrenit dhe hapjen e një pjese të rrugës deri në vendin e quajtur Buni i Ziçit. Për këtë na ndihmuan dy vëndas: Ndoci dhe Toma. Të nesërmen, në ora 3 të mëngjezit, filluam ngjitjen. Rrugën që kishim çarë një ditë më parë e kaluam pa vështirësi. Më vonë, kur nisëm të ecim mbi dëborën e pashkelur, ritmi u ngadalësua. Udhëhiqim me radhë në bazë grupi. Megjithëse koha dukej e bukur, kur arritëm në qafën e Grykave të Hapura, nisi një erë e furishme, që ngrinte lart grimca dëbore të akullta. Na u desh të ecnim mbi dëborë të ngrirë. U dha urdhër për mbathjen e kthetrave alpine dhe lidhjen e litarëve. U ndamë në tre grupe: Grupi i "Partizanit" me Vasil Stambulin në krye, ai i "Dinamos" me Minella Kapon në krye dhe grupi i tretë përbëhej nga alpinistë të "Studentit", "Skënderbeut" dhe "Flamurtarit". Mjegulla sa vinte e dëndësohej. Qëndronim afër njëri-tjetrit. Në orën 12 e 30 përpara nesh na doli një shkëmb i madh, që duhej kaluar pa tjetër. Udhëhiqte grupi i "Dinamos". I pari u ngjit në majë të shkëmbit Sulejman Dashi dhe pastaj, me radhë, të tjerët.

Ngjitja sa vinte e vështirësohej. Maja nuk dukej. Atë e pamë vetëm reth orës 15, kur mjegulla u largua pak. Filloi etapa përfundimtare e ngjitjes. Përsëri doli në krye grupi i përzier. Duhej kapërcyer një kurriz shumë të ngushtë, që nga të dy anët kishte pjerrësi shumë të madhe. Këtu gabimi më i vogël kushtone shtrenjt. Pasi u kalua edhe kjo pengesë e madhe, mbetën vetëm 5-6 metrat e fundit, të cilat përbënin pjesën më të vështirë të krejt ngjitjes, pothuajse si një mur i veshur me akull. Me ndihmën e kazmave alpine hapnim gropat për vendosjen e kthetrave. Sigurimi i shokut në të tilla kushte ka rëndësi të madhe. Për këtë qëllim Petrika Allabashi dhe Kostandin Kola ndiqnin me kujdes e vëmëndje çdo lëvizje të shokut të tyre. Të njëjtin veprim bënte edhe Vili Kosturi me shokët e "Dinamos", si dhe Vasil Stambuli me ata të "Partizanit". U deshën shumë kohë dhe emocione gjersa i pari të arrinte në majë. Pastaj, me radhë, u ngjitëm të gjithë. Në majë nisi një festë e thjeshtë, festë alpinistësh. U pushtuam nga ndjenja të papërshekruara gëzimi. Ngjitja shumë e vështirë në majën e Grykave të Hapura, për herë të parë gjatë periudhës së dimrit, u kurorëzua me sukses.

Në majat e mbuluara me dëborë

Kur dielli kishte perënduar, ne, 23 alpinistë, kaluam Shtegun e Dhënëve. Si zbritëm në Theth, u nisëm në dy drejtime të ndryshme.

Ngjitjet e prillit ishin një nga gjërat e reja që i dhamë sportit tonë në muajt e parë të jubileut të 25-vjetorit të Çlirimit dhe fitores së revolucionit tonë popullor.

Alpinistët e Beratit dhe të Vlorës, nën drejtimin e mjeshtrit të sportit Petraq Kule, përshkuan itinerarin: Bogë - Shtegu i Dhënëve - Theth - Qafa e Pejës - Jezercë - Pabllugë - Dobraq - Maja e Shnikut dhe zbritën në Tamarë.

Grupi ynë përbëhej nga alpinistët e "17 Nëntorit", "Dajtit", "Studentit", "Labinotit" dhe "Skënderbeut". Ne ndoqëm një itinerar të ri.

Ngjitjet e kualifikuara dimërore, të parashikuara në kalendarin sportiv kombëtar, ishin dëshmi e rritjes së aftësive tekniko-fizike të alpinistëve tanë, dëshmi e aftësisë për të ndërmarrë ngjitje të kategorive të larta të vështirësisë dhe itinerarë të gjatë, realizimi i të cilëve kërkon përgatitje të lartë fizike dhe forcë të madhe morali. Duhet theksuar se, në sajë të kujdesit të SHTASH-it dhe të klubeve sportive, pajisja me material teknik në këto ngjitje ishte më e mirë se në të kaluarën.

* * *

14 vetë, si lamë Thethin, u drejtua për në Qafën e Kakisë. Dëborë ka mbuluar gjithçka. Është vështirë të besosh se në zonat e ulta kanë çelur pemët. Panoramën e maleve, të mbuluar me dëborë, e pamë që nga larg; për borën e madhe të këtij viti na folën edhe miqtë tanë të vjetër - malësorët e Thethit. Në ditët e para të prillit malësorët thonë së "dëborë zien". Kjo shprehje do të thotë se dëborë sado shtresë të trashë që të ketë, nuk mban, fundosesh në të. Këtë e dinim dhe e provuam të gjithë, por "mbresë" më të madhe kjo i la Maridon Hitos, çanta e të cilit kishte rreth 50 kilogram. Ai s'kishte harruar të merrte me vete dhe një furnellë nga ato të Gjirokastrës. Dhe kur e pyet për çantën e tij aq të rëndë, ai fërkon një herë ballin dhe përgjigjet:

- Ç'të bësh, duhen të gjitha.

Në grupin tonë bënë pjesë mjeshtri i sportit Grigor Perikliu dhe alpinistët e rinj Fejzi Liço dhe Shefki Juma.

Ne udhëtuan me çantat e rënda në krahë për 11 ditë rresht në një itinerar të papërshtuar më parë nga alpinistët dhe, aq më tepër nga vëndasit, në një periudhë të tillë. Dukuritë atmosferike bënë gjatë këtyre ditëve plot "shaka", por ne i kaluam ato me sukses.

Gjatë itinerarit tonë, sivjet relievi dhe moti na detyruan të demonstrojmë të gjitha dijenitë dhe aftësitë tona alpinistike. Për orë të tëra gjatë ditës, duhej të ecje me rrathë, se për ndryshe fundoseshe në dëborë deri në mes, ndërsa natën dhe herët në mëngjez duheshin përdorur patjetër kthetrat për të ecur mbi dëborën shumë të ngrirë. Nuk mjaftonte vetëm dëborë; afër majave duhej kacavjerrur dhe në shkëmb...

U nisëm me një qëllim të caktuar. Duhej të pushtonim disa nga majat më të larta të Alpeve, duke realizuar ngjitje që kërkojnë nivel të lartë teknik. Një detyrë e tillë ka qëndruar para nesh dhe herët e tjera, por kësaj radhe mendojmë se bëmë një hap përpara për ta lidhur sa më mirë alpinizmin me jetën, për të lidhur sportin me situatën politike që po jeton Atdheu ynë.

Për vite të tëra ne i kishim vënë vetës si detyrë të rritnim mjeshhtërinë sportive. Ishte kjo arsyeja që ne sulmonim të njëjtën majë mali nga disa drejtime dhe, si rrjedhim, drejtoheshim në disa maja të caktuara. Pa nënvleftësuar për asnjë çast rritjen e aftësive teknike (pa këtë nuk mund të bëhesh kurrë alpinist i aftë) duhet në të njëjtën kohë që ne, alpinistët, të njohim të gjitha shtigjet dhe grykat e maleve, të jemi në gjëndje t'i kalojmë ato në çdo periudhë të vitit dhe në çdo kondita atmosferike, për t'u bërë zot të maleve tona, që, po të jetë nevoja, në vendin e kazmave alpine, të mbajmë në pushkë barutin e thatë. Për të realizuar këtë orientim, sulmuam dhe morëm majën e Gavnit dhe atë të Paqes (Maja e Hekurave). Ne u ngjitëm në këto maja duke kaluar nga Qafa e Kakisë, në Lum Pja, nga Qereçi dolëm në Qafën e Ndroçes, prej këtej zbritëm në Zall të Motinës - Dragobi - Bajram Curri.

Të ngjitesh në majë të malit nuk mjafton vetëm përgatitja e mirë fizike, por duhen edhe veti të larta morali, sedër e pastër sportive. Ishin pikërisht këto të dhëna që e bënë alpinistin Agim Kajanaku të mos qëndronte në çadër, por bashkë me shokët e tjerë të sulmonte në një itinerar të ri të vështirë majën e Paqes. Në këtë drejtim shembull

që premtion shumë dha edhe alpinisti Sulejman Poda, i cili, megjithëse i sëmure, nuk i lejoj vetes të bëhej barrë për shokët.

Për herë të parë alpinistët tanë sulmuam dhe morën majën e Gavnit, majën e parë ne e kemi marrë disa herë. Rradhën e fundit më 12 prill. Afër majës sulmuam në tre drejtime, secili grup punoi në mënyrë të pavarur. Dy litarë i udhëhoqën alpinistët e "Studentit" - Vullnet Zylyftari e Shpëtim Gokaj. Pas katër orë përpjekjesh ne u takuam në kurrizin e Majës së Paqes, ku për çudinë tonë nga alpinistët e "Skënderbeut" pamë vetëm Koço Zison (që me shakatë e tij të bën ta harrosh lodhjen), ndërsa Gaqua me Lamën ishin kthyer te çadrat...

Zbritjen nga maja të grupit të alpinistëve të qytetit të Tiranës e udhëhoqën Kristaq Korçari (Kiçka. Shënimi im: K.G.) dhe Mario Trinkera.

* * *

Duke mbyllur këto shënime dua të theksoj se në ngjitjet e kualifikuara dimërore nuk morën pjesë alpinistët e klubeve sportive: "Partizani", "Dinamo", "Vllaznia" dhe "Apolonia". Në të njëjtën kohë, për mungesë organizimi në rrethe, alpinistët e Gjirokastrës dhe të Peshkopisë erdhën pothuajse të papërgatitur.

Kozma Grillo, 22 prill

"T'u ngjitemi me guxim shkrepave e majave, të pushtojmë lartësitë e Atdheut tonë!"

Përmbajtja e kësaj thirrjeje që i bëhet lëvizjes sonë fizikulturore dhe marrja e masave më të mira organizative për të realizuar me sukses aktivitetin e madh të parashikuar në kuadrin e vitit jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit dhe të fitores së revolucionit popullor, e shtyu kryesinë e Shoqatës së Turizmit dhe të Alpinizmit për të mbledhur një aktiv të gjerë kombëtar.

Në punimet e këtij aktivi morën pjesë përfaqësues të shoqatave lokale, inspektorë të fizikulturës, trajnerë, alpinistë të dalluar dhe të ftuar të tjerë. Asistoi edhe shoku Rexhep Doda, kryetar i KP të BFSSH-së. Fjalën e hapjes e mbajti Muharrem Sinoimeri - sekretar i SHTASH-it. Referatin: "Turizmin dhe alpinizmin t'i bëjmë sporte të masave, të

rritim cilësinë e këtyre sporteve” e mbajti Kozma Grillo - kryetar i komisionit teknik të alpinizmit.

Në aktiv e morën fjalën shumë të pranishëm, që treguan për sukseset e arritura, të metat dhe dobësitë që ende vihen re, shkëmbyen përvojën dhe folën për masat që kanë marrë për realizimin e detyrave në përgjithësi dhe të këtij viti jubilar në veçanti. Në aktiv e mori fjalën edhe shoku Rexhep Doda.

Alpinistët e kanë filluar mbarë aktivitetin e vitit jubilar. Dëshmi për këtë janë: realizimi me sukses i ngjitjeve të kualifikuara dimërore, ku u ndërmorën dy itinerarë të rinj dhe të vështirë, mposhtja për herë të parë gjatë stinës së dimrit e majës së Grykave të Hapura, e cila mori emrin e mësuesit hero – Ismet Sali Bruçaj dhe të shumë ngjitjeve të tjera të organizuara muajt e fundit. Këto tregojnë për rritjen e mjeshtërisë sportive të alpinistëve tanë, janë tregues i mundësive të tyre për të realizuar me sukses ngjitje akoma më të vështira nga ana teknike.

Është meritë e alpinistëve, e përgatitjes së tyre të mirë politike, që asnjë herë nuk e kanë konsideruar të ndarë rritjen e mjeshtërisë së tyre sportive nga përhaja e këtij sporti të guximshëm në radhët e punonjësve dhe të brezit të ri. Alpinistët tanë më të mirë, siç doli edhe në punimet e këtij aktiv, janë në të njëjtën kohë propagandistë dhe aktivistë të dalluar shoqërorë, sportin, pas të cilit janë të pasionuar, përpiqen dhe punojnë me guxim për ta përhapur në qendrat e punës, në shkollat dhe në institucionet e ndryshme të rrethit të tyre.

Masiviteti dhe cilësia sportive janë aspekte të gërshetuara në mënyrë harmonike për lëvizjen tonë fizkulturale, por në sportin burrëror të alpinizmit kjo veçori bie më mirë në sy. Një shprehje e këtij gërshetimi harmonik ishin edhe dy iniciativat e mëdha që u morën në fillimin e këtij viti.

Punëtorët e Kombinatit të Tekstileve “Mao Ce Dun” të Beratit, anëtar i të cilit kolektiv është edhe mjeshtri i sportit Petraq Kule, morën iniciativën që gjatë vitit jubilar 3.500 punëtorë të ngjiten në 25 maja të Atdheut, 10 prej të cilave jashtë rrethit të Beratit. Dhe siç doli në aktiv, iniciatorët ja kanë filluar mirë punës. Para disa ditësh mbi 1.000 punëtorë, nën drejtimin e Petraqit, pushtuan një majë në rrethin e tyre. E ngjashme me iniciativën e tekstilistëve të Beratit është edhe iniciativa e punëtorëve të trikotazhit të Korçës, të azotikut në Fier, të pionierëve turistë të Gjirokastrës e kështu me radhë.

Për rritjen e mjeshtërisë sportive, një iniciativë të guximshme kanë marrë edhe alpinistët e Klubit Sportiv "Partizani" që, nën drejtimin e trajnerit të tyre, mjeshtër të sportit Vasil Stambuli, për nder të jubileut të madh 25 alpinistë (të klubit të tyre) do të pushtojnë në muajin nëntor 25 maja në Alpe. Për realizimin e kësaj iniciative kanë filluar prej kohësh përgatitjen: organizuan me forcat e tyre një zbor alpinistik, kanë intensifikuar stërvitjet javore, etj.

Por në aktiv u theksua se duhet punuar akoma më shumë për përhapjen e iniciativave, për popullarizimin e tyre, për shtrirjen e tyre në rrethe dhe në klube të tjerë sportivë, për marrjen e masave të nevojshme në mënyrë që entuziazmi i marrjes së iniciativës të shoqërohet me punë konkrete.

Në aktiv doli e qartë se krahas përmirësimit të punës, vlerësimit më të drejtë që duhet t'i bëjnë punonjësit e komiteteve të fizkulturës në rrethe këtyre sporteve, të rifreskimit të kryesive lokale të SHTASH-it, të aktivizimit më të mirë të kuadrit vullnetar dhe alpinistëve të dalluar, duhen marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të ngushtë me organizatat e masave si kusht i domosdoshëm për masivitetin në këto dy lloje sporti.

Në aktiv u theksua se për përhapjen e turizmit dhe të alpinizmit në masat e gjëra duhet hequr dorë nga puna me hope dhe me fushata. Rrethet e Shkodrës, Tiranës, Elbasanit, Peshkopisë dhe Kukësit duhet të punojnë shumë për të ecur krahas rretheve të përparuar.

Pjesëmarrësit e aktivit aprovuan edhe planin e aktiviteteve të SHTASH-it për vitin jubilar ku, midis të tjerash, parashikohen një sërë aktivitete për rritjen e aftësive të kuadrit vullnetar dhe përgatitjen e një sesioni shkencor për turizmin dhe alpinizmin.

Korresp. i "Sportit Popullor", 1 qershor

Me pushtuesit e majave

Në gjuhën sportive, pushtuesit e majave apo të lartësive i quajnë alpinistë. Të tillë ka kudo në vendin tonë. Nuk është e drejtë të mendosh se në këto lartësi shkojnë vetëm alpinistët. Edhe malësorët i njohin shumë mirë dhe u ngjiten majave të larta. Malësorë të tillë në vendin tonë ka qindra-mijëra, nëpër shtigjet e maleve, qafave dhe majave, vigjëlojnë sypatrembur kufitarët tanë heroikë. Megjithatë,

alunistët e vërtetë i dallon diçka nga kjo masë e madhe njerëzish të maleve. I dallon pasioni i veçantë për këtë sport dhe, mbi të gjitha, teknika alpinistike.

Të gjithë sportet janë të bukur e të vlefshëm. Por tek alpinizmi vihet re një karakteristikë, që shumë rrallë e gjen tek sportet e tjerë. Ekipte sportive apo individë përgatiten të fitojnë në luftë sportive me "kundërshtarë". Kurse në alpinizëm kjo s'ka shumë rëndësi. Tropojasi, gjirokastriti, tiranasi, vlonjati, beratasi etj, varg, njëri pas tjetrit, pushtojnë majën dhe frutin e fitores e ndajnë së bashku. Pastaj është edhe miqësia, miqësia alpiniste, që lind e forcohet në përpjekje me sa e sa vështirësi e rreziqe.

Mund të flasësh shumë për alpinizmin dhe alpinistët. Do të tregoj vetëm për një qendër të alpinizmit, që e njohin mirë njerëzit e këtij sporti, kufitarët e asaj zone dhe...sportdashësit.

Në theth

Maqina e vogël e alpinistëve i ngjitet malit përpjetë. Të shikosh nga kabina, sapo del në Qafën e Thores, të duket vetja sikur je në aeroplan. Lugina e thellë, më shumë se njëmijë metra, të del përpara e mbushur me gjelbërim dhe e rrethuar nga të katër anët me maja të larta. Kjo është lugina e Thethit të bukur e piktoresk. Me pyje është veshur pothuajse e gjithë sipërfaqja e saj. Dallohen shtëpitë e kooperativistëve, parcelat e tokës së punuar, njerëzit në ara. Nëpër monopate shtegtojnë tufa bagëtish.

Është një bukuri e rrallë, që njeriut i takon ta shikoj jo shpesh. Ajo të mahnit e të bën për vete.

... Shumë fëmijë vrapojnë pas maqinës. Ata i thërrasin shoferit:

- Anastas! Anastas!

Ky nuk heq dorë nga zakoni i tij. Në fillim i bën fëmijët të vrapojnë, pastaj i hip të gjithë në automjet e i çon tek ndërtesa e kampit.

Mbledhja e shtabit

Sa herë që makina ndalon në oborrin e kampit, mbledhen të gjithë rreth e rrotull të saj.

- Mirë se erdhët!

- A u lodhët?

- Ç'kemi andej nga Tirana?

Dhe shpejt e shpejt të ndihmojnë të rregullohesh. Pastaj njerëzit shpërndahen. Ca shëtisin, të tjerë këndojnë dhe luajnë shah.

Sa mirë! Sonte bëhet mbledhja e shtabit. Aty mund të dëgjosh plot gjëra interesante.

... 73 alpinistë, vajza e djem, nga të cilët 60 për herë të parë, marrin pjesë në zborin alpinistik. Mbledhja e shtabit analizon punën pesëmbëdhjetë ditore. Komandatët e togave flasin për sukseset dhe kritikojnë me kurajo të metat. Alpinistë të “vjetër” e të “rinj” tregojnë mbi përvojën, shtrojnë detyrat për të ardhmen. Të gjithë do të kthehen nesër në rrethet e tyre si instruktorë të alpinizmit e do të ndihmojnë në masivitetin e këtij sporti. Prandaj kërkojnë që çdo gjë të shkojë në rregull.

Alpinistët nisen

Ndaloj përpara një urdhër dite. Mban numrin 14. Në të thuhet, midis të tjerave, se më 30 korrik 1969, dita e fundit e zborit alpinistik të Thethit, do të zhvillohen ngjitje dhe në mbrëmje do të bëhet ndarja e diplomave e çertifikatave.

Zbori karakterizohet nga rregulli e disiplina, sepse me rregull e disiplinë punojnë edhe alpinistët, tamam si në një repart ushtarak.

...Kolonat nisen për demonstrim. Aty afër shushurin me të madhe lumi i Shalës, që buron nga malet e Thethit. Ai ka ujë të ftohtë. Fshatarët thonë se po ta futësh këmbën brënda, “ta pret”. Alpinistët zhyten në ujë deri në fyt, dhe s’pësojnë gjë veçse dalin të...lagur.

Është vështirë të ndjekësh çdo togë. Në drejtim të kataraktit u vu në lëvizje toga e parë e drejtuar nga alpinisti fierak Aleksandër Bojaxhi. Në të dy anët është përgatitur litari për kalimin teleferik, kurse një litar tjetër është lëshuar thikë në mes të shkëmbinjve deri poshtë në buzën e lumit.

Më tërhoqi vëmendjen alpinisti i parë, i cili u lëshua me shpejtësi e guxim nëpër teleferik. Ai e kreu kalimin me sukses. Po zgjidhte litarin personal kur iu afrova t’i flas. Sapo ktheu fytyrën nga unë dallova një...vajzë rreth 20 vjeçe. Ishte Besnike Haxhija, kandidate partie. Ajo posa ishte kthyer nga zonat e thella malore ku qëndroi një kohë të gjatë. Tashti kjo pjesëtare e brigadës të një ndërmarrje ndërtimi të Shkodrës, përgatitet si instruktore alpinizmi. Kjo s’ishte e vetmja femër në zbor. Shoqe të tjera nga Gramshi, Librazhdi, Tirana etj. do të bëhen si ajo instruktore.

Kalimi nëpër teleferik për ata ishte një gjë e zakonshme dhe u krye pa vështirësi. Po kishte edhe zbritje të vështira, thikë, midis shkëmbinjve të lumit të Shalës.

Katarakti

Nga një largësi prej 50 e ca metrash bie poshtë me zhurmë ujët e kristaltë të Thethit. Vendi laget nga ciklat e ujit. Bri këtij katarakti gjarpërojnë litarë të shumëngjyrshëm, ku punojnë tri skuadra alpinistësh.

...Zbritja fillon pas disa orësh: një zbritje shumë interesante dhe e shpejtë. Midis fytyrave të njohura, pashë edhe dy pionierë - Eqerem Shehun e Jorgaq Grabockën.

Miq dhe shokë të pandarë

Në Theth, si kudo tek ne, miqtë përcillen si miq. Sonte është nata e fundit. Pranë tryezave janë ulur kufitarë, kooperativistë, alpinistë. Po festojnë, si miq e shokë të pandarë, frutet e punës pesëmbëdhjetë ditore...

Pjesëmarrësit në zbor nderohen me tituj e diploma. Dy alpinistë - Agim Kajanaku e Aleksandër Bojaxhi shpallen mjeshtra sporti...

Skënder Dedja, 5 gusht

Alpinistët e "Partizanit" në 25 maja të Alpeve

Për nder të jubileut të lavdishëm të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit tonë popullor, edhe alpinistët e "Partizanit", të përfshirë në vrullin e madh revolucionar të të gjithë popullit tonë, u zotuan për t'u paraqitur në këtë jubile me një tok suksesesh e aktivitetestesh në sportin e tyre të bukur e të preferuar. Për këtë qëllim, ata u zotuan, veç të tjerave, që të krijojnë një grup të përbërë nga 25 vetë, kryesisht alpinistë të rinj, të cilët do të përgatiteshin në të gjitha drejtimt dhe gjatë gjithë vitit për të pushtuar në muajin nëntor 25 majat më të larta të Alpeve.

Aktiviteti i parë i alpinistëve të "Partizanit" ishte pjesëmarrja e tyre me sukses në ngjitjen e organizuar në janar të këtij viti në Grykat e Hapura, nën kujdestarinë e KS "Partizani". Ata morën pjesë në këtë aktivitet bashkë me alpinistë të tjerë të vendit tonë.

Më vonë vazhduan në aktivitete të tjera. Në mars u organizua një zbor dimëror për përgatitjen e kuadrit dhe të alpinistëve në malin e Dajtit. Po kështu, morën pjesë në zborin kombëtar të Thethit dhe në ngjitjet e kualifikuara verore.

Më 21 nëntor, 25 alpinistë, të rreshtuar para pallatit të sportit "Partizani", nën drejtimin e mjeshtrit të sportit, komandatit të grupit, Vasil Stambuli, u nisën në drejtim të Alpeve.

Ngjitjet u kryen në tre etapa. Në etapën e parë u bënë ngjitje në zonën e Bogës dhe në atë të Fushës së Dënellit në Theth, ku u pushtuan 11 maja me lartësi mbi 2.400 m.

Në etapën e dytë ngjitjet u vështirësuan. Duke luftuar me vështirësitë e motit, dëborën e madhe, acarin, erën, tufanin, akullin, alpinistët treguan vendosmëri të madhe dhe pikërisht në ditën e jubileut të lavdishëm pushtuan edhe tetë maja të tjera, duke përfshirë majën e Radohimës, majën e Thatë, Kurorën e Visensit, etj.

Etapa e tretë dhe e fundit u krye në zonën e Gropave të Bukura, ku ngrihen male akoma më të lartë e më në thellësi të Alpeve, si maja e Rinisë (2.693 m), Maja 8 Marsi, e Alisë, e Kolajve, e Arapit. Dëbora kishte arritur mbi 1 metër; ecja ishte mjaft e vështirë dhe prandaj në çdo 10 metra shoku, që printe në krye, duhej zëvendësuar.

Pavarësisht nga këto e shumë vështirësi të mëdha, alpinistët nuk u mposhtën në asnjë çast...Ngjitjet u kurorëzuan me sukses të plotë. Të gjithë pjesëmarrësit janë krenarë sepse bënë realitet zotimin e tyre dhe i dhuruan lëvizjes fizikulturore-sportive një sukses modest në ditën e jubileut të madh.

Kur alpinistët u kthyen në Theth, tek Qafa e Thores dhe Shtegu i Dhënëve dëbora kishte arritur kuotën mbi dy metra. Lindi pa dashur një "etapë e katërt", që vështirësonte kalimin e grupit nga Thethi në Bogë. Duke sulmuar Shtegun e Dhënëve për dy ditë me radhë, alpinistët e kaluan me sukses edhe këtë vështirësi.

Kurorëzimi me sukses i ngjitjeve i frymëzon më tej alpinistët e KS "Partizani" për të ndërmarrë në të ardhmen iniciativa edhe më të guximshme, për të kryer ngjitje akoma më të vështira.

**Vasil Stambuli, komandat i ekspeditës,
Alush Abdihoxha, shef i ekspeditës, 16 dhjetor**

1970

Kalendari Sportiv Kombëtar

1. 3-15 janar: Zbori dimëror i USHT-së.
Vendi i zhvillimit: Voskopojë.
2. 16-30 janar: Zbori kombëtar dimëror i alpinizmit nën patronazhin e Këshillit Qëndror të BPSH-së.
Vendi i zhvillimit: Voskopojë.
3. 7-15 mars: Ngjitje kombëtare dimërore të kualifikuara ushtuar 25- vjetorit të forcave të kufirit.
Vendi i zhvillimit: Alpet jug-lindore:
Bajram Curri - Valbonë - Grykat e Hapura-Briaset- Krasniq - Borsh - Theth - Bogë.
3-8 shkurt: Vendi i zhvillimit: Tiranë-Dajt-Bizë-Martanesh-Batër-Burrel. Për nder të 25-vjetorit të BPSH-së.
3-8 shkurt: Vendi i zhvillimit: Berat-Dardhë-Maja 11 shkurti-Çuka Partizani - Bargullas-Berat.
4. Ngjitje kombëtare 5-ditore në zona të reja jashtë rrethit.
5. 15-30 korrik: Zbori veror i USHT-së. Vendi i zhvillimit: Theth.
6. 16-30 korrik. Zbori kombëtar alpinistik veror. Vendi i zhvillimit: Theth.
7. 1-14 gusht: Ngjitje kombëtare të kualifikuara verore.
Vendi i zhvillimit: Alpe. (Theth).
8. 26 nëntor: Ngjitje kombëtare dimërore.
Vendi i zhvillimit: Shnik nga Nikshi, Jezercë nga Valbona, Ostrovicë nga Gramshi, Tomorr nga fshati Tomorr.
9. 1-15 shkurt: Zbori dimëror me alpinistë të Ushtrisë Popullore.
Vendi i zhvillimit: Theth.

“Sporti Popullor”, 6 janar

Frymë revolucionare tek alpinistët

Sikundër u njoftua edhe në numrin e kaluar të gazetës sonë, në Voskopojë përfundoi zbori dimëror kombëtar i alpinizmit, nën

kujdestarinë e Këshillit Qëndror të BPSH-së, që zgjati dy javë dhe ku morën pjesë përfaqësues të 17 klubeve sportive të vendit. Qëllimi i zborit ishte ngritja e mëtejshme tekniko-profesionale dhe ideopolitike e alpinistëve, aftësimi më i madh i tyre për të qënë edhe organizatorë të zotë e drejtues të aftë të lëvizjes turistike e alpinistike në qendra pune e prodhimi, kooperativa bujqësore, shkolla etj., për kalitjen fizike të masave punonjëse e në radhë të parë të brezit të ri.

Mbi këtë bazë u ndërtuan edhe programet stërvitore, në të cilat një vend kryesor zunë elementët e kacavarrjes në shkëmb, rrëshqitja me ski, kryerja e marshimeve me fjetje jashtë në çadra dhe ngjitja e majave më të larta të zonës.

Mobilizimi i gjithanshëm, morali i lartë dhe disiplina e ndërgjegjshme bënë që programi të realizohej me sukses. Fryma e shëndoshë revolucionare u vu re që në ngjitjen e parë ku me gjithë dëborën e ngrirë, tufanin e egër dhe mjegullën e dëndur, pas pesë orë përpjekjesh, grupi i alpinistëve prej 10 vetësh arriti të pushtojë majën e Ostrovicës: 2.346 m. mbi nivelin e detit.

Po ky grup, disa ditë më vonë, duke përdorur kthetrat dhe litarët u ngjit në majën më të lartë të vargmalit të kësaj krahine, në atë të Faqekuqit (2.352 m.), që ishte pjesërisht e veshur me akull. Këtë radhë koha ishte me alpinistët. Rrezet e forta të diellit dhe bardhësia e dëborës të bënin për vete. Përpara alpinistëve shtrihej një panoramë e bukur, që rrallë herë të takon të soditësh. Po në këtë majë, në një kohë shumë të bukur, u ngjit edhe një grup tjetër i përbërë nga 11 alpinistë. Ky grup kontrolloi një zonë shumë të gjerë, nëpërmjet një itinerari interesant që kalonte nëpër fshatrat Gjergjevicë, Marian, Çemerice, Vithkuq e Voskopoje - rreth 60 kilometra të gjatë. Ndërkohë, 56 alpinistë të tjerë, ku bënë pjesë edhe 15 vajza, pasi fjetën një natë jashtë në çadra, pushtuan majën e Lisecit (1.714 m).

Edhe ditët e tjera ishin të mbushura plot aktivitete. Të gjithë pjesëmarrësit zhvilluan ngjitje shkëmbore duke përdorur gjerësisht mjetet e alpinizmit. Ata mësuan gjithashtu edhe elementët e parë të rrëshqitjes me ski.

* * *

Krahas punës së mirë që u zhvllua në këtë zbor, duhen vënë në dukje edhe disa të meta, të cilat burojnë kryesisht nga mosvlerësimi i

drejtë që i bëhet sportit burrëror të alpinizmit nga komitetet e fizkulturës të rretheve të ndryshme. Mund të përmendim, për shembull, komitetin e fizkulturës të Kukësit, i cili jo vetëm që dërgoi vetëm një person, por edhe atë jo në gjendje të mirë shëndetësore dhe, çka është më kryesorja, pa inventarin e duhur. Edhe rrethi i Tropojës nuk e vlerësoi drejt zborin pasi dërgoi një ekip sa për të kaluar radhën, dhe jo me perspektivë për të krijuar një bërthamë të shëndoshë alpinistësh.

Duhet theksuar se mosha mesatare e alpinistive ishte rreth 24,3 vjet. Mendoj që në të ardhmen kjo mesatare të përmirësohet duke zbritur në 20 - 22 vjeç.

Mihal Bozdo, 10 shkurt

Dajti na fton...

Po mbushet një muaj që kur është çelur stina turistike dimërore dhe që atëherë mijëra qytetarë e fshatarë të gjitha moshave, sidomos të rinj e të reja, janë ngjitur në majën e këtij mali dhe kanë kaluar një-dy ditë pushimi aktiv në qendrën sportive turistike të fushës së këtij mali.

Për të informuar lexuesit e shumtë të gazetës sonë se si është organizuar jeta dhe aktiviteti në këtë qendër turistike, korrespondenti ynë i drejtoi disa pyetje shokut Dhori Anxhari, inspektor në komitetin e fizkulturës të Tiranës.

Pyetje: Si u zhvillua sezoni turistik i vitit të kaluar?

Përgjigje: Sezoni i turizmit vitin e kaluar u karakterizua nga numri i madh i ekskursionistëve, që arriti shifrën rreth 15.000 vetë. Vlen të përmendet se vitin e kaluar, djemtë dhe vajzat e Institutit të Kulturës Fizike "Vojo Kushi" ndërtuan qendrën sportive, e cila ka fushën e futbollit, dy fusha basketbolli, tre voleybolli, një tenisi, kënd gjimnastikor, brez kalitje, etj.

Gjatë gjithë sezonit turistik, në qendrën e kalitjes së shëndetit, siç e kanë quajtur me të drejtë Dajtin, kaluan ditët e pushimit mbi 13.000 kryeqytetas, sidomos të rinj e të reja. Ata u ngjitën atje me këmbë, bënë lojëra e ngjitje malore, rrëshqitën me ski, etj.

Pyetje: Cilat janë mësimet që nxuarrët nga veprimtaria e sezonit të vjetëm?

Përgjigje: Dëshira e masave punonjëse, rinisë shkollore e universitare, për të bërë ekskursione dhe ngjitje malore, është e madhe, sidomos dimrit, se në verë i tërheq më shumë lumi, liqeni, deti. Qendra turistike është shfrytëzuar vetëm të shtunave e të dielave, edhe këto në mënyrë të pjesëshme. Ditët e tjera të javës frekuentimi ka qenë shumë i pakët. Mungesa e organizimit të mirë i ka lënë shteg ekskursioneve të paplanifikuara. Edhe furnizimi nuk ka qenë gjithnjë i rregullt. Pak u përdorën aktivistët specialistë të sportit.

Pyetje: Si parashikoni ta organizoni punën këtë vit?

Përgjigje: Për zhdukjen e të metave dhe dobësive, për t'i shërbyer më mirë kalitjes fizike e përgatitjes ushtarake, shëndetit dhe zbavitjes së mijëra qytetarëve e kooperativistëve, puna sivjet bëhet në mënyrë të planifikuar dhe të organizuar, duke i mbushur të shtatë ditët e javës.

Edhe sezoni i sivjetshëm i turizmit malor u çel me një ekskursion malor masiv, në të cilin morën pjesë rreth 20.000 vetë. Pas tij, në çdo ditë të javës (dhe jo vetëm të shtunave e të dielave) qendra turistike u gjallërua dhe u mbush me të rinj e të reja.

Plani, që kemi hartuar, parashikon një ekskursion dyditor për çdo shkollë 8-vjeçare dhe dy ekskursione dyditore për çdo shkollë të mesme. E shtuna dhe e diela janë lënë të planifikohen në bazë të kërkesave të punonjësve e të studentëve. Ky plan është duke u realizuar me sukses.

Dhe të gjithë ata, të cilët i janë përgjigjur “ftesës” së Dajtit dhe që numërohen deri 400 vetë çdo ditë e çdo natë, janë të kënaqur edhe nga furnizimi i rregullt, dhe nga shërbimi i kulturuar në mence, bufe e hotel.

1971

Kalendari Sportiv Kombëtar

1. 7-17 mars: Ngjitje kombëtare të kualifikuara dimërore, kushtuar forcave të kufirit. Pjesëmarrësit ndahen në dy grupe.
2. Korrik-gusht. Ngjitje alpinistike në Alpet.
 - 1 -14 korrik: grupi A.
 - 16-30 korrik: grupi B.
 - 1 -14 gusht: grupi C.
 - 16-30 gusht: grupi D.
3. 8-15 nëntor: Ekspeditë e madhe alpinistike kushtuar "30-vjetorit të themelimit të PPSH", sipas itinerarit të caktuar: grupi A nisët nga Berati; grupi B nga Përmeti; grupi C nga Korça, grupi D nga Peshkopia dhe grupi E nga Bajram Curri.

9 shkurt

Alpinistët i përfunduan me sukses ngjitjet

Më 8 nëndor, në orët e para të mëngjezit, 5 grupe alpinistësh, të shpërndarë në të katër anët e vendit, filluan ngjitjet kushtuar 30-vjetorit të PPSH. Ekspedita alpinistike ishte më e madhja e organizuar deri më sot në vendin tomë. Në të morën pjesë mbi 50 alpinistë.

Grupet u ndanë në këtë mënyrë: grupi i parë bëri ngjitje në vargmalet Tomorr-Zaloshnjë-Ostrovicë; i dyti në zonën e Tropojës; i treti në atë të Thethit; i katërti në malet e Peshkopisë dhe i pesti në vargmalin Nemërçkë-Dhëmbel.

Karakteristikë e këtyre ngjitjeve ishte se të gjithë alpinistët, me përjashtim të pesë drejtuesve të grupeve, ishin të rinj, të cilët treguan aftësi të mira dhe i përballuan me sukses vështirësitë e shumta. Koha nuk punoi mirë për sportistët e maleve. Ndërsa grupi që veprroi në Nemërçkë i bëri ngjitjet me kohë të mirë, ndërsa kthimin në orët e

vona të natës e bënte në itinerarë të panjohur dhe me mjegull. Grupi i Peshkopisë përdori gozhdë në ngjitjet e veta, kurse ai i Thethit çante dëborën e ngjeshur të alpeve.

Agim Tabaku

Alpinistët e qytetit të Peshkopisë, në kuadrin e 30-vjetorit të themelimit të PPSH dhanë fjalën që t'u ngjiteshin 30 majave më të larta të Dibrës dhe rretheve të tjera të vendit.

Starti nisi me "pushtimin" e Gurit të Kuq, që ndodhet mbi fshatin Zimur. Me gjithë të ftohtit dhe dëborën të rinjtë e kryen me sukses ngjitjen. Pas kësaj, u vinte radha 29 majave të tjera. Edhe ato u "pushtuan" një nga një. Ku ndodheshin ato? Në Dibër, Kukës, Burrel, Shkodër dhe në Librazhd. Gjatë ngjitjeve na dolën përpara shumë të papritura, të cilat i kaluam me guxim, trimëri e vendosmëri...

Taxhedin Shehu

U PËRGJIGJEMI LEXUESVE

Lartësi dhe horizonte

Një lexues nga Korça, i dhënë pas alpinizmit, i drejtohet me letër redaksisë dhe kërkon të dijë më shumë për sportin e tij të preferuar dhe sidomos mbi historikun e ngjitjeve alpinistike në botë.

Shkrimi që po botojmë është, si të themi, një faqe nga historia e sportit burrëror, një përmbledhje e aksioneve më të rëndësishme të alpinizmit.

* * *

“Përse njerëzit ngjiten në majat e maleve?”

Një alpinist i famshëm, të cilit iu drejtua kjo pyetje, u përgjigj me thjeshtësi të madhe: “Sepse malet ekzistojnë!”. Po, malet janë aq të lashtë sa vetë toka. Megjithatë, nuk ka asgjë më të natyrshme për njeriun se sa ngjitja e maleve. Mund të themi se kjo nuk është një dëshirë, por një nevojë që gjithkush e ka në gjakun e vet, që në lindjen e tij. Të gjithë fëmijët kacavjerren. Çdo njeri i ditëve tona, inxhinier apo poet, punëtor apo nëpunës, ka shijuar gëzimin e ngjitjeve, që kur ai ishte në moshën midis dy dhe dhjetë vjetëve: në dritare, në pemë, në mur...Dëshirë për t’u kacavjerrur dhe për t’u ngjitur, por edhe dëshirë për të hedhur vështrimin më larg, për të parë më lart, për të zbuluar të panjohurën...Këto dëshira të njeriut mund t’i shprehim me dy fjalë të vetme: lartësi dhe horizonte. Por, a nuk shprehin këto dy fjalë atë që njerëzit e kanë quajtur “alpinizëm”? Dritarja, pema, muri janë bërë kodrina, pastaj Alpet, Himalaja..., por dëshira nuk ka ndryshuar.

Ngadhnjimi i maleve të lartë ka filluar vetëm dy shekuj më parë. Në këtë rrugë të vështirë dhe të rrezikshme ka patur vetëm disa përjashtime si Pjetri III i Aragonës, që u ngjit na malin Kanigu më 1280, poeti Italian Petrarka në malin Vantu në vitin 1136, dijetari i madh Leonardo Da Vinçi në malin Bozo më 1511 dhe, pas kësaj ngjitjeje, në pikturat e tij të famshme ai e përdori malin sis fond.

Vetëm në shekullin XVIII filloi sulmi drejt majave të Alpeve. Në vitin 1741, Uiljam Vinhemi, që banonte në Gjenevë të Zvicrës, organizoi me disa bashkatdhetarë të tij një “udhëtim” në akullnajat e Savojës, në luginën e Shamonisë. Vetëm 20 vjet më vonë u mendua që të arrihej “pullazi i Europës”, Mon Blan (Mali i Bardhë). Të parët që u ngjitën mbi këtë maj ishin doktor Pakard dhe udhëtreguesi Zhak Balma. Që nga ajo kohë ngjitja në këtë mal u bë e modës. Kështu, nga një vit në tjetrin, u shkelën të gjitha majat e Alpeve, u krijua shoqëria e udhëtreguesve (më 1821) dhe klubi i parë alpin. Maja e fundit që u pushtua ishte Çervino, që “rezistoi” deri më 1865.

Ja dhe “pullazi” i planetit tonë. Në fund të shekullit të kaluar alpinistët iu drejtuan vargmaleve të tjerë të mëdhenj të rruzullit tokësor, sidomos Himalajave: 2.500 kilometra gjatësi, 200 kilometra gjerësi, 14 maja më të larta se 8.000 metra, 300-400 maja mbi 7.000 metra dhe mijëra të tjera me lartësi midis 5.000 - 6.000 metra.

Deri në vitin 1896 ishin arritur 40 maja më të larta se 6.000 metra. Nuk do të zgjatemi që të përshkruajmë hollësisht të gjitha ekspeditat drejt Himalajës. Një e tillë arriti për herë të parë majën Anapurna (8.087 m.) në vitin 1950; në vitin 1952 një tjetër ekspeditë u ngjit në shpatin e Nepalit dhe arriti lartësinë 8.600 metra dhe një vit më vonë, më 29 maj, u arrit maja më e lartë e globit, Everesti ose Xhomolungma. Ekspedita shumë interesante kanë organizuar në vitet e fundit edhe alpinistët kinezë, të cilët iu ngjitën Xhomolungmas dhe majave të tjera të Himalajave.

Edhe në vendin tonë pas çlirimit alpinizmi është zhvilluar dhe po ecën në rrugën e masivitetit. Qindra janë të rinjtë dhe të rejat që ushtrojnë me kënaqësi këtë sport burrëror. Ata kanë shkëlur në periudha të ndryshme të vitit majat më të larta të Atdheut tonë.

1972

Kalendari Sportiv Kombëtar

1. Shkurt. Ngjitje kombëtare dimërore me alpinistët e kategorisë së dytë e lart, kushtuar forcave të kufirit.

Itinerari: Grupi A: 3-13 shkurt: Bogë-Theth-Briaset-Krasniq-kalim nga Gavni-Grykat e Hapura-Valbonë-Bajram Curri.

Grupi B: 5-15 shkurt: Bajram Curri-Grykat e Hapura-Gavën-Briaset-Krasniq-Borsh-Theth-Bogë.

Grupi C: 18-28 shkurt: Bogë-Borsh-Briaset-Krasniq-Gavën-Grykat e Hapura-Valbonë-Bajram Curri.

2. Korrik: Ngjitje alpinistike verore në Alpe.

Vendi i zhvillimit: Në Theth Grupi A, 5 deri më 17.

Grupi B: 22-korrik deri më 3 gusht.

3. 5-17 gusht: Ngjitje alpinistike verore në Valbonë.

4 janar

Ngjitje kombëtare alpinistike

Në bazë të Kalendarit Sportiv Kombëtar, më 5 korrik u çel në Alpe stina e ngjitjeve verore shkëmbore, që do të vazhdojë deri më 3 gusht.

Shumica e alpinistëve, që përbëjnë grupin e parë, janë të rinj, të cilët e duan sportin burror të alpinizmit dhe kanë perspektivë për t'u bërë alpinistë të mirë. Në ngjitjet që filluan më 5 korrik morën pjesë 35 alpinistë, përfaqësues të rretheve të Peshkopisë, Beratit, Tiranës, Vlorës dhe Elbasanit.

Grupi është ndarë në tre toga. Secila togë drejtohet nga instruktorë me përvojë, siç janë alpinistët e njohur T. Shehu, P. Kule, A. Bojaxhi, M. Hito, V. Ristani, P. Lika, etj.

Në bazë të programit, togat do të punojnë në zona të ndryshme, si në zonën e Thethit, Shtegun e Dhënëve, Radohimë, Majën e Dritës, Rrethin e Vishnjës, Jezercë, Borsh, etj.

Me të mbaruar ky grup, ngjitjet do t'i vazhdojnë dy grupe të tjerë, edhe ata të formuar në pjesën më të madhe nga të rinj.

Synohet që të zhvillohen 8-10 ngjitje dhe të realizohen shumë itinerarë shkëmborë.

Andon Tapia

Verë jo e zakonshme për alpinistët

-Mbresa nga Thethi-

Si lë mbrapa Bogën, rruga gjarpëron midis pemëve dhe kur altometri shënon 1.800 m. gjënde në Qafën e Thores, ku udhëtari krijon përshtypjen fiktive se ndodhet në ndonjë aeroplan, që është drejtuar drejt Dukagjinit dhe Shoshës. Qëndrojmë. I tregoj bashkudhëtarit majat e maleve...Vinë dy barinj, të cilët na thanë se alpinistët, që i udhëheq mjeshtri i sportit Astrit Omeri kishin bërë një sërë ngjitjesh në shkëmbinj të dhe faqet shkëmbore të Shtegut të Dhënëve, se "ishin boll të zotë, por se kishin vuajtur shumë jo vetëm nga koha e keqe, por edhe...".

Nisemi...Nga larg duket "Qendra Turistike" - godina më e madhe e këtij fshati, që për vite me radhë ishte e alpinistëve. Sapo u futëm në territorin e "Qendrës turistike", m'u afrua një burrë:

- Alpinistë jeni ju?

- Po.

- Na falni atëhere, është e ndaluar të futeni këtu!

Kërkesa jonë nuk u muar parasysh edhe kur i thamë se ne nuk nuk do të hyjmë në godinë, por do të bëjmë një fotografi dhe do të sodisim malet. Vendosa të luaj "kartën" e fundit:

- Nga këto anë je, mor shok?

- Po.

- A ka ba vaki në Dukagjin të vijë miku dhe të mos e lejojnë të futet tek oborri i shtëpisë?..

Më pa drejt në sy, mbeti pak kohë pa folur dhe m'u përgjigj:

- Kjo nuk është shtëpia ime, mor shok. Më ka thanë drejtori Idriz Xhura që miqtë të futen në territorin e "Qendrës Turistike", por alpinistët në asnjë mënyrë!

Kur mori vesh se nuk kisha vajtur për ngjitje alpinistike, por me shërbim si gazetar, i qeshi fytyra dhe më tha:

- Mirë se vini!

Pas kësaj bisede të "ngrohtë", nuk hymë brenda, por pamë se ku alpinistët ngrinin çadrat alpine po ndërtoheshin disa baraka ?!.

- E çuditshme, më tha bashkudhëtari, jo vetëm që u nxorrën nga "shtëpia", por nuk u lënë as ta shihni atë.

* * *

E gjashtëmbëdhjeta verë që alpinistët erdhën përsëri në Theth, në këtë vend kaq të bukur, nga ku çelen dyertë për të vajtur na majat e Alpeve. Po ato shkëmbinj dhe po ato male ku punuan dhe alpinistët e parë në vitin 1956. Shkëmbinj të dhe malet kanë mbetur ashtu të heshtur dhe hijerëndë, ndërsa jeta e malësorëve ka ndryshuar. Vitet e parë ata na shihnin me njëfarë kureshtje dhe admirimi, i mbanin sytë tek konopët tanë shumëngjyrësh, shihnin me habi tranzistorët tanë apo të alpinistëve të huaj; sot ata jo vetëm që kanë radjo në shtëpi, por shumë prej tyre nisen për në punë me tranzistor në duar dhe interesohen për llojet e ndryshme të baterive. Në Thethin, që për gjashtë muaj izohet nga dëbora e madhe, sot ka dy aparate televizivë dhe sa shumë u pëlqen atyre të shohin se çfarë bëhet në Shqipëri. Ja, një detal i vogël që flet aq shumë për rritjen e mirëqenies materiale dhe kulturore. Alpinistët e rinj vazhdojnë ta ruajnë miqësinë me të rinjtë e fshatit, është gjë e bukur të shohësh një ndeshje volejboli apo futbollit midis malësorëve dhe alpinistëve. Këta malësorë te rinj dinë jo vetëm të luajnë kala dibrançe, por edhe lojëra të ndryshme sportive; njohin me emër futbollistët më të mirë tanë dhe të huaj, tani flasin për lojërat e ardhshme olimpike.

Me gjithë miqësinë e madhe herëpashere ata u vënë alpinistëve fletë-rrufe, përmbajtja e të cilave është e njëjtë: "Përse ju, shokë alpinistë, mbani mustaqe dhe lini mjekrën kur vini në bjeshkët tona ?...". Këto ditë ishte varur një fletë-rrufe e tillë dhe nuk e di kush do të tërhiqet – malësorët apo alpinistët, të cilët thonë se një gjë të tillë e bëjnë që të mos u prishet lëkura nga ndryshimi i temperaturës...

Jeta e këtij fshati, të kolektivizuar dhe të ndriçuar nga drita elektrike, ka ndryshuar shumë këto 16 vjetët e fundit. Brenda këtyre viteve shumë alpinistë kanë ardhur në Theth, ku kanë mësuar alfabetin e ngjitjeve të kategorive të larta të vështirësive. Është viti i dytë që alpinistët në vend të zboreve mësimore bëjnë ngjitje shkëmbore.

Alpinistët e turnit të dytë i drejtojnë (të ndarë në tre toga) Agim Tabaku, Astrit Omeri dhe Piro Liko.

* * *

Tek Kroni i Shtrazës, aty ku fillon ngjitja për në Qafën e Pejës, takuam reth 20 alpinistë që po ktheheshin nga maja më e lartë e Alpeve - Maja e Rinisë (Jezerca), nën drejtimin e instruktorit Piro Liko. Ai na tha: "Ishte ngjitje e bukur, dëborë ka më pak se vitet e tjerë, të gjithë u treguan të përgatitur mirë teknikisht dhe fizikisht. Në majë nuk e gjetëm letrën e alpinistëve të mëparshëm, ne e lamë tonën...".

Është kënaqësi e veçantë të rrish dhe të bisedosh pranë zjarrit me alpinistët; në fjalët e tyre ka shumë humor dhe shumë poezi: ata tregojnë sesi kaloi kacavjerrja në shkëmbinjtë e kataraktit apo të kooperativës, sesi Alleksandër Bojaxhi ka vendosur të shkojë edhe një herë për të studiuar kalimin nga mali Gavnit për në Grykat e Hapura; tregojnë për peripecitë e pambaruara, për sigurimin e ushqimit; njëri prej tyre që vinte për herë të parë na tha: "Në këto vise përpara kanë vuajtur për bukën, ndërsa tani e kanë me bollëk, por e bukur është se ne, alpinistët, po bredhim sa nuk thuhet për të siguruar ushqimet. Mos vallë edhe kjo bën pjesë në përgatitjen e alpinistëve, apo kemi të bëjmë me mungesë organizimi të palejueshëm? Gjatë këtyre ditëve përveç shkëmbinjve na u desh t'u bëjmë ball vështirësive të kohës së keqe dhe sigurimit të ushqimit...".

Biseda vazhdon, nis një këngë, ndonjëri shtyn urët e zjarrit dhe mendja më shkon tek pasioni i madh i këtyre njerëzve që sulmojnë majat e maleve, tek dashuria e tyre për këtë sport, për rreziqet që kanë kaluar duke bërë kacavjerrje në shkëmbinj të lagur. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, ata duhet të përballojnë pasojat e dëmshme të mungesës së organizimit. Të shkon mendja tek lufta e madhe që duhet bërë për të thyer konceptin e gabuar se alpinistët duhet të jenë të ngarkuar rëndë, se nuk ka asgjë të keqe në rast se ata duhet të ecin për orë të tëra me çantën plot, e kështu me radhë.

Kur po afronte ora për t'u futur në çadër, m'u afrua Astrit Omeri dhe më tha: "Të lutem, po të shkruash, mos harro të përmendësh edhe alpinistët e dalluar të togës sonë: Qemal Zagonjari, Robert Llabani dhe Meçan Luçko".

1973

Sulmi kundër "Polit të tretë"

...Që nga viti 1921, dhjetë vjet pas zbulimit të dy poleve gjeografikë, alpinistët filluan sulmin kundër polit të tretë, polit të lartësisë tokësore - Xhomolungmës ose, siç e quajnë ndryshe, Everestit. Ato përpjekje të dëshpëruara, pa aparate oksigjeni, për të arritur lartësinë 8.848 m kushtuan disa jeta njerëzore. Pas tyre alpinistët u bindën se rruga për në majën e majave nga ana verilindore, nga Tibeti, ishte e pamundur të përshkohej.

Prandaj, pas Luftës së Dytë Botërore përpjekjet për të arritur në majë rifilluan, por nga Nepali, nga ana e akullnajës perëndimore. Pikërisht që andej e filluan rrugën e tyre neozelandezi Edmund Hillar dhe treguesi vendas Tensing Norgej, të cilët ishin të parët që shkelën në majën Xhomolungma më 29 maj 1953. Grupe të tjerë e përsëritën pas tyre këtë itinerar, një nga të cilët e përbënë alpinistët kinezë. Këta më 25 maj 1960 ngulën flamurin e kuq të Kinës Popullore në majën më të lartë të "mbretëreshës së akullit dhe të dëborës", siç i quajnë Himalajet malësorët vendas tibetas.

Po këtu, para se të vazhdojmë tregimin tonë, duhet të themi disa fjalë për akullnajën perëndimore, e cila nuk është një vend aq i këndshëm sa mund të duket, edhe pse pikërisht nëpër të janë bërë të gjitha përpjekjet për në "polin e tretë". Gjatë ditës shpatet e mbuluar me dëborë të akullnajës i pasqyrojnë aq intensivisht rrezet diellore, san që në atë "kazan cirku", tamam sikur ky të ishte fokusi i një xhami zmadhues, njeriut i zihet fryma sa nuk mund të durojë, kurse rrezet ultraviolet i djegin lëkurën e pambrojtur nga veshja, ngrica është kaq e fortë, sa gishtat ngrijnë dhe ngjiten tek gurët dhe metali.

Të parët që filluan sulmin mbi Xhomolungmën nëpër shpatin e tij jugperëndimor qenë alpinistët japonezë. Kjo ndodhi vetëm dy vjet më parë. Kur arritën lartësinë 8.000 metra, ata u tërhoqën. Për të patur një ide sado të zbehtë të detyrës shumë të vështirë që duhet të kryenin ata, duhet të themi se itinerari nëpër shpatin, ose më mirë të themi, mëpër murin jugperëndimor përbëhet prej dy pjesësh: pjesa e parë zgjat 1.900 m me një pjerësi mesatare prej 44 gradësh dhe pjesa e dytë zgjat 1.100 m me një kënd mesatar prej 58 gradë. Gjithsej itinerari është 3 kilometra nëpër shkëmbinjtë e thepisur të mbuluar

nga akulli dhe që kanë një kënd mesatar pre 49 gradësh.

Në vitin 1971 Norman Dierenfurti, pasi mundi të bashkonte në një grup të vetëm “yjet e alpinizmit botëror”, vendosi të sulmonte përsëri Xhomolungmën nëpër dy drejtime: njëri nëpër kreshtën e zakonshme dhe tjetri nëpër murin jugëperëndimor. Po më kot.

Po atë vit dy anglezë për pak ia arritën synimit. Në fund të majit 37 vjeçari Don Uilans dhe 29 vjeçari Dungllas Heston ngritën bivakun e gjashtë në lartësinë 8.236 m. Por koha e keqe dhe stuhia i pengoi.

Në pranverën e sivjetme ekspedita e parë ndërkombëtare, me në krye mjekun 56-vjeçar Karl Herilkofer nga Munihu, ngriti bivakun e shtatë në lartësinë 8.400 m. Por edhe ajo, për shkak të stuhisë dhe të kohës së keqe, u detyrua të ndërpriste sulmin. Por pjesëtarët e saj nuk ishin shpërndarë akoma, kur u dha lajmi se nëpër murin jugëperëndimor do të sulmonte “polin e tretë” një ekspeditë e re, angleze, e udhëhequr nga Kris Boningtoni, një nga specialistët më me përvojë për ngjitjen e shkëmbinjve dhe akullnajave gjigande. Në fillim të tetorit 11 alpinistë, 40 udhëtregues vendas dhe 400 mbartës me këmbë, që të aklimatizoheshin, u nisën nga Namçe-Bazari i Nepalit drejt akullnajës Kumbu, ku organizuan kampin kryesor. Tetori dhe nëntori kaluan për të bërë aklimatizimin dhe për organizimin e kampeve të ndërmjetëm.

L. Bardhi, 30 janar

60 të reja dhe të rinj beratas ngjiten në Çukën Partizani

Në sallën e kinemasë “22 Tetori” të qytetit të Beratit zhvillonte punimet konferenca e 20-të e BRPSH-së së rrethit. Kanë zënë vend aty të rinj e të reja, delegatë nga organizatat e rinisë së qëndrave të punës e prodhimit, shkollave e kooperativave bujqësore.

Pas një seance pushimi, në sallë hyri një i ri me radisostacion në duar. E vendosi aparatën diku dhe nisi të merrte kontakt me korrespondentin: “Tomorri! Tomorri! Si më dëgjon? Jam unë fusha. Marrje!”. Nuk vonoi dhe salla u mbush me zëra që vinin nga Tomorri. Në fillim u dëgjua thirrja karakteristike “Zig-zag, zig-zag, hej-hej-hej, alpinista jemi ne!”. Pastaj ishin fjalët e një të riu:

“Ju përshëndesim nga majat e mbulura me dëborë. Jemi 60 të rinj e të reja nga kolektivat fizkulturore të qytetit që sot ndodhemi në pikën më të lartë të malit Tomorr, në Çukën Partizani, nga ku ju dërgojmë përshëndetjet më të përzemërta dhe ju urojmë suksese!”.

Në sallë u dëgjuan edhe dy përshëndetje të tjera, ku shprehej kënaqësia për panoramën që sodisnin nga lartësia, mirënjohja për Partinë, besimi për të ardhmen më të bukur.

....

Vlash Pambuku, 18 dhjetor

1974

Alpinizëm, do të thotë të përgatitesh fizikisht

Kanë kaluar 18 vjet që nga dita kur mjeshtri i merituar Minella Kapo, drejtoi zborin e parë alpinistik të përbërë nga 15 vetë. Që atëhere, alpinistët tanë kanë bërë realitet pushtimin e të gjitha majave të Atdheut. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeshhtërisë sportive nga ana e tyre.

Të ushtrosh alpinizmin do të thotë të përgatitesh fizikisht dhe të jesh i pajisur me forca të tilla morale që të arrish të mposhtësh çdo vështirësi e të kalosh të papriturat e natyrës. Alpinistët, të edukuar me mësimet e Partisë, ja kanë arritur këtyre qëllimeve, dhe me aftësitë e tyre është lidhur edhe emërtimi i shumë lartësive të reja, si Maja e Rinisë, Shkurte Pal Vata, etj.



Mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, se forca e gjallë e Atdheut qëndron tek njerëzit dhe sa më të fortë të jenë ata, aq më i fortë është Atdheu, ka bërë që në këtë sport të vështirë të vërshojnë qindra e

qindra të rinj nga çdo anë e vendit. Dëshmi e qartë e kësaj të vërtete është fitorja e shkëlqyer në ngjitjen e kohëve të fundit nga një grup alpinistësh në Alpet e Veriut duke përshkuar 120 km. U "pushtuan" katër maja malesh me lartësi 2.500 m dhe u bë i mundur kalimi nga Briaseti në Valbonë, gjë e dëshiruar prej kohësh.

Meritë në masivizimin e mëtejshëm të alpinizmit tonë ka, përveç të tjerëve, Klubi Sportiv "Tomorri" dhe sportistët e edukuar nga -mjeshtri i merituar Petraq Kule dhe Vangjel Melengu. Ata u kanë shtënë në gjak të rinjve ajrin dhe shkrepat e lartësive të ftohta. Po kështu punon dhe Ahmet Lika në Korçë dhe në përgjithësi klubi "Partizani". Mbështetja akoma më e fuqisjme tek të rinjtë dhe puna me plane të studiuara nga ana e trajnerëve do të sjellin më tepër sukses në këtë kalitje.

Si në çdo sport, edhe në alpinizëm, në plan të parë mbetet përgatitja e sportistëve dhe edukimi i tyre i mëtejshëm komunist. Në këtë drejtim ka akoma për të bërë, duke filluar nga hartimi i shpejtë i planeve stërvitore dhe bashkë me to edhe i atyre edukative. Dihet se pa plan nuk ka rezultate dhe as që mund të mësohen fillestarët, të përgatiten në mënyrë të gjithanshme, të përvetësojnë teknikën dhe njohuritë e domosdoshme për të realizuar ngjitje të çdo kategorie. Qysh me ngritjen e grupit, stërvitja duhet të bëhet sistematike, e ndërtuar drejt metodikisht, koha të kalojë në mënyrë interesante për pjesëmarrësit. Trajnerët duhet të mbështeten në aktivizimin e sa më shumë sportistëve. Veç këtyre, në plan trajneri duhet të parashikojë drejt afatet e periudhave stërvitore, si dhe vendin, ku do të zhvillohet aktiviteti – në sallë apo në natyrë. E ndjejmë të nevojshme t'i përsërisim këto, pasi ka edhe klube që punojnë "qesim". Tipikë janë "Labinoti" dhe "Përparimi". Ekipet e këtyre klubeve nuk kanë programe pune, dhe as që bëjnë fare stërvitje. Kur marrin pjesë në aktivitet, do të vijnë me vonesë, ose do të jenë gjysmakë. Po në këtë gjendje ndodhen edhe klubet "Dinamo", "Dajti", "Apollonia", "Ylli i Kuq". Nuk e kuptojmë përse këto klube e braktisën alpinizmin? Apo se disa prej tyre janë klube cilësie dhe nuk duan telashe të tjera? Nuk duhet harruar në asnjë rast se tri të katërtat e Shqipërisë janë male dhe se këta male duan në gjirin e tyre sa më shumë djem, të cilët të ngrenë mbi to flamujt e sportit tonë popullor.

Dihet se pajimet kanë rëndësi të madhe në alpinizëm. Qofshin këto personale apo kolektive. Unë mendoj se këtu duhet të ndalemi. Ka mungesa të mëdha që vijnë jo nga që nuk ka, por nga nënvleftësimi ose pakujdesia e trajnerëve dhe e vetë pjesëmarrësve.

Këtu ka nxjerrë kokën një e keqe. Hidhen sytë tek importi. Nuk merret mundimi të prodhohen në vend gjërat më të domosdoshme dhe më të mundshme. Të tilla janë kazmat, çekiçët, gozhdët, etj. Dhe është për t'u habitur se tërë këto materiale ne i kemi prodhuar dhe janë mjaft të mira. Po pse disa klube nuk i kanë ato dhe nuk marrin mundimin të venë në uzinën "Traktori" për t'i tërhequr? Ato janë aty që nga viti 1968. Nuk është e lejueshmë që alpinistët të shkojnë në alpe me të meta materiale, se mungesa të tilla sjellin të papritura. Por ka edhe raste kur materiali i importit keqpërdoret. Kështu, në qytetin e Krujës ka një bazë materiale të ngjitjes malore, por ajo nuk mirëmbahet. Litarët kolektivë 45 m. përdoren për rrethim, ndërsa një pjesë tjetër kalbet në magazinë.

Duke rrahur këto probleme që m'u dukën si më shqetësueset, mendoj se edhe Shoqata e Turizmit dhe e Alpinizmit duhet të ndihmojë më shumë në zgjidhjen e tyre.

Astrit Omeri, mjeshtër sporti, 16 prill

NDODHIN NË VENDET REVIZIONISTE

Vdekje tragjike e tetë alpinistëve sovjetikë në Pamir

Para pak kohësh ndodhi një ngjarje tragjike që, me gjithë përpjekjet e tij, shtypi revisionist sovjetik nuk mundi ta mbajë të fshehtë. Është fjala për 8 alpinistë, të cilët gjetën vdekjen në rajonin e Pamirit. Duke dhënë njoftimin për këtë katastrofë, agjensia revizioniste sovjetike "TASS" u përpoq t'ua hidhte përgjegjësinë "kushteve të këqija meteorologjike" dhe e paraqiti fundin e 8 alpinistëve si aksidental. Nga ana tjetër, shtypi sovjetik filloi një fushatë të gjerë për të mbuluar të metat e mëdha të organizimit të këtij aktiviteti dhe t'ia "ngarkonte" përgjegjësinë "fatit të keq". Njëkohësisht, për të tërhequr vëmendjen e opinionit sportdashës vendas, u njoftua krijimi i një komisioni për të hetuar gjoja shkaqet e vërteta të vdekjes së grupit.

Me gjithë përpjekjet për të shfajësuar organizatorët, e vërteta qëndron krejt ndryshe. 8 Alpinistë ranë viktimë e sportit borgjez në Bashkimin Sovjetik, që i ka vënë vetes po ato detyra që ka sporti në vende të tjera revizioniste e kapitaliste : sigurimin e fitimeve e famën. Jo më kot para pak kohe në shtypin sportiv botëror shkruhej se “sportistët sovjetikë, për të arritur rezultate sa më të larta në garat e ndryshme ndërkombëtare, joshen me premtime, duke përfshirë shumta të mëdha rublash, sigurimin e punës së rehatshme e pa telashe, etj. Në disa pika premtimet e rusëve shkojnë akoma më larg se ato të biznesmenëve amerikanë”.

Edhe në rastin konkret del ajo që është tipike në sportin borgjez revisionist : jeta e sportistëve merret nëpër këmbë...Shoqëria “Spartak” (që ishte organizatore e kësaj ngjitje alpinistike, nuk kishte marrë as masat më elementare për sigurimin e jetes së alpinistëve, siç janë ambientimi në mënyrë graduale me lartësitë e mëdha dhe me kushtet e veçanta atmosferike, pajisja me sinjalet e ndryshme dhe të domosdoshme për të mos humbur në humnerat e shumta gjatë ngjitjes si dhe marrja e informacionit të plotë për kohën dhe ndryshimet e mundshme të saj. Nga ana tjetër, duke patur frikë se mos ekspeditat e tjera ngjiteshin më përpara në majë, organizuesit sovjetikë i nxitën alpinistët ta vazhdonin ngjitjen edhe pse kushtet atmosferike parashikonin një keqësim të kohës.

Duke bërë fjalë për përgatitjet e dobëta që ishin bërë nga alpinistët sovjetikë për këtë ekspeditë të rrezikshme, shtypi botëror vë në dukje faktin se atyre u mungonin bile edhe veshjet e trasha për t’i bërë ballë të ftohtit të madh.

Kjo ngjarje e hidhur nuk është një rast i shkëputur. Sipas të dhënave të shtypit sovjetik, dy alpinistë vdiqën në Pamir në vitin 1969. Edhe në boks, sport që gëzon një përhapje të gjerë në Bashkimin Sovjetik dhe të cilit i bëhet një reklamë e madhe, kanë gjetur vdekjen në ring ose kanë pësuar tronditje nervore më se 10 vetë, po kjo dukuri vihet re edhe në garat me motoçikleta.

Korresp. i “Sportit Popullor”, 3 shtator

Në majat e bardha

Në kuadrin e 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor, Shoqata e Turizmit dhe e Alpinizmit organizoi një ngjitje kombëtare në majat më të larta të zonave të Korçës, Beratit e Skraparit – të Ostrovicës, Tomorrit dhe Zaloshnjës. Ja si e përshkruan këtë aksion të guximshëm komandati i grupit të alpinistëve, mjeshtri i sportit Taxhedin Shehu.

E martë, 26 nëntor. Mëngjes. 22 alpinistë dibranë, korçarë, shkodranë, përmetarë dhe të Klubit Sportiv "Partizani" u rreshtuan për ceremoninë e nisjes. Atyre u foli inspektori i turizmit dhe alpinizmit në Komitetin e Fizkulturës të rrethit të Korçës Ahmet Lika. Sportistët u nisën për rrugë duke përshëndetur qytetarët korçarë me "zigzagun" alpinistik.

Kemi lënë prapa Vithkuqin e Shtyllën dhe po i drejtohem Sektorit. Rruga u vështirësua nga shiu e dëborë. Megjithatë alpinistët janë gjithë energji dhe të vendosur për të vazhduar më tej. Ata i kanë akoma të freskëta në kujtesë fjalët e komisarit, i cili përpara nisjes u tha se : "Prindërit tanë, partizanët, e kanë përshkuar kushedi sa herë këtë rrugë këmbëzbathur, pa bukë e të armatosur keq, por të frymëzuar nga një ideal i lartë dhe në luftë të vazhdueshme me okupatorët e tradhtarët për të na sjellë lirinë që gëzojmë sot".

Në pasdite, vonë, arritëm në Sektor. Punëtorët na pritën me përzemërsi. Midis tyre kaluam natën e parë.

E mërkurë, 27 nëntor. Grupi rreshtohet për rrugë. Kontrollojmë bazën materiale dhe pasi e gjejmë në rregull, nisemi për në Qafën e Martës. Bashkudhëtarë kemi shiun, dëborën, mjegullën dhe heraherës furtunën. Mirëpo alpinistët nuk duan t'ia dinë. Të mobilizuar për nder të 29 Nëntorit, ata i shtynë dëshira fisnike që t'i japin diçka të bukur Atdheut në këtë 30-vjetor.

Afër majës, sportistët lidhen me litar dhe vendosin kthetrat.

Ngjitja është sa e lodhëshme, aq dhe e rrezikshme. Duhet kujdes i madh. Ndaj çdo hap i hedhur me mundim shoqërohet me fjalët :

- Sigurimi, gati?
- Po nisem!

Pastaj litari fillonte e zgjatej. Kështu vazhduam deri sa në orën 11 alpinistët u gjendën në majë. Përqafohemi për fitoren. Nën këmbët tona është Ostrovica (2.383 m.) e veshur me petkun e dimërit.

E premte, 29 nëntor. Bashkë me fshatarët e Gjerbësit jemi mbledhur në shtëpinë e kulturës për të parë paradën ushtarake dhe manifestimin e punonjësve të kryeqytetit. Kur zëri i spikerit njoftoi : “Tani po ju lidhim me bulevardin “Dëshmorët e Kombit...” dhomën e mbuloi qetësia. Zemrat tona rrahin fort. Presim daljen në ekran të udhëheqësit tonë të dashur, shokut Enver Hoxha. Dhe kur çasti i lumtur erdhi, një gëzim i patreguar mbushi sallën. Kudo dëgjoheshin fjalë urimi për Partinë dhe shokun Enver.

E shtunë, 30 nëntor. U nisëm për në Kulmak dhe prej andej në malin e Tomorrit. Rruga ishte e vështirë nga akulli. Dëbora binte flokë-flokë dhe mjegulla nuk të linte të shikoje një metër larg. Këto vështirësi nuk e thyen vullnetin e alpinistëve. Në mesditë ndodheshim në Çukën Partizani - 2.416 m mbi nivelin e detit. Prej andej u kthyem në Kulmak.

E diel, 1 dhjetor. Sot “pushtuam” edhe majën e Zaloshnjës (2.173 m).

Alpinizmi – sport masiv

Nga viti në vit alpinizmi është duke u bërë sport i dashur masiv. Qindra punonjës, sidomos të rinj e të reja, bëjnë ngjitje të rregullta e sistemstike në majat e maleve të vendit tonë.

Një ndihmë të madhe për njohjen, zhvillimin dhe përhapjen e këtij lloj sporti kanë dhënë kurset e ndryshme që janë organizuar me drejtues dhe alpinistë. Një qendër e tillë është bërë Thethi, ku janë kualifikuar alpinistë nga i gjithë vendi.

Një shtytje të re mori lëvizja alpinistike gjatë vitit jubilar të 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe fitores së revolucionit popullor. Në Spartakiadën e 3-të Kombëtare, organizuar për nder të kësaj feste, në mjaft rrethe lindën dhe u zbatuan iniciativa të reja. Punonjës, të rinj e të reja, të udhëhequr nga mjeshtër të alpinizmit ngjitën nga 30 maja

malesh në rrethet e tyre. Në mënyrë masive u kryen këto aksione në rrethet e Skraparit, Korçës dhe Dibrës.

Alpinistët Taxhedin Shehu, Aleksandër Bojaxhi, Koço Ziso, Hasan Temali, Servet Aliko, etj. janë bërë të njohur jo vetëm për zotësinë dhe shkathtësinë e tyre në ngjitje, por edhe për ndihmën e çmueshme që u japin shokëve, sidomos alpinistëve të rinj.

(Sipas ATSH), 17 dhjetor

1975

Kalendari Sportiv Kombëtar

Ngjitje dimërore:

- 7 - 12 shkurt. Vendi i zhvillimit në Alpe.
- 13 -17 shkurt. Vend i zhvillimit në Valbonë.
- 15-21 gusht. Vend i zhvillimit në Alpe.
- 22-27 gusht. Vendi i zhvillimit : Bjeshkët e Namuna dhe Valbonë.

Aktivitet cilësor në bazë rrethi:

Ngjitje dimërore: 13-15 mars dhe 11-13 dhjetor.

Ngjitje verore: 10-12 korrik dhe 6-8 gusht.

“Brenda 30 orëve, alpinistët të gjënden dhe të jenë në Tiranë!”. Enver Hoxha

Sapo kishte kaluar mesnata dhe kalendari shënonte 7 shkurt 1975. U zgjuam nga zilja dhe hapa portën. U habita kur pashë Kiço Negovanin. Ishim komshinj. Është njeriu më i ndershëm dhe më parimor që kam njohur në jetë. Ishte zëvendësministër i arsimit. Si kaloi momenti i habitës sime, më tha se kishte nevojë të bisedonte me mua si alpinist. U ulëm.

- Dëgjo Kozma. Sapo më komunikoi ministri se me alpinistët që janë në Alpe punët nuk janë mirë. Ti, çfarë di?

- Shoku Kiço, janë rreth 30-40 alpinistë të kualifikuar, me komandat Vasil Stambulin. Në këtë orë do të jenë duke fjetur në postën verore tëkufirit, tani, në dimër rreth 6 orë larg Thethit.

- Ky preokupim nuk është vetëm i ministrisë, por i udhëheqjes më të lartë të shtetit... Komandati i Postës së Kufirit në Theth ka njoftuar Tiranën se tre malësorë nga zona e Kelmendit, kur zbritën në Theth, u paraqitën në postë dhe deklaruan se në mes të tufanit

kanë parë nga larg rreth 30 burra që kishin mbetur në dëborë.

- Shoku Kiço. E kam shumë të qartë situatën, se i njoh shtigjet më tëlehtë që përshkojnë kelmendasit në stinën e dimrit. Ata i kanë parë nga Rrethi i Vishnjës.

- Lajmi thotë se në pasditen, mbrëmjen dhe në orët që po flasim po shryn një tufan i lemerishëm. Si e mendon fatin e tyre?

- Të jinni të sigurt se, ata kur janë parë nuk kanë qenë duke u ngjitur në ndonjë shkëmb, apo faqe mali ku, kuptohet, tufani do ta rrezikonte së tepërmi jetën e tyre. Për të mbërritur në vendin ku do të kalonin natën do t'u duheshin jo më shumë se 3-4 orë të përshkonin një terren thuajse fushor. Pra, jashtë çdo rreziku nga ortekët.

Mendoj se ata të 30 ia kanë dalë me sukses...

- Ti nuk do shqetësohesh në rast se do kthehem përsëri.

Si doli nga shtëpia, i shtyrë edhe nga gruaja që (disa nga këta alpinistë i njihte) nisi të më drejtonte njëqint pyetje, nisa të meditoja...

Përjetoja ndjenjën që do të më pëlqente të isha bashkë me ata. Nuk vajta në këtë ngjitje se disa ditë më parë theva krahun nga një aksident banal. Duke dashur të ndizja gazin kinez të gazetës "Mësuesi" ku punoja, para shtëpisë për t'u nisur me shërbim, motori dha goditje të kundërt që solli thyerjen e krahut të djathtë. Ma vunë në allçi.

Isha shumë i shqetësuar për fatin e shokëve. I thoshja vetes se ata ishin shëndoshë, se ortekët, edhe po të donin, nuk u bënë dot gjë. Sado i egër të ishte murlani, nuk do të ishte si i papërsëritshmi i janarit të 1968-ës. Shili vërtet është "i krisur", por me ato çanta aq të rënda dhe në atë kohë aq të keqe, nuk mund të kërkonte zbulimin e një itinerari të ri që lidhej me malin e Arapit...Kishte kaluar rreth gjysëm ore, kur dëgjova hapa pranë portës...

- Unë e di që krahun e ke të thyher, por, në rast se je dakord, vishu. Tre veta do të niseni me helikopter për të vrojtuar për alpinistët. Kë mendon të jenë dy të tjerët?

- Minella Kapo dhe Andon Tapia. Shoku Kiço, është e nevojshme të marrim pajisjet alpinistike...

- Rreth orës 4 u takuam të tre në magazinën e Klubit Sportiv "Studenti", kun na priste magazinjeri aq i mirë Fehmi Resuli.

Atë natë tre makina të ministrisë ishin në dispozicionin tonë...

Rreth orës 5 mbërritëm në Repartin Ushtarak të Helikopterëve në Farkë. Pa na pyetur për identitetin, na shoqëruan në një dhomë relativisht të madhe ku pamë gjithë ata pilotë të veshur me uniformën

zyrtare. Na prisnin. Na thanë se në repartin e tyre alarmi ishte dhënë në mesnatë. Dinin vetëm se ishim alpinistë që do t'ju tregonim më mirë se hartat zonën ku do të vrojtonin. Të gjithë kishin dëshirën ta bënin këtë fluturim edhe për faktin se ishte hera e parë që nuk e kishin të caktuar vendin ku do të uleshin. Ishte hera e parë që do të bënin me Alpet. Kur më panë disa nga ata që pija duhan, m'u afruan dhe shkëmbyem cigaret. Ishin shumë komunikues, ndoshta edhe për faktin se ishim të parët civilë që bisedonim natën në repartin e tyre.

Hipëm në atë mjet të madh luftark dhe u nisëm. Ishte hera e parë dhe e fundit që udhëtoja me helikopter. Ishte i madh. Bënte shumë zhurmë dhe pak ftohtë. Kisha privilegjin të qëndroja prapa shpinës së pilotëve. Nuk mirrja vesh asnjë fjalë që këmbenin midis tyre. Koha ishte e mrekullueshme.

Kur iu afruam luginës së Shalës, njëri nisi të më pyeste. Me gisht u tregova majën e Arapit. Fluturonim në lartësi të madhe. Runica dukej shumë e vogël. U rrotulluan dy tre herë mbi të, por, fatkeqësisht as unë dhe as ata nuk pamë asnjë gjurmë. Morrën rrugën e kthimit. Më erdhi keq që do të ktheheshim në Tiranë. Por nuk ndodhi kështu. Pas dy tre xhirosh mbi Runicë uulëm afër urës së Thethit.

Pa e fikur motorin, u përshëndetëm dhe u ndava me ata.

Këtu, buzë lumit të Shalës, gjithçka është e mbuluar me një shtresëdëbore të shndërruar në të ngrirë ose në akull. Minella me Andoninpërgatitën çantat e shpinës dhe u nisën. Bashkë me kureshtjen e disa tërinjve nisem për te klubi (kafe-bar). Matem dy herë para se të hedh një hap, me frikën se mos rrëshqas. Këtë herë jam i privuar edhe nga kasma alpine.

Nuk e kisha mbaruar ende kafen, kur disa malësorë u futën brenda dhe thanë:

- Helikopteri, po vjen helikopteri!

Dëgjohej zhurma e tij. Pas pak çastesh e pamë. Thashë me vete do vazhdojnë për te posta verore. Pas pak e kuptova nga manovrimet e pilotëve se do të zbriste këtu. Bashkë me kureshtarët kaluam urën. Dolën dy pilotët:

- Ti je Kozma Grillo?

- Si thua, bëjmë edhe një provë të tre mos i gjejmë alpinistët?

Hipëm. Më thanë, mbahu!

Ende nuk e kam harruar mbresën që më la shkëputja nga toka. Ishte më e shpejtë se ajo e mëngjesit dhe lartësinë e fituan menjëherë.

Këta ishin “çakmakë”. Ndryshe nga dy shokët e tyre, ata morën drejtimin nga prapa Jezercës, iu afruan shumë (apo e kaluan) kufirin. Kaluan mbiRunicë, lanë Arapin në krahë të majtë, dolën diku mbi zonën e Bogës, u kthyen për ta përshkuar edhe një herë këtë rreth, por kësaj here në lartësi pak më të ulët. Më së fundi, i preka me dorë, duke u thënë shihni poshtë. Fare të vogla pash disa ngjyra të kuqe. Ishin tesha të shokëve që kërkonim. U gëzova pa masë.

E ulën helikopterin ku më morën. Nuk u tundova nga ftesa që më bënë të kthehesha në Tiranë me atë krahë të thyer. Kur po ndaheshim, më thanë: nuk mund të fluturonim më ulët se nuk e lejon rregullorja. Ti e kupton... Krijova përshtypjen se ishin njerëz të mirë dhe të guximshëm.

Këtë herë u ula jashtë klubit ta pija kafënë dhe të bisedoja me gjithë ata miq të këtyre 20 vjetëve. Jetoja me ndjenjën që shokët ishin mirë.

Nga ajo gjendje përtacie e ëmbël më nxorri telefonisti i fshatit, që nga nxitimi me zi fliste:

- Shpejt se të kërkojnë në telefon, shpejt!

E dija nga përvoja se me atë telefon të Luftës së Dytë Botërore nuk do të merreshim vesh, megjithëkëtë vajta.

- Jam kryeministri. Ti je ai alpinisti që me helikopter zbuluat gjurmët e grupit të alpinistëve?

- Po, shoku kryeministër. Ata nuk kanë probleme të rënda. Kam bindjen që gjithçka shkon mirë. Në emër të tyre, ju faleminderit për gjithë këtë kujdesje...

- Dëgjo, dëgjo këtu. Deri nesër pasdite të gjithë alpinistët duhet të jenë në Tiranë?

- Por, shoku kryeministër.... Ai ndërhyri pa e mbaruar fjalën.

- Më përsërit çfarë të thash!

- Nesër pasdite të gjithë alpinistët të jenë në Tiranë, por... (desha t'i thoshja që është e vështirë se ata janë larg...).Më ndërpreu:

- Më thanë që ti je gazetar dhe duhet t'i kuptosh gjërat. Si të quajnë?

- Hë, hë.

Të them të drejtën, më tepër në fillim nuk u habita nga urdhëri që më dha, se sa nga fakti që me atë telefon dëgjohej sikur ishte në atë dhomë të vogël të postës së Thethit, me ato mure të nxirë nga tymi i duhanit dhe i një stufe të vjetër që nxirrte më shumë tym brenda se jashtë.

Ishte hera e parë (dhe, fatmirësisht, e fundit) që më jepte direkt

një urdhër i dyti i kupolës së shtetit, një urdhër që vështirë se do ta zbatoja me atë krah të thyer. Nuk i kisha mbushur të tridhjetat, por i kisha të qarta pasojat e moszbatimit. Mirë unë, po përse ta pësonin edhe ime shoqe e dy vajzat.

Fillova të përgatitesha për në Qafën e Pejës, nga ku do të më duheshin edhe 2 orë të tjera të takoja shokët. Kësaj here jo për kënaqësi, por t'u transmentoja urdhërin.

Si kisha bërë dyqint metra, ra një "rrufe në qiellin e kaltërt". Shtanga, nuk më bënin sytë. Ishin Qazim Liço dhe Kujtim Onuzi. Pa u përqafuar, thoshja me vete po këta nga po vijnë, nga ky drejtim ata nuk po vijnë nga Qafa e Pejës...

Unë u tregova se përse ndodhesha këtu... Ata më treguan:

"Në Bogë u sëmurëm. Kundër dëshirës, mjeku dhe shokët na mbushën mendjen se duhet të ktheheshim. Në të kundërtën, do të dëmtonim shëndetin tonë dhe do t'u bëheshim barrë atyre. U ndamë nga ata. Nga shtëpia ku bujtëm dëgjuam zhurmë helikopteri. Më vonë kjo zhurmë vinte nga afër dhe në pak kohë u përsërit dy herë. U habitëm. Mendja na shkoi tek shokët, që duhet të përballonin atë tufan të egër, që ne i dëgjonim vetëm vërshëllimën pranë oxhakut. Dolëm jashtë. Pamë nga larg disa kamionë dhe dëgjuam uturimën e tyre. Ishin të mbushur me ushtarë. Komandati, si mësoi që ishim alpinistë, na tha :

- Kemi marrë urdhër t'u shkojmë në ndihmë një grupi alpinistësh në Qafë Pejë, por para një ore na lajmëruan të mos nisemi me këmbë pa marrë urdhërin e dytë.

Sapo dëgjuam këto fjalë "u shëruam në çast". Morëm çantat dhe ia mbathëm për të ardhur këtu.

Si u mbushën me frymë, u thash :

- Jam nisur për te shokët. Duhet vajtur pa tjetër dhe sa më parë.

- Kur duhet vajtur sa më parë, ti nuk duhet të vish. Shkojmë ne.

Nga ajo ditë kanë kaluar 34 vjet. Dhe tani që po e kujtoj nuk jam në gjendje të shpreh ndjenjat që më kanë pushtuar. Këto 17 vitet fundit me Kujtim Onuzin jam takuar 3-4 herë, Qazim Liçon nuk e kam parë më. Pyetjes : "Kush i shtyri këta djem të sëmurë, të linin Bogën, të ngarkuar të kalonin Shtegun e Dhënëve, të zbrisnin këtu dhe pa pushuar të niseshin për në Qafën e Pejës", mund t'i përgjigjem vetëm me pak fjalë "të thata":

Dashuria për shokun! Tek këta njerëz të mrekullueshëm kishte ndikuar, qoftë edhe pak, sporti që ushtronim - ALPINIZMI.

Nuk e di përse, por nuk u tregova për urdhërin që më kishte dhënë kryeministri. Shkrova dy letra. E para për Shilin (si komandat i ngjitjes). Kishte këtë përmbajtje:

“Gëzohem që je dhe jini të gjithë mirë. Sa të marrësh këtë letër, zbrisni menjëherë në Theth. Sot. Pa tjetër. Aktiviteti ndërpritet!”.

Si më njihte, ashtu dhe unë e njihja Shilin “dhëmbë e dhëmballë”. Duke e njohur natyrën e tij, nuk kisha bindjen se do të kthehej.

Letra e dytë ishte për Minellën. I shkruajta gjithë bisedën me kryeministrin dhe urdhërin e tij...

Pa vajtur ora 4 u nisën. Tani gjithçka varej nga ata të dy.

* * *

Atë natë e kalova tek miku im Lulash Marku. Bisedonim. Me mendje ndiqja rrugën që po bënin ata të dy. Si kaluan katër orë, përfytyroja Shilin duke exuar letrën.

Të nesërmen, rreth orës 8, i zoti i shtëpisë më tha se paska “boll njerëz tek Turizmi”.

Pa u mbushur ora isha afër tyre. Takova Muharrem Lleshin, komandatin e postës së kufirit. Më tregoi si kishte ndodhur. Si herët në mëngjes ishte nisur me kufitarë dhe thethjanë për të takuar alpinistët. Ishim miq të vërtetë dhe unë i tregova gjithçka.

U takova me shokët. Herë-herë, Shili më shihte sikur edhe unë kisha ndihmuar që ai të mos vazhdonte ngjitjet...

Në Bogë na prisnin maqinat që na prunë në Tiranë.

Me gjuhën ushtarake duhet t’i mbyll këto kujtime me fjalët: “Urdhëri u zbatua!”

Me që ra fjala, bëri mirë apo keq diktatori që dha atë urdhër?

Kozma Grillo, Oneglia-Itali, janar-prill 2009

Ditar nga ngjitjet shkëmbore në alpe

Në bazë të kalendarit sportiv kombëtar, prej datës 20 deri më 29 gusht u zhvillua aktiviteti kombëtar veror i alpinizmit në Alpe. Komandati i ngjitjeve, mjeshtri i sportit Vasil Stambuli, ka mbajtur këto shënime në formë ditari.

19 gusht. Në këtë aktivitet kanë ardhur për të marrë pjesë ekipet më të mirë të vendit : "Partizani" me pesë alpinistë, "17 Nëntori" me katër, "Tomorri" me 4, "Korabi" me 3, "Flamurtari", "Skënderbeu" dhe "Vllaznia" me nga dy sportistë. Grumbullimin e bëmë në Qendrën Turistike të Thethit. Apinistët u takuan me njëri-tjërtrën dhe u shtruan në biseda nga më të ndryshmet. Si gjithmonë ata janë plot me episode.

20 gusht. Të ngarkuar me pajimet karakteristike, morëm rrugën e lodhshme, por edhe të këndshme drejt majave të thepisura të Veriut. Çdo alpinist mban në shpinë një peshë të rëndë mbi 30 kilogram. Për të ruajtur forcat për ngjitjet shkëmbore në Theth morëm disa mushka për transportimin e pajisjeve. Pas dy orësh fillon ngjitja për në Qafën e Pejës. Karvani ynë, në të cilin bën pjesë edhe mjeku, shkel me kujdes në monopatin e gjatë. Koha është e keqe, majat e maleve janë të mbuluara me re. Në orë 17 mbërritëm në vendin ku do të ngremë çadrat alpine.

Filluan pikat e para të shiut, të shoqëruara me erë të ftohtë. Ndërsa në Shkodër është ngrohtë, këtu na rrethon një ambjent dimëror. Në qoftë se nuk e vë re blerimin përreth, kujton se je në stinën e dimrit. Veshim tutat e trasha dhe trikot e leshta. Të nesërmen koha bëhet më e keqe.

22 gusht. Pjesëmarrësit janë ndarë në dyshe e treshe. Të rreshtuar dëgjojnë urdhërin e ditës. Përshëndetja e alpinistëve jehon tej e tej. Ajo do të dëgjohet gjithë këto ditë. Pas dy orësh, goditjet metalike të çekiçëve, që mbahen fort në duart e fuqishme të alpinistëve, filluan të dëgjohen në hapësirë. Nisën të ngulen kështu gozhdët alpine në të çarat e faqeve shkëmbore të Malësores dhe Kolajve. Ndërkohë, në orën 10, ora fikse e ndërlihdjes, valët elektromagnetike të aparatit transmentues i bënë ditur qendrës në kamp se gjendja e grupeve të alpinistëve ishte shumë e mirë. Duke u ndeshur me shkëmbin e

pashkelur nga qenie të gjalla, sportistët guximtarë kacavjeren dhe ngjiten me mund e djersë, por të vendosur.

Ditën e parë vetë sportistët zgjodhën për ngjitje itinerarë të vështirësisë së kategorisë së pestë e të gjashtë. Vetë ndodhem rrëzë faqeve ku kryhen ngjitjet. Me ndihmën e dylbisë kontrolloj çdo veprim të alpinistëve në shkëmb. I shikoj gjatë ata dhe më pushton një ndjenjë krenarie. Lartësia është krejt pingule. Në çdo ngjitje të tillë sportisti nxjerr deri në dy litra djersë. Megjithatë ai ndjehet i lumtur. Në qoftë se nuk e jeton, nuk je në gjendje ta kuptosh dot këtë ndjenjë. Pastaj ngjitjet kanë të bëjnë edhe me mbrojtjen e Atdheut.

Treshja e "17 Nëntorit" me Acin, Marion dhe Dashin arrin në majën e Malësores nëpër një itinerar të kategorisë së pestë të vështirësisë. Në të njëjtën kohë, nga maja e Kolajve dëgjohet thirrja përshëndetëse e treshes së "Partizanit" me Qazimin, Bertin dhe Kujtimin, të cilët njoftonin mbërritjen në majë nëpër një itinerar të shkallës së pestë të vështirësisë. Më pas plotësoi pikësynimet e veta treshja e "Korabit" me Taxhin, Rushitin dhe Azemin, ndërsa "Tomorri" kishte sot një katërshe me Petraqin, Vullnetin, Vangjelin dhe Janin. Pastaj dëgjohet thirrja e treshes "mikse" e përbërë nga Landi, Vironi dhe Gëzimi të "Partizanit", "Flamurtarit" e "Vllaznisë". Vetëm dyshja e "Skënderbeut" ende nuk po duket. Me anën e radios morëm vesh se Koçoja me Lamën i qenë futur një oxhaku shkëmbor, ndaj dhe nuk dukeshin. Kaloi pak kohë deri sa i pashë që dolën në faqen shkëmbore. Aci nga maja e Malësores kërkon udhëzime. Do të dijë se nga mund të bëhet zbritja më mirë. Vrojtova me kujdes faqet e thepisura dhe e udhëzoja. Aparatet transmentuese që sot i kemi marrë me vete na hynë shumë në punë.

23 *gusht*. Vazhdojnë ngjitjet e shkallës së gjashtë të vështirësisë në drejtime e maja të ndryshme. Sot realizova edhe unë një ngjitje të kësaj kategorie. Në litar kisha Ladin dhe Kujtimin.

24 *gusht*. I gjithë grupi prej 21 alpinistësh, së bashku me mjekun Vlash Koxhalli, kryen ngjitje malore me efekt studimi për ngjitjet dimërore të vitit të ardhshëm në zonën Sqet e Sqapit (2.312 m) dhe Prozhmit (2.452 m).

26 *gusht*. Kryen ngjitje malore të kategorisë së tretë të vështirësisë po për efekt studimi për stinën e dimrit në majën e Langojve (2.499 m) dhe në majan më të lartë të Alpeve - atë të Rinisë (Jezercë) - 2.693 m. Megjithëse koha është e keqe, me shi të ftohtë dhe mjegull, prap se

prap ngjitjet realizohen me sukses. Pasdite u kthyem në Theth.

29 gusht. Vazhdon të bjerë shi, por ne ndërmarrim një ngjitje në shpellën e "Rrathëve", që ndodhet në lartësinë 1.800 m. Marshimi ishte shumë interesant. Në shpellë ndezim zjarr dhe thahemi. Shpella i ngjan një tuneli të gjatë me degëzime anësore. Lart varen stalaktite, ndërsa poshtë aty-këtu ngrihen stalakmite. Pas 30 metrave detyrohemi të zbesim me litar. Gjatë zbritjes hasim në një liqen të vogël...

Vasil Stambuli, mjeshtër sporti, 9 shtator

Dajti - mali i kalitjes së rinisë

Në verilindje të fushës së Tiranës ngrihet si piriq madhështor mali i Dajtit, maja më e lartë e të cilit është 1.612 m mbi sipërfaqen e detit. Ai ka një "kësulë" të pyllzuar me ah e drurë të tjerë dhe, rrëzë këtij pylli, një pllajë të gjerë, një "ballkon" të madh natyror në lartësi 1.050 m, nga ku soditet kryeqyteti, mozaiku i fushës, kurora e kodrave me vetulloret e taracave dhe thellë, në largësi të horizontit, kaltërsia e Adriatikut. Në këtë fushë malore dhe parkun pyjor rreth saj janë ngritur shtëpitë e pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve dhe një qendër turistike moderne.

Natyra e bukur, ajri i pastër, klima e shëndetshme, panorama e larmishme, burimet e kristaltë, pistat e rrëshqitjes me ski, shtigjet dhe vragat malore, kompleksi sportiv, komoditetet e jetesës dhe mjetet e shumta të çlodhjes së kulturuar e kanë bërë malin e Dajtit të dashur e të afërt për banorët kryeqytetas, sidomos për brezin e ri, "shëtitorë" të kalitjes së tyre fizike.

Po qendra turistike e Dajtit ç'është për punonjësit dhe rininë e kryeqytetit? Cila është veprimtaria e saj? Si i pret ajo ekskursionistët nga Tirana dhe qytetet e tjerë?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, korrespondenti ynë bisedoi me përgjegjësin e saj Josif Vaso.

Qendra turistike e Dajtit, ashtu si gjithë mali, është bërë shumë e dashur për banorët e kryeqytetit (dhe jo vetëm për këta), sepse i shërben vënies në jetë të një prej tre komponentëve themelorë të edukimit të njeriut tonë të ri - përgatitjes fizike-ushtarake, çlodhjes aktive dhe argëtimit të kulturuar.

Atje çdo qytetar gjen, sipas stinës, jo vetëm një natyrë të

shumëllojshme, komoditetet e jetesës e të fjetjes, por edhe mjete edukative, çlodhjeje e dëfrimi dhe, në mënyrë të veçantë, gjithçka që nevojitet për kalitjen fizike si komplekse sportive, vegla e mjete sportive nga topat e deri tek skitë, shah etj. Jeta e brendshme është e larmishme dhe të gjitha aktivitetet, si brenda ashtu dhe jashtë pallatit, janë të programuara.

Kapaciteti bujtës i qendrës turistike është deri 350 vetë në natë, por kërkesat janë shumë më të mëdha. Prandaj në bashkëpunim me Komitetin e Fizkulturës së Rrethit, për të disiplinuar e rregulluar frekuentimin është caktuar ky grafik javor : të martën, të mërkurën e të premten shkollat, të shtunën e të dielën ndërmarrjet e kryeqytetit, të enjten kolektivat shkollorë nga rrethet e tjerë të vendit.

Me dhjetëra mijëra janë ekskursionistët që ngjiten, me grupe, shtigjet dhe "shëtitoren" e madhe kalitëse të Dajtit dhe kthehen në qytet në të njëjtën ditë, sidomos të dielave dhe ditëve të pushimit, duke i bërë këto ditë kalitjeje fizike. Po ka edhe mijëra të tjerë që bëjnë ekskursione turistike një dhe dyditore. Këta e kalojnë natën në bujtinën e godinës turistike. Disa qindra të tjerë janë punëtorë, pionierë, sportistë dhe familjarë, që kalojnë pushimet e tyre vjetore në kampet malorë të pushimit në Dajt. Numri i tyre shtohet nga muaji në muaj, nga viti në vit. Gjatë vitit 1974 u ngjiten në formë të organizuar në Dajt, me kolektiva, dhe kaluan aty natën, 22.500 ekskursionistë. Gjatë dimrit dërguan nxënësit me arsimtarët 117 shkolla, 55 ndërmarrje punonjësish si dhe 16 grupe artistike e 9 skuadra të klubeve sportive. Brenda këtij viti kanë ardhur rreth 4.500 punëtorë e 18.000 nxënës. Këtyre u duhen shtuar edhe afër 10.000 familjarë, sportistë, punonjës e pionierë të shtëpive të pushimit e të tjerë si dhe rreth 8.000 nxënës e punonjës nga Durrësi, Kavaja, Rrogozhina, Lezha, Laçi etj.

Kjo rritje e frekuentimit dhe e fuqisë tërheqëse gjithnjë e më e madhe e malit të Dajtit dhe e qendrës së vet turistike ka bërë të nevojshme jo vetëm modernizimin e tij të mëtejshëm, por edhe zgjerimin e sferës së tij vepruese. Për këtë qëllim atje, veç të tjerave, ka filluar ndërtimi i një godine me shumë dhoma, i një amfiteatri natyror dhe këtë muaj nisi pyllëzimi me gjelbërim të përhershëm e zbukurimi i territorit me lule.

Korresp. i "Sportit Popullor", 16 dhjetor

1976

Alpinistët i kryen me sukses ngjitjet, në luftë me vështirësitë e terrenit dhe të motit

Sezoni alpinistik dimëror kishte filluar prej kohësh, por për të realizuar kalendarin kombëtar dhe për të arritur pikësynimet tona në këtë vit jubilar të 35-vjetorit të themelimit të Partisë, duhej të mposhtnim edhe majat e larta të Alpeve. Për të shkuar drejt tyre duhej përgatitje më e mirë fizike dhe aklimatizim. Janari na ndihmoi për këtë. Bora, që këtë radhë, mbuloi çatitë e taracat e shtëpive të Tiranës dhe të qyteteve të tjerë, u vlejti alpinistëve të bënin përgatitjet e tyre përfundimtare në kushte sa më të afërta me ato që do të gjenin rrugës.

Dhe ja, dita e pritur me padurim erdhi. Më 27 shkurt, autobusi me 19 sportistë, që përfaqësonin 7 klube të vendit, niset drejt Shkodrës. Të nesërmen, fshati Bogë gumëzhiti nga zërat gazmorë dhe entuziastë të alpinistëve.

Nisi etapa e parë. Bora e ngrirë kërciste nën peshën e këmbëve tona. Alpinistët, me pajimet në shpinë, krijuan një kolonë, e cila së largu dukej si një shirit i larmishëm, që lëviz mbi sfondin e bardhë. Malësorët e Okolit të Bogës na pritën, si gjithmonë, bujarisht, duke na strehuar në shtëpitë e tyre. Atë natë, rreth gjuhëve të flakës, pranë oxhakut, shtabi i ekspeditës, i përbërë nga mjeshtri i merituar Petraq Kule - komandat, Vasil Stambuli - komisar, Kozma Grillo - zëvendëskomandat, Vangjel Melengu e Taxhedin Shehu - anëtarë, rishikoi edhe një herë itinerarin që do të përshkohej brenda dy javëve larg qendrave të banuara.

Ora 6 e datës 29 shkurt na gjeti në lëvizje. Nisi ngjitja e lodhëshme në lugun e thepisur drejt qafës së Vukalit - mbi 1.800 m. Koha kalon pa u kuptuar. Lodhja nuk ndjehej pasi herë pas here në sytë tanë fiksoheshin bukuritë e rralla të Alpeve. Maja e Radohimës (2.570 m), e para që do të pushtohej, na u shfaq me tërë madhështinë e vet. Rrëzë saj, mbi qilimin e bardhë, ngritëm çadrat. Në orën e caktuar ndërlihdësi, Ramazan Tusha, foli me radio me ndërlihdësin Perikli Bici që ndodhej në Theth. Gjatë gjithë ditëve që qëndruam në male, ndërlihdja nëpërmjet radios nuk u ndërpre.

Mëngjesi i së nesërme ishte më i bukur se i një dite më parë. U nisëm herët. Megjithëse trashësia e dëborës ishte shumë e madhe... (Rreth gjysëm faqe daktilografike është prerë nga gazeta në koleksionin e "Sporti Popullor" – shënimi im : K.G.).

...Krenarë për këtë sukses filluam zbritjen. Kalimi i qafës drejt lugut, që të çon në gropat e Kllogjit, u bë me zbritje sportive. Na zuri nata. Të ftohtët dhe ngrica dëmtuan pilat e elektrikëve të dorës, kështu nuk funksiononin. Por ne, të stërvitur edhe në errësirë, u orientuam për bucuri. Të qëndronim në vend do të kishim pasoja të rënda. Në orën 23 mbërritëm në qafën e fundit pranë majës së Arapit. Pjerrësia, dëborë e ngrirë dhe errësira e thellë përbënin rrezikun kryesor gjatë zbritjes....Pushimi, dielli, dreka dhe darka e ngrohtë, na ripërtëritën forcat.

Të nesërmen, me fuqi të shumëfishuara sulmuam majën e Prozhmit (2.452 m) dhe të Shnikut (2.554 m). Koha po na buzëqeshte. Edhe këto dy maja i pushtuam. Në aparatën fotografik fiksuam, aq sa mundëm, disa nga përpjekjet tona më të guximshme. Kështu, ishim ngjitur në katër maja. Për realizimin e objektivit na mbeteshin edhe dy: Maja e Rinisë (Jezerca - 2.693 m) dhe 8 Marsi. (Paplluga - 2.516 m).

Agimi i 5 marsit ishte shumë i ftohtë. Era që frynte nga Veriu të mpite fytyrën...Përsëritetja jonë nga Maja e Rinisë jehoi nga qafa në qafë, nëpërmjet radios marrëse-dhënëse njoftuam suksesin.

Aksioni ynë ende nuk kishte përfunduar. Duhej të pushtonim edhe Majën 8 Marsi. U nisëm në një mëngjes ku gjithçka ishte kredhur në mjegull. Na u deshën 4 orë për të arritur në majë.

Të nesërmen, nëpërmjet lugut të Valit (mbi 2.400 m) zbritëm në fshatin Rragam. Malësorët na pritën me dashuri, por edhe me padurim se kishin dëgjuar për itinerarin tonë. Filloi të bjerë dëborë, që brenda 4-5 orësh e lartësoi edhe 1 metër shtresën e saj. Majat i kishim lënë pas, por në to kishim lënë një pjesë të zemrës sonë. Duhet të vazhdonim marshimin për të mbërritur në qytetin që mban emrin e heroit të popullit, trimit të Dragobisë, Bajram Curri.

Kështu ekspedita jonë përfundoi. Ajo u kurorëzua me mposhtjen e 6 majave më të larta të Alpeve, të vështirësive 4 dhe 5 dimërore. Ishte një sukses i bukur i alpinistëve tanë më të mirë, të cilët i dhuruan popullit e Partisë në vitin e jubileut të madh të 35-vjetorit të themelimit të saj dhe të diskutimit popullor të Projektkushtetutës së re të RPSSH.

Vasil Stambuli, mjeshtër sporti, 23 mars

Probleme që dolën nga një ngjitje alpinistike

Gjatë rrugës që kalon nga Kopluku në Bogë, në të djathtë shtrihet fshati malor Ducaj. Nga tre anë të horizontit fshati është i rrethuar nga maja vargmalesh, ku gjenden 9 maja mbi 2.000 m, që të gjitha me pamje piktoreske dhe me interes alpinistik, si për ngjitje dimërore ashtu dhe për ato verore. Në këto maja do të shkonte grupi i alpinistëve të kategorisë së dytë, i cili, për nder të 35-vjetorit të themelimit të Partisë, do të realizonte ngjitje kombëtare në zonën e Bogës.

Grupi, që përbëhej nga 37 alpinistë, i ngriti çadrat në afërsi të fshatit Ducaj. Alpinistët i drejtonte shtabi i këtyre ngjitjeve me komandat mjeshtrin e sportit Vangjel Ristani dhe komisar kandidatmjeshtrin Mario Trinkera.

Gjatë tetë ditëve, alpinistët ngjitën 5 majat kryesore, megjithëse konditat atmosferike ishin pjesërisht me shi e shtrëngata që zgjatën 40-50 orë pa ndërprerje. Po kjo nuk i dekurajoi alpinistët, që edhe në këto kushte vazhduan të plotësonin programin. Pozitive për këtë ekspeditë ishte jo vetëm se u pushtuan majat më të larta të zonës, por ajo vlejti edhe si ngjitje mësimore për pjesëmarrësit. Në çdo ngjitje caktohej një udhëheqës i ri, i cili duhej të demonstronte njohuritë dhe aftësitë e veta si alpinist.

Në fund u bë kontrolli i njohurive të fituara dhe përsëritja e elementëve teknikë dhe taktikë në alpinizëm. Gjithashtu, gjatë ngjitjeve u bë edhe studimi për të dhënat fiziologjike të alpinistëve në kondita qetësie dhe ngjitjeje. Të dhënat e vjelura treguan qartë përgatitjen e lartë fizike të tyre.

Gjatë qëndrimit në Ducaj, alpinistët u njohën me kooperativistët, punuan bashkë me ata në hapjen e tokave të reja, kaluan disa orë të lira bashkë.

Mësimet që dolën nga kjo ekspeditë duhet të kihet parasysh në të ardhshmen nga të interesuarit. Kështu, mungesa e pajisjeve të domosdoshme solli disa anomali, të cilat u kritikuan në analizën e fundit. Nisja ka filluar të bëhet me vonesë dhe jo në orët e para të pasmesnatës, në mënyrë që alpinistët ta kenë ditën përpara. Në ekspeditat e mëparshme ishte bërë traditë e mirë regjimi ditor i programuar. Po tani ai pothuajse është harruar. Mungesa në këto ngjitje i shumë rretheve ishte serioze dhe flet për një nënvleftësim të

dukshëm nga ana e tyre të këtij sporti me vlera të mëdha kalitëse dhe edukuese. Për më tepër që edhe kushtet e krijuara për alpinistët janë shumë të mira. Kjo duhet thënë edhe për Universitetin e Tiranës, që ka qënë qendra e lëvizjes alpinistike.

Përgatitja e alpinistëve për këto ngjitje ishte e kënaqshme. Tek të gjithë spikati pasioni për t'u marrë me sportin burror të alpinizmit, vullneti për t'i kryer detyrat dhe veprimet sa më mirë e në çastin e duhur. Megjithatë, në drejtim të përgatitjes teknike, në mjaft ekipe niveli ishte i ulët. Madje pati nga ata që nuk kishin çelësa gjoksi, gozhda alpine, litar personal, etj. Sikundër ndodhi me ata të Vlorës, Beratit e Peshkopisë, gjë që është e palejueshme. Çdo rreth duhet që me forcat e veta t'i plotësojë pajisjet e nevojshme.

Fatkeqësisht vihet re që vitet e fundit pjesëmarrja e femrave në alpinizëm ka ardhur duke u pakësuar. Kjo u pa edhe në këtë ekspeditë. Ky fenomen është krejtësisht i padrejtë dhe në kundërshtim me mundësitë e mëdha që ka femra jonë për t'u aktivizuar në të gjitha sportet.

Ka ardhur koha që çdo rreth të bëjë piketimin e maleve e të itinerarëve të ngjitjeve dimërore e verore. Dhe kjo jo vetëm për kategorinë "Alpinist i RPSH", por edhe për të tjerat. Rezulton se sot kemi efektivisht 2 mjeshtra të merituar sporti, 9 mjeshtra, 20 alpinistë të kategorisë së parë, 41 të kategorisë së dytë dhe po aq të kategorisë së tretë. Shoqata e Alpinizmit me të drejtë vendosi para disa vitesh që çdo rreth të përgatisë vetë Alpinistë të RPSH, madhe dhe alpinistë të kategorisë së tretë. Po realiteti tregon se ky vendim nuk po zbatohet, gjë që dëmton masivitetin e këtij sporti me vlera të mëdha kalitëse.

Minella Kapo, 6 prill

Në luginën e Valbonës

Stina verore e alpinizmit u çel para disa ditësh me shumë ngjitje të kualifikuara shkëmbore në Alpe. Pjesëmarrësit ishin ndarë në tri toga dhe secila prej tyre kishte një itinerar më vete. Toga e parë vepronte Shtegu i Dhënëve, e dyta në Rrethin e Vishnjës dhe e treta në luginën e Valbonës. Ngjitjet zgjatën 10 ditë. U realizuan 19 ngjitje të kategorisë së tretë të vështirësisë, 11 të kategorisë së katërt, 37 të kategorisë së pestë dhe 24 të kategorisë së gjashtë. Më shumë ngjitje

bënë alpinistët e togës së tretë ku ishin alpinistë të “Korabit”, “Vllaznisë” dhe “Përparimit”, për të cilët bëhet fjalë në këtë shkrim.

Të mobilizuar për nder të jubileut të madh të 35-vjetorit të themelimit të Partisë dhe Kongresit të 7-të të saj, alpinistët, si gjithë sportistët e tjerë, ishin të vendosur t’i kurorëzonin ngjitjet me sukses.

Ja një ditë e zakonshme pune në Alpe.

20 korrik, e martë. Ora 5. Të gjithë alpinistët, të ndarë nëpër treshe sipas ekipeve janë të rreshtuar. Fillon gjimnastika e mëngjesit, e pas saj pastrimi dhe rregullimi i kampingut.

Ora 5,45. Grupi është gati për nisje. Drejtuesit e tresheve kontrollojnë bazën materiale dhe i raportojnë komandatit. Jepet urdhëri për nisje.

Pas disa çastesh qetësia e luginës priset nga zhurma e çekiçëve. Nën forcën e muskujve të alpinistëve, ata ngulin thellë gozhdët në shkëmb. Në këtë mënyrë sigurohet jeta e alpinistëve nga dëmtimet dhe rrëzimet që mund të ndodhin në ngjitje e sipër.

Ora 11.30. Vendi rrethëqark ushton nga thirrjet e alpinistëve që lajmërojnë kryerjen me sukses të ngjitjeve shkëmbore.

Shfletojmë ditarin dhe në të gjejmë shënime nga më të ndryshmet.

...Rushiti i “Korabit” dhe Gëzimi i “Vllaznisë” ishin pak të shqetësuar për sigurimin e bazës materiale, sepse do të kryenin një ngjitje të kategorisë së gjashtë. Alpinizmi zakonisht ushtrohet larg sportdashësve, por në këtë ngjitje kooperativistët e Valbonës qëndruan afër për t’i parë dhe për t’i nxitur ata. Treshja e përbërë nga Rushiti, Azemi dhe i riu Petrit Kuçi kryen ngjitje në murin e majtë si thikë nga pjesa jugore e shkëmbit. Aty qëndruan rreth 9 orë, për të kapërcyer vështirësi të shumta. Kishte vende ku një gabim i vogël mund të rrezikonte edhe jetën, por çdo gjë kaloi me sukses. Në orën 16.30 të tre alpinistët dolën në majë. U gëzuan shumë si ata që u ngjitën, ashtu edhe ata, të cilët ndoqën nga afër ngjitjen e vështirë.

Kooperativisti Shpend Bajrami, i cili pa me vëmendje dhe i emocionuar përpjekjet e alpinistëve për të arritur majën, tha :

Nuk e besoja se do të ngjiteshin, por tani që i pashë nga afër gëzohem shumë për djem të tillë që rrit Partia.

T. Shehu, komandat toge, 5 gusht

1977

Kalendari Sportiv Kombëtar

1. Ngjitje dimërore në Alpe. Fillojnë më 5 mars dhe mbarojnë më 16 mars.

2. Ngjitje verore shkëmbore me ekipe në zonën e Nemërçkës (Përmet). Nga data 18 deri më 27 korrik.

18 janar

Një traditë e bukur

Tomorri i lartë ka shumë maja. Që të gjitha ato janë pushtuar nga alpinistët. Ndër to është edhe Maja 11 Shkurti. Emri i kësaj maje është i lidhur me një traditë të bukur të krijuar nga vetë sportistët beratas. 12 vjet më parë, një grup punëtorësh të kombinatit të tekstileve "Mao Ce Dun", nën drejtimin e alpinistëve të njohur, mjeshtrat Petraq Kule e Vangjel Melengu, u ngjitën për herë të parë në majën me lartësi 2.210 m. Atje vendosën një pllakë me mbishkrimin : "Maja 11 Shkurti. 1965". Kështu e festuan atëhere punëtorë e alpinistë sëbashku 20 vjetorin e themelimit të BPSH. Kështu nisi dhe tradita e bukur që çdo vit, në këtë datë, tekstilistët shkojnë në majën e emëruar prej tyre.

11 shkurt 1977. Ashtu si çdo vit, për të dymbëdhjetën herë, të rinj e të reja, punëtorë të kombinatit të tekstileve morën përsëri rrugën drejt majës së tyre. Moti ishte shumë i ashpër. Megjithatë, ngjitja u krye me sukses.

Vlash Pambuku, 15 shkurt

Alpinistët në Alpe

Nga data 5 deri më 16 mars, alpinistët tanë të kategorisë së parë dhe mjeshtrat e sportit rrealizuan ngjitje të kualifikuara në Alpe.

Nëpërmjet fotografive të marra nga mjeshtri i sportit Vasil Stambuli po japim 3 prej tyre.

29 mars

Bukuria e sportit në male

Çadrat i ngritëm një orë larg, sipër fshatit Stërmbec në rrethin e Përmetit. 93 alpinistë të ardhur nga 13 rrethe dhe klube sportive - punëtorë, ushtarakë, kooperativistë e intelektualë, demonstuan përgatitjen e lartë moralo-politike, fizike e teknike, në ngjitjet e kualifikuara verore, të cilat u zhvilluan në faqen shkëmbore të Papingut, në dhjetëditëshin e fundit të korrikut.

Është hera e parë që në një aktivitet alpinistik marrin pjesë kaq shumë sportistë - 93. Shumica janë të rinj në moshë. Po ashtu, është hera e parë që ngjitjet e kualifikuara verore nuk i bëjmë në Alpe. Nga të tre anët jemi të rrethuar nga faqet shkëmbore të këtij mali kaq të madh. Dita e parë e ngjitjeve nuk na shkoi mbarë. E ndjemë shumë lodhjen fizike, bën vapë. Lodhja përjetohet më shumë kur kthehesh nga mali pa arritur synimin që i ke vënë vetes. Thujse asnjë ekip nuk e realizoi itinerarin.

Ndënjëm vonë natën dhe biseduam gjerë e gjatë për të gjetur mënyrën si të kapërcenim pengesat që na dalin... Kërkuam edhe mendimin e më të rinjvë në moshë dhe më me pak përvojë. Ditën e dytë u realizuan disa itinerarë shkëmborë, por nuk arritëm të çanim rrethimin e këtyre gërxheve për të arritur në majën më të lartë të Nemërçkës - në Paping

Kënaqësinë e marrjes së kësaj maje na e dhanë alpinistët korçarë, të cilët ndoqën itinerarin verior. Ky sukses i shokëve tanë na shtoi forcat dhe entuziazmin.

Erdhëm këtu që të hipim në majën e Papingut nga itinerarë që janë krejtësisht të paarrtshëm pa përdorur teknikën e sportit tonë. Itinerarin e korçarëve e kryen edhe alpinistët e disa rretheve. Por faqja e madhe shkëmbore, që kemi përpara, ka vështirësi të shumta për t'u ngjitur na majë.

Ditën e katërt e sulmuam frontalisht Papingun. Kemi me vete rreth 40 litarë kolektivë, secili me gjatësi rreth 45 m, kemi rreth 70 çekiçë dhe 4-5 herë më shumë gozhda alpine. Ky është "armatimi" ynë për të mposhtur vështirësitë e malit në ditët e verës. Papingun e sulmuam në 10 itinerarë, njëri më i vështirë se tjetri. Dy alpinistë të mirënjohur të "Partizanit" : Vasil Stambuli dhe Azem Hyka

ndërmorrën itinerarin më të gjatë, do të kacavjerreshin në gjithë këtë faqe shkëmbore ngjyrë gri në të kuqëremtë, rreth njëmijë metra e lartë.

Pas dy-tri orë secili "litar" filloi kacavarjen, nisi "melodia " e gozhdëve që nguleshin në shkëmb. Kur dielli ngjitet në zenith shkëmbi nis e lëshon një afsh të nxehtë. Çdo dy veta kemi një pagur me ujë. Vetëm ndonjërit me pak stazh i shkon mendja për të kthyer ndonjë gllënjë, vuan nga etja si ai. Secili përpiqet të sigurojë më shumë pikakapje në shkëmb. Të vetmet fjalë që dëgjohej janë:

- Sigurimi, gati?
- Gati!
- Po nisem!
- Të ruaj!

Këto fjalë kaq të thjeshta mbartin një forcë shumë të madhe kur je duke u ngjitur. Hedh sytë poshtë e të duket sikur ndjen një marrjemendsh të lehtë. Vjosa, atje poshtë, duket si një përrua i hollë e i gjatë. I vetëm nuk mund të ngjitesh në humnera të tilla. Dëgjon fjalët e shokut, ndjen si ai mbledh me ngadalë litarin dhe ti punon i qetë. Bashkë me ty punojnë dy shokët e tu të litarit; ti je i bindur se edhe po rrëshqite ata nuk do të lejojnë të të ndodhë gjë.

Mbresë të veçantë më la në këto ngjitje kur në një nga mbrëmjet e para erdhi në mbledhjen e shtabit trajneri i alpinistëve të rrethit të Kukësit Berzat Mane.

Ishte hera e parë që nga ky rreth vinte në aktivitet kombëtar një ekip i plotë. Ai na tha : "...një nga tanët bëri një gabim të rëndë, fyejti një shokun tonë. Ne nuk pajtohemi me sjelljen e tij. U mblodhëm dhe erdha t'ju them se ai nuk ka vend këtu, nuk mund të vazhdojë ngjitjet. Kjo është bindja jonë, të cilën lutemi ta miratoni. Na vjen keq që ndodhi, na vjen rëndë nga shokët e ekipeve të tjerë, por...".

Ngjitja vazhdoi gjithë ditën, ku gjithë pesha e trupit mbahet në gishtërinjtë e këmbëve dhe të duarve (për të qënë më të saktë në tre prej tyre). Mendja na shkon gjithnjë tek të dy shokët tanë që kishin marrë ngjitjen më të vështirë. Atëherë kur dielli nisi të perëndoi, disa treshe kishin mbërritur në majë. Këtë e kuptojmë nga përsëritja jonë : "Zig-zag, zig-zag - hej, hej, hej - alpinista jemi ne!". Si ata ashtu dhe gjithë të tjerët filluan përgatitjet për ta kaluar natën jashtë. Disa u detyruan të lidhen me litar në shkëmb dhe ashtu të prisnin sa të zbardhte, për të vazhduar ngjitjen të nesërmen. Të vetmit që shqetësuan gjithë ditën ishin zogjtë, dhitë e egra dhe një lloj shqiponje

që ngre folenë në lartësi kaq të mëdha.

Ne i duam malet. Pasioni dhe gatishmëria për t'u përgatitur sa më mirë për mbrojtjen e Atdheut na motivojnë të vemi vazhdimisht tek miqtë tanë gjigandë, që janë përjetësisht të heshtur. I vetmi shenjë respekti dhe dashurie për ata është stërvitja intensive që bëjmë gjatë gjithë vitit. Kjo stërvitje u demonstrua edhe në ngjitjet e këtij viti.

Të nesërmen, në mbrëmje, të gjithë u kthyem nga ngjitjet. Ata me më pak stazh nuk pinë tek çadrat aq ujë sa mendonin dhe dëshironin gjatë këtyre dy ditëve që ndodheshin në shëmb...Na u bë zemra mal për suksesin e Vasilit dhe të Azemit, të cilët e kaluan natën në një shpellë të vogël të atij muri shkëmbor. Gëzimi ynë u bë më i madh kur pas dy ditësh e përshkuan këtë itinerar edhe dy alpinistë të tjerë të Beratit (Petraq Kule) dhe të Shkodrës (Gëzim Oruçi)...

Ngjitje shumë të bukur bëri edhe Nuredin Seci bashkë me dy shokët e tij - punëtorë në Fierzë. Ata përshkuan itinerarin e kataraktit (alpinistët janë të pakursyer në emërtimin e zonave të panjohura). Përqafohemi me ata dhe i urojmë që radhët e alpinistëve në rrethin e Tropojës të shtohen...

Kozma Grillo, Stërmbec, korrik

1978

Ngjitjet dimërore në Alpe

Prej datës 7 mars, alpinistët më të mirë të kategorisë II e III ndodhen në zonën e Bogës dhe të Okolit ku, në bazë të Kalendarit Sportiv Kombëtar, po zhvillojnë ngjitjet dimërore.

Sportistët guximtarë të maleve, që përfaqësojnë 14 klube sportive e rrethe të vendit, do t'i përfundojnë ngjitjet më 16 mars.

Korresp. i "Sporti Popullor", 14 mars

Përfunduan ngjitjet alpinistike

Këto ditë përfunduan ngjitjet alpinistike të kategorisë II e III, të cilat u kryen në zonën e Bogës dhe të Okolit.

Alpinistët u ngjitën me sukses në mjaft maja. Ky aktivitet, ku morën pjesë rreth 80 alpinistë nga klube e rrethe të vendit, i shërbeu kualifikimit të mëtejshëm të alpinistëve.

Korresp. i "Sporti Popullor", 21 mars

Në ndeshje me motin dhe malet

Rrallë ka ndodhur në lëvizjen tonë alpinistike një ndeshje kaq e gjatë dhe këmbëngulëse midis motit e malit nga njëra anë dhe alpinistëve nga ana tjetër. Ajo nisi në ditët e para të shkurtit kur 14 alpinistë, ndër më të kualifikuarit e vendit tonë, morën rrugën për në thellësi të Alpeve. Kushtet atmosferike tepër të vështira të atyre ditëve ishin pengesë serioze për realizimin me sukses të programit. Por jo vetëm kaq. Bora e madhe që kish rënë dhe moti gjithnjë në keqësim nuk rekomandonin nisjen e sulmit për pushtimin e majave. Situata kërkonte kthimin tonë, për t'u kthyer rishtazi më vonë. Por sedra sportive ishte e vështirë të thyhej. Si të ktheheshim ne, zotëruesit e maleve, para vështirësivë të natyrës? Diskutimi i këtij problemi zgjati

ca, por së fundi u vendos njëzëri : detyra jonë është të mos bëjmë sulme në itinerarë të zakonshëm. Majat të pushtohen në rrugë të reja. E kjo kërkon ditë me mot të stabilizuar. Andaj të kthehemi.

Kështu ndodhi që u kthyem dhe sulmin e rifilluam ditët e fundit të marsit. Natyra na zhgënjeu. Ndonëse në qytete lamë pranverën, malet na pritën mjaft egër. Dimri nuk po dorëzohej.

Ja si ditët zëvendësuan njëra-tjetrën:

22 mars. Makina arrin në qendër të Bogës. Më tej ajo nuk mundet. Koha është krejt e papërshtatshme për të udhëtuar për në Theth. Madje dhe e rrezikshme. Vendosëm që natën ta kalojmë në lagjen më të sipërme të fshatit, në shtëpinë e malësorit mikpritës Zef Malaj.

23 mars. Mot i mrekullueshëm. Pranverë mbi dëborë. Arrijmë në Theth nëpërmjet Shtegut të Dhënëve. Përgatitemi që nesër të vazhdojmë më tej.

24 mars. Si ndryshoi koha nga mbrëmë sot? Ndonëse ora është 5, duket se ka disa orë që bie borë e dëndur dhe e pandërprerë. Ajo vazhdoi të binte për 24 orë me radhë.

25 mars. Moti është mjaft i keq, aq sa nuk mund të lëvizim. Banorët vendas, miqtë e përherëshëm të alpinistëve, na këshillojnë të mos nisemi. Në mbrëmje vendosëm sëbashku: sido që të jetë koha, nesër do të marshojmë drejt Qafës së Pejës. Në qoftë se moti është i mirë do të nisemi me çantat për tek Kroi i Bardhë.

26 mars. Mot i keq. Megjithatë në 5,30 nisemi pa pajisje. Duke marshuar do të theyjmë plogështinë e dy ditëve dhe do të njihemi me situatën në lartësi.

Pas dy orë udhëtimi, natyra bëri shaka me ne: koha u bë krejt e kthjellët. Ishte një shaka e ëmbël se shijuam një ditë të bukur në lartësi të Alpeve, duke çarë dëborën deri në Qafë të Pejës, por edhe e hidhur sepse u ngjitëm pa patur çantën dhe pajisjet me vete. Kjo dhe fakti që moti po paraqitej shumë i pastabilizuar na detyruan që, kur u kthyem në darkë në bazë, të ndryshonim planin. Duhej të sulmonim sa më parë disa maja, sepse përpara këtij moti mund të mos kryejë asnjë ngjitje. Dhe sulmin duhej ta bënim nga baza jonë në Theth e jo nga Kroi i Bardhë. Koha që kishim në dispozicion s'na sugjeronte ndonjë formë tjetër më të përshtatshme. U përgatitëm.

27 mars. Ora 2 pas mesit të natës. Me pajisjet teknike me vete fillojmë udhëtimin drejt majave. Është vranët dhe fryn erë. Pas dy orë ecje ndërpresim marshimin. Sot fitorja mbi majat është e dyshimtë.

28 mars. Ora 2 e 20. Fillon marshimi. Moti pa re. Vetëm se fryn erë e fortë. Rrezet e forta të diellit na zunë tek Gropat e Bukura. U ndamë në dy grupe: 2 të "Skënderbeut", një i "Labinotit" e dy të "Korabit", nën drejtimin e Jani Qendros të "Tomorrit" sulmuan e nënshtruan nëpër një itinerar të shkallës së pestë të vështirësisë Majën e Jezercës, kulmin më të lartë të Alpeve tona, Prej aty, nëpër një itinerar të shkallës së tretë të vështirësisë nënshtruan Majën 8 Marsi (Paplluga).

Grupi i dytë përbëhej nga 7 alpinistë: dy të "Studentit" e "17 Nëntorit" e tre të "Partizanit". Ky grup, nën drejtimin e Kristaq Korçarit të "17 Nëntorit" arriti Majën 8 Marsi nëpërmjet një itinerari të shkallës së pestë të vështirësisë dhe katër prej tyre, nën drejtimin e Vasil Stambulit të "Partizanit" sulmuan majën e vështirë të Alisë nëpër një itinerar të shkallës së pestë të vështirësisë.

Fitorja në këtë aktivitet u arrit si rezultat i një pune këmbëngulëse dhe i vendosmërisë së të gjithë grupit. Ngjitja më e suksesshme ishte ajo e realizuar në majën e Jezercës, kurse ajo teknikisht më e vështira në majën e Alisë.

Aleksandër Bojaxhi, mjeshtër sporti, 4 prill

Sportist me vullnet të fortë

Të shkruash në pak rreshta për shokun, me të cilin për më shumë se 20 vjet ke kaluar shumë rreziqe dhe çaste gëzimi, ke mposhtur furinë e tufaneve në mal, ke kaluar natën me rroba e këpucë të ngrira, ke ndarë pikat e fundit të ujit në pagurin thuajse të boshatisur dhe, të nesërmen i lidhur në të njëjtin litar, ke sulmuar majën e malit, është kënaqësi e veçantë, por e vështirë...

Ish-hyzmeqarin nga Derviçani, mekanikun duarartë Vasil Stambuli e njoha 22 vjet më parë atje ku u hodhën themelet e sportit të alpinizmit në Atdheun tonë – në Theth.

Ne të gjithë e thërrasin Shili. Është sportist me zemër të madhe dhe vullnet të çeliktë. Tek ai gërshetohen sedra dhe ambicia revolucionare me përgatitjen e lartë fizike e teknike. Janë këto veti që e kanë bërë Shilin të vërë këmbën i pari në majën e Papingut (nga muri karshi Çarshovës), në Gurin e Capit e në disa maja të Alpeve.

Ne të gjithë kemi çfarë të mësojmë nga Vasil Stambuli. Në radhë të parë nga pasioni i tij për alpinizmin, nga figura e tij moralopolitike,

nga thjeshtësia dhe sinqeriteti i tij, nga gatishmëria për t'i ardhur në ndihmë shokut. Është në prag të pesëdhjetave dhe ai nuk e njeh shijen e duhanit dhe të pijeve alkoolike. Gjithnjë i dashur me shokët, kërkues ndaj vetes e ndaj të tjerëve, i papërkulur nga vështirësitë e shumta për të mbërritur në majën e malit. Këto cilësi të larta i njohën tek ai vite më parë studentët e pedagogët e UT, alpinistët e ekipit të parë alpinistik në vendin tone - "Studenti".

Shili është alpinist shumë i mirë, nuk e teproi po të them më i miri, dhe trajner i dalluar. Duke gjetur përkrahjen e plotë në Klubin Sportiv "Partizani" ai ka përgatitur një ekip shembullor.

Njeriu që gjithnjë ngarkohet me çantën më të rëndë dhe trup drejt, është inxhinier në degën teknike të Oficinës së Automjeteve të Ndërtimit, është shpikës dhe racionalizator i dalluar. Këto tipare të larta, të fituara në punë dhe në sportin që ushtron, ai i manifeston në shoqëri dhe në familje. Është prind shembullor. Dy djemtë e tij mësojnë mirë dhe presin vitet të nisen me çantë në shpinë drejt maleve, si babai i tyre. Dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe!

Vitet kanë bërë punën e tyre, shihen në thinjat e tij, por jo në pasionin dhe forcën e tij. Ashtu si vite më parë, ai punoi me të njëjtin entuziazëm edhe në ngjitet e fundit të kualifikuara, nga sapo u kthyem.

Dhënia e titullit Mjeshtër i Merituar i Sportit alpinistit Vasil Stambuli është një vlerësim i lartë që i bën Partia sportit tonë, është nxitje e fuqishme për Shilin dhe gjithë ne, alpinistët, për suksese të reja. Ky është një nder dhe gëzim i madh, në të cilin marrin pjesë jo vetëm alpinistët, por edhe malësorët e kufitarët tanë trima, me të cilët na lidh një miqësi e fortë.

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 11 prill

"Ua lumsha! Kështu çahet rrethimi

Dimri i gjatë dhe vera e vonët bënë që Alpet të ishin të mbuluar me dëborë edhe në ditët e para të korrikut. Ja përse çadrat i ngritëm tek Kroni i Shtrazës, sipër fshatit piktoresk të Thethit, aty ku nis e përpjeta për të vajtur në qafën e Pejës, në "portën e Alpeve". Sapo perëndonte dielli "harronim" se ishte verë dhe shumë njerëz në plazhe kërkonin për të pirë pije të ftohta. Ne visheshim trashë dhe afroheshim

gjithnjë e më shumë pranë zjarrit ku, krahas shakave dhe këngëve, bisedonim për ngjitjet e nesërme dhe për ato të kaluarat.

Kështu rodhën dhjetë ditët që vazhduan ngjitjet kombëtare verore, ku morën pjesë alpinistët më të mirë të Klubeve Sportive "Partizani", "Tomorri", "Flamurtari", "Studenti", "17 Nëntori" dhe "Korabi".

U kryen mjaft ngjitje të kategorive të larta të vështirësisë, që të gjitha së bashku do t'i përgjanin një "koncerti" me numra të zgjedhur, ku vend i parë ishte i padiskutueshëm. Është fjala për ngjitjen në murin shkëmbor të faqes jugore të Arapit, të malit ku zë fill lugina dhe buron poshtë këmbëve të tij lumi i Shalës. Maja e Arapit është nga më të ultat e Alpeve, është vetëm 2.200 m. Në majë të tij jemi ngjitur disa herë, por nuk jemi në gjendje të themi si i ka mbetur ky emër, megjithëse jemi të bindur se nuk ka ekzistuar ndonjë arap aq i krisur sa të vinte e të ngjitej në të. Kemi bërë edhe ngjitje mjaft të vështira, por asnjëherë nuk është sulmuar ky itinerar rreth 1.000 metra i lartë, megjithëse gjithnjë na ka joshur dhe kemi menduar për të.

Propozimin e Azem Hykës për të ndërmarrë këtë ngjitje shtabi e miratoi. Pa pritur të lexohej urdhëri i ditës, të 21 alpinistët e morën vesh këtë lajm që i gëzoi pa masë. Ngjitjen do ta bënte Azemi bashkë me Maridon Hiton e "Studentit". Të gjithë shprehën kërkesën që të nesërmen të punonin në shkëmbinjtë e afërt, në mënyrë që të ndiqnin ngjitjet e dy shokëve, të ishin sa më afër tyre. Ashtu u bë.

Nuk e di kush ishte më shumë i emocionuar atë natë, dy alpinistët që do të niseshin pas disa orësh në atë ngjitje mjaft të vështirë, apo të tjerët, të cilët me kënaqësi të veçantë u ofruan atyre çdo gjë të mirë të pajisjeve të veta. Edhe kjo gjë, në pamje e vogël, tregon shumë për dashurinë e madhe të alpinistëve, për gadishmërinë e tyre për t'i ardhur në ndihmë njëri-tjetrit, për botën e tyre të pasur shpirtërore, që nuk ka asgjë të ngjashme me zilinë dhe çdo gjë meskine.

U nisëm herët. Pasi shtegtuan rreth një orë lidhën litarët. Për orë të tëra qëndrova bashkë me Pëllumb Llubonishtin tek vendi ku ata nisën të ngulnin gozhdët e para. Nisën kacavarrjen në atë mur shkëmbi, duke qënë të sigurt në forcat e tyre, në përgatitjen e tyre teknike, duke e ndjerë se të gjithë alpinistët e tjerë do të jetonin bashkë me ta, megjithëqë ndihma jonë do të ishte e vogël në atë faqe shkëmbore me përmasa gjigande.



Metrat e parë i kaluan pa shumë vështirësi. Por të gjithë e dinim se nuk do të vazhdonte shumë kështu. Para tyre doli një pllakë e lëmuar, pothuajse prependikulare. Të tilla pllaka alpinistët nuk i kanë për zemër, se në to nuk gjejnë pika mbështetje dhe vende për të ngulur gozhdët alpine, të cilat nuk janë si ato që përdoren në ndërtim. Gozhdët nuk i shërbejnë alpinistit për të vendosur duart apo këmbët, por që në to të kalojë litarin kolektiv, atë litar rreth 40 metra, me të cilin alpinistët lidhen në gjoks. Ky litar (litari kolektiv) është i vetmi mjet nëpërmjet të cilit ndjen në çdo centimetër që ngjitesh dashurinë, gatishmërinë dhe forcën e shokut, i cili është duke të siguruar. (Asnjëherë alpinistët në vende të vështira nuk lëvizin të dy, ose të tre, në të njëjtën kohë, kur njeri punon tjetri/të tjerët e sigurojnë atë).

Orët kalonin. Azemi dhe Marjo gjithnjë e më shumë zvogëloheshin në sytë e mi. Ndiqja me vëmendje të përqëndruar zhurmën e çekiçëve, që të përfytyroja se në ç'gjendje ishin. Ata nuk e ndjenë shpesh atë ditë ndjenjën e fuqishme që jeton alpinisti kur litari i tendosur i rrëshqet me shpejtësi nga duart. Kjo tregon se shoku ka rrëshqitur, atëherë vë të gjitha forcat për të ndaluar sa më parë lëvizjen e litarit,

atë lëvizje që mbart kob. Dhe nuk kalojnë disa çaste e litari është përsëri i tendosur, pret me padurim thirrjen e shokut që ka rrëshqitur:

- Tërhiq litar!

Ti që je duke siguruar përfytyron si rrëshqiti, pas sa metrash ndaloi, si mbeti i varur për disa çaste, i varur si një lavjerës gjigand mbi humnerë, si mbledh veten nis e ringjitet. Ku i gjen gjithë këto forca njeriu?!

Në mesditë ata ishin ngjitur lart dhe nuk shiheshin më. Vëmendjen tonë e trazonte zhurma e ndonjë guri që shkëputej, fërshëllima e tij në ajër dhe vetëm si kalonin disa sekonda dëgjohej zhurma e tij kur arrinte në tokë.

Aty nga ora 14 “u zgjuam” nga pikat e para të shiut, që pa kaluar disa minuta na lagu deri në kockë. Shija herë pas here Pëllumbin, por nuk flisnim. Na dukej se po të flisnim do ta kishin më të vështirë shokët tanë, të cilët tani duhet të kacavarreshin në shkëmb të lagur. Kjo shton mundësinë për të rrëshqitur. Pritëm një copë herë të dëgjonim zhurmën e çekiçëve, por më kot. Kaloi mjaft kohë, që na u duk më e gjatë se ishte në të vërtetë. E ku ta dinim ne se ata të dy shiu i kujtoi që nuk kishin ngrënë gjë, megjithëqë kishin kaluar tetë orë që punonin me nerva të tendosura në shkëmb. Kur shiu u dëndësua, ata u lidhën mirë në shkëmb, hapën çantën e vogël alpine dhe nisën të hanin diçka.

Nisëm të dëgjonim sërish zhurmën e çekiçëve, zhurmë që na u duk më e ëmbël dhe më e bukur se melodia e një simfonie. Ata tinguj na treguan se shokët ishin mirë dhe nisën përsëri kacavarren drejt majës. Unë dhe Pëllumbi çadrat i kishim më shumë se një orë larg, të lagur nisëm të zbrisnim.

Si kaluan 13 orë pritje dhe shqetësimi, aty rreth orës 19, dëgjuam melodinë më të bukur për alpinistët kur ndodhen në mal, dëgjuam jehonën që përhapën qafat e maleve të përshëndetjes së shokëve tanë. Iu përgjigjëm të gjithë që ishim te çadrat. Ishin mbledhur shumë dru për të nderur zjarrin.

Ata do të vinin tek ne nëpërmjet Qafës së Pejës. Erdhën kur ishte errësuar. Sa shumë shtrëngime duarësh, përfaqime, urime! Njëri nga alpinistët përsëriti fjalët e bariut më të moshuar të Thethit, që duke parë nga fillimi i pyllit ngjitjen e shokëve tanë, kishtë thënë:

- “Ua lumsha! Kështu çahet rrethimi!”.

Kozma Grillo, 18 korrik

Atje ku shqiponjat ngrënë folenë

-Në përgjigje të pyetjeve të lexuesve-

Si u krye ngjitja në majën e Arapit? Këtë dëshirë të disa lexuesve po e plotësojmë me këto radhë që i zgjodhëm nga një bisedë me pjesëmarrës të ngjitjeve të kryera kohët e fundit në Alpe nga alpinistët tanë më të mirë.

* * *

Maja e Arapit ndodhet në fillim të luginës së Thethit, në pjesën veriore të saj. Qëndron si gjigand me lartësi 2.217 m mbi nivelin e detit dhe midis dy qafave të larta mbi 1.800 m - asaj të Pejës dhe Rrethit të Vishnjës. Me faqet e saj shkëmbore, vende-vende me pjerrësi negative, Arapi ka qenë prej kohësh objekt i alpinistëve. Ata e kanë shkelur atë në drejtime të ndryshme. Tekat e tij i kanë mposhtur alpinistët e njohur si Azem Hyka, Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Aleksandër Bojaxhi etj. Vetëm faja jugore e ajo juglindore nuk ishin shkelur. Për ta mposhtur edhe këtë anë, gjatë aktiviteteve të viteve të fundit u bënë vrojtimet e duhura dhe në korrik të këtij viti, alpinistët Azem Hyka i "Partizanit" e Maridon Hito i "Studentit", kryen një ngjitje të shkallës shumë të lartë të vështirësisë.

Lufta me shkëmbin nisi në mëngjesin e 8 korrikut. Dyshet e tjera të alpinistëve i kryen shpejt itinerarët e tyre. Ndërsa Azemi e Maridoni kishin itinerar më të gjatë e shumë të vështirë. Koha kalonte, por të dy alpinistët përparonin. Mbas orës 14, natyra shfaqti kapriçiot e saj. Nisi të bjerë shi. Ujët e tij u hyri në trup dhe, kuptohet, në atë lartësi ua shtonte të ftohtit. Kur gjenin ndonjë "shesh" majë shkëmbit, bënë lëvizje për t'u ngrohur.

Kështu, hap pas hapi, në luftë me vështirësitë e shkëmbit, të motit e të lartësisë, Azemi e Maridoni iu afruan majës. Ishte ora 19.30 kur u dëgjua sinjali, përsëritja tradicionale e alpinistëve. Maja e Arapit, në atë lartësi ku shqiponjat ngrënë folenë, ishte shkelur.

Gëzim i madh për të dy guximtarët, për të gjithë shokët e tyre që prisnin me ankth, një sukses tjetër i sportit të alpinizmit tonë, që realizoi një ngjitje të vështirësisë shumë të lartë.

Një nga "shqiponjat" e shkrepave

-Portret-

Alpinisti ynë i talentuar, pjesëtar i klubit sportiv "Partizani", Azem Hyka, e filloi ushtrimin e këtij sporti që në fëmëni. Djaloshi i vogël nga Tropoja, tek kulloste bagëtinë në Pojanë të Shipshanit, i pëlqente të varej e të kacavarrej nëpër degët e pishave e të aheve, të hynte nëpër shkropa e të kalonte shtigje ku nuk kishte kaluar ndonjëherë këmbë njeriu. Vendkalime të vështira si shkëmbi Gllaznicës e disa të tjera në grykë të Llugës qenë "provat e para" të alpinistit të ardhshëm.

Rrugën e vërtetë sportive, Azemi e filloi gjatë kohës kur kryente shërbimin ushtarak. Ngjitjen e parë alpinistike, në përbërje të ekipit të "Partizanit", ai e shënoi në dimrin e vitit 1966, për koincidençë në bjeshkët e vendlindjes së tij, në Majën e Hekurave (Maja e Paqes). Pas kësaj, ngjitjet, për dymbëdhjetë vjet me radhë, pasuan njëra-tjetrën. Ato janë me dhjetra, në të gjitha zonat e Shqipërisë. Alpinizmi, krahas të tjerave, të bën të shkelësh e të mësosh me pëllëmbë malet tona të bukura, me brinja e kodra, me burime e shpella, pra të bën një gjeograf të vërtetë. Ndaj kur rrin e bisedon me alpinistë ndjen vërtet kënaqësi të madhe.

Në të shumtën e ngjitjeve të vështira Azemi është i pari. Në reportazhet e botuara në shtyp, ne jemi njohur me shumë ngjitje të vështira të kryera nga alpinistët tanë të kategorisë së parë si dhe mjeshtrit. E gjithnjë në mes tyre një vend të rëndësishëm ka zënë dhe emri i Azemit. Ngjitje të tilla si ajo e vitit të kaluar në majën e Papingut (2.190 m) mbi nivelin e detit, me një pjerrësi 65 gradë, por sidomos ajo e kryer në muajin korrik në majën e Arapit, lënë gjurmë të pashlyer në kujtesën e sportistëve alpinistë. Dhe në këto ngjitje Azemi mbajti një barrë kryesore. I drejtua dy pyetje:

Çfarë ndjen njeriu kur ngjitet në majën e malit?

- Njeriu provon shumë emocione në jetë, por ato të shkëmbit janë ndër më të fortat. Ato janë të gjata dhe kanë efekt të madh. Të mos kesh provuar emocionin e pushtimit të lartësive, e quaj një mungesë të madhe, - na thotë Azemi.

Ku është sekret i suksesit në sportin e alpinizmit?

- Si për të gjithë sportet e tjerë rëndësi të madhe ka pasioni i ushtruesit. Po nuk i deshe malet, shkëmbinjte, borën...nuk mund të

arrish të “familjarizohesh” e të jetosh me to. Kujdes i duhet kushtuar punës studimore para ngjitjes. Ajo kurrë nuk duhet nënvleftësuar. Pa ditur nga do të nisesh e nga do të dalësh në majë, kurrë nuk duhet filluar. Krahas këtyre, alpinizmi do njerëz të përgatitur fizikisht dhe moralisht.

Pastaj Azemi na flet gjatë për ngjitjen e fundit të kryer në majën e Arapit bashkë me shokun e tij, alpinistin e talentuar Maridon Hito. Dashurinë për sportin, Azemi nuk e kufizon vetëm me alpinizmin. Ai është një skiator i talentuar, madje ndër më të mirët e vendit tonë. I kërkuam të na thoshte diçka për alpinistët e rinj. Ai na foli me dashuri. Janë të shumtë dhe me talent si Eduard Sheldia e Pëllumb Llobanishti të “Partizanit”, Stefan Kule i “Tomorrit”, Viron Velaj i “Flamurtarit” etj.

Në fund, një pyetje tjetër:

Dhe sa kohë mendoni ta ushtroni alpinizmin?

- Gjithë jetën!

Zeqir Lushaj, 22 gusht

1979

Të çojmë përpara arritjet në alpinizëm

Tani, në stinën e dimrit ne, alpinistët, ndonëse kemi tre muaj që kemi nisur stërvitjet, e ndiejmë se aktiviteti që vjen së shpejti do të na kërkojë shumë.

Këtë vit ngjitjet zhvillohen në kuadrin e jubileut të 35-vjetorit të lavdishëm të Çlirimit të Atdheut dhe, çdo alpinisti i del si detyrë që, për nder të tij, të realizojë me sukses objektivat e caktuara.

Arritjet e vitit të kaluar dhe sidomos ngjitja në faqen jugore në majën e Arapit, janë një mbështetje e sigurt për të bërë hapa të tjerë përpara. Sidoqoftë, e vlen që të ndalemi edhe tek disa dobësi që u vunë re në aktivitet e kaluara.

Gjatë vitit 1978 patëm dy raste të spostimit të datave të aktiviteteve për arsye atmosferike dhe një ndërrim zone për zhvillimin e garës për shkak të relievit të ngarkuar me shumë dëborë. Në të tre këto raste u "gjuajt" moti dhe zona më e thjeshtë për ngjitje. Po ta shohim këtë qëndrim me syrin kritik, do të thonja se nuk është vepruar drejt. Ne duhet të luftojmë që alpinistët të përgatiten të luftojnë me vështirësitë e natyrës dhe jo të gjurmojmë atë, se ku do t'i gjejmë caqet më të lehta.

Pati edhe ekipe si "Korabi" e "Skënderbeu", që nuk ju përgjigjën aktivitetit dimëror me kategoritë e larta. Por pati edhe ekipe të tjerë, që në sezonin dimëror edhe në atë veror, nuk sollën numrin e caktuar të alpinistëve...Po ekipe të tilla si "Kastrioti", "5 Shtatori", pse mungojnë të hyjnë në "vallen" e përbashkët të ngjitjeve? Një shembull i bukur është "Tërbuni", i cili megjithëse për të parën herë, debutoi mjaft mirë.

Gjatë vitit të kaluar u aktivizuan mjaft alpinistë të rinj, qofshin ata me kategori të larta, apo të ulët sportive. Me këtë rast, lëvizja alpinistike u vu në rrugën e korrigjimit të një defekti për të cilin edhe është kritikuar disa kohë më parë.

Mendoj se edhe drejtuesit e aktivitetit duhet të zgjidhen më me

kriter. Kështu për ngjitjet e kategorive të ulta, përgjegjësit të caktohen më parë se ato për kategoritë e larta dhe jo të caktohen me to “çfarë të mbetet”...Mendoj se kjo çështje duhet të shikohet më drejt nga komisioni teknik pranë Federatës. Ky komision gjithashtu duhet që 1-2 muaj përpara fillimit të ngjitjeve t’u dërgojë klubeve e rretheve programin e punës, masat organizative etj. Kështu vihen përpara përgjegjësisë edhe rrethet që nuk i përgjigjen si duhet kalendarit të ngjitjeve.

Është vënë re se punës për përgatitjen teorike e praktike, trajnerët i kushtojnë pak kujdes. Por akoma më keq qëndron çështja me plotësimin e dokumentacionit. Dihet se mosmbajtja e dokumentacionit sjell mjaft çrregullime e vështirësi serioze ashtu siç sjell edhe mosnjohja e rregullores teknike dhe e asaj të brendshme.

Gjithashtu, duket se në aktivitet nuk po del në pah aq sa duhet roli i trajnerit. Për këtë flet fare qartë ardhja e disa ekipeve pa trajnerë.

Për nder të 35-vjetorit të Çlirimit, alpinistët tanë, me hov revolucionar, të udhëhequr nga mësimet frymëzuese të Partisë dhe të shokut Enver, do të sulen drejt majave e maleve historikë....

Aleksandër Bojaxhi, 9 janar

Kur guximi bashkohet me urtësinë...

- Dobruna, Dobruna, si më dëgjon?

- Të dëgjoj mirë!

- 10 alpinistë u ngjitën në majën e Rinisë nga faqja verore! U realizua për herë të parë ky itinerar i vështirë gjatë stinës së dimrit. Kjo është një arritje e merituar e alpinizmit tonë. Të gjithë u kthyen mirë...

Ky sihariq iu dha nëpërmjet radios kufitarëve dhe thethianëve, natën e 12 shkurtit.

Ka disa ditë që jemi larg tyre, që jetojme e demonstrojmë përgatitjen tonë për mposhtjen e vështirësive të dimrit, për të mbërritur në majat e maleve të Alpeve. Në njëfarë mënyre na takoi neve, alpinistëve, të çelnim aktivitet e shumta sportive të vitit jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Pa siguruar njëri-tjetrin, pa vënë në përdorim mjetet dhe teknikën e lartë të sportit tonë, u ngjitëm me çantat e rënda në Qafën

e Pejës. Ndoshta kjo është hera e para që ndodh kështu gjatë stinës së dimrit. Ka rënë shumë dëborë e re dhe ajo fundon. Mbi atë sipërfaqe të bardhë nuk mbeten prapa gjurma, por një “kanal” i vërtetë, sepse thellësia vende-vende arrin deri në mes.

Vazhdojmë këtë shtegtim të lodhshëm dhe më në fund mbërrim në zonën e Bjeshkëve të Namuna. (Ju kujtohet nga eposi i kreshnikëve si ato i mallkoi Muji se nuk i dhanë ujë gjogut të tij?).

Mbërrim në vendin e parashikuar. Heqim çantat dhe përgatitemi për të organizuar jetesën për disa ditë. Ndoshtemi në lartësinë 1.700 m. Poshtë këmbëve tona kush e di sa është trashësia e dëborës. Ndezim primusin dhe në kusinë e vënë mbi të hedhim dëborë për të siguruar ujin, për të përgatitur çajin dhe supën, që aq shumë na shijojnë këtu. Ndërrojmë teshat e lagura (kush e di sa do të habiteshin të vegjëlit po të na shihnin si heqim kanotjerët në mes të kësaj hapësire të bardhë dhe të ftohtë...). Futemi në dyshekun alpin jo për të fjetur, por për të ngrohur teshat e lagura. Pas pak kohe dalim prej tij dhe kënaqemi kur shohim avujt që krijohen. Këtë veprim e përsërisim disa herë. Është mundësia e vetme për “të tharë” rrobat e lagura. Në këtë zonë edhe në verë është e vështirë të ndezësh zjarr se përrreth nuk ka dru. Sa për diellin kemi dhjetë ditë që nuk shohim asnjë rreze të tij.

Gjithnjë e më shumë moti po keqësohet. Kjo shfryrje e egër e natyrës nuk po lodhet. Si i themi natën e mirë njëri-tjetrit, përpiqemi të na zërë gjumi me shpresën të mos dalë parashikimi i motit për të nesërmen. Por më kot. Çdo ditë këtu agon vonë, gjithçka është e mbuluar nga ngjyra bardhë në gri. Mjegulla dhe retë e ulta nuk la lejojnë të shohim ndonjë majë mali, të shohim njëri-tjetrin disa metra larg. Dukuri të natyrës më të disfavorshme se këto për të kryer ngjitje alpinistike nuk ka. Shpatet dhe majat janë të ngarkuara me një shtresë të trashë dëbore të re. Era e ngrohtë e jugut i përmend malet “të lëvizin” shpatullat e tyre dhe të bien orteqet, që marrin gjithçka që u del përpara, duke lënë prapa atë gjëmimin e shurdhët që dëgjohet larg.

I treguam të gjitha këto jo për të shlyer sado pak kurreshtjen e lexuesit, por për të treguar vështirësitë në të cilat u realizuan këtë vit ngjitjet e kualifikuara dimërore nga alpinistët e 9 klubeve sportive. Për të mposhtur vështirësitë e motit dhe pasojat e tij të mundshme në mal, nuk është e mjaftueshme vetëm forca fizike dhe përgatitja teknike. Kryesorja në raste të tilla është përgatitja e lartë shpirtërore, besimi

në forcat e veta, dashuria e pakufishme për shokun, mobilizimi i gjithë energjive, organizimi i përsosur, motivimi dhe bindja në arritjen e qëllimit. Këto karakteristika të mrekullueshme të njeriut të shoqërisë sonë socialiste, Partia i ka skalitur edhe tek alpinistët tanë. Janë këto cilësi që mënjanojnë apatinë, pesimizmin, rastet e papëlqyeshme, dështimin.

Mjegullën e këtyre ditëve “e shpërndamë” nga njohja shumë e mirë e terrenit. Alpinistët tanë janë zotër të vërtetë të maleve. Këtë e vërtetuan veçanërisht në ngjitjet e sivjetme duke punuar në kushtet që u treguam. Në mbremjen e 11 shkurtit pamë se kishim pushtuar 5 maja, njëra më e vështirë se tjetra. Është kënaqësi që midis nesh janë për herë të parë në ngjitjet e kualifikuara dimërore edhe alpinistët e rrethit të Tropojës, një prej të cilëve është djali i fuqishëm dhe gjithnjë buzagaz, gjithnjë i gatshëm për të sakrifikuar për të mirën e grupit, punëtori i kualifikuar në Hydrocentralin “Drita e Partisë” në Fierzë - Nuredin Seci.

* * *

Nesër gdhihet 12 shkurti. Majat që kemi marrë janë një rezultat i mirë për kushtet që ndodhemi. Nuk jemi të kënaqur me këtë arritje. Duam të sulmojmë patjetër edhe Jezercën. Në stinën e dimrit mund të ngjitesh në itinerarë të vështirë në disa maja, por në rast se nuk ngjite në Jezercë të duket se diçka të mungon, jeton me ndjenjën se ke bërë pak pa provuar emocionet e mëdha që jep ngjitja në të. Kemi 4 vjet që vijmë në alpe për ta sulmuar atë nga ana veriore, por nuk kemi mundur, na ka kthyer. A do ta realizojmë këtë vit dëshirën tonë të madhe?...

Zgjohe mi herët. Presim që koha të përmirësohet sado pak. Por është e kotë. Në atë situatë, si komandat i ngjitjeve, pas shumë e shumë lëkundjesh, vendosa që ngjitja të bëhej. Shtabi e miratoi dhe u dha të drejtën alpinistëve të kryeqytetit dhe atyre të Vlorës të ndërmirrinin itinerarin e ri, të papërshtuar ndonjë herë gjatë ditëve të dimrit.

10 alpinistët e “Tomorrit”, “Korabit”, “Valbonës”, “Skënderbeut” dhe “Vllaznisë”, nën drejtimin e Jani Qëndros nisen për të sulmuar majën e Jezercës në drejtimin e njohur. Përqafohem mi më shokët...

Në orën 9 zbresim në Runicë dhe prej andej marrim drejtimin

që të nxjerrë në një qafë të vogël, bri malit të Bojës. Para nesh ngrihet madhështore pamja veriore e Jezercës. Frynë erë e fortë. Kemi dy orë që shtegtojmë. Zbresim pak poshtë të përcaktojmë drejtimin që do të ndjekim. Për të mos humbur lartësinë e fituar dredhojmë nëpër gropat e mëdha të mbuluara me dëborë. Pas një ore e gjysëm ngjitjeje të thepisur kalojmë një tranvers të rrezikshme...Luftojmë me vete për të mposhtur emocionet që ndjen njeriu kur kalon bri humnerave. Vazhdon të fryjë ere e fuqishme. Ecim me shumë kujdes dhe pa folur. Orët kalojnë dhe tani e shohim majën e këtij mali më nga afër. Pushojmë disa minuta rrëzë një shkëmbi që të mbledhim forcat që na kanë mbetur, për sulmin e fundit.

Sa më shumë ngjitemi aq më shumë dëborë i lë vendin dëborës së ngrirë dhe akullit. Duke përdorur njohuritë dhe aftësitë teknike, litarët, kazmën dhe kthetrat, i japim mundësinë Mario Trinkerës të dalë i pari në krye të kësaj pjerrësie marramendëse, rreth 700 m.

Ndodhemi rreth 20 metra larg majës. Ora është 16 e 30 minuta. Na pushton një gëzim i papërshkrueshëm. Detyrohemi të ngulim kazmat alpine për të mos na flakur era e lemerishme. Përpiqemi të fotografojmë me duart gjysëm të ngrira. Sipas zakonisht, në majë lëmë kutinë me letrën ku shkruajmë:

“Pas 7 orësh mbërritëm në majë nga itinerari verior. Jemi të gëzuar për suksesin e arritjes së kësaj fitoreje. Grupi ynë përbëhet nga alpinistët: Mario Trinkera, Viron Velaj, Servet Aliko, Kristaq Gega, Aleksandër Bojaxhi, Eduard Sheldia, Kristaq Korçari, Kujtim Onuzi, Shefki Juma, Kozma Grillo. Zbritjen do ta bëjmë nga ana e Gropave të Bukura”.

Nisëm zbritjen kur po errësohej, megjithëqë i njohim të papriturat e kësaj maje. Përdorim gjithë kujdesin dhe njohuritë. Pas më shumë se një ore, në errësirë të plotë shkelim në gjurmët e shokëve tanë, të cilat na e “ndriçuan” udhën atë natë dimri shumë më mirë se elektrikët e dorës që kishim me vete, që na ndihmuan aq shumë për të mos u sorollatur.

Kur nisëm të ecnim në gjurmët e shokëve u kujtuam se në çantat e vogla të shpinës kishim ushqime dhe ujë, por që nuk na kishte shkuar mendja për to gjatë gjithë ditës.

Pas 12 orëve nga çasti i nisjes, natën vonë mbërrim tek vendi ku kemi kaq ditë që jetojmë, ku shokët na pritnin të shqetësuar...Tufani vazhdon të bëjë të tijën...Përqafohemi dhe gëzohemi (si dinë të gëzohen alpinistët) për suksesin e njëri-tjetrit, për dhuratën tonë

modeste që i bëmë Atdheut në vitin jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit.

Lodhjen në këtë mjedis sikur nuk e ndjejmë...Bisedojmë për të nesërmen...

Kozma Grillo, 27 shkurt

Alpinizmi – sporti i njerëzve të guximshëm

Malet gjithnjë kanë qënë të afërtë dhe të dashur për shqiptarin, por 35 vjet më parë ishin të pakët ata që ëndërronin dhe përpiqeshin t'i shndërronin ato në terrene sportive me përmasa gjigande, ku brezi i ri të ushtronte alpinizmin. Në kohën e regjimeve antipopullorë, në periudhën kur industria ishte në fazën e disa punishteve mesjetare, bujqësia në stadin e parmendës prej druri dhe mbi 80 në 100 vetë nuk dinin të shkruanin dhe të lexonin, nuk mund të kishte zhvillim të sportit në përgjithësi dhe të alpinizmit në veçanti. Nga vitet e shumtë të së kaluarës ne trashëguam një numër të vogël shëtitjesh turistike malore, të ndërmarra nga mësues, nxënës dhe intelektualë përparimtarë. Ndërmjet tyre përmendim me mirënjohje veteranët Avni Zajmi dhe, në mënyrë të veçantë, mjeshtrin e sportit Luigi Shala.

Alpinizmi në vendin tonë lindi dhe u zhvillua në kuptimin e plotë të fjalës në epokën e Partisë. Vitet e parë u shoqëruan me hedhjen e hapave të pasigurtë. Ju kujtohet kur vitet e parë pasëçlirimit niseshin edhe gjatë stinës së dimrit, të veshur me kostumin e atletëve, me vrap për në malin e Dajtit?...Atëherë, alpinist i zoti quhej ai që e përshkonte itinerarin malor në një kohë sa më të shkurtër. Nga vitet 50 nisën të sulmoheshin edhe disa maja malesh. Por themelet e alpinizmit, si sport, u hodhën në korrik të vitit 1956, kur në portën që të nxjerrë në Alpe, në Theth, 16 të rinj zhvilluan zborin e parë kombëtar.

Vitet rrodhën. U rrit mirëqënia materiale dhe kulturore e masave punonjëse. Sporti ynë i dashur nisi të hidhte shtat, të dashurohej nga të rinjtë dhe të rejtat. Shifrat këtu do të ishin të tepërta, por po mjaftohemi vetëm me një fakt. Në fillim të viteve 60 në malin e Dajtit (kështu dhe në malet e tjerë pranë qyteteve) shkonin vetëm disa alpinistë. Këto dhjetë vjetët e fundit, në ditët e pushimit, vërshojnë atje mijëra të rinj dhe të moshuar. Në këtë mënyrë dolëm në një nga veçantitë e alpinizmit tone - ndryshe nga vendet e tjerë, ku më parë është zhvilluar turizmi malor. Në vendin tonë në fillim

lindi alpinizmi dhe pastaj u përhap turizmi malor.

Meqë ra fjala për veçoritë, veçoria kryesore e alpinizmit tonë është se, ndryshe nga vendet e zhvilluara ku ai është "pronë" e të pasurve dhe intelektualëve, alpinizmi ynë është kryesisht sport i punëtorëve. Ata përbëjnë pjesën dërmuese të ekipeve alpinistike, janë drejtues të ekskursioneve dhe të marshimeve turistike malore. Është fakt shumë i bukur dhe me domethënie të madhe, që në veprat tona të mëdha, ka grupe alpinistësh. Kështu ndodh në Fierzë e gjetkë.

Ne e donim shumë sportin tonë, por nuk i njihnim shtigjet që të drejtojnë në majë të malit. Është kjo arsyeja që, deri në fillim të viteve 60, karakteristikë e alpinizmit tonë ishte sulmi i sa më shumë majave, pa i kushtuar vëmendjen kryesore shkallës së vështirësisë së ngjitjeve.

Ndryshe nga llojet e tjerë të sportit, ku matin forcat dy individë apo kundërshtarë, në sportin tonë përballë kemi një kundërshtar shumë më të fuqishëm dhe shumë më të madh. Të mposhtësh vështirësitë, që të shoqërojnë për të mbërritur në majën e malit (si duke u kacavjerrur nëpër shkëmbinj gjatë stinës së verës ashtu dhe duke kaluar mbi dëborë apo akull gjatë stinës së dimrit) duhen forca të mëdha fizike. Dhe këto forca nevojiten jo vetëm për orët që vazhdon aktiviteti sportiv, por për gjithë kohën që alpinistët qëndrojnë në mal, ku ata duhet të përballojnë vështirësitë e terrenit dhe të motit, sigurimin e ujit të pijshëm dhe jetesën. Ja përse ky sport kërkon nga alpinistët forcë të madhe fizike dhe, në të njëjtën kohë, solidaritet, dashuri për shokun. Është sporti që i zhvillon ushtruesit në mënyrë të gjithanshme...

Për të vajtur në mal nuk mjafton vetëm forca fizike, janë të nevojshme dhe të domosdoshme aftësitë teknike dhe forca e madhe morale. Pasioni dhe bindja se duke ushtruar këtë sport njeh Atdheun lindin energji të pashtershme tek alpinistët tanë. Po përsëritim një të vërtetë të njohur: Sa më mirë ta njohësh Atdheun aq më shumë e do atë. Nuk ka asnjë sport që të edukojë si alpinizmi, që t'i njohë të rinjtë dhe të rejat me bukuritë përrallore të Atdheut, me vendet ku janë shkruar faqet e lavdishme të historisë sonë, me shndërrimet e mëdha të epokës së Partisë.

Si sport që ndikon drejtpërdrejt në përgatitjen fizike dhe ushtarake të brezit të ri, Partia ka treguar kujdes të veçantë, ka krijuar kushte të mrekullueshme për zhvillimin e alpinizmit. Më 1957 në vendin tonë kishim vetëm një qëndër alpinistësh - Universitetin e

Tiranës, sot kemi disa ekipe cilësorë. Le të përmendim midis tyre "Partizanin", "Tomorrin", "Flamurtarin", "17 Nëntorin", "Korabin", "Skënderbeun", etj. Vitet e fundit është punuar mirë për përhapjen e këtij sporti në rrethet e Veriut, me sukses po debutojnë alpinistët e Tropojës, Pukës, e kështu me radhë.

Radhët e alpinistëve po rriten nga dita në ditë. Kanë nisur veprimtarinë e tyre ekipet e të rinjve dhe të pionierve, po bëhen përpjekje për hapjen e klasave sportive. Arritjet për sa i takon masivizimit të alpinizmit janë të konsiderueshme, por synimet tona janë shumë më të mëdha për t'iu përgjigjur kujdesit që tregohet, kushteve që janë krijuar.

Nga alpinistët tanë janë realizuar me sukses ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë. Le të kujtojmë midis tyre ngjitjen në murin shkëmbor të faqes jugore të malit të Arapit, marrjen e Jezercës nga ana veriore në stinën e dimrit, faqen shkëmbore të Papingut e kështu me radhë. Do të duhej një listë e gjatë për t'u njohur me alpinistët tanë të talentuar, por po mjaftohemi duke përmendur një për çdo ekip: Azem Hyka, Viron Velaj, Maridon Hito, Stefan Kule, Shefki Juma, Qemal Hakorja, Koço Ziso, Nuredin Seci, Gëzim Oruçi, etj.

Alpinistët tanë kanë mposhtur çdo majë mali të truallit tonë me lartësi mbi 1.800 m. Janë dalluar edhe në aktivitetet e ndryshme ndërkombëtare të zhvilluara në malet tona apo jashtë kufijve. Në rritjen cilësore të alpinizmit kanë kontribuar sidomos mjeshtrit e merituar të sportit: Minella Kapo, Petraq Kule, Vasil Stambuli dhe Vangjel Melengu....

Kozma Grillo, 3 korrik

Heshtja e madhe nuk i duron fjalët e tepërta

Atje, kur zbret nga makina dhe përshëndete me shaljanët e parë që takon, është vendosur një pllakë përkujtimore ku lexohet: "Për të zbatuar urdhërin luftarak të Shtabit të Përgjithshëm, më 2 Nëntor 1943, forcat e batalionit partizan "Perlat Rexhepi" nisën marshimin nëpër Bjeshkët e Namuna për në Malësi të Gjakovës, duke kapërcyer vështirësi të panumërta të natyrës dhe rrethimin e forcave të reaksionit".

Qysh nga ajo ditë kanë kaluar 36 vjet. Ashtu si në gjithë Atdheun

tonë, ndryshime të mëdha kanë ndodhur edhe në jetën e këtyre malësorëve. Dëshmitarë të heshtur të këtyre shndërrimeve janë edhe malet, majat më të larta të Alpeve tona. 26 alpinistët më të mirë të vendit, më 17 korrik, morën rrugën nga kaluan partizanët e atij batalioni. Në vitin jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, alpinistët kujtojnë më mirënjohje të thellë epopenë e partizanëve trima, jetojnë e ndiejnë nga afër kujdesin e veçantë të Partisë dhe të shokut Enver edhe për lulëzimin e sportit tonë popullor. Erdhën ata në këtë terren me parmasa gjigande, ku, si përherë, nuk ka spektatorë, për t'i dhuruar Atdheut ngjitje të kategorisë së lartë të vështirësisë, për të demonstruar përgatitjen e tyre të gjithanshme psikologjike, teknike dhe fizike.

Çadrat i ngritëm matamë qafës së Pejës, tek Shehu i Bardhë. Në dy nga dhjetë ditët që jetuam atje, provuam të ftohtët e netëve të dimrit, jetuam nën një mjegull të dendur ku nuk shihje as dy metra larg. Ngjitje shkëmbore të shkallës së lartë të vështirësisë nuk mund të ndërmerren në mot të tillë. Por edhe "duarkryq" nuk mund të rrinim. Është kjo arsyeja që, nëpërmjet itinerarëve që ndërmarrim gjatë stinës së dimrit, sulmuam dhe morëm Jezercën, Papllugën, Shtogun dhe Prozhmin. Ky ishte një përjashtim (për ngjitjet e kualifikuara verore) që kishte hijeshinë e vet.

Dy ditët që nuk patëm "rendiment" të lartë, na mobilizuan më tepër, na bënë të shfrytëzojmë ende më mirë ditët që na kishin mbetur... Kryesisht punuam në malin e Kolajve, ku në dy itinerarë të tij kryen ngjitjet e kontrolluara disa alpinistë, për të plotësuar në këtë mënyrë një nga kërkesat për të merituar titullin mjeshtër sporti.

Herët në mëngjes, alpinistët e "Partizanit", "Tomorrit", "17 Nëntorit", "Korabit", "Studentit", "Flamurtarit", "Vllaznisë", "Valbonës", "Skënderbeut" dhe "Labinotit", merrnin pajimet dhe niseshin për t'u kacavjerrur në shkëmb. Niseshim të veshur trashë dhe ktheheshim pa perënduar dielli me kanotjere. Ç'ndryshim i madh i temperaturës brenda 24 orëve! Secila ngjitje vazhdoi nga 6 në 8 orë. Në fitimin e kohës ndikoi pozitivisht fakti që shumica e ngjitjeve u realizuan duke punuar në të njëjtin litar jo tre, por dy alpinistë. Ky është një tregues që flet për rritjen e mjeshtërisë sportive të alpinistëve tanë.

- Sigurimi, gati?...
- Gati!...
- Po nisem!...
- Të ruaj!...
- Tërhiq litar!..

Këto fjalë dhe tingujt e çekiçëve që ngulin në shkëmb gozhdët alpine përbëjnë të vetmen “melodi” që na shoqëron gjatë orëve të kacavjerrjes, të cilat ngërthejnë emocionet e fuqishme, që shoqërojnë alpinistët. Çdo fjalë tjetër, si: “Dëgjo këtu”, “mos u mërzit”, “bukur, shumë bukur”, etj. kanë një domethënie të përbashkët - diçka nuk shkon mirë me shokun që është duke u kacavjerrur. Megjithatë shoku nuk është më shumë se 30-40 metra larg teje, ti nuk e sheh përherë atë, por e “ndjen” nëpërmjet litarit. Nga mënyra si lëviz litari nëpër duart dhe supet e tua, ti e kupton gjendjen e tij dhe pret me nerva të tendosura se mos litari rrëshqet me shpejtësi nga duart. Kjo dukuri tregon se shoku ka rrëshqitur, është shkëputur nga shkëmbi! Është një ngjarje që në mundësi mbart kob. Të gjithëve u ka ndodhur. Sa metra poshtë do të bjerë? Kjo varet nga përvoja dhe aftësitë e tij, nga mënyra si i ka ngulur dhe sa gozhdë ka ngulur. Por, kryesisht mënjanimi i fatkeqësive varet nga shoku (ose shokët) që janë të lidhur në të njëjtin litar. Kalojnë pak çaste dhe ai qëndron në mes të shkëmbit si një pendul i një sahati të madh. Përmendet, mbledh forcat, kërkon leje nga shoku të rinisë ngjitjen, pa i shkuar në mendje se mund të jetë gërvishur. (Jo më kot thonë që alpinistët e kanë lëkurën të trashë). Mund t’ju duket e pabesueshme, por e vërteta është se emocionet më të mëdha nuk i përjeton ai që rrëshqet, por shoku i tij, ai që e siguron me anë të litarit. Në fund të fundit varet nga ai fati atij që rrëshqet, vendos ai që shoku të mos bjerë në greminë. Jo vetëm kaq. Edhe fati i këtij varet nga aftësia vetjake për të mos lejuar që litari të lëvizë. Është ky shpjegimi që në raste fatkeqësie, për shkak të gabimit njerëzor, nuk aksidentohet një, por të gjithë ata që janë të lidhur në të njëjtin litar.

Edhe në raste të tilla alpinistët janë të kursyer në të folur. Si duket, heshtja e madhe që i rrethon nuk i duron fjalët e tepërta, ata që “shesin mend”, meskinët, njerëzit me shpirt të vogël. Shakatë dhe rromuzet bëhen tek çadrat. Alpinistët dallohen për humorin e tyre...

Bashkë me mjeshterin e merituar Petraç Kule, ndjekim nga afër dhe me vëmendje kacavjerrjet e Koço Zisos dhe të Viron Velajt. Ata po bëjnë itinerarin I-4. Me këtë ngjitje ata plotësojnë kërkesat për të fituar titullin mjeshtër sporti. Pas disa orësh, ulemi në një gur të madh, bri një grope me dëborë të përjetshme, dhe bisedojmë me punëtorin korçar Koço Ziso...

“...Çfarë të them unë, bre. Ka 16 vjet që ngjitem në male. Qenka pasion i madh ky alpinizmi...E nisa me shëtitje turistike, që aq shumë i duan bashkëqytetarët e mi. Kur mora vesh që ata të “Studentit”

ishin ngjitur në Gurin e Capit (më 1962) dhe kishin lënë një shënjë që e valëvizte era dhe dukej nga larg, se si më erdhi. Nisa ta ushtroj alpinizmin më 1963. Më 1966, bashkë me Gaqon dhe Koço Qafzezin, si bëmë edhe disa gozhdë të forta, u ngjitëm në Gurin e Capit. Është një ngjitje shumë e bukur...Alpinistëve të Korçës dhe mua si trajner na mbetet ende shumë për të bërë, që të përlligjim kushtet e mrekullueshme që na ka krijuar Partia”.

Pas shumë e shumë ngjitjeve, Koço Ziso plotësoi kërkesat për të merituar titullin mjeshtër sporti. Urime Koço! Ai është ndër më të moshuarit në këto ngjitje, por gjithmonë i gatshëm, i përgatitur dhe me “këmbë të lehta”.

...Është kënaqësi për ne alpinistët, që shokët tanë: Kujtim Onuzi, Kristaq Korçari, Qemal Hakorja, Jani Qendro dhe Vladimir Memisha plotësuan ngjitjet për të fituar titullin mjeshtër sporti. Fjalë të mira duhen thënë edhe për alpinistët Nuredin Seci, Besnik Kica, Romeo Maxhari, etj.

Itinerarin më të bukur dhe më të vështirë e përshkoi edhe këtë vit dyshja: Azem Hyka dhe Maridon Hito, po në majën e Arapit.

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 14 gusht



1980

Dhjetë ditë në Alpe

Përfunduan ngjitjet e kualifikuara dimërore në Alpe për vitin 1980. Morën pjesë alpinistët më të mirë të klubeve sportive dhe rretheve. Po shkëpusim disa shënime të mbajtura nga mjeshtri i sportit Taxhedin Shehu për këto ngjitje.

Ishim 35 alpinistë. Na u caktua detyra për të kapur, siç themi ne alpinistët, majat më të larta në zonën e Valbonës. E dinim se vështirësitë do të ishin të shumta. Kishte rënë dëborë e madhe...U nisëm me besim të patundur në forcat tona, falë shpirtit të lartë të sakrificës, vullnetit të fortë, qëndrueshmërisë fizike dhe, mbi të gjitha, solidaritetit e ndihmës vëllazërore, që i karakterizon alpinistët në çdo hap, dhe aq më tepër në ngjitje të tilla të vështirësisë së lartë.

5 shkurt. Toga jonë kishte në përbërje alpinistë nga klube të ndryshëm. Në krye qëndronte komandati Kujtim Onuzi. Ishim rreshtuar në atë mëngjes të ftohtë gati për nisje. Ishte ora 4 dhe njëritjetrin e shihnim falë ndriçimit të hënës.

U nisëm drejt Bunit të Valbonës. Çarjen e dëborës e nisi alpinisti më i ri i togës - Gëzimi. Për të kjo është një provë serioze. Dikush e "ngacmon" sa për të hapur një bisedë...Tek Buni i Valbonës arritëm si pa e kuptuar. Pasi i kishim thënë disa herë suferinës së mëngjesit "ndal", tani ishim të detyruar të ndaleshim ne. Por vetëm nga urdhëri i komandatit, sepse disiplina e alpinistëve kështu e kërkon. Ndalemi të pushojmë disa minuta.

Sa të ëmbla janë këto pushime. Alpinisti e ka mendjen dhe vështrimin larg...Nisemi për në malin e Valit. Orteqet prishin qetësinë e maleve. Shpejtojmë ritmin për të mos na kapur ora kur orteqet nisin "lojërat" e tyre. Mbërrijmë në majë. Objektivi ynë i parë u realizua.

Pas Valit i drejtohemi majës së Alisë, që përbën dhe objektivin kryesor. Ajo është krejt e veshur me akull, veçanërisht tranversa që të

nxjerrë në maj. Duhej bërë zgjedhja e saktë për të rrezikuar sa më pak...Me treshe e përshkojmë transversën duke përdorur të gjithë teknikën alpinistike. Në orën 9 toga ndodhet fitimtare në majën e Alisë.

Maja 8 Marsi. Është shkruar edhe herë të tjera për të. Ndodhet midis Alisë dhe Jezercës. Vështirësitë për t'u ngjitur në të janë të shumta. Përsëri ecim me treshe me siguri. Në orën 13, alpinistët, me atë gëzim të ligshëm, ashtu siç e ndiejnë thellë ata, lëshuan thirrjen e fitores...

7 shkurt. Ora 3 e mëngjesit. Të gjithë ishim gati t'i drejtoheshim një zone që rrihej për herë të parë nga një itinerar i ri, tepër i vështirë. Fjala ishte për një ngjitje me pjerrësi rreth 80 gradë, në anën jug-lindore të Jezercës...

...Kemi ecur disa orë dhe tani që çeli dita jemi pranë majës. Reshiti u kërkoi shokëve të printe i pari. Ia plotësuam dëshirën, se e dinim që ai para tre vjetësh nuk pati mundësi të vazhdonte rrugën me shokët drejt majës, sepse pësoi një aksident të rëndë. E kush nuk u kujdes për të, e gjithë shoqëria. Dhe ai jo vetëm që erdhi sërish në jetë, por ja tani, përsëri shkon me guxim drejt kësaj maje.

Ora 9. E ka fjalën ndërlihdja. Njoftojmë me gëzim se maja më e lartë në pjesën jug-lindore të Jezercës u pushtua. Jemi 12 vetë : Kujtim Onuzi, Skënder Serani, Pëllumb Llabonishti e Spiro Ciko të "Partizanit", Gëzim Laçej, Sadik Tafiliku dhe Ymer Shkjau të "Tërbunit", Qemal Hakorja, Taxhedin Shehu, Rushit Reçi, Adil Manga dhe Zabit Tusha të "Korabit".

15 shkurt. Përsëri kemi udhëtim. Këtë herë drejt qyteteve tona, ku na presin familjet, shokët. Objektivat i realizuam plotësisht. Alpinistët, në këto ditë dimri të ftohta, pushtuan 9 maja, midis tyre edhe majat e Rragamit, Krasniqes, Jezercën e Vogël.

19 shkurt

Kështu nisën shtegtimin e gjatë

Belbëzimet në sportin e alpinizmit i kaluan në klubet sportive. Shumica e tyre i lanë pemët e lulëzuara, por më 5 mars u befasuan me malet që rrethojnë Bogën e mbuluar me dëborë. Çadrat i ngritën tek kroi i fshatit. 50 çadrat alpine shumëngjyrëshe, në atë sfond të bardhë, e hijeshuan më shumë këtë fshat të bukur malor.

Janë 102 alpinistë të kategorisë së 3-të dhe të 2-të, të ardhur nga

15 rrethe dhe klube sportive. Më i riu ndër ta është Misha i "Flamurtarit". Të gjithë i kanë vënë vetes si synim të bëhen alpinistë të kualifikuar, të ngjiten nesër në majat më të larta të Alpeve. Rruga që të shpie në to kalon nëpër Shtegun e Dhënëve. Ata i ngrenë çadrat në afërsi të këtij shtegu, ku përgatiten më mirë fizikisht e teknikisht, "miqësohen" me male më të ulët dhe relativisht më të lehtë për t'u ngjitur.

Malësorët i pritën me dashuri, ndërsa dukuritë atmosferike i vunë qysh natën e dytë para një prove të vështirë. Stuhisë dhe rreshjeve të fuqishme nuk u rezistuan shumica e çadrave... Megjithëse e kaluan të lagur atë natë të ftohtë (këtu pranvera është ende larg), të nesërmen u nisën për në mal. E kaluan atë shfryrje të egër të natyrës duke hedhur romuze e duke bërë shaka - ato shakatë karakteristike për këtë moshë dhe njerëzit që ushtrojnë këtë sport të bukur.

Takimin e parë me ta e bëra kur alpinisti Stefan Kule sapo ishte kthyer me togën që drejton nga maja e Bridashit dhe u ofronte të gjithëve karamete.

- Urime, Fani!

Kishte ditëlindjen. Është djali i mjeshtrit të merituar të Sportit Petraq Kule, që në këtë aktivitet kombëtar i është ngarkuar detyra e komandatit të shtabit të ngjitjeve. Fani është sot në moshën që kishte Petraqi kur u njoha me të në korrikun e vitit 1956 dhe mësuam bashkë si të mbajmë kazmën alpine dhe si t'i duam malet. Ishte zbori i parë që zhvillohej në vendin tonë. Brenda këtyre 24 vjetëve Petraqi realizoi ngjitje të bukura dhe përgatiti mjaft alpinistë, midis tyre dhe të birin. Në moshën që ka Fani sot, unë e Petraqi ishim fillestarë në këtë sport, ndërsa ai është alpinist i kualifikuar. Kjo na gëzon. Është kënaqësi e veçantë për ne, alpinistët e kualifikuar, t'i përgatisim sa më mirë alpinistët e rinj. Kjo për ne është më e rëndësishme se edhe ndërmarrja e një itinerari të ri të kategorisë së lartë të vështirësisë.

Më shkëput nga këto mendime ajo zhurma e mbytur, që të kujton jehonën e breshërive të largëta të një artilerie të fuqishme. Është jehona e orteqeve, që po bien dendur këto ditë. Ata që kanë ardhur për herë të parë në një lartësi të tillë dëgjojnë me vëmendje dhe kureshtje të veçantë, përpiqen të imagjinojnë si malet "lëvizin" shpatullat për të hedhur poshtë peshën e madhe.

Çdo mëngjes, në kolonë për një, të 102 pjesëmarrësit, të ndarë në toga, nisen për në maja të ndryshme, duke patur në krye një alpinist

të kualifikuar. Janë të pajisur shumë më mirë se ne kur ishim në moshën e tyre dhe hidhnim të drojtur hapat e parë në këtë sport. Rrugëve të fshatit përshëndeten me malësorët, që nisen për në punë, dhe dëgjojnë urimin :

- Ardhshi shëndoshë! Urdhëroni nga shtëpia!

Kthehen pasdite duke jetuar me kënaqësinë që shkakton lodhja e gjymtyrëve dhe ngarkesa emocionale që kanë përjetuar. I raportojnë komandatit për suksesin, përqafohen me shokët që kanë mbërritur më parë dhe nisin “punët e shtëpisë”.

Të shkosh në Bogë dhe të mos ngjitesh në majën e Çardakut, maja më lartë e kësaj zone, të duket se nuk ke bërë sa duhet. Më të përgatiturit, rreth 20 vetë, do ta “msyjnë”. Megjithëqë nuk kisha vajtur si alpinist, më “hanin brirët” për të vajtur me ata. Pajisjet m’i afruan disa nga ata djem të rinj.

U nisëm. Kishin kaluar shumë vite, por rrugën e mbaja mend. Dëborë që humbon, sa më shumë që fitojmë lartësi, i lë vendin dëborës së ngrirë. Ngjitja në këtë majë, ashtu si në çdo ngjitje të vështirë, kërkon të vësh në përdorim forcat dhe dijet. Orët kalojnë...Aty nga ora 12 mbërritëm në atë qafën e vogël nga ku të jepet e drejta të ngjitesh në majë. Dëborë vazhdon të bjerë. Erdhi çasti që duhet të përdorim kthetrat dhe litarët kolektivë.

Nuk qëndrojmë “bash në qafë” jo vetëm se frynë erë e ftohtë, por edhe se mjegulla dhe retë e ulta nuk të lejojnë të shohësh asgjë. Nisin përpjekjet e mëdha për të kaluar atë ullukun shumë të pjerrët ku, në mënyrë të veçantë të rinjtë, luftojnë për të mposhtur emocionet që krijohen kur kalon në vende shumë të pjerrëta, bri humnerave. Me muskuj e nerva të tendosur, fitojmë lartësinë hap pas hapi. Shoh me vëmendje si punojnë ata që kam përpara...

Pas një ore na erdhi radha neve. Kam pranë mjekun V. Koxhaku, H. Duro, Uranin, Ilirin, Mondin. Me të njëjtin kujdes punuam edhe si kaluam ullukun, mbi faqen e ngrirë që të nxirrte në majë. Ja, më në fund, edhe maja!...Siç e do zakoni, shtrëngojmë dorën njëri-tjetrit (do të ishte kortezi kalorsiake të hiqnim dorezat që janë thujse të ngrira), marrim shenjën që kanë lënë shokët para nesh dhe lëmë tonën, japim brohoritjen tradicionale. Na vjen keq që nuk mundëm të soditnim asgjë. Dëborë vazhdon të bjerë. Nisim zbritjen, ku mundësitë për ndonjë rast “të papëlqyeshëm” janë më të shumta se gjatë ngjitjes.

- Kujdes, herë pas here shkundni kthetrat me kazmë, se mbushen

dhëmbëzat e tyre me dëborë dhe rrëshqet më shumë se pa to, dëgjohet këshilla e ndonjë alpinisti më me përvojë.

Zbresim duke respektuar të gjitha kërkesat teknike. Në qafë nuk zgjidhim as litarët dhe nuk heqim as kthetrat se frynë erë e fortë. Më poshtë, si lirohemi nga këto pajime, ritmi i zbritjes bëhet mjaft i shpehtë...Dëbora vazhdon të bjerë, por sa më shumë i afrohemi fshatit ajo nis e rrallohet...

Të nesërmen u bë një takim i bukur i nxënësve e mësuesve të ciklit të lartë të shkollës 8-vjeçare të fshatit me alpinistët e "Flamurtarit" dhe të "Korabit". Shoh si demonstrojnë alpinistët dhe kureshtjen e entuziazmin e madh të këtyre malësorëve të vegjël dhe mendja më shkon vite më parë...Në këtë fshat të bukur vinin pasanikët dhe tregtarët e Shkodrës për të kaluar "zhegun e verës". Ishte koha kur gjyshërit e këtyre vogëlushve, të qeshur dhe të veshur për bukuri, nuk mbushnin as barkun me bukë...Shkolla e parë në këtë fshat u hap pas Çlirimit.

- Mësojnë mirë. Janë të zellshëm dhe e duan shumë sportin, - më thonë mësuesit e shkollës.

- Sa mirë që alpinistët vunë edhe nxënësit të bëjnë "kalimin teleferik".

- Tonini, ky që po lidhet me konop, është në klasën e 8-të. E do shumë zanatin e blegtorit. Mendoj se do të bëhet alpinist shumë i mirë. Sa mirë do të ishte që edhe në fshatin tonë të kishte një grup alpinistësh!

...Ditët rodhën. U bë edhe analiza e ngjitjeve, e 15 ngjitjeve të realizuara. U shpallën edhe të dalluarit. Me ata dhe me të tjerë do të njiheni nga afër nëpërmjet shkrimeve në vitet e ardhshëm...

Kozma Grillo, 8 prill

Pas kthimit nga Alpet

Më 11 korrik përfunduan ngjitjet verore të kategorisë së dytë e të tretë. Lidhur me këtë aktivitet biseduam me njërin nga drejtuesit e tij, mjeshtrin e sportit Azem Hyka, i cili na tha :

- Ngjitjet e sivjetme patën një karakteristikë të veçantë. Për herë të parë në historikun e ngjitjeve tona, drejt Alpeve vërshuan mbi 120 alpinistë të kategorisë së dytë e të tretë. Gjithashtu, si rrallë herë për këtë sezon, në zonën e ngjitjeve pati shumë dëborë. Për këto, ngjitjet

i organizuam të ndarë në dy grupe. Mbi 80 alpinistë punuan në zonën e Shtegut të Dhënëve, ndërsa rreth 40 të tjerë në zonën e Qafës së Pejës. U realizuan mbi 720 ngjitje të kategorive të ndryshme të vështirësisë, prej të cilave mbi 200 të mesme, po kaq gjysëm të larta dhe rreth 30 të larta.

Sipas llogaritjeve paraprake del se alpinistët e mbyllën këtë aktivitet me një mesatare vështirësie 4,1. Kjo tregon se cilësia po vjen në rritje dhe se nga kategoritë e para kërkohet më shumë. Ata së shpejti fillojnë aktivitetin e tyre, prandaj kjo duhet të jetë nxitje për ta.

Në këtë aktivitet u dalluan mjaft ekipe. "Partizani" e "Korabi" patën koeficientin më të lartë të vështirësisë : 4,5. "Kastrioti" e "Përparimi" realizuan respektivisht 54 e 49 ngjitje. Për rezultate të mira u dalluan edhe "Tërbuni", "17 Nëntori", "5 Shtatori", "Tomorri" etj. Si individë u dalluan : Kule i "Tomorrit", Sade e Gashi të "Partizanit", Tafili i "Flamurtarit", Çollaku i "Skënderbeut", Myftaraj i "5 Shtatorit", Uka i "Studentit", Çafka i "24 Majit", Doçi i "Valbonës", Tema i "Kastriotit", Tapia i "17 Nëntorit", Domi i "Përparimit", Kovaçi i "Luftëtarit", Laçi i "Tërbunit", etj. Gjithashtu, u cilësua si ngjitja më e mirë ajo e Gashit e Hykës të "Partizanit" si dhe për punë të qetë në shkëmb u dallua dyshja e Tiranës, me në krye Tapinë dhe ajo e "Luftëtarit" me Kovaçin si drejtues.

Me gjithë masën e madhe të alpinistëve, shtabet përkatëse nuk e patën të vështirë drejtimin e aktivitetit. Organizimi i mirë dhe, më kryesorja, predispozicioni i të gjithëve për t'u kacavjerrë në shkëmb me kujdes e cilësi, bënë të mundur që ky aktivitet të përfundonte me sukses të plotë. Megjithatë, duhet theksuar (kjo është detyrë e të gjithë trajnerëve) se përgatitja psikologjike akoma nuk është në nivelin e duhur. Fakti është se, pothuajse masa më e madhe e të rinjve që vinin për herë të parë në Alpe, punën në shkëmb e bënë në tension. Kjo tregon se pak punohet në klube e rrethe dhe se duhet që të rinjtë t'i freskojnë akoma më shumë ekipet e të rriturve.

Sporti i alpinizmit gjithnjë e më shumë po bëhet pronë e rinisë, sepse ai po vlerësohet drejt si sport i karakterit kalitës nga ata që e ushtrojnë dhe nga disa komitete fizkulture në rrethe. Por lipset që mjaft rrethe, si Mati, Lezha, Mirdita, Tepelena, Pogradeci dhe Kolonja të marrin shembull nga Puka, Kruja, Skrapari, etj.

Ngjitje që na mësuan shtigje të reja

Kushdo që niset për në Valbonë jeton me mendimin se do të ndodhet midis kaltërsisë së atij lumi të rrëmbyeshëm malor dhe kaltërsisë së qiellit. Lamë prapa qëndrën e rrethit të Tropojës, ndaluan mbi urën, ku vite më parë qëndroi disa çaste shoku Enver, kaluan Dragobinë dhe, më tutje vendin ku ra heroikisht trimi i vegjëlisë - Bajram Curri.

Ka vite që nuk kemi ardhur gjatë verës në Valbonë. Brenda këtyre 10-15 vjetëve ajo ka ndryshuar shumë, është bërë më e bukur dhe më e begatë. Takohemi me malësorë dhe kufitarë të njohur. Bëjmë takimin e parë me alpinistët e kategorive të larta, jepen porositë e fundit dhe, të ndarë në tri toga (nën drejtimin e Taxhedin Shehut, Nuredin Secit e Gëzim Oruçit) nisemi për në vendet e caktuara. Këtë vit do të qëndrojmë në tri bune : në atë të Ziçit, Ibrahimit dhe të Valbonës...Pas disa orësh nisëm të ngremë "shtëpitë" tona, po ato që ngremë në dimër.

Më 18 korrik, nisi të jehojë melodia aq e dashur për ne : zhurma e gozhdëve alpine, që futen thellë në të plasurat e vogla të pareteve shkëmborë, nëpër të cilët gjarpëron litari kolektiv. Ishte një nisëm me ritëm pak të ulët, jo të zakonshëm për ditët e verës. I tillë ishte moti i atyre ditëve të kësaj vere. I vetmi urim që u bëjnë para nisjes alpinistëve në gjithë botën është :

- Kohë të mirë!

Alpinistët e duan motin e mirë veçanërisht gjatë stinës së verës, sepse nuk është e këndshme të kacavjerresh orë të tëra në paretin shkëmbor të mbështjellë me mjegull, kur të ftohtit nis e të futet në palcë. Të gjitha këto të pengojnë të demonstrosht teknikën e lartë të sportit të njerëzve të guximshëm.

Koha nuk na mbajti. Qëndruam 10 ditë në zonën e Valbonës dhe nuk e pamë pothuajse asnjëherë majën më të lartë të Alpeve, Jezercën, Majën e Rinisë, se ajo ishte gjithnjë mbuluar me mjegull (vendasit i thonë jezer mjegullës) ose nga retë. Tri ditë ra shi.

E kujt i shkante ndërmend se Valbona do të na befasonte në këtë mënyrë!

Alpinistët që ishin tek buni i Ibrahimit (ku punoi edhe mjeshtri i merituar, komisari i këtyre ngjitjeve, Vasil Stambuli) kishin si qëllim

të studionin majën e Thatë (është maja që ka patur mbi vete më pak alpinistë se çdo majë tjetër) dhe Kollatën. Ata që u vendosën tek buni i Valbonës (ku punoi edhe mjeshtri i sportit, zëvendëskomandati i këtyre ngjitjeve, Aleksandër Bojaxhi) kishin “punë” me majën e Alisë dhe të Valit. Duke qënë në këtë pellg, ata nuk përtuan t’i bënë një “vizitë” edhe Papllugës, e cila të krijon përshtypjen se është zënë dorëpërdore me Jezercën.

Duke jetuar dhjetë ditë me alpinistët që ngritën çadrat tek buni i Ziçit, po tregoj për një nga ditët e punës së tyre.

Më 24 korrik u zgjuam më herët, morëm pajisjet teknike dhe u nisëm për në Grykën e Hapur. Bën ftohtë, por rruga e gjatë në atë të përpjetë na djersit. Pa u mbushur tri orë rrugë, mbërrim tek Gropa e Helmit - gropa e fundit në rrëzë të malit. Qëndrojmë pranë një shkëmbi, ku nuk na zë era, mbledhim disa kërthija me të cilat ndezim zjarrin për të tharë djersën dhe për të larguar të ftohtin nga trupi.

Alpinistët e tropojës zgjodhën një itinerar që niste me kalimin e një bunari (kështu e quajnë vendasit pusin). Në skajin tjetër punuan me entuziazëm alpinistët vlonjatë. Në një itinerar interesant u futën edhe alpinistët e Gjirokastrës (A. Hoxha dhe V. Kore). Kështu, pas një “pushimi” të gjatë “Luftëtari” nisi të aktivizohet me këto ngjitje. Të gjithë demonstrojnë përgatitjen fizike, aftësitë teknike, dashurinë e madhe për shokun, forcën e madhe për të mposhtur pjerrësinë dhe vështirësitë e shumta.

Heshtjen e madhe të këtij mjedisi, ku zotëron ngjyra gri dhe e bardhë, e prish herë pas here shpërthimet e minave të punëtorëve, që çajnë rrugën nëpër shtigje të ngushta e të pjerrët, për të shfrytëzuar pasuritë e natyrës. Jehona e këtyre shpërthimeve vazhdon për një kohë të gjatë, duke u përcjellë nga qafa në qafë.

Dëgjoj atë zhurmë të mbytur e padashur më kujtohen fjalët e një miku tim, që duke qeshur më tha : “Ka ardhur koha për t’u bërë alpinistëve një karrikaturë miqësore me këtë ide : Përpara një kamion duke iu ngjitur malit në një shpat të pjerrët, pas tij ecin alpinistët me çantat në shpinë...”.

...Ngjitja vazhdon, por maja e mbuluar me atë shtresë të trashë mjergulle nuk duket. Mbas tre orësh, alpinistët e tre litarëve mbërrijnë në majë, ku shohin pllakën e vendosur nga shokët e tyre në dimrin e vitit 1969 : “Ismet Sali Bruçaj - Hero i Punës Socialiste”.

Të 38 alpinistët e kategorive të larta, që u aktivizuan në ngjitjet

e kësaj vere, u ngjitën në majat e maleve të Alisë, Valit, Kollatës, Rosit, etj. Secila nga këto maja u mposht në më shumë se tre itinerarë të ndryshëm. U rrëzua mendimi se për të hipur në majën e Thatë ka vetëm një apo dy shtigje.

Çdo pjesëtar në këtë veprimtari kombëtare dha kontributin e tij për të realizuar detyrën që na ishte ngarkuar. Duke bërë ngjitje shkëmbore, të bëhej studimi i majave më të larta të zonës së Valbonës. Të gjithë punuan me sedër sportive dhe entuziazëm rinor për të mposhtur lartësitë, kohën jo të përshtatshme, telashet që shkakton shkëmbi i thërmuar, si dhe dëborën e madhe që ruajnë malet këtë verë.

Mendimi i përbashkët i 38 aktorëve të kësaj veprimtarie, shprehur në analizën e ngjitjeve që u zhvillua më 27 korrik, ishte se zona e Valbonës nuk ka parë asnjëherë kaq shumë alpinistë në stinën e verës për të bërë ngjitje të kualifikuara shkëmbore...Ndër më të dalluarit e këtij aktiviteti kombëtar, ku mësuam kaq shtigje të reja, përmendim : S. Tafilakun, R. Reçin, E. Sheldian, R. Maxharin, I. Beun, B. Picin, T. Byçykun, V. Velajn, V. Koren, J. Belushin, etj.

Më datën 28 korrik u nisëm për në Bajram Curri, mbasi përcollëm për në majën e Kollatës tre shokët tanë : A. Qirjo, K. Gega dhe G. Oruçi. Mësuam se ata bënë një ngjitje të bukur dhe të vështirë jashtë programit të këtij aktiviteti, për të vënë "në vend" diçka që nuk rodhi si duhet gjatë ngjitjeve dimërore që u zhvilluan para pesë muajve.

Kozma Grillo, mjeshtër sporti, 5 gusht

Për guximtarët e lartësive

Para pak ditësh, në klubin sportiv "Skënderbeu" erdhi një letër e nënshkruar nga katër barinj, punonjës të sektorit Shashicë të NB "Rinia" të rrethit të Vlorës. Ndërmjet të tjerave, në letër thuhet : "Jemi barinj të rrethit të Vlorës. Në periudhën qershor-tetor shtegtojmë me tufat tona në rrethin e Skraparit. Duke qënë lart në malet e këtij rrethi, në majën e Faqekuqit na ra në sy një vazo qelqi. Mbi të lexuam të shkruajtur : "Alpinistët". E hapëm vazon dhe pamë një shënim të lënë nga alpinistët e klubit sportiv "Skënderbeu", të cilët ishin ngjitur në këtë majë në kuadrin e vitit jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Shënimi mbante datën 14.02.1979. Kjo na bëri përshtypje

të madhe, sepse kemi dëgjuar që, në këto qafa, dikur kanë humbur njerëz, të cilët janë gjetur kur ka shkrirë dëborë, në pranverë.

Një bari i vjetër, që ishte me ne, pasi e dëgjoji përmbajtjen e letrës, na porositi :

- Dëgjoni, more djem! Për mua është një kureshtje e madhe të mësoj të vërtetën. Çuditë se si kanë mundur ta kryejnë këtë ngjitje në ato ditë të vështira, prandaj t'u dërgojmë një letër atyre. Nuk di përse më lindi për ta një respekt i madh. Le t'u urojmë suksese alpinistëve të këtij klubi për të ardhshmen".

U takuam me kryetarën e grupit, alpinistin Koço Ziso, që ka drejtuar ngjitjen në këtë datë. Ai na tha : "Gjatë vitit jubilar alpinistët korçarë zhvilluan ngjitje të vështira në majat e Ostrovicës, duke realizuar objektivat e tyre. Ngjitja në majën e Faqekuqit është bërë në kushte shumë të vështira atmosferike, në borë, suferinë, në një temperaturë minus 13 gradë celsius. Grupi i alpinistëve i përbërë nga gjashtë shokë, me vështirësi të mëdha, por plot kurajo, vullnet të çeliktë e sakrificë e realizoi për tri orë ngjitjen. Fjalët e barinjve na bëjnë të ndiejmë më shumë kënaqësi për punën tonë".

Vlerësime të tilla kanë marrë edhe herë të tjera alpinistët tanë. Se gjurmët e tyre i gjen pothuaj në çdo majë të maleve të Atdheut. Sa kënaqësi ndiejnë ata kur ua "zbulojnë" gjurmët. Dhe dëshira e tyre është të kenë sa më shumë shokë, sa më shumë shoqe.

Në fakt radhët e alpinistëve shtohen vazhdimisht, megjithëse të bëhesh alpinist nuk është gjë e lehtë. Megjithatë, kushdo mund të bëhet. Por që të njohësh pëllëmbë për pëllëmbë Atdheun, që të realizosh programin e ngjitjeve, sipas kategorive edhe në kushte të vështira atmosferike, në radhë të parë duhet të jesh sportist i përgatitur në të gjitha drejtimet. Të tillë njerëz kërkon alpinizmi, me vullnet të çeliktë, me shpirt të lartë sakrificë. Por alpinistët nuk lindin të tillë. Është edhe vetë ky sport i guximtarëve që të përgatit me veti të larta morale e fizike. Prandaj, të rinjtë e të rejtat tona, gjithnjë e më shumë po aktivizohen dhe duhet të aktivizohen në këtë sport. Rruga për atje nis me shëtitjet e ekskursionet, marshimet e ngjitjet e thjeshta. Është gjë e bukur kur shikon se si kolektivat fizikulturore të qëndrave të punës e prodhimit, të shkollave dhe kooperativave bujqësore, herëpashere zhvillojnë në mënyrë të organizuar marshime dhe ekskursione, sidomos në periudhën e vështirë të dimrit. Tradita e mirë korçare për shëtitjet individuale e familjare në pikat turistike të

Moravës, etj., po ruhet e çohet më tej. Sezoni i ri turistik dhe ngjitjet e planifikuara për këtë vit në rrethin e Korçës, si në çdo rreth tjetër të vendit, aktivizimi i të gjithë moshave, duke filluar që nga alpinistët e rinj dhe pionierë të shtëpisë së pionierit të qytetit, do të ndihmojnë për masivizimin e mëtejshëm të këtij sporti burrëror dhe me vlera të mëdha shëndetësore e kalitëse.

Petrit Spaho, 21 tetor

1981

Filluan ngjitjet e kualifikuara dimërore në Alpe

Më 22 janar filluan ngjitjet e kualifikuara për sezonin dimëror të vitit 1981. Në këto ngjitje, që zhvillohen në Alpe e që do të përfundojnë më 30 janar, marrin pjesë alpinistë të kategorive të para sportive si dhe mjeshtrit. Në bazë të programit të këtij aktiviteti, pjesëmarrësit janë ndarë në tri grupe:

Grupi i parë: në zonën e Bunit të Valbonës, do të punojnë ekipet: "17 Nëntori", "Valbona", "Tomorri", "Labinoti" dhe "Luftëtari".

Grupi i dytë: në zonën e Bunit të Ziçit, do të punojnë ekipet: "Studenti", "Flamurtari", "Vllaznia", "Skënderbeu" dhe "24 Maji".

Grupi i tretë: në zonën e Bunit të Ibrahimit, do të punojnë ekipet: "Partizani", "Tërbuni", "Korabi", "Përparimi" dhe Kastrioti".

Alpinistët do t'i kryejnë ngjitjet në bazë ekipesh, ku do të ketë grupe prej dy deri në gjashtë veta.

Bisedë me kryetarin e Federatës së Alpinizmit e Çiklizmit, Eqerem Shaba

Me këto ngjitje të kualifikuara, sporti i alpinizmit nis udhën e tij në vitin jubilar të 40-vjetorit të themelimit të Partisë, i cili do të jetë i ngjeshur me shumë aktivitete të larmishme. Mund të themi se përgatitjet e bëra për kryerjen me sukses të këtyre ngjitjeve janë të mira. Janë marrë të gjitha masat dhe janë kryer stërvitje në baza shkencore që ato të realizohen me cilësi, duke synuar pjesëmarrjen e elementit të ri dhe kualifikimin e ngritjen e mëtejshme cilësore të alpinistëve.

Nisma e këtij aktiviteti, sipas informacionit që kemi deri tani, është e mirë, me gjithë vështirësitë e mëdha të kohës që kanë hasur e po kalojnë sportistët. Duke u mbështetur në shpirtin e kolektivitetit,

përgatitjet e bëra dhe përvojën e fituar, mendojmë se ky aksion do të kryhet me sukses.

Por ajo që dua të theksoj me këtë rast është fakti që këtë vit në aktivitetet masive të këtij sporti do të përfshihen një masë e madhe punonjësish nga qyteti e fshati, sidomos të rinj e të reja. Në të gjithë vendin, në aksionet e mëdha kalitëse, në kapjen e majave dhe të pikave turistike të rretheve do të përfshihen me mijëra të rinj e të reja. Ne synojmë të gjallërojmë edhe më tej iniciativat e marrura për zbatimin me sukses të busullës turistike të rrethit, për njohjen pëllëmbë për pëllëmbë të terrenit, e të tjera. Këto iniciativa janë një mjet i rëndësishëm kalitës, sidomos për brezin e ri. Ndonëse është kohë e ftohtë e me rreshje bore, në shumë zona të vendit janë kryer e po kryehen ngjitje malore, ekskursionet e marshime në vende historike e pika turistike nga mijëra të rinj e të reja në bazë të kalendarit sportiv të rrethit. Sigurisht që gjatë muajve të ardhshëm këto do të dendësohen edhe më, duke i dhënë gjallëri të veçantë jetës sportive të kolektivave fizkulturore. Kjo do të bëjë që gjatë vitit jubilar të 40-vjetorit të themelimit të Partisë, të arrijmë një shtrirje sa më të gjerë e me një pjesëmarrje sa më të madhe në këtë lëvizje.

Për sportin e alpinizmit objektivi është të shkelen gjatë këtij viti 6 itinerarë të rinj, si dhe të kryhen disa ngjitje të kategorisë së 6-të të vështirësisë. Po kështu, do të arrihen 70 kategori të para, 120 të dyta, 100 të treta, etj. Njëkohësisht, do të synohet të arrijnë normat e mjeshtrit të sportit 10 sportistë, të kandidatmjeshtrit 20.

27 janar

Sfiduesit e lartësive

-Reportazh-

Në Grykën e Dragobisë u befasuam nga një pamje e rrallë për ditët e para të janarit - një ortek i madh kishte bashkuar të dy brigjet e lumit të Valbonës. Çdo hap që hedhim në drejtim të fshatit që mban emrin e këtij lumi me ujë të rrëmbyeshëm na forcon mendimin se do të kemi të bëjmë me një dimër të egër. Jemi më shumë se çdo herë tjetër – 62 alpinistë të kategorive të larta.

...Nga qendra e fshatit majat e maleve i kemi larg dhe, më e keqja është se, në çdo orë të këtyre ditëve, kur agon vonë dhe errësohet

shpejt, gjithçka është e mbuluar në mjegull apo nga retë, të cilat kanë atë ngjyrën karakteristike në mal. Koha është e keqe, por duarkryq nuk mund të rrimë. Sapo u mblodhëm të gjithë, dy grupe alpinistësh u nisën në drejtim të malit të Rosit dhe të Kollatës. Urdhëri ishte i qartë : Do punoni 5 orë për hapjen e gjurmëve! U kthyen pas 7 orësh dhe na thanë vetëm këto fjalë :

Ka shumë borë dhe ajo humbon!

Befasia e dytë ndodhi në mesnatën e 24 janarit kur pamë hënën që ndriçonte. Ngrihemi në orën 4 të mëngjezit. Nisemi në drejtim të Rosit, që është sulmuar vetëm një herë gjatë stinës së dimrit. Nuk është e vështirë teknikisht të ngjitesh në këtë majë, por shtegtimi për të vajtur atje është tejet i gjatë dhe i mundimshëm. Këtë majë “e nderuam” më tepër se duhet - 40 alpinistë u ngjitën mbi të. Pas 7 orësh nga çasti i nisjes fillojmë zbritjen. Shpresojmë se edhe në ditët që vijnë moti do të mbajë si sot.

Por kjo mbeti vetëm një dëshirë. As jugu nuk fryu dhe as dielli nuk ndriçoi. Kjo do të thotë se dëborra nuk do të ngrijë, pra, do të ecim deri në mes të fundosur. Dhe kështu ndodhi në të 9 ditët e kësaj veprimtarie. Në katër maja të kësaj zone (me lartësi mbi 2.400 m) nuk i veshëm asnjëherë kthetrat. Edhe për të kaluar metrat e fundit deri në majë ishte e mjaftueshme hapja e disa qukave (kështu i quajnë malësorët gjurmët që hapim me kazmën alpine). Kjo ndodh rrallë herë dhe do ta mbajmë mend për shumë kohë.

Me gjithë këtë mjedis të papërshtatshëm për të bërë ngjitje, të 62 alpinistët derdhën mjaft djersë, për t’u ngjitur në majën e Rosit, Rragamit, Alisë, Papllugës dhe Valit.

Erdhi dhe 30 janari, dita e fundit e aktivitetit tonë. Sipas traditës, mblidhemi dhe bëjmë analizën e ngjitjeve, përgatitemi për për të vajtur në qytetin Bajram Curri. Por këtë vit e prishëm traditën, për arsye se sapo agoi, qielli ishte i hapur. Përgatitemi shpejt e shpejt dhe pa vajtur ora 7 një grup sulmon Zhaboret, një tjetër majën e Valbonës dhe i treti Kollatën.

Kollata! Emrin e këtij mali e njohin të gjithë nga vargjet e këngës së bukur popullore :

*“Ç’ka Kollata që gjëmon,
Bajram Curri po lufton,
Ç’ka Kollata që po dridhet,
Bajram Curri gjallë s’po lidhet...”.*

Ecim me ritëm të lartë, në gjurmët që kanë hapur shokët tanë disa ditë më parë. Mundohemi të fitojmë sa më shumë kohë, se jemi mësuar me të papriturat e malit. Jemi 13 alpinistë, ku pjesën më të madhe e bëjnë ata të "Partizanit". Pas pak orësh mbërrijmë në grykën e hapur dhe të gjatë që të shpie në Qafën e Prosllopit. Aty nga ora 11 koha ndryshoi...Vazhdojmë të fitojmë lartësi. Marrim djathtas dhe mbërrijmë bri një shkëmbi të madh. Sigurojmë njëri-tjetrin. I pari që kaloi pjesën e itinerarit midis shkëmbit e dëborës ishte alpinisti me moshën më të re në grupin tone - Aleksandri i "Flamurtarit". Sa mirë është kur entuziazmi dhe forca e të rinjve harmonizohen me përvojën e ngjitjeve të më të moshuarve. Pas 20 metrave vazhdon më tutje A. Hyka, të cilin e siguron P. Llubanishti. Kalojmë në këtë mënyrë disa minuta dhe futemi në një ulluk të gjatë rreth 500 m.

Pjerrësinë e madhe e ndjejmë nga pozicioni që merr trupi, ku shpesh mjekra gati sa nuk prek borën. Poshtë këmbëve tona bora lëshon një drithmë të lehtë që e ndiejmë në gjithë qenien tonë. Kjo dridhmë tregon se bora e rënë kohët e fundit nuk është shndërruar në një masë të vetme me të mëparshmen, pra ka mundësi që ajo të rrëshqasë dhe të marrë poshtë gjithçka. Për t'iu shmangur sado pak kësaj, nuk shkëmbejmë asnjë fjalë me njëri-tjetrin, se ato ndihmojnë që orteku të krijohet më lehtë. Vazhdojmë ngjitjen më shumë kujdes dhe nerva të tendosura. Kemi në ndihmë vetëm erën e fortë që përplasat në shpinën tonë. Ngarkesa e madhe emocionale nuk të lejon të jetosh me ndjenjën e lodhjes së kalimit të asaj pjerrësie të rrezikshme dhe as të na shkoj mendja tek të ftohtit. Pa vajtur ora 14 mbërrijmë në majën mbi 2.550 m (majë e paemërtuar, një ndër më të lartat në bllokun e Kollatës). Shtrëngojmë dorashkat e ngrira me njëri-tjetrin për suksesin e arritur dhe dëgjojmë Berzatin e Kukësit, të cilit iu kujtua se klubi i tij sportiv nuk e ka pajisur ekipin me aparat fotografik.

Gëzimi na shton forcat. Vendosi më të mbërrijmë në majën më të lartë të Kollatës, të cilën nuk e kemi parë gjithë ditën. Gjithçka është e mbyllur, me vështirësi dallojmë shokun pak metra larg...Pa vajtur ora 16, me keqardhje vendosëm të kthehemi. Zbresim me shumë kujdes, duke vënë në përdorim gjithçka që kemi mësuar këto 25 vjet (alpinizmi këtë vit feston 25-vjetorin e tij). Në këtë mënyrë vazhdojmë më tepër se një orë. I pari që mbërriti në atë grykën e gjerë që të nxjerr në Qafën e Prosllopit ishte O. Gashi.

Zbresim në drejtim të fshatit. Para meje ecën mjeshtri i merituar i sportit Vasil Stambuli, që dy ditë më parë festoi në Alpe ditëlindjen. (Ai nuk do të tregojë sa vjeç është. Dhe mirë e ka. Ç'rëndësi kanë vitet për një trup të shëndoshë dhe kaq të fortë, për një njeri entuziast dhe gjinjë optimist siç është Shili). Ecim krejt të pasforcuar, megjithëqë është natë e nxirë dimri dhe jemi në mal. Gjurmët janë të vetmet që na "ndriçojnë" rrugën. Era fryn nga të katër anët dhe na përplas në fytyrë borën që ajo "fshin" nga shpatet dhe qafat e maleve. Në një nga "krijimet" e erës e pësoi edhe Shili, që shkeli mbi një strehë dhe m'u zhdruk nga sytë. Shili nuk "vuri mend" atë natë, pas gjysëm ore ra përsëri disa metra poshtë dhe nisi të çalojë. Në hyrje të pyllit na priste Azemi me alpinistët e Kukësit, të cilët "na kujtojnë " se kemi gjithë ditën që nuk kemi vënë gjë në gojë, megjithëse në çantë kemi plot ushqime...

Vazhdojmë të zbresim...Ja dhe dritat e fshatit, që duken sikur xixëllonë atje poshtë. Shohim elektrikët e dorës që sa venë e po afrohen. Janë disa nga shokët tanë, që duke parë se ora po kalonte, janë nisur për të na dalë përpara.

Na bëhet zemra mal që po atë ditë beratasit, tiranasisit, elbasanasit dhe tropojanët ishin ngjitur në Zhabore; gjirokastritët, shkodranët dhe "Studenti" në majën e Valbonës, ndërsa ata të "Skënderbeut" dhe të Vlorës në majën e Alisë dhe të Papllugës, itinerar ky që e kishin realizuar një ditë më parë alpinistët e "Korabit" dhe të "Tërbunit".

...Nisemi për Bajram Curri. Hedhim vështrimin nga Kollata, duke iu drejtuar asaj me fjalët :

Do të shihemi përsëri!.

Kozma Grillo, 10 shkurt

*Përplasja me ortekun!**
Si vdiqën 11 djem të Shkollës së Bashkuar
dhe u plagosën 115 të tjerë

6 shkurt 1981. Në Feken, rreth 40 kilometra larg Tiranës, ndodhi një përplasje e egër mes forcave të verbra të natyrës dhestudentëve dhe pedagogëve të shkollës sonë të oficerëve. Për pasojë të kësaj përplasjeje përfunduan brenda një dite 115 burra të plagosur në spital dhe u varrosën 11 djem, që aspironin të bëheshin oficerë.

Gjithsesi, solidariteti ushtarak në ato kushte përpjekjesh mbinjerëzore, ka qenë një "film" i mahnitshëm. Ja biseda me njërin nga protagonistët e asaj ngjarjeje, të mirënjohurin kolonelin në pension dhe mjeshtrin e mundjes, **Bashkim Lika** :

...Çfarë bëtë një ditë para nisjes për marshim?

Kishim planifikuar një marshim vajtje-ardhje për tetë orë. Kjo, në kuadrin e programit të përgatitjes fizike. Një marshim nëpër male në kushtë të egra të motit.

Si kishim përgatitur itinerarin, konfirmuam edhe një herë bazën materiale, si litarë, kazma alpine, çanta shpine, sigurisht edhe armatimin. Ushqim s'do të merrnim me vete. Do të hanim mëngjes – një mëngjes i përforcuar, kuptohet dhe, pastaj, dreka si të ktheheshim; kurdo që të ktheheshim. U rreshtuan të gjitha togat. Togat e mia nuk do të vinin në marshim, sepse nuk kishin program. Mirëpo, unë mora togat e kolegut tim, futbollistit Ilir Lame, që nuk ishte. Veç togave të Ilirit, që do të komandoja unë, por qe nuk i njihja personalisht, ishin edhe togat e Sul Starovës, futbollist i njohur edhe ky, të Ylli Ramës dhe ato të Mark Micit. Me ne do të vinte të nesërmen në mëngjes edhe shefi i fizkulturës në Ministrinë e Mbrojtjes, **Bashkim Topçiu**. Pra, plot 204 burra.

Nëpër dëborë do të marshonit? Kush do të printe kolonën? Ti, Bashkim?

Po, do të marshonim nëpër dëborë. Ajo ishte mbi një metër. Kolonën do ta drejtonte një oficer i mrekullueshem. Në ballë të saj, do

të ishin togat e Mark Micit... Ai e njihte dëborën se ishte nga zona alpine e Tropojës... Për mua, si Bashkim, ishte hera e parë që shkoja në një marshim të tillë në Feken.

Si u gdhi koha të nesërmen?

Shumë e keqe. Me një shikim bërnut, dhe me borë që kishte rënë tërë natën pa pushim. Dhe, tepër ftohtë.

A propozoi njeri që të mos bëhej marshimi?

As që bëhej fjalë. Absolutisht. Sigurisht që, asnjërit nuk i shkoi mendja, apo, më saktë, nuk u kujtua për mundësinë e ndonjë orteku.

E, si u ballafaquat me këtë kundërshtar që nuk e kishin parashikuar?

Dëborën po e çanin togat e Markut. Ishte ora 10. Marku dhe një pjesë e vogël nga djemtë e tij, për pak po arrinin në majën e Mëçekut. Unë me togat e mia ishim ca më poshtë. Krejt pa pritur, u ça dëbora dhe rrëshqiti tërë faqja e malit në mënyrë masive. Ishte e pamundur për çfarëdolloj manovre. Nuk pata kohë të bëja asgjë. Masivi i akullt erdhi dhe u përplas edhe te këmbët e mia. Ndjeva një dhimbje të tmerrshme te këmba e djathtë. Thashë se m'u thye. Fill atë moment, kur e pashë veten duke m'u zënë fryma, sytë po më nxirrnin xixa. Sikur po më çahej timpani i veshëve. Një peshë tmerrësisht e rëndë po më shtypte, sikur donte të ma nxirrte shpirtin...Më kishte rrëkëlyer rrota vigane e ortekut. Gjatë rrokullisjes me të, kur isha përsipër, pesha e shtypjes lehtësohej, por, kur isha teposhtë, gati sa nuk më pëlçisnin sytë. Nuk e mbaj mend se sa rrokullisje kam bërë thujse pa frymë kur, kam ndjerë veten se po rrëshqisja nëpër një zonë të akullt. Arrita të shtrija duart përpara. Ndjeva që po rrëshqisja tanimë, pa kaluar më nën urdhrat e ciklit të ortekut. Ai nuk mund të më merrte më me vete. Po rezistojta pa frymë me shpirt në dhëmbë...

Çfarë kishte ndodhur?

Isha ndalur në trungun e një peme. Pas atij trungu kish qenë ajo boshësi ajri që më shpëtoi jetën. Si u ngopa me frymë, u kapa nga trungu i pemës dhe, nëpër atë, arrita të dilja mbi dëborë. Pashë hapësirën. Isha gjallë. Këmba po më dhimbte shumë, por nuk ishte thyer. Pashë përqark. Pashë studentë që po kërkonin. I pashë se si

nxirrnin njerëz nga dëbora. Diku dukej një këmbë njeriu. Diku një dorë. Diku një tytë automatiku. Ishte si në një fushë beteje.

Erdhi njeri të të ndihmonte ty?

Ndjeva një dorë që më tërhoqi fort dhe më thirri në emër. Ishte dora e Bashkim Topçiu. Ai po organizonte nxjerrjen e njerëzve. Vetë nuk qe dëmtuar fare Bashkimi. Edhe unë u vura të organizoja njerëzit për të shpëtuar të mbeturit nëpër borë. Kujtoj që kam bërëtitur me të madhe : "Kujdes! Largohuni që këtej! Mund të vijë orteku tjetër!"...

Nga e dije ti këtë?

Nga literatura. Dhe...oh, nuk kisha gabuar. Orteku i dytë erdhi me të vërtetë. Dhe ishte fatal. Edhe më i përbindshëm se i pari.

Kur erdhi ky ortek? Për më tepër, po komanda e shkollës, çfarë qëndrim mbajti? E kishte marrë vesh ajo se çfarë ju kishte ndodhur?

Orteku i dytë erdhi pas mbi një ore.

Çfarë po bëje ti, ndërkohë?

Me mjaft studentë që i kisha marrë përpara, kishim zbritur në një shesh-fushim, që ishte i mbrojtur natyralisht nga ortekët...Po bënim bilancin. Për të shkuar deri atje, me atë këmbë aq të plaguar, më ndihmoi një student...Ishte djali i xhajës tim, sigurisht që ia ke dëgjuar emrin, Diko Zeqo. Ama, Marku, vazhdonte lart. Me djemtë e tij, ai sulmonte togjet më të mëdhenj të borës për të nxjerrë njerëz. Ka nxjerrë me dhjetra Marku...

Shkolla qe njoftuar menjëherë. Mbase nuk ju besohet, por i gjithë efektiv i shkollës si një trup i vetëm, ka qenë tek ne brenda njëzetë minutash. Me vetë komandatin Rustem Peçi. Edhe me shefin e fizkulturës së shkollës, Petrit Murzakun. Si një sokol mali, Petrit Murzaku u sul në majën ku përleshej me dengjet e borës Mark Pici. Ai i tha Markut të zbriste teposhtë, dhe vetë u sul në kërkim ku ishte sasia më e madhe e borës. Marku, si një luan, kishte shpëtuar kushedi se sa jetë njerëzish. Në kohën që ia nisi kërkimeve Petriti, plasi orteku tjetër. Si kaloi ai, alamet Petrit Murzaku, nuk gjendej më askund. E kishte përpirë orteku?

Vdiq Petriti?

Për pak sa vdiq. Ndërsa ai ka qenë duke dhënë frymën e **fundit**,

kishte përmbledhur forcat dhe kish mundur të ngrinte njëren dorë lart. Dhe...Myzafer Kambo, papritur pa mes dëborës katër gishtërinj. Dhe asgjë më tjetër. "Kushedi se cili nga shokët do të jetë aty", mendoi Myzaferi dhe u sul me tërë fuqinë të nxirrte përjashta të zotit e atyre katër gishtave. Kishin qenë gishtat e mjeshtrit të sporteve të rënda, Petrit Murzaku. Ai ishte me brinjë të thyera dhe në pragun e fundit të vdekjes.

Cili ishte bilanci i kësaj tragjedie?

11 të vdekur dhe 115 në spital.

Keni bërë më stërvitje në Feken?

Sigurisht. Veçse tanimë ishte e qartë se, kur është borë me furtunë, s' duhet ngjitur më në majën e Mëçekut. Dhe nuk duhen bërë më ngjitje nëpër dëborë të ngrirë, kur mbi të ka rënë dëborë e re.*

* Ky shkrim është marrë nga gazeta : "LIBERTAS", datë 31 mars 2009

Alpinizmi ynë në 25 vjet

Është vështirë të ketë të huaj dashamirës të vendit tonë që, kur kujtojnë Shqipërinë, të mos i kujtohen edhe malet. Ky asociacion i ka rrënjët jo aq në rrafshin gjeografik (Shqipëria është një ndër vendet më malor të Ballkanit dhe të Europës) se sa në atë që malet kanë qenë barrkada të luftrave, përpjekjeve dhe rezistencës së popullit tonë për pavarësi e liri.

Është kjo arsyeja që malet gjithnjë kanë qënë të afërt dhe të dashur për shqiptarin, por 37 vjet më parë ishin të pakët ata që ëndërronin t'i shndërronin ato në terrene sportive për kalitjen e brezit të ri. Shqipëria ishte vendi më i prapambetur i Evropës edhe në sport. Kështu që nga vitet e shumtë të së kaluarës ne trashëguam një numër fare të vogël shëtitjesh turistike malore, të zhvilluara me iniciativën e disa mësuesve, nxënësve dhe intelektualëve përparimtarë, midis të cilëve kontribuan veteranë si Avni Zajmi e të tjerë dhe, në mënyrë të veçantë, mjeshtri i sportit Luigj Shala.

Alpinizmi është dhuratë e mrekullueshme e viteve të Partisë

për bezin e ri, për punëtorët e kooperativistët. Alpinizmi lindi si sport në vendin tonë, kur në Europë prej më shumë se 165 vjet më parë ishte mposhtur maja më e lartë e kontinentit dhe ishin hedhur sytë në malet e kontinentëve të tjerë. Hapat e parë të alpinizmit tonë u hodhën me ngjitjet modeste që u kryhen në prag të viteve 50. Në shkurtin e vitit 1956 u mposht në stinën e dimrit Korabi, maja më e lartë e Atdheut tonë. Pas kësaj "nxemjeje", në korrik të vitit 1956 në Theth u zhvillua zbori i parë, ku 16 të rinj të ardhur nga rrethe të ndryshëm mësuan *abc*-ën e teknikës së alpinizmit nga instruktori Minella Kapo.

Brenda këtyre 25 vjetëve alpinizmi ynë hodhi shtat dhe u masivizua. Kështu, për shembull, sot kemi më shumë ekipe se sa kishim alpinistë në vitin 1956. Në rast se për vite me radhë klubi sportiv "Studenti" ishte e vetmja bazë për zhvillimin e këtij sporti, me kalimin e viteve u krijuan dhe u konsoliduan një sërë ekipesh të tjerë. Përmendim midis tyre "Tomorrin", "17 Nëntorin", "Partizanin", "Korabin", "Skënderbeun", "Flamurtarin" dhe vitet e fundit "Valbonën", "Përparimin", etj. Për sa i takon cilësisë sportive, alpinizmi ka hedhur hapa të sigurt, janë bërë një sërë ngjitjesh të kategorive të larta të vështirësisë si në Alpe ashtu dhe në male të lartë. Kujtojmë midis tyre ngjitjen në murin shkëmbor të faqes jugore të Arapit, marrjen e Jezercës nga ana veriore në stinën e dimrit, kacavjerrjen në faqen shkëmbore të Papingut e kështu me radhë. Alpinistët tanë më të mirë kanë përfaqësuar me dinjitet sportin tonë popullor në një sërë ngjitjesh ndërkombëtare.

Arritjet e këtij sporti dëshmojnë për kujdesin e veçantë të Partisë dhe të gjithë shoqërisë sonë socialiste, dëshmojnë për dashurinë e madhe të të rinjve tanë për të ushtruar këtë sport, ku rival nuk kanë një individ apo një ekip të një klubi tjetër, por një kundërshtar shumë më të fuqishëm dhe shumë herë më të madh. Për të mposhtur vështirësitë, për të mbërritur në majë të malit, si duke u kacavjerrur në shkëmbinj apo duke shtegtuar mbi dëborë apo akull, duhen forca të mëdha fizike. Këto forca nevojiten jo vetëm për të mposhtur vështirësitë e "aktivitetit sportiv", por edhe ato të terrenit dhe të motit, për sigurimin e jetesës...

...25 vjet më parë e nisëm këtë sport me pak njerëz dhe pa bazën e nevojshme materiale; ngjiteshim në mal me litar prej lini dhe u kishim zili alpinistëve të huaj pajisjet. E nisëm këtë sport duke mësuar shtigjet që të shpien në majë të malit që "të miqësoheshim me ta". Vitet

rrodhën. U rrit mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i masave punonjëse. Shoqëria sociale na vuri në dispozicion bazën e nevojshme materiale (shumë nga këto sot prodhohen në vendin tonë).

Për organizimin dhe drejtimin më të mirë u krijua Shoqata e Alpinizmit, u rrit numri i alpinistëve (disa nga fëmijët e atyre që 25 vjet më parë bënë zborin e parë në Theth sot janë bërë alpinistë të kualifikuar), sot nuk ka asnjë mal me lartësi mbi 1.600 m ku të mos jenë ngjitur alpinistët tanë. Në çdo aktivitet kombëtar rritet numri i itinerarëve të rinj dhe shkallës së lartë të vështirësisë. Në këto arritje ne kemi ndjerë angazhimin e veçantë të shtetit, ndihmën e madhe morale të malësorve dhe të kufitarëve. Në rritjen cilësore të këtij sporti kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe Mjeshtrit e Merituar Minella Kapo, Vasil Stambuli, Petraq Kule e Vangjel Melengu...



1982

Drejt Alpeve të Veriut
- Reportazh -

Sipas Kalendarit Sportiv Kombëtar, nga data 21 deri më 30 janar, alpinistët e kategorisë së parë zhvilluan ngjitjet dimërore në Alpe. Ekipet punuan në katër zona...

20 janar. Grupet janë rreshtuar në qytetin Bajram Curri, ku zhvillohet ceremonia e nisjes. Prej këtej grupi mori drejtimin për në liqenin e Ponarit, nga ku do të fillojnë edhe ngjitjet e majave të kësaj zone.

21 janar. Në orën 6 grupi ishte gati. U kontrollua baza materiale dhe nisi ecja në drejtim të Thepit të Livadheve, me lartësi 2.350 m mbi nivelin e detit. Tek liqeni ishte një mjegull e dendur, e padepërtueshme. Por, ndërsa ngjiteshim, për çudi mjegulla dobësohej. Siç duket dielli që po lindte po e shpërndante atë. Kur arritëm në Majën e Paqes koha u qartësua krejtësisht dhe ne shikonim gjithë majat përreth. Pëllumb Bici, alpinist i "Labinotit", tha "Ndoshta do të lodhemi sa të kalojmë transversat e rrezikshme, por ama koha është me ne". Duke siguruar njëri-tjetrin dhe me ndihmën e kthetrave në orën 11 e 30 mbërrimë në Majën e Dhive (Thepi i Livadheve.) Mbasi vrojtua me kujdes rrugëkalimin që do të bënim të nesërmen morëm rrugën e kthimit.

22 janar. Zgjohemi në orën 3 pas mesnate. Bëjmë gjimnastikë, ngarkojmë çantat 35 kg në shpinë dhe nisemi drej rrugëkalimit.

Natë. Alpinistët të rreshtuar për një ecin në drejtim të Qafës së Gropshit. Adil Manga, është para, në dorë mban elektrikun dhe shikon gjurmët që i kishim bërë një ditë më parë për të lehtësuar lodhjen e ditës së sotme. Kur zbardhi dita ishim në afërsi të Majës së Paqes, e cila ngrihet krenare në këtë zonë. Pushojmë në Qafën e Gropshit (2.250 m). Itinerari është shumë i vështirë dhe ngjitja kryhet për herë të parë në këtë rrugëkalim (nga pjesa jug-perëndimore e majës). Vendi ku do të ngjitemi është një pllajë me pjerrësi afro 70 gradë e kishte vetëm

akull dhe shkëmb. Filluam ngjitjen. Në krye të litarit është Besnik Kica, alpinist i “Korabit”. Ai ecën me vëmendjen më të madhe, duke vendosur me kujdes këmbën. Çdo avancim bëhet me sigurim. Mbase mbaruam ngjitjen e pllajës na u desh të kalonim një kurrizore afro 150 metra, e cila të dërgon në humnerë, si në të majtë edhe në djathtë. Zabit Tusha kalon i pari në këtë rrugëkalim. Me këtë ngjitje ai fiton titullin “kandidatmjeshtër”. Dhe ja më në fund alpinistët, të nfarë në treshe e dyshe, të drejtuar nga Xhevdet Osmani dhe Seit Gajda të “Labinotit” pushtuan Majën e Paqes. Ky ishte një gëzim i madh për ne dhe gjithë lëvizjen alpinistike. Pushtuam Majën e Paqes në një rrugë të re që nuk është shkelur deri tani nga alpinistët.

Të nesërmen u ngritëm herët dhe 8 u nisëm në drejtim të majës Gavnit. Në orën 15 maja u pushtua. Gjatë kthimit u takuam me grupin që vinte nga Rragami dhe ngritëm kampingun. Sëbashku morëm drejtimin nga Lugu i Vathshqefirit për tek Qafa e Zhabores. Edhe ky kalim ishte shumë i vështirë. Çdo hap me sigurim. Ecën Apostoli, siguron Kujtimi dhe nga ana tjetër siguron Zabiti dhe avancon Besniku. Mbas disa orësh arritëm në lartësinë 2.300 m. U nisëm për në majën e Zhaborës dhe prej andej për në Bosh. Në orën 13 maja e Boshit është nën këmbët tona.

Zbritëm për të vajtur në Gjelaj, lagjja e sipërme e fshatit Rragam, ku fshatarët na presin me përzemërsi. Pushojmë një ditë.

Nisemi për në Grykat e Hapura, ku do të bënim kalimin e transversës dhe ngjitjen në majën e Lugbatit dhe në majën “Ismet Sali Bruçaj”. Ngjitja ishte e vlefshme për mjeshtër sporti. Edhe këto lartësi u pushtuan nga grupi ynë.

Të gjithë alpinistët ishin të përgatitur për këtë aktivitet të rëndësishëm. U dalluan radisti alpinist Hajdar Hasa, Besnik Kica të “Korabit”, Ernest Qiro i “Skënderbeut”, Kujtim Ibrahim i “Labinotit”.

Taxhedin Shehu, mjeshtër sporti, 2 shkurt

Sportet dimërore - për të gjithë

Dimri, sado i vonët këtë vit, po troket. Kjo “trokitje” na kujton edhe dhënien e startit për sportet dimërore, sportet e të gjithëve.

Në rast se në çdo lloj sporti janë shënuar suksese të konsiderue-

shme në krahasim me të kaluarën, këto arritje janë gjithashtu të mëdha edhe në sportet dimërore.

Ekskursionet dhe marshimet, ngjitjet malore dhe alpinistike, rrëshqitjet me ski dhe ecje-rendjet në terren të thyer, janë mjete të pazëvendësueshme për edukimin komunist të brezit të ri. Mijëra e dhjetëra mijëra të rinj e të reja, punonjës të moshave të ndryshme, nisen ditët e diela dhe ditët e pushimit drejt maleve, në të katër anët e vendit. Gjallëria e veçantë e pikave turistike në malin e Dajtit, në Kapinovë të Beratit, në Moravë të Korëës etj., dëshmon për dashurinë e madhe të punonjësve dhe të rinisë për të ushtruar turizmin malor, për t'u kalitur fizikisht, për t'u përgatitur sa më mirë për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit, të Atdheut tonë.

Sportet dimërore janë sa argëtues aq edhe mjete të fuqishëm edukativë. Ushtrimi i tyre do të thotë ta njohësh nga afër Atdheun, të kaluarën dhe të tashmen e tij. Rrugët dhe shtigjet që të çojnë në mal kanë si udhërrëfyese pllakat dhe lapidarët që evokojnë faqe të historisë sonë. Marshon nëpër këtë truall dhe jeton me ndjenjën e madhe që krijon harmonia e bukurisë së natyrës me veprat e epokës së Partisë. Bukuritë mahnitëse të Valbonës dhe të liqejve të Lurës, të brezave të Lukovës dhe të luginave të Alpeve, të maleve, janë burim frymëzimi, rrisin krenarinë për Atdheun tonë socialist. Edukim fizik dhe ushtarak i rinisë, nëpërmjet ushtrimit të këtyre sporteve, është njëkohësisht edhe edukim patriotik i saj.

Një ndër veçantitë e sporteve dimërore është karakteri i theksuar masiv. Kënaqësia e madhe që të jep kalimi i një terreni të thyer e te mbuluar me dëborë të ngrirë, ndjenjat dhe emocionet që e shoqërojnë shtegtarin kur tufani shfryn apo thellimi i skuq fytyrën, janë mjete të pazëvendësueshme për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit, për kalitjen fizike të të gjithëve. Shoku Enver porositi: "...Të dielat ose pushimet e nxënësve, sidomos nga 16 vjeç e lart, duhet të jenë medoemos pushime aktive, të organizohen sporte masive, shëtitje e marshime me këmbë, pa marrë parasysh kohën, vendin, pa marrë parasysh se lodhen. Natyrisht, në këto ekskursionet edhe mund të lodhen, por ato duhet të zhvillohen me masë, të bëhen brenda rregullave e sipas moshave".

Për të gjitha këto vlera të mëdha, këto mjete kalitëse dhe edukative, po bëhen gjithnjë e më të dashura për rininë, po shndërrohen në lëvizje masive.

Për masivizimin e madh të sporteve dimërore, dëshmon edhe

funksionimi i ekipeve zinxhir të alpinistëve në 21 rrethe e klube sportive, rrethet e turizmit malor pranë shtëpive dhe pallatit të pionierëve etj. Krahas masivizimit, kujdes i veçantë po tregohet kohët e fundit për rritjen cilësore të sportit të alpinizmit, ku janë arritur një sërë suksesesh, siç janë mposhtja e të gjitha majave mbi lartësinë 1.800 m, realizimi i mjaft ngjitjeve të vështira në stinën e dimrit edhe në kacavarrjen në shkëmb. Megjithëkëtë mbetet ende shumë për të bërë. Ekzistojnë të gjitha kushtet për të ndërmarrë itinerarë të rinj, të shkallës së lartë dhe shumë të lartë të vështirësisë.

Gjithashtu masivizimi i mëtejshëm i ekskursioneve dhe i marshimeve, i rrëshqitjeve me ski dhe i ngjitjeve malore kërkon të ngrihet në një shkallë më të lartë drejtimi i kësaj lëvizjeje. Kjo shtron detyrën e bashkëpunimit konkret midis komiteteve të kulturës fizike dhe klubeve sportive me organizatat e BRPSH-ës dhe BPSH-ës. Ky bashkëpunim duhet të mishërohet në propagandimin më të mirë të vlerave të këtyre sporteve, në hartimin dhe ndjejejn e zbatimit të planeve, në gjetjen e formave të reja të punës, në përgjithësimin dhe vënien në jetë të përvojës së përparuar, në kualifikimin e kuadrit, etj.

Pra, masivizimi i mëtejshëm i sporteve dimërore bën të domosdoshëm që komitetet e fizkulturës dhe klubet sportive ta vlerësojnë konkretisht këtë çështje, të aktivizojnë mësuesit e dukimit fizik e ushtarak, kolektivat fizkulturore, të gjallërojnë veprimtarinë e komisioneve të turizmit dhe të alpinizmit, për të realizuar në praktikë përfshirjen e të gjithëve në sportet dimërore.

Kryeartikull, 21 dhjetor

1983

Pushtohet lartësia 2.560 m

Nga data 16 deri më 24 janar u zhvilluan ngjitjet e kualifikuara dimërore. Ngjitjet u zhvilluan në majat e Lugbatit, të rrethit të Tropojës, në Livadhet e Bogës dhe në stanet e Dënellit. Në zonën e staneve të Dënellit alpinistët u drejtuan nga mjeshtri i merituar i Sportit Vasil Stambuli, ata të Livadheve të Bogës punuan nën drejtimin e mjeshtrit Viron Velaj, ndërsa ata të Lugbatit nën drejtimin e mjeshtrit T. Shehu. Në këtë grup u aktivizuan alpinistët e Dibrës, Pukës, Korçës, Kukësit dhe Gjirokastrës, gjithsej 26 vetë.

Më 14 janar, na përshëndesin banorë të Bajram Currit. Nisemi. Arrijmë në fshatin Çereç Mulaj. Kampimgun e ngritëm të nesërmen afër Lugbatit.

16 janar. Zgjohemi dhe përgatitemi për rrugë. Hapat e parë të kolonës i hedh Ganiu. Si bëmë një copë rrugë, Nesti i bën zë Ganiut të bëjë një hap djathtas dhe del në krye për të çarë dëborën. Në afërsi të qafës, moti filloi të prishet, në trup na bien flokët e parë të borës. Si ecim dhe pak, për t'iu përgjigjur kushteve të terrenit veshim kthetrat dhe lidhemi në litar. Tani në krye ka dalë Rushiti, alpinist i "Korabit".

Vazhdojmë të ngjitemi në atë mjedis të ftohtë. Si kishin kaluar pesë orë nga nisja ndodhemi në majën e Lugbatit. Përqafohemi, shkruajmë emrat tanë, japim përshëndetjen "zik-zak...", fillojmë zbritjen.

Nëpër furtunë

Çdo gjë u bë e akullt. Bora bie furishëm e shoqëruar nga një erë e rreptë. Grupi, si një trup i vetëm, çau nëpër këtë furtunë të akullt. Kur arritëm tek çadrat vumë re se ato ishin shkullur nga era. U mblodhëm dhe vendosëm të shpërngulemi te Lugu i Vashqefmit. Kur u sistemua, Asllani që mbante radion na dha një lajm të gëzuar:

“Koha nesër do të jetë e mirë!”. U gëzuam mbas asaj që hoqëm për orë të tëra. Vendosëm që më 18 të mësynim Majën e Paqes.

Ora 3. Nisemi. Në dorë kemi elektrik dore. Udha është e gjatë, e vështirë. Në ndryshim nga vitet e tjerë, zgjedhim itinerarin që kalon nga Lugu i Alshinës, ku sa më lart ngjitesh aq më të vështirë e ke. Ecim duke siguruar njëri-tjetrin. Një copë rrugë prinë Besniku, të cilin e siguron Agroni nga Gjirokastra. Në afërsi të majës, biem në një tufan të fortë, të rrezikshëm. I themi njëri-tjetrit të mbulojmë fytyrën dhe t’i kthejmë shpinën erës për të thithur mundësisht sa më shumë ajër.

Shaqiri, Genci e Tolja kishin qëndruar në një pllajë në anën perëndimore të majës. I pyes përse nuk po vazhdojnë ngjitjen. Pa e mbaruar fjalën dallova një masiv dëbore që kishte filluar të çahet. I këshillova të ecnin vertikalisht në drejtim të pyllit, pa bërë zhurmë, sepse zhurma më e vogël “zgjon” ortekun. Ata punuan me kujdes dhe u bashkuan me ne, sido që tufani nuk na u nda deri në majë. Pas disa orësh mbërritëm në majë (2.320 m). Përpara lartohej Maja e Paqes. Edhe afro 300 metra na duheshin, por ishin metra në një terren shkëmbi e akulli.

Ecim duke siguruar njëri-tjetrin me kujdesin më të madh sepse edhe kthetrat e kishin të vështirë të nguleshin në akull. Ishte ora 13 e 30 minuta kur e pushtuam Majën e Paqes. Të 26 shprehim gëzimin për këtë fitore. Por më i gëzuar ishte Përparimi, që shkelte në këtë majë për herë të parë. Për të arritur këtu na u deshën 8 orë në furtunë, në të ftohtë dhe akull.

Edhe në zbritje nuk na u nda furtuna, mirëpo tani nuk jemi aq të shqetësuar sa më parë. Të nesërmen e bëjmë pushim. Ganiu na lexon kapituj të librit të shokut Enver Hoxha: “Titistët”. Edhe ne, në mal, e ndjejmë veten krenarë për Partinë sokolesh dhe udhëheqësin e dashur shokun Enver.

...Vijua ngjitjet në majën e Dhive të Egra dhe më 23 kryhem ngjitjen më të vështirë të kësaj zone. Pushtuam majën e Briasetit, që përcaktohet e kategorisë së gjashtë të vështirësisë në këtë stinë. Të gjitha mjetet i përdorëm për këtë ngjitje. Ishte ngjitja e fundit që mbylli dhe tërë udhëtimin malor. Por udhëtime të tjera na presin.

Taxhedin Shehu, 1 shkurt

***Kur dhe si lindën sportet:
Sporti i lartësive***

Malet i kanë joshur njerëzit që në kohët më të lashta. Po kureshtja për njohjen e tyre ka qenë e përzier edhe me frikën që ndiente njeriu para majave të larta, që kundroheshin si seli të perëndive. Megjithëkëtë dolën njerëz të guximshëm, që mposhtën frikën dhe nisën rrugën drej shtigjeve të vështira.

Straboni, gjeografi grek i shekullit të parë të erës sonë, në veprën e tij "Gjeografia", tregon se në kohën e sundimit të Augustit (shekulli i parë para erës sonë) ishin të pakët njerëzit (por të tillë nuk mungonin) që ngjiteshin në malin Argeo (4.034 m) në Azinë e Vogël, ku soditnin Detin e Zi dhe Detin Mesdhe. Por gjurmët e alpinizmit janë më të hershme. Që disa shekuj para erës sonë janë bërë fushata ushtarake, ndër të cilat legjendare mbetet kalimi i Alpeve të Italisë, me ushtri dhe elefantë nga Hanibali i Kartagjenës në shekullin e tretë para erës sonë.

Njihet si ngjitja e parë alpinistike ajo që u bë në vitin 1492 në malin Egyij ("Gjilpëra") me lartësi 2.097 m, nga Antuan dë Vije me 9 bashkudhëtarë. Ishte kjo një ngjitje sportive e vërtetë, ata përdorën një shkallë litari dhe disa kunja për t'u ngulur në të çarat e shkëmbit. Në vitin 1511 dijetari, shpikësi dhe piktori gjenial Leonardo Da Vinçi u ngjit në majën e malit dhe pas këtij suksesi, mali "i pushtuar" u përdor si sfond në pikturat e tij të famshme.

Por ngadhnjimi i vërtetë i maleve të larta nga njeriu filloi vetëm para dy shekujsh. Në vitin 1741 Uliam Vinhemi nga Gjeneva e Zvicrës organizoi të parin "udhëtim" nëpër akullnajat e Shamonisë dhe pak më vonë më 1775, nisi epopeja e parë alpinistike: përpjekjet për t'u ngjitur në majën Mont Blanc (Mali i Bardhë), në alpet franceze. Majën e tij (me lartësi 4.807 m) e shkelën më 8 gusht mjeku Mishel Pikard dhe gjuetari Zhan Balmat. Më pas, më 1808 Maria Paradisi nga fshati alpin Shamoni, së bashku me Balmatin dhe katër udhërrëfyes, u ngjitën në Mont Blant, duke u bërë e para alpiniste që njeh historia.

Viti 1857 shënoi një datë historike për sportin e alpinizmit. Me të lidhen dy ngjarje të rëndësishme: krijimi nga 34 alpinistë anglezë të të parit klub alpin, që filloi të botojë të parën revistë të sportit të alpinizmit. Më pas klube të tillë u krijuan edhe në vende të tjerë, ku sporti i alpinizmit kishte marrë përhapje, si në Austri, Gjermani, Zvicër, Itali, Francë, etj.

Pas Alpeve u erdhi radha të shkelen vargmale të tjerë të njohur si Pirenejtë, Kaukazi, Urali, Karpatet. Pasi shkelën majat e tyre të larta, alpinistët iu drejtuan "pullazeve malorë" të kontinenteve të tjerë. Më 1874 u pushtua maja e Kilimanxharos, më e larta në Afrikë (6.010 m), më 1880 ajo e Këmborazos (6.310 m) në Ekuador.

Krijimi pajisjeve më të mira (litarët prej nejloni, gozhdët, kazmat, kthetrat e forta dhe të lehta, përdorimi i bombolave me oksigjen, prodhimi i ushqimeve të koncetruara dhe i veshjeve të përshtatshme për të ftohtat "kozmiqe" si dhe teknika e përsosur alpine) u dha mundësi alpinistëve më të mirë të marrin rrugën e vështirë drejt "dy pullazeve të Tokës", maleve të Himalajave dhe të Karakorumit, ku ngrihen drejt qiellit 400 maja mbi 7.000 m e midis tyre 14 mbi 8000 m.

Nga ngadhënjimi i Malit të Bardhë tek ai i majës së parë mbi 8000 m kaluan afro dy shekuj. Dhe shumë domethënës është fakti se, udhërrëfyesi nepalez Tensing Norgej ishte i pari njeri që bashkë me neozelandezin Edmund Hillar arritën më 29 maj 1953, majën më të lartë të rruzullit të Tokës, Xhomolungma (Everest) me lartësi 8.848 m.

Në gushtin e vitit 1980, italianin Rajner Mesner, që i pari që arriti majën më të lartë Botës, Everestin, krejt i vetëm, në kushte të vështira të stinës së musoneve dhe që nuk përdori bombolën me oksigjen, për të ndihmuar frymëmarrjen. Këtë ndërmarrje ai e përsëriti dy vjet më vonë duke arritur, edhe kësaj here në po ato kushte si të udhëtimit të parë, në majën e malit K-2, i dyti në botë me lartësi 8.611 metra.

Sabri Çelnikasi, 12 prill

*Drejt majave të Alpeve...***-Ngjitje të suksesshme të 70 alpinistëve-**

Nga 4 deri më 12 korrik u zhvilluan në Alpe ngjitjet kombëtare alpinistike, ku morën pjesë 70 alpinistë të kategorive të larta të 15 klubeve sportive. Ngjitjet u përqëndruan në zonën e Livadheve të Bogës nën drejtimin e mjeshtrit të sportit Viron Velaj; në zonën e Kllogjeve nën drejtimin e mjeshtrit të sportit Gëzim Oruçi dhe në zonën e Valbonës nën drejtimin e mjeshtrit të merituar Vasil Stambuli. Fryti i punës stërvitore gjithëvjetore i alpinistëve dhe mobilizimi i tyre në këtë veprimtari u kurorëzua me realizimin e mjaft itinerarëve të rinj e të përsëritur, kryesisht të shkallëve të larta të vështirësisë nëpër majat më të larta të Alpeve.

Sapo hyn në fshatin Valbonë të tërheq vëmendjen maja e Thatë. Për syrin e alpinistit ajo lartësohet madhështore. Me shpate gati vertikale mbi 1.000 metra, duke qëndruar në qendër të fshatit, ajo duket fragmenti më krenar në sfondin e bukurive të rralla të kësaj lugine. Nga alpinistët ajo është sulmuar mjaft rrallë, ndoshta për lartësinë modeste që ka, nëpërmjet të vetmit shteg, jo dhe aq të thjeshtë që të çon në majë.

Alpinistët dhe banorët e Alpeve, shpesh në vitet e Partisë kanë jetuar me gëzimet e shqetësimet e njëri-tjetrit, kanë ndihmuar njëri-tjetrin. Dhe lajmi i përqëndrimit të grupit tonë në rrëzën perëndimore të Majës së Thatë ngjalli interesim në banorët e fshatit. Edhe për ta ky mal është i veçantë. Ai është streha më e sigurt e dhive të egra, është prova më e fortë e kacavjerrësve popullorë më të guximshëm, amatorë të gjahut e të shtigjeve të vështirë.

Emrin e Sherif Valbonës e shokëve të tij, që shquhen për guximin e tyre në rrugët e ngjitjeve të vështira drejt majave, i dëgjuam shpesh nga fshatarët. Ata me interesim prisnin të dëgjonin për shtigjet e reja që alpinistët do të realizonin në këtë veprimtari. Dhe alpinistët e thanë fjalën e tyre.

Duke pasur parasysh se objekti kryesor i tyre ishte sulmi në Majën e Thatë, ata ndërmoren 7 itinerarë të rinj drejt saj, ku u shquan e kipet e "Partizanit" dhe të "Përparimit", e sidomos alpinistët Esat Matrunja, Andrea Kutali, Pëllumb Llabonishti, Berzat Mane, Azem Hyka, Hasan Duro, etj.

U hodh kështu një hap përpara në sulmin drejt itinerarësh me gjatësi të madhe (pati prej tyre që i kaluan 20 litarë gjatësi). Veç kësaj maje, alpinistët realizuan ngjitje në malin e Rupës, Rragamit dhe për të parën herë u ngjit një treshe në Majën e Kokërhokës 2.478 m e lartë, në lindje të Jezercës. Ngjitja shërbeu për të përcaktuar itinerarin më të mundshëm për ngjitje në sezonin dimëror të kësaj maje, nëpër lugun jugor që të nxjerr në kreshtën lindore të majës.

Ditën e 10 korrikut, alpinistët organizuan një ngjitje malore në majën kufitare të Rosit, bashkë me një grup kufitarësh.

25 alpinistë të ekipeve të "Partizanit", "Skënderbeut", "Përparimit", "Minatorit të Rr." dhe "17 Nëntorit" realizuan në këtë zonë 168 ngjitje, një e treta e të cilave ishte e kategorive më të larta. Si ekip u dallua "Partizani", ndërsa si alpinistë Azem Hyka, Sokol Doko, Anesti Qirio, Pëllumb Llabonisht, etj.

Kjo veprimtari tregoi se alpinistët e ekipeve kishin bërë një punë të mirë stërvitore. Rezultatet e arritura nga alpinistët e kualifikuar do të jenë mobilizuese për rezultate më të larta. Para tyre shtrohen objektiva shumë më të mëdha për vitin e ardhshëm, vit në të cilin veprimtaritë do të kryhen në kuadrin e jubileut të 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Aleksandër Bojaxhi, 19 korrik

1984

*Nga biblioteka sportive
"Alpinizëm"*

Ç'është alpinizmi, ç'i tërheq njerëzit të përballojnë vështirësitë e shumta të motit e të terrenit? Një pyetje e tillë thuhetse vjen vetvetiu kur shikon alpinistë duke u ngjitur a duke u kacavjerrë nëpër shpatet e thepisura të shkëmbijve, duke kapërcyer humnera të thella; duke pushtuar maja malesh të mbuluara nga bora e përjetshme.

Përgjigjen e këtij pasioni të madh e gjen në librin "Alpinizëm" të mjeshtrove të sportit Kozma Grillo e Aleksandër Bojaxhi (botuar kohët e fundit nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor).

Më shumë se një kuriozitet sportiv, libri është një manual për alpinizmin, një material ndihmës për mësuesit që drejtojnë rrethet jashtëshkollore, për trajnerët që drejtojnë ekipet e alpinizmit. Ai ka një karakteristikë të vetën në trajtimin e kapitujve. Ruan shtjellimim historik, të gërshetuar me njohuritë teorike didaktike, për fillestarët e deri në përsosmërinë e mjeshtërisë. Të 6 kapitujt e parë shërbejnë për të na njohur me historikun e alpinizmit në botë dhe në vendin tonë, si dhe jepen njohuri të përgjithshme për bazën materiale të domosdoshme, për taktikën dhe organizimin e ngjitjeve alpinistike. Në vazhdim (7 kapituj) jepen njohuri të hollësishme për bazat e teknikës, organizimin e ngjitjeve në mal, të dhëna për klimën, motin dhe rreziqet e mundshme në mal, për dhënien e ndihmës së shpejtë, për zgjedhjen e ndjekjen e itinerarit, etj. Materiali është i shoqëruar me skica, me tabela të veçanta për probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë përgatitjes e kryerjes së ngjitjeve alpinistike.

Për përgatitjen e një materiali të tillë për sportin e alpinizmit, autorët kanë shfrytëzuar një literaturë të gjerë, por në radhë të parë atyre u ka shërbyer përvoja e gjatë 28-vjeçare që merren me këtë sport. Madje mjaft të dhëna teorike janë gërshetuar me organizimin konkret të ngjitjeve alpinistike në vendin tonë, nga ekipe të ndryshëm sportiv, ku të dy autorët kanë marrë pjesë. Si i tillë, ky libër ka shumë vlera.

Alpinistët arrijnë objektivin

Ngjitjet kombëtare dimërore me alpinistë të kategorisë së parë dhe mjeshttra sporti këtë vit patën të veçantën e tyre. Për 9 ditë me radhë (1-9 shkurt) alpinistët u ndeshën çdo çast në luftë me vështirësitë e motit dhe dolën fitues në sajë të moralit të lartë, përgatitjes së gjithanshme fizike e teknik, vendosmërisë të të gjithëve për të kryer detyrën. Në çdo grup spikaste harmonizimi i mirë dhe i studiuar i pjesëmarrësve mjeshtër me përvojë dhe atyre të rinj. Në grupin që drejtohej nga Taxhedin Shehu, janë tre të rinj, që luftojnë me shpirt të lartë gare, duke treguar përgatitje të kënaqshme fizike e teknike. Rënia e jashtëzakonshme e dëborës dhe moti aspak i përshtatshëm e bëjnë të vështirë dhe gati të pamundur realizimin e objektivave. Mblidhemi në Rragam dhe vendosim të realizojmë me çdo kusht ngjitjen. Itinerari ynë kalon nëpër Lugun e Valit, Gropat e Bukura, Fushën e Okolit.

Në të njëjtën kohë, kështu kishin vepruar edhe grupet e tjerë: ai që drejtohet nga mjeshtri i merituar Vasil Stambuli kalon nëpër Rrragam - Buni i Ibrahimit, Maja e Jezercës, Theth - Bogë; ai që drejtohet nga mjeshtri i sportit Aleksandër Bojaxhi kalon nga Boga, Radohimë, Posta Verore, Rragam; ndërsa ai që drejtohet nga mjeshtri V. Memisha nga Ponara, Maja e Hekurave, Zhabor.

Siç shihet, bëhet fjalë për ngjitje të një shkalle të lartë të vështirësisë. Kapja e majës së Alisë e të Papllugës kërkon përgatitje speciale. Ato janë të shkallës së 5-të e të 4-t të vështirësisë në kushte normale. Ndërsa në kushtet tona atmosferike vështirësia rritej. Nëpër mjegull arrijmë në majat, duke ndjerë kënaqësinë e suksesit. Që të gjithë janë të gëzuar, që nga veterani Koço Ziso, Seiti, Besniku e deri tek të rinjtë si Petrika dhe Mehdiu.

Po më tej? Objektiv tjetër ishte kapja e majës së Jezercës në këto kushte dhe në anën veriore. Kjo kërkon kualifikim tepër të lartë - është shkalla e 6-të e vështirësisë. Kjo majë është arritur vetëm një herë para 4 vjetësh dhe tani arrihet përsëri.

Anesti Qirjo, mjeshtër sporti, 14 shkurt

Mark, I-4

Para pak ditësh përfunduan me sukses ngjitjet verore të alpinistëve me kategorinë e dytë sportive, të cilat u zhvilluan në tre zona: në Livadhet e Bogës, në Dënellë dhe në Shtegun e Dhënëve.

Çdo kilometër në drejtim të Alpeve na rriste dëshirën për të lënë prapa vapën, që kishte zverdhur edhe barin. Dëborë në male ishte shkrirë në një sipërfaqe të madhe. Bri saj, në afërsi të Shtegut të Dhënëve ngritëm çadrat. Ata që vijnë për herë të parë këtu mezi e besojnë kalimin e tij në ditët e dimrit, lodhjen, rreziqet dhe vështirësinë.

40 alpinistë të kategorive të ulta sportive punuan 8 ditë duke kryer një sërë ngjitjesh, disa prej të cilave shumë të bukura. Është e pamundur të tregosh në një shkrim, sado i gjatë që të jetë, të gjitha; të tregosh si shokët e komitetit të fizkulturës të rrethit të Skraparit i kishin nisur alpinistët pa pajisjet e nevojshme alpinistike; si ekipi i "Apolonisë", me trajner Eqerem Shehun punoi më mirë se vitin e kaluar; si progonatasit me Rahit Hilën në krye punojnë gjithnjë me dëshirë në shkëmb, si ata të "17 Nëntorit" me trajner Aleksandër Bojaxhiun u treguan mjaft të përgatitur; si ata të "Dajtit" edhe këtë vit kryen më shumë ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë.

I nisëm këto shënime duke treguar diçka nga jeta e alpinistëve, për arsye se në këtë sport vërtetë që secili e kryen ngjitjen vetë, por pa shokun nuk e ndien veten të sigurt. Alpinizmi është sporti ku arritjet e njerit krijojnë entuziazëm tek të tjerët.

U realizuan 327 ngjitje, ndër të cilat 86 të shkallëve të larta të vështirësisë. Dy ditë para mbylljes së aktivitetit u nisëm drejt malit që kush e di përse i ka mbetur emri Mark. Ashtu si në çdo mal, edhe Marku ka shumë itinerarë për të mbërritur në majë. Duke pasur shumë, ka midis tyre relativisht të lehtë deri deri tek më të vështirët, të shkallës së gjashtë. Një litar i Tepelenës dhe një i "Dajtit", pranë njëri-tjetrit, do të sulmonin dy nga këta itinerarë.

Si shkëputen nga "toka", dhe u kavjerrën rreth 40 m., u doli përpara një pllakë, rreth 4 m e lartë. Pllakat janë ndër pjesët e shkëmbit që gjithnjë u hapin telashe alpinistëve. Në sipërfaqen e tyre të lëmuar

me më shumë se 60 gradë pjerrësi, në rast se është e pamundur, vështirë të gjesh ndonjë të plasaritur sado të vogël që të ngulet gozhda. Ky moslejm i bën alpinistët që kur i afrohen asaj të ngulin disa gozhdë, poshtë dhe bri saj. Dhe kur alpinisti që drejton litarin i krijohet bindja se nuk i dilet me kacavjerrje, as me ndihmën e shkallës, vendos të përdorë mjetin e fundit i mundshëm - piramidën. Kjo do të thotë që në mes të shkëmbit, ku gishtërinjtë e duarve dhe të këmbëve mezi sigurojnë mosrëshqitjen nga shkëmbi, një ndër shokët e litarit të mbajë mbi supet të parin në litar që të fitojë disa centimetra lartësi. Shputat e këmbëve të Xhixhës, Gëzim Hima, hipën dhe qëndruan disa herë në supet ose në pëllëmbët e duarve të shtrira në kokën e Kolit (Sokol Hoxha). Shyqyr që në verë alpinistët nuk veshin këpucë me gozhdë...

Mobilizimi për kapërcimin e vështirësive, sedra sportive, përgatitja fizike, bëjnë që pesha e trupit të shokut për disa çaste të duket më e vogël se ç'është në të vërtetë. Punuan me pjekuri teknike dhe shumë të qetë (një ndër cilësitë më me vlerë të alpinistëve), gjithnjë të gatshëm për të ndihmuar njëri-tjetrin, por gishtërinjtë e Xhixhës nuk arritën të ngecnin sado pak në atë pllakë. Me gjithë dëshirën dhe kërkesën e tyre ta provonin dhe herë të tjera këtë përpjekje, i urdhërova të merrnin rrugën e kthimit. Ishte hera e parë që ata do të jetonin ndjenjën e rëndë të mosarritjes së suksesit. Për të fituar kohë (dielli kishte kaluar zenithin) u thashë alpinistëve të Tepelenës, që ishin në lartësi më të madhe, t'u hidhnin litarin nga lart. Pas disa provash e kapën litarin. Tani nuk kishte më probleme aq të mëdha për kalimin e pllakës shkëmbore.

Nuk do tregoj për reagimin e Sokolit, por për tepelenasit që kur raportuan për ngjitjen, ndër të tjera, thanë:

- Shoku komandat, ne kot e hodhëm litarin, për arsye se ata po ngjiteshin vetë!

Ata nuk donin që shokëve të një ekipi tjetër të mos u njihej ngjitja. Ishte shfaqje solidariteti, e cila ndërthen jo vetëm zemërgjerësi por, në të njëjtën kohë, edhe naivitetin e mungesës së përvojës. Kur alpinistëve u hidhet litari nga sipër ngjitja është e pavlefshme për sa i takon vlerësimin sportiv. Kështu ndodhi edhe me Xhixhën e Kolin që punuan 6 orë në shkëmb.

Të nesërmen ata e realizuan itinerarin që përshkuan tepelenasit...

1985

Për skiatorët dhe alpinistët tanë guximtarë
Mjeshtri veteran

Mjeshtrin e sportit të alpinizmit Taxhedin Shehun në Dibër e njeh i madh dhe i vogël. Jeta e tij sportive është e pasur. Gati dy dekada si futbollist por edhe si alpinist e trajner. Dhe pse i ka mbushur të 45 vjetët vazhdon të ngjitet si në rininë e tij. Nuk ka majë të veriut ku nuk ka shkelur këmba e tij. Por më shumë si sportist qyteti e njeh si njeri të sakrificës në çdo rast. Taxhi është kudo i pari, është izoluar një njeri nga bora përsëri Taxhi nisët i pari, i pari, i pari. Një virtyt i shenjtë i një populli të lashtë, një solidaritet që Partia i dha përmasa kaq të mëdha.

Kronika heroike për këta njerëz ta fal dhe përsëritjen. Ja para pak ditësh, më 17 janar, në orën 2 të mëngjesit, një ekip mjekësor i përbërë nga mjekët Tahir Alku, Selim Dreshka e Lulëzim Pilafi kërkonin të shkonin në fshatin Sllovë për të operuar një rast urgjent. Një rrugë e vështirë, ku trashësia e borës i kalonte 2 metrat, me të papriturat e saj... Dikush kujtohet për Taxhin, por Taxhi është kujtuar vetë. I gatshëm si gjithnjë ai do të ishte udhërrëfytyesi dhe udhëheqës i grupit për në fshatin Sllovë. Nuk binte borë, por të ftohtit priste brisk. Rrezik janë dhe orteqet, por mbi këtë rrezik ngrihet një mendim: "Çdo metër i fituar është shpresë jete për pacientin". Taxhi ecën vetë, por dhe ndihmon grupin mjekësor, duke mbajtur më të shumtën e pajimeve mjekësore. Pas 7 orë udhëtimi mbërrijnë në Sllovë. Megjithatë askush nuk është i qetë. Si do të dalë operacioni? Gëzimi i Taxhit i shfaqet në sy kur mëson se operacioni doli me sukses. Për jetën e njeriut, a ka sakrificë më të bukur?

Njerëzit e përgatitur fizikisht dinë t'u bëjnë ballë vështirësive. Dhe Taxhi kthehet i lehtësuar, për t'ua lënë të tjerëve fjalën. "Ngjarjet e këtyre ditëve flasin për heroikën e mjekëve tanë, por edhe të sportistëve të tillë si Taxhedin Shehu, që asgjë nuk kursejnë për jetën e njeriut, kapitalit më të çmuar të shoqërisë sonë socialiste", na thotë përgjegjësi i seksionit të shëndetësisë Qemal Çadri.

Gjyzel Hasani, 22 janar

Në mal gjatë dimrit -Disa këshilla praktike-

Kur bora bie me shumicë e jashtë normave të zakonshme, siç ndodhi këtë vit, ajo bëhet pengesë për lëvizjet, shkollat, qendrat e punës, etj. Për t'i kapërcyer këto pengesa del e domosdoshme që lëvizjet të bëhen të organizuara dhe me grupe ku çdo pjesëmarrës të zbatojë një disiplinë të rreptë dhe çdo veprim ta kryejë me përpikmëri.

- * Çdo person duhet të marrë me vete një kazmë alpine apo një shkop të trashë 1,5 m të gjatë, të cilën e përdor jo vetëm si mjet mbështetës e mbrojtës, por edhe si mjet vrojtimi e zbulimi në zona të caktuara (gropa, të çara, etj.).

- * Grupi prej 2-3 vetësh është mirë të ketë me vete dhe një litar që garanton ecjen e sigurt. Sidomos në zona me rrëshqitje nga pjerrësia ose me orteqe sigurohet jeta e njëri-tjetrit dhe në çdo rrethanë litari krijon mundësinë e shpëtimit të jetës së njeriut deri qind për qind.

- * Në zona me borë gjysmë të ngrirë ecja duhet të bëhet njëshkolonë dhe ku i vendos këmbët i pari duhet t'i vendosin gjithë të tjerët. Rekomandohet që gjatë marshimit të respektohen rregullat që grupet të çajnë borën me radhë.

- * Në rast se ka tufan duhet të vendoset shami ose shall mbi hundë për të penguar futjen e borës në rrugët e frymëmarrjes. Në tufan, grupi të mos ndalet sepse krijohen premisa për ngrirje ose për të shkaktuar dremitjen e deri te "gjumi i bardhë".

- * Gjatë lëvizjeve në zona të pjerrëta me rrezik për rrëshqitjen e borës ose rrezik orteku duhet që i pari nga i dyti, dhe ky nga i treti, të kenë një largësi prej 5 deri 15 m, duke siguruar shoku shokun me litar.

- * Në zonat me rrezik orteku nuk duhet folur, kënduar, vërshëllyer, qëlluar me gurë ose me armë. Të gjitha këto bëhen shkak për të krijuar ortekun. Zona që janë me pjerrësi 25 gradë janë zona orteku. Ka raste që në vende të zhveshura e pa pengesa të krijohen orteqe edhe në pjerrësi prej 15 gradë. Prandaj, vlerësimi i situatës garanton kalimin me sukses të zonës, duke qenë i lidhur dhe i siguruar.

- * Në radhë të parë duhet që zonës së ortekut t'i shmangemi, duke kaluar pak më gjatë në një itinerar më të sigurt.

Organizimi, disiplina, pajisja, kujdesi dhe zbatimi me rigorozitet i këtyre njohurive fillestare me bazë alpinistike, na siguron kapërcimin me sukses të çdo pengese e situatë.

Doc. Minella Kapo

Mbresa në vite **Pëllumbi i majave**

“Më të vështirën po e mbaj për vete, më të lehtë mbaje ti!”. Kjo shprehje që mund ta dëgjosh zakonisht në gojën e alpinistëve, do të na e rrisë konsideratën dhe respektin për Pëllumb Llabonishtin, alpinistin e klubit sportiv “Partizani”, mjeshtër sporti.

Nuk mund t’i harrojmë lehtë kujtimet e bukura që kemi me shokët e mirë. Kështu edhe me Pëllumbin ato që ruajmë nga ngjitjet e ndryshme në jug dhe në veri të Atdheut, në dimër dhe në verë, janë fare të freskëta. Disa herë, me kameran televizive, duke xhiruar një ngjitje, jemi ndalur për të detajuar përpjekjet, vështirësitë që shikon në çdo çast në këtë sport të guximshëm. E portretin e Pëllumbit e kemi fiksuar gjithnjë optimist, edhe në çastet e vështira të ngjitjeve. Po edhe në bllokun e shënimeve gjejmë të shkruara copëza bisedash, mbresa, ngjarje të shkurta, ku lexojmë edhe emrin e Pëllumbit, i cili e nisi këtë sport të bukur e burrëror që në moshën 16-vjeçare. Dhe e ushtroi atë me vullnet dhe pasion të admirueshëm, duke treguar një këmbëngulje dhe shpirt të lartë gare.

Një herë, gjatë një ngjitjeje në Bjeshkët e Namuna, vend ky nga më të thatët në verë, Pëllumbi kishte disa orë varur në shkëmb. Në paguren e tij vetëm disa pika ujë, se kështu e kanë alpinistët, me një pagure mund të kalojnë edhe tre ditë. Shkëmbi i nxehtë të shton etjen. Shoku poshtë tij nuk e ndiente veten mirë, dihaste. Pëllumbi sapo e pa i zbriti pagurin e tij, megjithëse ngjitja do të zgjaste orë të tëra. Asnjë nuk e pa.

Sapo kishim mbaruar xhirimin e një emisioni, kur na zuri shiu, një shi me erë në majë të malit. Pëllumbi pa folur hoqi mushmanë dhe mbuloi kameran. Na tha: “Duhet mbrojtur kjo se, veç të tjerave, me të ju fiksoni në film edhe historikun e sportit tonë!” dhe vazhdoi rrugën me ne nëpër shi.

I tillë ishte Pëllumb Llabonishti, mjeshtër sporti, titull që e meritoi me punën dhe pasionin për sportin. Alpinizmi e kaliti, i forcoi dashurinë për shokët, të cilën ai e shprehte me çdo punëtor të oficinës së riparimit të autoveturave, ku punonte si kontrollor cilësie. I tillë i dashur dhe i respektuar ishte edhe për njerëzit e familjes, për banorët e lagjes, e sidomos për shokët, që në çdo ngjitje të vështirë, ku ai nuk do të jetë më me ta, do ta kenë gjithmonë pranë si mishërimin e optimizmit dhe të sakrificës.

**Astrit Omeri, mjeshtër sporti,
Engjëll Ndocaj, 6 gusht**

1986

Kalendari Sportiv Kombëtar

- Sezoni dimëror për alpinistët e kategorisë së parë dhe mjeshtrat: në malet e rrethit të Topojës.

- 7 – 12 shkurt: sezoni dimëror për alpinistët e kategorisë së dytë në malet e rrethit të Tropojës, Shkodrës e Korçës.

- 5 – 10 korrik: sezoni veror për alpinistët e kategorisë së dytë në rrethin e Shkodrës e Tropojës.

- 18 – 27 korrik: ngjitjet e kualifikuara verore për alpinistët e kategorisë së parë dhe mjeshtrat në rrethin e Shkodrës e Tropojës.

Fjalë për bukurinë e sportit të alpinizmit

Në bazë të kalendarit sportiv kombëtar, nga data 17 deri më 26 korrik, në Alpe u zhvilluan me sukses ngjitjet verore me pjesëmarrjen e alpinistëve të kualifikuar. U punua në tre zona: në Qafën e Pejës, në Livadhet e Bogës dhe në afërsi të majës së Thatë.

Thonë që miqësia ruhet duke vajtur e duke ardhur tek njëri-tjetri. Por këtë të vërtetë të pakundërshtueshme e prish miqësia jonë me malet. Dhe kjo jo vetëm se midis nesh mungojnë bisedat dhe ngritja e dollive, por edhe për faktin se vetëm ne e marrim rrugën tre herë në vit për të vajtur tek ata.

Në dimër i gjejmë “të veshur” krejt në të bardhë, ndërsa në verë me atë “pëlhurën” ngjyrë grin në të errët, me ca njolla thuajse të bardha, që kur shkel mbi to ndien freskinë e dëborës së përjetshme. Ata na mirëpresin. Por kur ndonjë nga ne cënon ritet e kësaj miqësie, sa të madhe aq edhe unike, janë të pamëshirshëm dhe ndëshkojnë aq

rëndë sa nuk mund të korrigjohet. Është kjo arsyeja që të gjithë alpinistët, me mund e me pasion, stërviten gjatë gjithë vitit. Madje jo një, por vite e vite me radhë, për përgatitjen e gjithanshme fizike e teknike, psikologjike e taktike. Pa përvetësuar si duhet këto, është e pamundur të kacavjerresh në itinerarë të shkallës së lartë të vështirësisë, të ndahesh mirë me këta miq të ngurtësuar me përmasa gjigande.

Në mal nuk vemi asnjëherë vetëm. Mblidhemi në këmbët e tij dhe ndahemi tre nga tre (apo dy e dy). Çdo treshe (apo dyshe) lidhet në atë litarin (kolektiv) mbi 40 metra të gjatë. I pari është drejtuesi i ngjitjes, është më i përgatituri nga ana tenike e taktike, ka aftësi të mëdha për t'u kacavjerrur, për të gjetur ndonjë të dalë edhe në pllakën shkëmbore që të "mbërthejë" në të gishtërinjtë e dorës apo për të vënë majën e këmbës. Ai duhet të gjejë edhe ndonjë të plasaritur për të ngulur gozhdën alpine. Sa më i vështirë të jetë itinerari, aq më shumë gozhdë ngulen në shkëmb. Ato nuk i ngulim as për shenjë dhe as për bukuri. Në secilën prej tyre vihet një çelës. Në gjithë ata çelësa kalojnë ato 40 metra litar kolektiv, që është i vetmi mjet që bashkon forcat fizike dhe morale të të tre alpinistëve për të mos u shkëputur nga faqja shkëmbore; me fjalë të tjera, për të mos rënë në humerë. Gabimet në alpinizëm nuk "paguhen" as me marrjen e faullit apo humbjen e ndeshjes, por me gjënë më të shtrenjtë për njeriun - jetën.

Nga mënyra si rrëshqet litari në pëllëmbët e tyre, alpinistët me përvojë e kuptojnë se në ç'gjëndje është shoku (kur nuk e shohin dot) që kacavjerret para tij, e ka të vështirë apo shumë të vështirë.

Si ka siguruar mirë veten, jeton me shokun që punon (në shkëmb një lëviz, ndërsa dy të tjerët sigurojnë atë që është duke u kacavjerrur), por vëmendjen e ka gjithnjë të përqëndruar tek shpejtësia e rrëshqitjes së litarit. Ai ndjek me kujdes nëse kjo lëvizje mund të bëhet e vrullshme - shenjë që tregon se shoku u shkëput nga shkëmbi, ra. Në këtë situatë, fati i këtij varet nga mënyra si i ka ngulur gozhdët. Në rast se gozhdë më pranë vetes së tij është ngulur mirë, nuk shkëputet nga shkëmbi nga pesha e atij që është duke rënë, "fluturimi" i tij është 6-8 metra. Në rast se ajo nuk mban, "fluturimi" i tij do të jetë më i gjatë, por jo më shumë se 40 metra.

Po i dyti çfarë bën në këtë situatë që ndjell kob? Me të gjitha forcat e duarve duhet të ndalojë rrëshqitjen e litarit nëpër duart e tij.

Në rast se litari frenon në duart e tij, shoku i tij që ra do të qëndrojë, por pa qënë i takuar me shkëmbin. Si "merr veten", ai nis nga e para, vazhdon ngjitjen. Ndodh që litari i pret edhe lëkurën e pëllëmbëve të duarve të dytit, por ai duhet të bëjë të pamundurën që litari të të mos lëvizë qoftë edhe pak centimetra. Vetëm kështu ai siguron jetën e shokut dhe jetën e tij. Në rast se një nga të tre bie, dhe kryesisht i dyti nuk kryen rolin e tij, atëherë fundi tragjik është i njëjtë për të tre, të tre janë të lidhur në një litar, janë "në të njëjtën varkë".

Tek aftësia për të ngulur gozhdët në shkëmb (që ajo të mos shkulet) dhe tek aftësia e të dytit për të siguruar shokun si duhet qëndron "sekreti" që alpinistët nisen e kthehen shëndoshë e mirë. Nuk ka asnjë alpinist me përvojë që të mos ketë rrëshqitur ndonjëherë disa metra. Por ata kanë bindjen se respektimi i "sekretit" është e vetmja mënyrë për të shpëtuar shokun dhe veten nga çdo fatkeqësi në mundësi, që e shoqëron alpinistin aq orë sa vazhdon çdo ngjitje.

Këto operacione janë në gjëndje t'i kryejnë me mjeshtëri shumë alpinistë të klubeve sportive. Në afërsi të majës së Thatë (zona e Valbonës) u dalluan në mënyrë të veçantë Sokol Doko e Ilir Tapia të "17 Nëntorit", pa harruar Ismailin e "Përparimit", Nestin dhe Mihallaqin të "Skënderbeut", Gëzim Himën, Leonard Ramën dhe Agim Muçën të "Dajtit".

Ne i realizuam ngjitjet në ditët që, nëpërmjet radios, dëgjonim për të nxehtin e madh në qëndrat e banuara. Dhe ironia është që këtë lajm, që u përsërit disa herë, e dëgjonim në orët e vona të mbrëmjes të veshur mirë pranë zjarrit. Janë orët kur hidhen e priten rromuze, diskutohet për ngjitjet e ardhshme, janë orët e vetme që jemi të gjithë bashkë. Nga mjeshtrit Aleksandër Bojaxhi dhe Koço Ziso më të rinjtë dëgjojnë dhe mësojnë për ngjitjet e kaluara.

Kur kthehemi nga ngjitja nisim punën si amvise për të përgatitur ushqimin e për të prurë ujë. Ato orët e pakta të ditës kalojnë sipas dëshirës. Kështu, Petrika Janaqi bën një copë rrugë të mirë dhe nis e pikturon me bojëra vaji pejsazhe alpine. Ato janë më të arrira se ato që kanë vënë për të zbukuruar mjediset e godinës së Turizmit që është ngritur në Valbonë; ndonjë lexon, disa bëjnë përshkrimin e ngjitjes së kryer, të tjerë luajnë shah apo futboll me kufitarë e kooperativistë.

Grupi ynë (klubet sportive "17 Nëntori", "Dajti", "Minatori i T.", "Skënderbeu", "Përparimi" e "Kastrioti") nuk realizoi shumë ngjitje të shkallës së lartë të vështirësisë. Ishte një vetsakrifikim i

lavdërueshëm për të ndihmuar rrirjen e cilësisë sportive në të ardhmen. U piketuan më shumë se 10 itinerarë të rinj në malin e Rragamit, duke krijuar në këtë mënyrë një poligon të ri me vlera alpinistike. U krijua bindja se duhen zhvleftësuar nga komisioni teknik dhe kryesia e federatës disa itinerarë që për vite me radhë janë cilësuar të shkallës së lartë të vështirësisë në majën e Thatë, etj.

Siç shihet, me gjithë bukurinë e papërsërithsme të sportit tonë, jo gjithçka shkon si në vaj. Rritja e mjeshtërisë sportive të alpinistëve si dhe i numrit të tyre shtrojnë detyrën për të piketuar, përshkuar dhe vlerësuar itinerarë të rinj.

Kozma Grillo, komandat i ngjitjeve, 7 gusht

1987*Everesti fiton*

Eshtë bërë tashmë e zakonshme që çdo vit në majën më të lartë të botës ngjiten ekspedita të ndryshme. Sivjet në katër muajt e fundit mund të thuhet që Everesti e fitoi sfidën me alpinistët që iu kacavjerrën shpateve të tij legjendarë, duke mos arritur asnjëri prej tyre të ngulë flamurin në “çatinë e botës” - 8.848 metra e lartë. Bora e madhe dhe erërat e fuqishme këtë vit filluan shumë më shpejt sesa priteshin, megjithatë jo pak por 7 ekspedita tentuan të ngjiteshin para fillimit të dimrit. Katër nga ato synuan itinerarin nga ana e Nepalit, ndërsa tre të tjerat nga ana e Tibetit.

Nga ana e Tibetit, në fillim të shtatorit u nis një ekspeditë e madhe, qëllimi i së cilës ishte të shkelte në gjurmët e dy alpinistëve të famshëm anglezë, Zhorzh Li Melorit dhe Endriu Irvingut (alpinistë që u zhdukën në rrafshnaltën e veriut para gjashtë dekadash, më 24 korrik 1924 dhe që besohet se që të dy janë ngjitur në Everest). Por ekspedita amerikane e përbërë nga 24 alpinistë nuk mundi të shkojë më larg se lartësia 7.770 m.

Ekipi i dytë amerikan (pesë meshkuj dhe një femër) kishte për qëllim të ngjitej në majë dhe pastaj të zbriste me ballon. Pjesëtarët e këtij ekpi arritën deri në lartësinë 7300 m, ku ndaluan plotësisht të dërrmuar nga pesha e pajisjeve të rënda.

Nga ana perëndimore tentoi edhe një ekspeditë angleze që drejtohej nga Brami Stouks, fitues i ngjitjes së Everestit në vitin 1976. Qëllimi i kësaj ekspedite ishte të ngjitej nga drejtimi veri-lindje, një anë e papushtuar deri tani. Ekspedita arriti deri në lartësinë 7.925 m.

Nga ekspeditat që tentuan ngjitjen nga ana e Nepalit më këmbëngulëse ishte ajo e Zvicrës, e përbërë nga 25 alpinistë, që ndihmoheshin nga 10 vendës. 3 alpinistë arritën më 25 shtator vetëm 85 metra poshtë majës, por atje u detyruan të ndalojnë për shkak të kohës së keqe. Dy ditë më vonë, një ekspeditë e vogël franceze me 6 alpinistë arriti deri në lartësinë 8.600 m.

Me mossakses përfundoi gjithashtu edhe tentativa e ekspeditës së Zelandës së Re së bashku me një tjetër amerikane, ekspedita që përbëheshin me nga 5 alpinistë, nga të cilët vetëm njëri, në afërsi të majës, do të kryente vendosjen e flamurit. Neozelandezët morën leje për ngjitje nga fundi i shtatorit meqënëse u tërhoq një grup francez. Ata e nisën ngjitjen pa ndihmën e vendësve, por nuk ia arritën qëllimit.

Për sezonin e sivjetshëm të ngjitjeve në Everest, statistika tregon kështu:

Maja më e lartë e botës është pushtuar 209 herë. Dekoratën më të lartë të malit e kanë merituar 185 alpinistë meshkuj dhe 6 alpiniste femra. Mbi të gjithë dallohet nepalezi Sungdare që është ngjitur 4 herë në Everest.

J. Çela, 5 janar

Më shumë cilësi në ngjitje

- Numri i ngjitjeve të mos shërbejë për të mbuluar dobësitë teknike dhe mosinteresimin e klubeve sportive -

Në ditët aq të bukura të fillimit të shkurtit, në zonën Bogë-Ducaj dhe Ostrovicë të Korçës, alpinistët më të rinj të ekipeve të klubeve sportive “u ndeshën” me malin për sezonin dimëror.

Nën drejtimin e alpinistëve, tashmë me përvojë të lëvizjes sonë, Koço Ziso, Ylli Mullaraj, Kujtim Onuzi, Hasan Duro dhe Dashamir Fejzo, te rinjtë në këtë sport realizuan ngjitje të bukura, të gërshetuara me forma të larmishme të relievit. Kjo bëri të mundur që alpinistët të rrisin më tej mjeshtërinë sportive si dhe përvojën e tyre drejtpërdrejt me malin. Me interes ishin itinerarët në majën e Ostrovicës, në Pishterc e Mardom të Ducajt, si dhe në Rabë e Livati të Bogës.

Është e vështirë të dallosh ndër 115 pjesëmarrësit, për vetë karakterin më fort mësimor të këtyre ngjitjeve, se cilët u dalluan më tepër. Por vlen të theksohet përgatitja e mirë e ekipeve “5 Shtatori”, “Minatori” i Tepelenës, “24 Maji”, “Apolonia”. Gjithashtu, përmendim edhe përgatitjen e mirë të alpinistëve Ramadan Dumani (“31 Korriku”), Arben Kosta (“24 Maji”), Gazmend Zajmi (“17 Nëntori”), Gjok Mani (“Vllaznia”), Petrika Tonça (Skënderbeu”), Rait Mema “Minatori” i Tepelenës, etj.

Krahas arritjeve, të cilat, ndër të tjera, janë 500 ngjitje të realizuara, u vunë re edhe mangësi. Kështu, për shembull, në mjaft individë u dukën të meta në përgatitjen fizike, si dhe mosnjohje të teknikës së përdorimit të kazmës e litarit, pa folur për mosnjohjen e kthetrave aq të përdorshme në realizimet e transversave në terren të vështirë.

Këto mangësi lidhen me punën e pamjaftueshme të trajnerëve në procesin mësimor-stërvitor, me punën e pamjaftueshme që bëjnë ata në drejtim të ngritjes së tyre, si dhe ndihmës e kontrollit të pamjaftueshëm nga drejtuesit e klubeve. Dhe nuk po i cilësojmë se cilët janë më dobët, sepse kjo është një vërejtje që qëndron, me pak ndryshime, për çdo ekip. Edhe mangësitë në pajisje me bazë materiale,

më të theksuara këto në ekipet e formuara tani shpejt, flasin se klubet duhet të rrisin interesimin e tyre për këtë sport burrëror e me vlera aplikative.

Alpinizmi, ky sport me amatorë aq të pasionuar, ka arritur vlera cilësore mjaft të mira këto kohët e fundit. Me më tepër interesim nga klubet dhe trajnerët, arritjet do të jenë edhe më të larta.

A. Bojaxhi, 16 shkurt

Me "pushtuesit" e majave...

- Mes vështirësive dimërore, 17 alpinistë
ngjisin majat e Alpeve -

Në Alpe, prej 17 deri më 26 shkurt, u zhvilluan ngjitjet alpinistike të sezonit dimëror me pjesëmarrjen e alpinistëve të kategorive të larta. 85 alpinistët e këtij aktiviteti punuan në tri zona: Livadhet e Bogës, Qafë Pejë e Valbonë, duke formuar një bosht Perëndim- lindje, që kalon nëpër majat më me interes alpinistik. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte pushtimi i majave të tilla si Radohima - Rushkulli-Jezerca-Paplluga-Boshi, etj., nëpër itinerarë të njohur, si dhe të rinj. Për të informuar më hollësisht lexuesit mbi ngjitjet e kryera në këtë numër po junjohim me veprimtarinë e grupit që punoi në Valbonë.

Dëbora e shumtë që ra në pjesën lindore të Alpeve dhe temperaturat e ulta, na e paraqitën fshatin piktoresk të Valbonës me madhështinë e veçantë alpine, bardhësinë e pafundme, e cila nga qendra e luginës ngrihet shpateve të maleve me pyjet e dendur e bredhat hijeshues, që sipër i lënë vendin majave të zhveshura e krenare. Majat e thikshme, që si shigjeta ngrihen drejt qiellit, me dëborën që mbajnë mbi vete, duken si kristale gjigande që mbyllin luginën e të joshin për t'u ngjitur në to. Poshtë, lumi i Valbonës, si një kordele e kaltërt valëvitet tejmbanë luginës.

Në këtë bardhësi joshëse, me bukuritë e ashpërsitë e natyrës dhe relievit, erdhën 30 alpinistë të klubeve "5 Shtatori", "Luftëtari", "Kastrioti", "Skënderbeu", "Labinoti", "Përparimi" dhe "17 Nëntori".

Fillimisht u pushtuan majat e Rosit dhe Valbonës. Përmes borës dhe mjegullës, alpinistët punuan me durim, optimizëm dhe ia dolën mbanë. Mazllëmi, Meleqi, Petrika e Iliri ishin më optimistë e më të vendosurit për arritjen e sukseseve të para.

Puna e mirë e drejtuesve të togave u shfaq në etapën e dytë të ngjitjeve: Kujtim Ibrahimit tregoi vlerat e tij në pushtimin e majave të

Boshit e Zhaborës, Kasem Krasniqi në arritjen e majave të Papllugës e Jezercës, kurse Sokol Doko në drejtimin e ngjitjeve në Çet Harushë e Peçmarë.

Etapa e tretë e ngjitjeve filloi më 24 shkurt, ku i gjithë grupi iu drejtua majës së Rragamit. Kushtet e dëborës së madhe, temperaturës së ulët dhe tufanit të mbarsur me dëborë të thatë, ishin pengesat kryesore gjatë gjithë ngjitjes. Me gjithë këto vështirësi, pas 7 orë përpjekjesh, 17 alpinistë mundën të arrijnë majën. Një fitore e bukur, por jo pa dëmtime: 7 vetë pësuan ngrirje të lehta.

Në etapën e fundit u ngjitën dy maja në malin e Kollatës, që formojnë vlera të reja alpinistike për ngjitjet në këtë zonë.

Në përfundim të aktivitetit vlen të veçohen për përgatitje të mirë dhe rezultate të larta alpinistët Sefer Tema e Iliaz Shuli të "Kastriotit", Esat Matmuja e Ismail Domi të "Përparimit", Kujtim Ibrahim i "Labinotit", Ilir Tapia i "17 Nëntorit", Petrika Janaqi i "Skënderbeut", etj. Për të 11 majat e ngjitura, si individë u realizuan 130 ngjitje me mesatare 4,2 ngjitje për çdo alpinistë. Si klube u dalluan "Skënderbeu", "Përparimi", "Kastrioti", "17 Nëntori". Më tepër vetmohim duhet nga alpinistët e klubeve "Luftëtari" e "5 Shtatori".

* * *

Krahas arritjeve, aktiviteti nxori në pah dhe dobësi e mangësi, të cilat lidhen drejtpërdrejt me punën më të kujdesshme që duhet të bëjnë trajnerët e ekipeve në procesin stërvitor, si dhe inspektorët përkatës, që mbulojnë këtë sport pranë klubeve

1. Kështu, për shembull, spikat puna e pamjaftueshme në stërvitje si në problemet e teknikës ashtu dhe të përgatitjes fizike.

2. Në mjaft ekipe dominon mosha 30 vjeç e lart (nga të 30 pjesëmarrësit nën 30 vjeç ishin vetëm 6 alpinistë: 3 nga "17 Nëntori", 1 nga "Skënderbeu" dhe 2 nga "Kastrioti". Kjo flet për plakje të ekipeve dhe për një punë të pamjaftueshme në freskimin e ekipeve me mosha të reja, krahas të vjetërve aq të nevojshëm në këtë sport. Proporcionet duhet të jenë të tilla, që e kipi të ketë tonus fizik krahas përvojës së malit.

3. Gjithashtu, u pa se ka ekipe që vijnë në aktivitet pa synime e plane konkrete për ngjitje. Ngjitjet i kryejnë pothuajse gjithmonë si ua parashtron shtabi drejtues. Kjo vjen edhe nga që ekipet i njohin

pak itinerarët dimërorë ose aspak, sepse kryesisht në sezonet verore merren thjesht me shkëmbin, pa interesa vrojtimi e soditje për itinerarët e shumtë që çojnë në qafa e maja. E në këto situata të kujtohen mjaft alpinistë të vjetër, që sot e kanë varur kazmën alpine, të cilët që në rininë e tyre ishin së pari mjeshtër të shtigjeve të Alpeve. Alpinistët tanë sot fare mirë mund të kompletojnë njohjen e shtigjeve në zonat ku punojnë me një punë më të organizuar nga trajnerët ose drejtuesit e aktiviteteve në stinën e verës.

4. Alpet tona janë një det i tërë me maja. Por ndër to çdo mal ka maja kryesore dhe maja të dyta. Ka plot raste që pikërisht majat e dyta të një mali janë më me shumë vlera se ato kryesoret. E sot kur alpinizmi ynë i ka zotëruar majat kryesore nëpër itinerarë të ndryshëm, është me vlerë shtrirja edhe në majat jo kryesore. Kjo do të rriste shkallën e njohjes së maleve dhe do të shtonte plotshmërinë e zotërimit të tyre. Gjthashtu, kjo do të shtonte më tej interesin e disa alpinistëve për ngjitje, të cilët, për shembull, kanë ngjitur 5 herë majën kryesore dhe kanë humbur “dëshirën” për ta ngjitur rishtaz.

5. Është e pafalshme për klubet “Përparimi” e “Kastrioti” që kanë ekipe të mira alpinistësh dhe nuk mundohen për kompletimin e tyre me bazë materiale etj, si dhe klubi “5 Shtatori” që ka mangësi të theksuara.

Aleksandër Bojaxhi, drejtues i aktivitetit, 9 mars

Mjeshtër në punë dhe në sport

Megjithëse vetë titulli i shkrimit bën fjalë për një mjeshtër sporti, ne nuk kemi qëllim të bëjmë thjesht një portret sportiv. Këtë radhë me Gëzim Oruçin, alpinistin e “Vllaznisë”, po bisedojmë për punën e tij si novator i talentuar në uzinën “Drini”. Shkas për këtë bisedë u bë një diskutim që po bëhej këto ditë në sheshin e lagjes “Qemal Stafa” të qytetit të Shkodrës, ku me zgjerimin e tij do të ngrihet një shatërvan me përmasa që t’i përshtatet mjedisit përreth.

Gëzimi është i njohur jo vetëm në këtë rreth, por edhe në të tjerë për punën e tij novatore. Ai është anëtar i bërthamës shkencore të repartit të makinerisë së rëndë në uzinë dhe bashkë me shokët ka arritur të bëjë me sukses modifikimet themelore të makinerive të rënda

vetëshkarkuese 3-40 tonëshe, të modifikojë motorë të buldozerëve dhe ekskavatorëve me motorë të tjerë e mjaft pajisje të tjera, të cilat kanë ndikuar në rritjen e efektivitetit të punës. Tani Gëzimi po punon me pasion për të vënë në funksionim shatërvanin e ri, në qendër të qytetit. Për këtë ai ka punuar duke shfrytëzuar literaturë bashkëkohore, ka ndjekur nga afër funksionimin e tyre në kryeqytet etj. Shatërvani është prodhuar nga ky novator i talentuar dhe do të vihet në punë së shpejti. Së bashku me të do të përgatitet edhe një basen, ku nëpërmjet 2500 sprucatorëve, do të shpërndahet uji që është grumbulluar aty. Pra, është i përmasave jo të vogla.

Duke qenë alpinist ai është marrë me pasion edhe me zbulime arkeologjike. Si spelolog ai ka vërtetuar dhe studiuar shumë shpella të vendit tonë, ne veçanti në Alpe, ku më të njohurat janë ato të bëra në Shpellën e Gajtanit, Jubanit, etj. Gjithashtu ka marrë pjesë si bashkëpunëtor në zbulimin e autografit të Shtjefën Gjeçovit, vend, i cili ka marrë emrin "Shpella e Gjeçovit".

Kështu si bashkëpunëtor i aftë i qendrës së kërkimeve arkeologjike në Tiranë, i muzeut popullor në Shkodër, me punimet e tij në këtë fushë ai është përsëri novator që duhet përgëzuar. Dhe bisedojmë me Gëzimin për punën e tij si novator. Ai thotë: "Ngjitjet alpinistike, zgjidhja e mjaft vështirësive në pushtimin e majave (ai nuk ka majë mali që të mos jetë ngjitur) më kanë inkurajuar të jem i guximshëm edhe në punën e përditshme. Duke i hyrë me kurajo mjaft problemeve teknike në punë kam arritur që të mos ndodhem para të papriturave".

Gëzimi si alpinist i njohur po kontribuon me krijimin e një fototeke të pasur me plot 35.000 negativa, ku janë fiksuar pamje të natyrës së bukur e madhështore të vendit tonë, të gëzimit të alpinistëve kur arrijnë suksesin, si dhe ka dorëzuar në muzeun sportiv "Vllaznia" një monografi mbi zhvillimin e alpinizmit në vendin tonë gjatë viteve të pasçlirimit. A nuk është dhe kjo një punë novatore? Dhe pikërisht për këto "e zgjodhëm" Gëzimin në këtë pragfeste të novatorëve, për të skicuar sado pak nga portreti i tij. Sepse mjeshtri i sportit Gëzim Oruçi është gjithnjë i palodhur, e mjeshtër jo vetëm në punë si mekanik, por edhe në sport...

Namik Mehmeti, 7 shtator

1988

Amundseni, zbuluesi i madh i poleve

Në tetorin e vitit 1972, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Rual Amundsenit, në përkujtim të përpjekjeve titanike dhe heroizmave të tij mbinjerëzore për zbulimin e poleve, katër eksploratorë norvegjezë, bashkatdhetarë të tij, kryhen një heroizëm të ngjashëm me atë që kishte bërë ai treçerek shekulli më parë. Me slita dhe ski ata përshkuan rreth 5.000 kilometra rrugë të bardhë, duke shfrytëzuar edhe lëvizjen e masave të akullit, duke e kryer bëmën e tyre në qershorin e vitit 1973. Ata u nisën nga ana e Arktikut që sheh nga Europa dhe, pasi përshkuan Veriun, dolën në anën që sheh nga Amerika.

Amundseni konsiderohet me të drejtë udhëtari dhe eksploratori më i madh polar, për sa i përket studimeve të tij gjeografike. Ai arriti i pari në Polin e Jugut dhe qe gjithashtu i pari që fluturoi me aeroplan nga Europa në Amerikë (pikërisht nga ishulli Spicberg në gadishullin e Alaskës), duke kaluar nëpër Polin e Veriut. Ai kaloi i pari me anijen e vogël "Jea" prej oqeanit Atlantik në oqeanin Paqësor nëpër "Shtegun veriperëndimor", afër brigjeve veriore të Europës e të Amerikës, duke u bërë kështu lundërtari i parë dhe deri atëherë i vetëm, që u kaloi pranë të gjitha brigjeve të Oqeanit të ngrirë të Veriut.

Në këto bëma pothuaj mbinjerëzore, dhe të tjera sikurse kanë shkruar biografët e tij, bashkëkohësit që e njohën nga afër dhe ai vetë në ditarin e tij, e ndihmuan shumë kalitja e organizmit dhe përgatitja fizike, pa të cilat as që do të merrte guximin të shkonte e të vihej përballë vështirësive të pakapërcyeshme të klimës polare, ngricës dhe temperaturave me dhjetëra shkallë nën zero, tufaneve të borës, akullnajave dhe shkretëtirës së bardhë.

Amundseni lindi më 16 korrik 1872 në Sapsborg, një ishull që ndodhet në hyrjen e fjordit të Oslos, në jug të Norvegjisë. Bir i një armatori të thjeshtë anijesh bregdetare me vela. Ai u rrit në një mjedis familjar dhe detar të ashpër. Ende shumë i ri, ndjeu t'i ndizej një

dashuri e madhe për detin, udhëtimet, aventurat. Dhe kur njohu bëmat e bujshme të eksploratorit Nansen, u mbush me admirimin për të dhe u pushtua vetëm nga një ide: të zbulonte kalimin veriperëndimor, duke kaluar zonën polare veriore, sipër kontinentit amerikan.

Për t'i arritur këtij synimi të vështirë i duhej të bënte përgatitje në dy drejtime: ta përgatiste veten si detar i zoti, i fortë dhe i durueshëm, i gatshëm për të përballuar çdo vështirësi, si dhe të ftohtin e zonave polare nëpër të cilat do të lundronte. Për këtë e mësoi trupin dhe organizmin e tij me kushtet që do të përballonte gjatë lundrimit. U kaloi në të ftohtin më të madh, vishej lehtë, lahej me ujë të akullit edhe në dimër, ushtrohej çdo ditë, si do që të ishte moti, me vozitjen dhe notin, bënte me dhjetëra kilometra ecje-rendje me ski dhe ngjitje në malet e veshura me borë e me akull.

Aventura e madhe dhe e rrezikshme, që filloi më 17 qershor 1903, zgjati afër tre vjet. Anija e vjetër dhe e vogël lundroi në jug të ishullit të Groelandës dhe çeli, me një guxim që për atë kohë ishte çmenduri, një rrugë nëpër labirintin e tmerrshëm të ngushticave dhe të kanaleve të ngrirë që gjënden në veri të Kanadasë.

Një vit më vonë eksploratori kishte një projekt tjetër: të arrinte Polin e Veriut. Amundseni u nxitua të bënte përgatitjet e duhura. Në mënyrë të veçantë i kushtoi kujdes të madh përgatitjes së tij fizike e morale për të mundur vështirësitë, për të kaluar privacionet dhe rreziqet që e prisnin. Sepse e dinte nga përvoja e tij se vetëm një trup i kalitur në shkallën më të lartë mund t'i bënte ballë shkretëtirës polare me të gjitha vështirësitë e pakapërcyeshme dhe të papriturat e frikshme të saj. Në mënyrë të posaçme u përgatit për udhëtime të gjata me sajë e me ski dhe për ngjitje e kacavjerrje në faqet e të përpjetat akullnajore. Nga ditari i tij, mësojmë se, veç të tjerave, bënte çdo ditë ecje-rendje me ski deri në 50 kilometra.

Kur përgatitjet kishin përfunduar mori vesh lajmin se Robert Piri kishte arritur në Polin e Veriut. Por ai nuk u dëshpërua, vetëm sa ndryshoi planin e tij. U nis për të zbuluar Polin e Jugut. "Frami", anija me të cilën u nis, ngriti spirancat më 6 qershor 1910, me 22 njerëz në bord dhe aty nga mesi i janarit të vitit 1911 arriti akullnajat e mëdha që rrethojnë kontinentin Antarktik. Hyri në Gjirin e Balenave të detit Ros. Atje, nja 1.350 kilometra larg polit, Amundseni shkarkoi pajimet, mjetet dhe ushqimet, 120 qentë e ekspeditës dhe ngriti mbi

shtresën e akullit, një kamp të ngulitur. “Frani” u nis, duke lënë midis akullnajave të përjetshme 9 njerëz dhe ushqime e mjete të tjera.

Ecja e tyre qe shumë e ngadalshme për shkak të të çarave të akullit, të majave të mprehta, të shtresave që dukeshin të sheshta po që ishin tinzare. Temperatura ulej deri në 50 gradë nën zero dhe ndonjëherë erërat polare të quajtura “bizard” shpërthenin me zemërim të papërmbajtur. Pas përpjekjesh titanike, pesë kreshnikët ngjitën rrafshnaltën ku ndodhet Poli i Jugut dhe më 14 dhjetor 1911, pasi kishin ecur me saja e me ski afër dy muaj, Amundseni dhe shokët e tij ngritën, të parët në botë, flamurin e Norvegjisë në Polin e Jugut.

Sabri Çelnikasi, 29 janar

Me alpinistët në Ostrovicë...

- Ngjitje në 5 majat më të larta të zonës -

Shkurti në Korçë erdhi me dëborë, pikërisht në fillim të tij, dhe si për të treguar se ka ende dimër, që në javën e parë çfryu dufin e vet. Dhe një ditë të ftohtë shkurti, në malin e Ostrovicës, 60 alpinistë të klubeve sportive “Skënderbeu”, “Vllaznia”, “Labinoti”, “24 Maji”, “Valbona”, “Minatori”. “Kastrioti” e “Tërbuni”, nën drejtimin e mjeshtrit të sportit Nuredin Seci e Petrika Janaqi, nisën ngjitjet e kategorive të ulta dhe për 7 ditë me radhë pushtuan me sukses 5 majat më të larta të zonës.

Mëngjes. Alpinistët të rreshtuar në katër toga nisen drejt majave. Më të përgatiturit prijnë, japin përvojën, këshillojnë, por japin edhe urdhëra të prera për ndonjë pakujdesi. Këtu ndryshon diçka me sportet e tjerë. Nuk ke kundërshtarë ekipesh, se të gjithë kanë një qëllim të përbashkët: të pushtojnë majat.

Pas çdo ngjitjeje, në fshatrat ku janë vendosur kampingjet e alpinistëve, mikpritja korçare zë vendin e vet. Alpinistët janë bërë banorë të dashur të kësaj zone. Mbrëmjeve rreth zjarrit, bisedat janë nga më të ndryshmet: për sportin, artin, për kampionatet tona kombëtare që janë bërë aq intresante këtë vit. Në shtëpinë e xha Axhemit, në fshatin Shtyllë, biseda vërtitet rreth blegtorisë. Nuredini është mbërthyer në bisedë me të, pasi edhe i jati i tij është blegtor. Xha Axhemi flet për rezultatet në rritje të blegtorëve të kësaj zone malore. Ai flet jo si një 80-vjeçar, por sikur të ishte djalë i ri.

Në mëngjesin e ditës tjetër, grupet alpine i drejtohen një maje tjetër, asaj të Faqekuqit, mbi 1.600 metra e lartë. Në fillim dëbora duket e shkrifët, por duke u ngjitur më lart, ajo e shton trashësinë dhe në sipërfaqe është e ngrirë. Ngjitja vazhdon në njëshkolonë e Petrika udhëzon për të shmangur ndonjë rrëshqitje të mundshme. Herë pas here, alpinistët ndërrojnë njëri-tjetrin në krye të vargut. Por, Nuredini sikur e ndjen veten më të lehtësuar kur prin i pari, jo se nuk ka besim te të tjerët, por e ha merakun.

Në majë çdo gjë është e ngrirë. Bën ftohtë dhe të gjithë detyrohen të veshin xhëmbat, pasi janë edhe të djersitur. Maja e Faqekuqit u pushtua me sukses dhe alpinistët urojnë njëri-tjetrin e përqafohen.

Në mbrëmje alpinistët ndodhen në Vithkuq. Dikush bën shaka me Ilmiun dhe Edmondin nga Shkodra. Petrika nga Korça ia ka marrë një kënge korçare, pak më tutje Ganiu nga Puka e Lulzimi nga Tepelena ia kanë shtruar një muhabeti vendçe. Mungon në këtë grup alpinistësh vetëm komisar i ngjitjeve, Petrika Janaqi. Dikush na tha se ai është duke hedhur në telajo një peizazh nga fshati Shtyllë, pasi është i talentuar edhe në pikturë.

E aty, rreth zjarrit që shkëndijon tek dëgjojmë e shikojmë atë atmosferë aq gazmore e të këndshme, na duket sikur ndodhemi në gjirin e një familje të madhe.

Tonin Frroku, 26 shkurt

Me alpinistët

Sipas kalendarit sportiv kombëtar, nga data 17 deri më 26 shkurt u zhvilluan ngjitjet e kualifikuara dimërore. Alpinistët tanë më të mirë, të ndarë në tre grupe, punuan në tre zona në Alpe: në Qafën e Pejës, atje ku ndahet Kelmendi nga Dukagjini dhe në Valbonë.

Kur rrugëton i vetëm të pushton një mpirje e lehtë dhe të lindin mendime të palidhura me njëra-tjetrën. Nuk e di përse m'u kujtua që në fillim të këtij shekulli shtegtonte bri këtij lumi një i huaj. I magjepsur nga bukuria e rrallë e natyrës, si gjithë eksploratorët, gjuajti me pushkë dhe thirri:

“Zbulova një tokë të re!”.

Shumë ujë ka rrjedhur në shtratin e gurtë të Valbonës nga çasti kur u dëgjua ajo krismë, shumë ndryshime janë bërë edhe në mendësinë dhe jetën e këtyre malësorëve. Po mjaftohem vetëm me një. Atje ku nis rrjedhën ky lumë është ngritur një shkollë 8-vjeçare. Në katër klasat e larta (V-VIII) të kësaj shkolle mësojnë gjithë-gjithë 21 nxënës. Klasa e 8-të ka vetëm dy nxënës. Rast unikal ky që në një klasë sheh më shumë mësues se nxënës, por ky rast tregon aq shumë për kujdesin e shoqërisë sonë që edhe në Rragamin e largët fëmijët të marrin arsim e kulturë.

Vitet e fundit atje vajti edhe rruga automobilistike. Ndoshta ky detaj nuk do të kishte vend në këto mbresa. Por ja që jo vetëm për çudinë time por edhe të malësorit më të moshuar nuk është parë që më 20 shkurt të shkoje me automjet në fshatin Valbonë. Ishim mësuar të shihnim kullat e këtij fshati si të kalonim mbi orteqet e shumtë të rënë në grykën e Dragobisë, që nga një herë krijonin atë “urë” gjysëm të akulltë, mbi të cilën kalonim nga një breg në tjetrin të Valbonës. Sigurisht që asnjëherë nuk na kishte shkuar në mendje të shijonim këtë “kënaqësi” që të josh për rrezikun që mbart.

Sapo zbritëm nga makina shkundëm pluhurin që krijon rruga e paasfaltuar. Ishin ditët e fundit të dimrit dhe Valbona nuk ishte e zbardhur. Dëborë kishte vetëm në lartësinë mbi 900 metra. Një dimër që nuk e ndeshim në ditarin e alpinizmit tonë.

Të parin që takova ishte komandati i ngjitjeve, mjeshtri i

merituar Petraq Kule, një ndër pionierët e alpinizmit tonë, me të cilin më lidhin ngjitjet e këtyre 33 vjetëve që kemi bërë bashkë. Petraqi të bën për vete jo vetëm për aftësitë po edhe për dashamirësinë e gatishmërinë për t'u ardhur në ndihmë të tjerëve, për t'u krijuar të gjitha mundësitë më të rinjve të ngjiten në shkallët e cilësisë së lartë me hap të sigurt dhe më të shpejt se hapi që hodhëm ne në moshën e tyre.

Toga e parë që u kthye nga ngjitja ishte ajo që drejtohej nga Avdi Zholi (me alpinistët e Progonatit të Tepelenës dhe të "Tomorrit"). Na tregojnë si e kishin kryer ngjitjen në Kollatë. Duke i përgëzuar, m'u kujtua se disa dimre më parë u raskapitëm 16 orë me radhë dhe nuk mbëritëm dot në majën e këtij mali, që shumë njerëz ia kanë mësuar emrin nga vargjet e rapsodisë së bukur:

*"Ç'ka Kollata që gjëmon,
Bajram Curri po lufton..."*

Nuk kishte kaluar ora dhe mbërritën alpinistët e "Valbonës", "24 Majit" dhe të "Dajtit" të drejtuar nga Ibish Doçi (bashkë me atë është edhe doktor Azir Malaj, i cili i njeh këto bjeshkë me pëllëmbë se dikur vinte e ruante bagëtinë) që kishin pushtuar majën Ismet Sali Bruçaj. Më parë kjo majë quhej Grykat e Hapura. Vite më parë, në një ditë të egër dimri vendosëm, pas shumë peripecive, mbi të një pllakë mermeri, të shkruar sipas Dekretit të posaçëm të Presidiumit të Kuvendit Popullor, për të përjetësuar jetën dhe veprën e mësuesit hero Ismet Sali Bruçaj.

Toga e parë e drejtuar nga Ilir Tapia (e përbërë nga alpinistët e "17 Nëntorit" dhe të "Apolonisë") u kthye nga Maja e Rinisë (Jezerca), që aq shumë emocione u krijon alpinistëve në stinën e dimrit. Është "kripa" e Alpeve. Rruga për të vajtur tek ajo kalon bri majës së Thatë, ku pak vite më parë u nis drejt saj shoku ynë, aq i mirë, Pëllumb Llubanishti dhe nuk u kthye më...

Një nga arritjet cilësore të këtij dimri ishte marrja e majës së Gavnit. Ajo gjithnjë i ka joshur alpinistët, jo vetëm për lartësinë dhe që është larg nga Valbona, por edhe për atë kalimin e vështirë, për kalimin e asaj tranverse. Ata që e sulmuan u nisën pa zbardhur dita. Mbas 3-4 orëve mbërrin në fillimin e një kreshte dhe merr për në Shtegun e Dëshëve. Heshtjen e prish komandati i ngjitjes, duke u thënë të qëndrojnë dhe të kontrollojnë si i kanë lidhur litarët, kthetrat,

si është “shëndeti” i kazmës alpine. Pas disa metrave zbritje të thikshme, por që këtë vit nuk jetuan me druajtjen e rrezikut të rrënies së ortekut, merr djathtas për të përshkuar atë tranversë (ecje pa humbur dhe pa fituar lartësi) që e bën malin e Gavnit në dimër të vlerësohet me shkallën më të lartë të vështirësisë. Në kalime të tilla demonstrohet e gjithë përgatitja disavjeçare e alpinistëve, si ajo fizike ashtu dhe ajo teknike e psikologjike, forca për t’u përqendruar që bën të “harrosh” se temperatura është shumë gradë nën zero. Për këtë alpinistët nuk kanë nevojë për mjet matës të temperaturës, ata e kuptojnë atë si nga shndërrimi i vetullave e qerpikëve në “shkopinj” të hollë akulli ashtu dhe nga fakti që dorezat ngjiten në pjesën metalike të kazmës. Ata që e bën këtë kalim për herë të parë në dimër do t’u japin të drejtë paraardhësve dhe bashkë me këtë do të kenë një “kujtim” të vogël - pasojë e të ftohtit dhe ecjes mbi kthetra për orë të tëra...

6 ditët e para të kësaj veprimtarie alpinistët punuan me entuziazëm dhe patën “breqet”. U duhej ky për të kompensuar mosarritjen e objektivave vitin e kaluar. Së rrallë herë mesatarja e shkallës së vështirësisë së ngjitjeve që u realizuan ishte thujse 5, nga 6 që është shkalla më e lartë.

Më 4 shkurt nisi dëborja. Filloi shtruar dhe nuk u lodh së rëni. Distancën prej 26 kilometra për në qytetin Bajram Curri e përshkuam me çantën në krah, si çdo dimër tjetër. Kur mbërritëm në qytet mësuam nëpërmjet aparatit televiziv se trashësia e dëborës në Rragam kishte arritur dy metra e gjysëm...

Kozma Grillo, 10 mars

Me alpinistët në Alpet e Veriut
- Të dy grupet arrijnë majën e Jezercës -

Udhëtoj me grupin e alpinistëve që është drejtuar për në Qafën e Pejës, i cili ka detyrën më të vështirë. Stacioni i fundit i autobusit është Boga. Sapo zbresim, takohemi me malësorët, të cilët janë miqtë tanë të vjetër e ku çdo alpinist ka të njohur. Mbas pak përgatitim çantat dhe nisemi. Miqtë na urojnë sukses dhe kohë të mirë. Grupi ynë përbëhet nga alpinistët e klubeve të "Vllaznisë", "Flamurtarit", "Korabit", "Kastriotit", "Studentit" dhe "31 Korrikut". Komandat i ngjitjeve është mjeshtri i sportit Veliqar Velaj...

Mbas dy orësh arrijmë në Qafën e Thores, një ndër qafat më të larta të vendit tonë. Është e mbuluar me mbi një metër dëborë, e cila në sipërfaqe ka një shtresë akulli. Kalimi i kësaj zone kërkon kujdes të veçantë se rrëshqitja të shpie në humnerën që përfundon në Ndërlisaj, qindra e qindra metra poshtë. Sigurohemi. Pas një ore vështirësitë kalohen me sukses dhe ndodhemi sipër kthesës së fundit të rrugës së Qafës së Thores, nga ku fshatin piktoresk të Thethit, duket sikur e sodit nga dritarja e një avioni. Përreth duken malet e larta të Alpeve, sikur janë tubuar aty në një vend, për të na pritur ne me veshjen e tyre të bardhë. Fillon zbritja. Në mesin e alpinistëve dëgjohen shakatë e Shuaipit të "Vllanisë" e Xhepit të "Studentit". Rugëtojmë për në Theth. Rruga zgjati 5 orë.

Ngrejme kampingun tonë alpin dhe përgatisim darkën e parë. Megjithëse jemi rreth zjarrit të madh që tashmë na pëlqen ta quajmë zjarri partizan, kemi veshur të gjitha sa kemi. Koha është ftohur së tepërmi. Të nesërmen bëhet mbledhja e shtabit, ndahen detyrat dhe diksutohet për ngjitjet që do të bëjmë, duke nisur me sulmin drejt një 1.700 metërshi tjetër, Qafës së Pejës, kampingu bazë nga do të sulmojmë majat e planifikuara.

Në Qafën e Pejës

Tashmë ngjitjet kanë filluar dhe kanë hyrë në pikun e tyre. Në çdo ngjitje vërehet seriozitet, këmbëngulje e guxim, karakteristika këto që i shquajnë alpinistët tanë. Temperatura zbret në minus 20 gradë. E gjithë zona është tërësisht e ngrirë, çdo lëvizje e bëjmë me kthetra. Janë orët e para të mëngjesit. Ekipet e "Vllaznisë" dhe të "Flamurtarit"

rrugëtojnë drejt masivit qëndror të Alpeve, drejt Jezercës (Maja e Rinisë) 2.693 m. Ngjitje kjo nga më të vështirat në Alpe. Grupi udhëhiqet nga Veliqar Velaj dhe komisar i ngjitjeve Kujtim Gjylbegu.

Ruga është e vështirë dhe plot të papritura. Akulli i madh të pengon të eëcsh, me vështirësi ecim përpara. Mjegulla e akulli na i vesh vetullat, qerpikët, krejt trupin. Kazmat alpine kanë punë. Ato hapin kllapa në faqet e thepisura të kësaj maje. Në të tilla rrethana disiplina në ngjitje është e lartë, asnjë gabim nuk të falet në këtë vend të akullit, ku shkëmbinjtë me akullin janë bërë një.

Ja, Aleksandër Tafili dhe Piro Dumani bëjnë sigurim me kazëm, lëvizin me siguri. Theodhori Shyti e Bujar Mezini përparojnë drejt majës në itinerarin jug-perëndim. Veprojnë alpinistët shkodranë në një itinerar mjaft të vështirë. Eshtë hera e dytë që përshkohet ky itinerar gjatë këtyre viteve të fundit. Ngjitemi, udhëheqin Kujtimi me kandidatmjeshterin Shuaip Isufi, të cilit nuk i mungon talenti edhe për kuzhinier, detyrë për të cilën shquhet. Me humorin e tij sikur na e lehtëson ngjitjen, ku të tërheq vëmendjen buzëqeshja karakteristike e Ali Galicës, pa harruar edhe veprimet e matura të Kastriot Çerkezit, i cili nën drejtimin e më të talentuarve premtos për t'u bërë një alpinist me vlerë.

Hap pas hapi i afrohemi majës, pikës më të lartë të Alpeve. Suksesi është i plotë, të dy grupet arrijnë në majë dhe në këto raste nuk mungojnë përçafimet, shtrëngimet e duarve, emocionet. S'ka gëzim më të madh se kur realizon qëllimin. Por, kjo kërkon një stërvitje me temp të lartë gjithëvjetor.

Në përfundim, shtabi drejtues bën vlerësimin . Dallohen te gjithë ekipet e në veçanti alpinistët Sh. Isufi i "Vllaznisë", A. Tafili i "Flamurtarit", R. Hysa i "31 Korrikut", V. Memisha i "Studentit", Z. Tusha i "Korabit" si dhe S. Tema i "Kastriotit" të Krujës.

Gëzim Oruçi, mjeshtër sporti, 11 mars

Guximi i alpinistëve tanë

- Gjatë 33 vjetëve faqen jugore të Arapit e kishin mposhtur vetëm 4 alpinistë, ndërsa këto dhjetë ditë: 12 alpinistë të tjerë -

Si ngjit një të përpjetë që të merr frymën, mbërrin në një shesh të vogël, i cili ngrihet bri një humnere. Malësorët e quajnë Sheshi i Pleqve.

Ata pushonin këtu, hidhnin edhe një herë sytë nga Thethi, se pas disa minutash nuk do ta shihnin më. Do të dilnin në Qafën e Pejës. Këto shtigje të thepisura, bri shkëmbinjve me atë ngjyrën gri të papërsëritshme, i futnin në rrugën e vështirë të mërgimit apo të kërkimit të ndodnjë pazari të largët për të siguruar pak kallamboq...

Nga ajo kohë ka mbetur vetëm ky shesh, aq i dashur për të gjithë alpinistët. Është një stacion ku pushimi në të respektohet në çdo stinë të vitit, pa qenë e shkruar në asnjë rregullore. Është vera e 33-të që qëndrojmë këtu për të rregulluar frymëmarrjen. Pisha shekullore, që ngrihet bri tij, dëgjon bisedat tona, biseda njerëzish që ripërtërijnë energjitë për të vazhduar shtegtimin më tej. Kjo pishë ka dëgjuar shumë dialogje, por pak këngë, ka dëgjuar më shumë krisma armësh e vikame. Por heshtjen e saj e tronditi si kurrë më parë gulçima e atyre dy helikopterëve që fluturuan mbi të.

Pilotët u përpoqën aq shumë të zbatonin urdhërin që dha Enver Hoxha në shkurtin e vitit 1975:

Të gjënden dhe të ndihmohen alpinistët!...”

* * *

Çadrat i ngritëm bri faqes jugore të Majës së Arapit. Në “jerarkinë” e lartësive të majave të Alpeve, mali i Arapit zë vendin e fundit. Por për vlerat alpinistike zë një vend të veçantë, zë vendin e parë për kacavjerrjet shkëmbore. Ka shumë itinerarë, njëri më i vështirë se tjetri, por faqja jugore e tij ka joshur gjithnjë alpinistët tanë dhe të huaj, alpinistët e të gjithë brezave. I jemi afruar shumë herë, e kemi vëzhguar kush e di sa herë me sy dhe me ndihmën e mjeteve optike, për të krijuar bindjen se sa mikpritës është ai. Brenda 33 vjetëve, pas

shumë e shumë përpjekjeve, vetëm dy herë ishte mposhtur ai. Vetëm 4 alpinistë e përshkuan këtë itinerar. Emrat e katër alpinistëve të Tiranës (Azem Hyka, Maridon Hito, Ilir Tapia e Sokol Doko) i njohin jo vetëm dashamirësit, por edhe thethianët e kufitarët.

25 alpinistë, përfaqësues të 5 klubeve sportive, pa ngritur mirë çadrat, hodhën vështrimin nga ai. Të nesërmen drejt tij u nisën Ilir Tapia dhe Artur Shehu. Të tjerët që i joshte dëshira për t'u futur në këtë itinerar u ngjitën në shpatin bri tij për të vrojtuar ngjitjen, për të parë si do të punonin dy shokët e tyre. Iliri është një nga të katërtët. Pas 3-4 orë përpjekjesh, aty nga ora 10 kaloi një ballkon (shkëmb me dalje nga jashtë). Ballkoni ishte i tillë që Turi disa herë tentoi dhe përsëri nuk ia dilte, kthehej. Për të kaluar ato 20 metra nuk mjaftuan as dy orë. Ishin notat e para të uverturës të kësaj "opere" madhore...Më vinte keq, por si komandat i këtyre ngjitjeve më në fund vendosa, nuk kisha si të veproja ndryshe. Urdhërova:

- Kthehuni!

Fjalët e mia ata i dëgjuan falë zërit të fuqishëm të Ismail Domit.

U kthyen pa fitore, por me besim se do t'ia dilnin herës tjetër.

Fjala u hap çuditërisht shpejt midis malësorëve, kufitarëve dhe ndër më kuriozët e atyre që kishin ardhur për pushime në kamp. Kishte midis tyre që edhe autorin e ketij shkrimi (mua) e quajtën të çmendur se lejon apo i fut të rrezikojnë jetën këta djem të rinj, këta djem të fuqishëm dhe të guximshëm. Ndoshta ishte edhe ky "presion" psikologjik, por fakti është që të nesërmen nuk lejova asnjë t'i afrohej Arapit.

Biseduam gjerë e gjatë në mbledhjen e shtabit. Morëm të gjitha masat që të mos hidhej ai hap që e ndan të madhërishmen nga çmenduria. Arapin duhet ta mposhtim, kemi kohë të përgatitemi. A ka rrezik? Po, ka shumë. Por, ashtu si në çdo fushë të veprimtarisë e krijimtarisë njerëzore, pa rrezikuar nuk arrihet asgjë!

Duhej grisur tisi i papërshtatshëm psikologjik që u krijua. Në "lojë" futëm alpinistin e mirënjohur Sokol Doko ("17 Nëntori"). Asnjë nuk ka punuar aq shumë, asnjë nuk e njeh Arapin si Sokoli. Më 1985 e mposhti si drejtues litari. Po atë vit u kacavjerr përsëri në të për të ndihmuar një alpinist që rrëshqiti...Pa u mbushur mirë viti, në korrikun e vitit 1986 ishim në Livadhet e Bogës, në Kelmend. Një buzëmbremje tek ne u ul një helikopter. Mësuam nga pilotët se me alpinistët e tjerë punët nuk ishin mirë në faqen shkëmbore të Arapit.

Sa e dëgjuam vendosëm dhe bashkë me disa të tjerë Sokoli shtegtoi natën nëpër Bjeshkët e Namuna. Të nesërmen nxorri nga gjoksi i Arapit Besnik Kicën, alpinistin e "Korabit" që kishte dy ditë e dy netë i ngjuar në të. Kështu, pa u emëruar nga asnjë forum, Sokoli është bërë përgjegjësi i grupit të shpëtimit për ata që Arapi nuk i mirëpret, kur nisen për tek ai pa u përgatitur dhe "pa mend në kokë".

Kjo është hera e katërt që futet në këtë itinerar. Në litarin që do të udhëheqë do të lidhen dy shokët e tij: Ardian Kurti e Mazllum Feka, të dy laprakas. Hera e parë që për "vizitë" në këtë majë u lidhën në litar tre alpinistë. U nisën pa zbardhur, që tek poti, aty ku nis vështirësia, të lidheshin, të verifikonin për të fundit herë materialin teknik.

Nga shpati karshi ndjekim ngjitjen e tyre. Punon pastër teknikisht e me guxim saldatori i kombinatit të autotraktorëve "Enver Hoxha". Të ngarkuara me emocione, minutat dhe orët rrjedhin. Ata luftojnë për të gjetur pikëkapje sado të vogla për gishtërinjtë apo të krijojnë pikëmbështetje artificiale, si të vetmet mjete për të siguruar atë mundësinë e vogël që të fitojnë disa centimetra lartësi. Ata nuk e ndienin etjen, se të gjitha forcat fizike e shpirtërore janë të përqëndruara. Luftojnë të mposhtin ndjenjat që lindin dhe e shoqërojnë njeriun në kapërcimin e vështirësive të mëdha, kur ndodhet në lartësi të tilla maramendëse. Do të ishte një gjykim fëminor të thoshje, që alpinistët nuk e njohin drojtjen dhe frikën. Edhe ata i pushton heraherës frika që i bën të tregojnë kujdes të jashtëzakonshëm.

Alpinistët janë njerëz të zkonshëm, por të guximshëm e këmbëngulës, me besim në forcat e veta dhe te shokët e të njëjtit litar. Falë pasionit, përgatitjes së gjithanshme fizike e teknike, psikologjike dhe ekuilibrit shpirtëror, ndjenjat negative fashiten më shpejt tek ata.

Alpinistët e kualifikuar thuajse nuk flasin fare midis tyre gjatë gjithë kohës që vazhdon kacavjerrja e vështirë. Si duket heshtja e madhe e hapësirës ku ndodhen nuk i duron fjalët e tepërta. Sa më e vështirë të jëtë ngjitja aq më shumë përsëriten shprehjet:

- Po nsem !
- Lësho litar !
- Të ruaj !

Nuk ka alpinistë të kualifikuar të mos ketë përjetuar ndjenjat që shkakton rrëshqitja në një faqe shkëmbore, kur vetëndërgjegjësohet se po qëndron i varur në gozhdën alpine disa metra sipër kokës së tij. Duket e pabesueshme, por emocionet më të fuqishme nuk i përjeton

ai që rrëshqet, por shoku i tij, ai që e siguron atë me anë të litarit.

Por edhe kjo nuk është plotësisht e vërtetë. Më shumë ngjitjen e vështirë e përjeton trajneri. Është kjo që sot herë pas here kthej kokën, mundësisht pa më vënë re, nga trajneri i tyre, Aleksandër Bojaxhi.

Kur kaluan nëntë orë dëgjojmë sinjalin e tyre. Mbërritën në majë! Fitorja e tyre na gëzon sa nuk thuhet. U përgjigjemi me “notat” e të njëjtit kod. Marrim rrugën për tek çadrat, që prej këtej duken si kuti shkrepseje. Duke zbritur e duke mbledhur dru. Megjithëse është verë, vishemi trashë dhe i afrohemi zjarrit.

Të njëjtin itinerar realizuan të nesërmen përmetarët (Flamur Muço, Maksut Fekushi dhe Pëllumb Muka). Dy ditë më vonë morën “hakun” ndaj Arapit Iliri me Turin. U erdhi radha alpinistëve më të ri në vendin tonë, të cilët e kaluan provën me sukses, atyre të “Dajtit” (Leonard Rama e Besnik Ibrahim). Ditën e parafundit të këtij aktiviteti kombëtar realizuan të njëjtin itinerar të vetmit e të gjithë klubeve sportive të Shqipërisë veriore. Ata ishin Hajdar Hasa e Vladimir Hymaj të “Valbonës”.

Brenda 10 ditëve kjo ngjitje, sa e vështirë aq edhe e gjatë, u realizua pesë herë. Gjatë 33 vjetëve e kishin mposhtur faqen jugore të Arapit vetëm katër vetë, ndërsa gjatë këtyre dhjetë ditëve arritën të njëjtin sukses 12 alpinistë. Është një sukses i paparë, i cili dëshmon për rritjen cilësore të alpinizmit tonë.

Kozma Grillo, 19 gusht

***Turizmi dhe ngjitjet malore janë veprimtari
me vlera edukative e kalitëse***

Një ndër tiparet e njeriut të emancipuar dhe të kulturuar është edhe aftësia e tij për të përdorur në mënyrë racionale kohën e lirë, për t’i dhënë një pjesë të konsiderueshme të saj ushtrimit të fizkulturës e të sportit, duke mos harruar për asnjë çast ekskursionet e marshimet turistike, ngjitjet malore, rrëshqitjet me ski dhe ecje-rendjet në terren të thyer, të cilat jo vetëm që të japin kënaqësi, por, në të njëjtën kohë, janë edhe mjete të pazëvendësueshme për edukimin e brezit të ri.

Kënaqësia e papërsëritshme që shkakton kalimi i një terreni të thyer e të mbuluar me dëborë të ngrirë, emocionet që e shoqërojnë atë që shtegton kur tufani shfryn, forcojnë shëndetin, kalitin organizmin

dhe e zhvillojnë atë në mënyrë harmonike, zhvillojnë qëndrueshmërinë, cilësitë e vullnetit, të karakterit e personalitetin në tërësi.

...Është kënaqësi kur sheh të rinj e të reja, punonjës të moshave e profesioneve të ndryshme, që nisen në ditët e pushimit drejt maleve e vendeve turistike. Mijëra e mijëra të rinj në vigjilje të 16 tetorit sulmojnë e mposhtin majat më të larta të truallit tonë, ndërmarrin veprimtari masive në prag të festave kombëtare e lokale. Është kaluar koha e fillimit të viteve '60 kur një numër i vogël studentësh e intelektualësh ngjiteshin në malin e Dajtit, prishnin qetësinë e tij. Sot është vështirë të sigurosh mundësinë për të kaluar një natë dimri në kampin e Dajtit. Erdhi kjo ditë, dhe do të vinte patjetër, që grupe të rinjsh bëjnë ç'është e mundur të sigurojnë fjetjen që të nesërmen të rrëshqasin me ski e t'u drejtohen majave....Gjallëria e veçantë e pikave turistike në malin e Dajtit, në Moravë e Voskopojë të Korçës, në Razëm të Shkodrës dhe Kapinovë të Beratit, dëshmon edhe për pasionin e të rinjve për të ushtruar turizmin malor, për t'u kalitur fizikisht.

Arritje ka dhe ato janë të konsiderueshme, ato shihen edhe nga krahasimi nga viti në vit. Por gjallërimi dhe masivizimi i mëtejshëm i kësaj veprimtarie masive përbën një problem kompleks, që kërkon trajtim e zgjidhje në rrafshin social, pedagogjik, etik e sportiv. Zgjidhja e këtij problemi kërkon më shumë përkushtim, bashkëpunim midis Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH-së me organizatat e masave dhe institucionet ekonomiko-sociale.

Ashtu si çdo ndjenjë tjetër edhe dashuria për malin e pasioni për turizëm nuk lindin bashkë me njeriun, por krijohen, zhvillohen e lulëzojnë gjatë jetës. Kjo aksiomë psikologjike kërkon që në shkollat që përgatitin mësues të punohet më shumë e më mirë për t'u ngjallur dashurinë për këto sporte mësuesve të ardhshëm, se nuk mund të ndikosh në botën shpirtërore të nxënësve pa e patur vetë këtë pasion...

...Kjo lëvizje masive, kjo lëvizje e gjallë, nuk ka asgjë të përbashkët me punën me fushata e për bujë, nuk e duron ngathtësinë, rutinën, formalizmin, shifromaninë...Rrethet malore si Puka etj. lipset të kenë grupin e alpinizmit. Po kështu, mbarëvajtja e kësaj lëvizje kërkon të jemi të kujdesshëm dhe racional për shfrytëzimin më të mirë të bazës materiale ekzistuese. Ne kemi shtëpi pushimi për punonjësit dhe pionierët. Në mënyrë të veçantë ato që janë ngritur në Theth, në Razëm, Voskopojë, Dardhë, etj., nuk bëjnë thujse asgjë për turizmin. E kush është ai që ka shkuar në kampin e Thethit dhe

është ngjitur në Qafën e Pejës apo në Shtegun e Dhënëve, në majën e Kakisë apo në Qafën e Valbonës? Me mend do të ishte që në një apo dy nga këto shtëpi pushimi të shkojnë vetëm të rinj....Ata që e duan malin e shkojnë në Dajt soditin si rrëshqasin gjithë-gjithë 10 apo 15 vetë me ski, se këto nuk gjenden në treg, nuk i prodhon ndonjë ndërmarrje...Por asnjë nuk interesohet që ata të shëtisin, të ngjiten në qafë, pse jo dhe në një nga majat e këtij mali.

**Kozma Grillo, kryetar i komisionit teknik të alpinizmit,
diskutim i mbajtur në Konferencën e 5-të
të BFSSH-ës, 26 shtator**

1989

Përvoja e Korçës për alpinizmin...

Vitin e kaluar ekipet e të rinjve e të rriturve të "Skënderbeut" morën pjesë në të gjitha veprimtaritë alpinistike verore e dimërore. Dashuria për malin ka bashkuar shumë të rinj sportistë që stërviten çdo ditë jave në poligonin e alpinizmit (pranë parkut "Rinia" të qytetit nën drejtimin e veteranit Koço Ziso e trajnerit të të rinjve Anesti Qirjo). "Skënderbeu" sot radhitet ndër ekipet më të mirë të vendit me "17 Nëntorin", "Dajtin", "Korabin" e "Flamurtarin".

Atë ditë korriku (viti 1988) në krye të treshes që do të ngjitej në majën e Gurit të Capit ishte vetë 53 vjeçari Koço Ziso. E ndiqnin atë alpinistët e talentuar Petrika Opingari e Mihallaq Çollaku. Të gjithë udhëtarët e rastësishëm qëndruan dhe ndoqën me vëmendje veprimet e tyre për katër orë dhe duartrokitën me gjithë shpirt arritjen e majës nga këta alpinistë. Ishin katër orë përpjekje në faqet e gurta të prera të Gurit të Capit, përpjekje që u kurorëzuan me sukses.

Në objektivat e vitit 1989 të këtij ekipi janë që të dilet me sukses në të gjitha veprimtaritë kombëtare dimërore e verore, dhe me rastin e 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut të pushtohet përsëri Guri i Capit që ka shkallë të lartë vështirësie. Në planin e ekipit parashikohet marrja e titullit mjeshtrë sporti nga alpinistët Genci Lika dhe Anesti Qirjo, ndërsa Arben Beka dhe Petrika Çomo të marrin kategorinë e parë.

"Përgatitjet për ngjitjet e ardhshme janë shumë të vështira - thotë Koçoja, - e nga ne kërkohet një punë më e kualifikuar, sepse parashikohet ngjitja në shkëmbinj me përdorimin e gozhdëve". Në shkurt ai do të jetë komandat i ngjitjeve kombëtare që do të bëhen në Ostrovicë.

Pasioni i madh me të cilin ai flet për alpinizmin, të bën ta admirosh. Ashtu në mes të ekipit, përpara se të niseshin në stërvitje, ai thotë: "Ne mbështesim fuqimisht nismën që çdo alpinist të drejtojë 4 marshime me të rinjtë e të rejtat. Vendet ku do të drejtojmë këta marshues janë Morava, Dardha, Voskopoja e Bozdoveci, si në dimër

ashtu dhe në verë. Ne nuk mund të heqim dorë nga dashuria për malin”.

Është një zotim që ndjek vazhden e traditës së bukur korçare, ku alpinistët kanë qenë dhe mbeten gjithmonë protagonistë aktivë për drejtimin e ekskursioneve turistike e marshimeve. E për këtë ata janë krenarë.

Albert Karanxha, 27 janar

Vështirësia e një ngjitje

Nga data 17 deri më 26 shkurt në Alpe u zhvilluan ngjitjet e kualifikuara dimërore. Alpinistët e kategorisë së parë dhe mjeshtrat punuan në katër zona. Në zonën e Valbonës komandat i ngjitjeve ishte Viron Velaj, në zonën e Shtegut të Dhënëve Aleksandër Bojaxhi, në Livadhet e Bogës Gëzim Oruçi, ndërsa në Qafë Pejë Taxhedin Shehu.

Në mbrëmjen e datës 16 shkurt, në Theth u mbledh shtabi i ngjitjeve, i cili nëpërmjet "Urdhërit të Ditës" na komunikoi se nesër herët në mëngjes do të bëhet nisja për në majën e Boshit (një nga majat më të vështira të Alpeve), që ngrihet krenare mbi kreshtat e Thethit, Rragamit e Curajve të Epërm.

Të nesërmen koha ishte e mirë. Në afërsi të qafës filloi zona e dëborës që ishte shumë e ngrirë. Komandati i togës Adil Manga urdhëroi të visheshin kthetrat dhe të siguroheshin me litar. Seferi, alpinist i Krujës, has vështirësi në çastin kur kaluam pjerrësinë e madhe të qafës. Më në fund, dolëm në zonën e Currajve...Sa më shumë t'i afroresh majës aq më shumë vështirësi ka rruga e kalimit. Por alpinistët ishin të vendosur për të arritur suksesin. Mbas një pune shumë të vështirë dhe me nerva të tendosura, në orën 11 arritëm në majë. Gëzimi më i madh ishte kur alpinistët e Fierit, duke filluar nga komisari i ngjitjeve, Gramoz Shehu deri tek më i riu Shpëtim Çela arritën majën.

U përqaftuam me njëri-tjetrin për suksesin. Ilir Karafili nga Berati thotë: "Sot jam shumë i gëzuar, sepse kam kaluar me sukses një itinerar të vështirë". Shkruajtëm emrat, dhamë zigzagun alpin dhe nisëm zbritjen. Duke parë që koha vazhdoi të ishte e mirë shtabi vendosi që një treshe të bëjë një itinerar shkëmbor dimëror për në majë të malit.

Ishte ky itinerar eksperimental. Për këtë u caktuan kandidatmjeshtrat: Asllan Xhiza, Zabit Tusha dhe Shaqir Lusha, të cilët do të ngjisinin majën e Visensit nga muri i Radohimës në itinerar të vështirësisë së 4-t verore. Kurse alpinistët e tjerë do të bënin ngjitje në majën e Visensit nga Rrethi i Vishnjës.

Të enjten, më 23 shkurt, në orën 5 të mëngjesit ekipet u nisën. Përpara se të shkonim tek Kroni i Shtrazës, u ndamë në dy grupe, njëri mori majtas, ndërsa tjetri në drejtim të Rrethit të Vishnjës. Tre alpinistët u nisën për tek muri i Radohimës.....

Ngjitja filloi në orën 8. Ajo zgjati 7 orë. Në orën 15 treshja që realizoi me sukses ngjitjen shkëmbore dhe alpinistët e tjerë e realizuan itinerarin nga ana e Rrethit të Vishnjës u përqaftuan me njëri-tjetrin për suksesin e arritur.

Në analizën e këtyre ngjitjeve dolëm në përfundimin se këto itinerarë mund të realizohen me sukses kur shkëmbi, faqja në të cilën do të bëhet kacavjerrja, duhet të jetë nga lindja. Po kështu alpinistët duhet të heqin dhe të veshin gjatë ngjitjes kthetrat. Kur këto nuk janë në punë duhet të përdoren kryesisht kazmat, të cilat lipsen të jenë të një madhësie më të vogël, më praktike.

Të gjithë alpinistët u dalluan për realizimin e kësaj detyre që na ishte ngarkuar për nder të 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe Spartakiadës së 6-të kombëtare....

Taxhedin Shehu, mjeshtër sporti, 10 mars

Ngjitje në Alpe

Prej datës 17 deri në 26 korrik, në Alpe u zhvilluan ngjitjet kombëtare me alpinistët më të mire. Alpinistët punuan në:

1. Ashtin e Rragamit: "Përparimi", "Tomorri", "Korabi", "Partizani" dhe "Kastrioti", nën drejtimin e Hazir Malaj dhe Eduard Sheldia.
2. Bunin e Valbonës: "Flamurtari", "Studenti", "Apolonia", "Vllaznia" dhe "Tërbuni", nën drejtimin e Viron Velaj.
3. Zonën e Boshit "17 Nëntori", "Dajti", "Valbona", "24 Maji", "Minatori" i Tepelenës, nën drejtimin e Kozma Grillos.

Korresp. i "Sportit Popullor", 31 korrik

Mposhtja e majës së Boshit

“Këtë që batë ju sot, nuk e ka ba burrë në këto 50 vjet që unë dal në livadhet e kësaj bjeshke”, u tha malësori i moshuar alpinistëve që për herë të parë pushtuan këtë majë.

Thuajse janë të njëjtët alpinistë që verën e kaluar realizuan atë numër të madh ngjitjesh në faqen jugore të Arapit. Po ata shkruan një faqe të re në alpinizmin tonë edhe në shkurtin e këtij viti, duke kryer një sërë kacavjerrjesh shkëmbore në stinën e dimrit.

Para pak ditësh u takuam përsëri në këmbët e malit të Boshit, një nga majat më të larta të Alpeve, që ngrihet madhështor mbi Thethin aq të bukur. Është një kështjellë natyrore me përmasa gjigande. Faqja shkëmbore e masivit të tij qëndror gjithnjë na kishte joshur. Alpinizmi ynë ëndërronte kryerjen e këtij itinerari.

Ashtu si në jetën e përditshme që para se të hedhësh një hap jo të zakonshëm duhet të matesh mirë, u punua një vit për të ndërmarrë këtë ngjitje. Përpjekjet u shtuan muajt e fundit. Me vëmendje qëndruam orë të tëra të kërrusur mbi hartën e zonës për “të lexuar” sa më shumë. Kujtonim hollësi nga ngjitjet që janë bërë më parë për të mbërritur në majën e këtij mali nga Fusha e Dënellit apo nga Zhaboret. Por ato pak na ndihmuan. Deri para pak ditësh nuk kishte asnjë gjurmë në dokumentacionin alpinistik për këtë itinerar.

Masivi shkëmbor i Boshit na mblodhi përsëri. Grupi ynë përbëhet nga progonatas, përmetarë, tropojas dhe kryeqytetas (“17 Nëntori” dhe “Dajti”).

Ndërmarrja e këtij itinerari shumë të gjatë dhe të panjohur fillon me mposhtjen e “vështirësive të vogla”, me kryerjen e disa riteve të pashkruara. Aleksandër Bojaxhiu me Mulin u lodhën shumë për të gjetur shtegun për të vajtur në vendin nga ku do të niste “sulmi” mbi të, nga ku do të kishim afër shkrepat e tij, gropa të mbuluara me dëborë të përjetshme.

Mbërritëm të nesërmen atje. Ngritëm çadrat. Dy ditët e para, shtegtonim rreth dy orë për “t’u miqësuar” me të dhe për të bërë

“nxemjen” e ngjitjes së planifikuar për në 21 korrik.

Grafiku ynë nuk u realizua në kohën e menduar. Shfryrja e atij murlani të çmendur dhe të ftohtët (tani në korrik !?) na bëri ta shtynim një ditë nisjen nga ai livadh fare i vogël dhe i pjerrët, pjerrësi që e ndiejmë më tepër natën kur kthehemi në gjumë e zgjojmë njëri-tjetrin...

Erdhi dita që prisnim. Murlani e kishte pastruar qiellin ashtu siç di të pastrojë ai. Si kaluan tre orë që dolëm nga çadrat nisi “simfonia” jonë, tingëllimi i gozhdëve alpine, 3 litarë sulmuan itinerarin e gjatë të masivit qëndror. Ishin gjithsej 7 alpinistë, nga 18 që përbëhej grupi ynë. Kështu ndodh gjithnjë në ngjitjet alpinistike edhe në ato që sulmohen 8.000 metroshët. Bashkimi i forcave të shumë njerëzve përbën çelësin e suksesit në sportin tonë, në këtë sport sa kolektiv aq edhe individual.

Ndjekim me vëmendje të veçantë ngjitjen tejet të gjatë dhe të vështirë të shokëve tanë, dëgjojmë si ata kërkojnë nga njëri-tjetri mënyrën si të sigurohen, shkallën prej litari apo vendin ku do të grupohen në atë pejzazh në ngjyrë gri. Fjalët janë të pakta, heshtja solemne e lartësive të mëdha dhe tendosja psikologjike dhe e gjithë forcave fizike të alpinistëve, që punojnë, nuk pranon as zhurma, madje as melodi. Dëgjohet vetëm tingëllimi i gozhdave dhe cicërima e zogjve të trembur nga mysafirët e paftuar.

Kështu rrodhën orët e asaj ngjitjeje të gjatë dhe të bukur, ku tre litarë të udhëhequr nga Sokol Hoxha, Ilir Tapia dhe Flamur Muço (të përbërë nga Besnik Ibrahim, Artur Shehu, Pëllumb Muke e Adriatik Fezga) mposhtën masivin qëndror të Boshit, këtë masiv të virgjër, ku mbetën gjurmët e para të gishtërinjve të duarve dhe të këmbëve të shokëve tanë.

Mbresat dhe mendimet për këtë ngjitje ngërthehen në fjalët që na tha në mbrëmje pranë zjarrit thethiani i moshuar Koliq Pjetra: “Shqiptarët kanë ba punë shumë të mëdha. Por këtë që batë ju sot nuk e ka ba burrë në këto 50 vjetët e fundit që dal në livadhet e kësaj bjeshke. Më falni, por nuk e besoj që do i dilnit Boshit drejtpërdrejt. Ju lumtë!”.

- Faleminderit.

Alpinizëm

■ Është sporti më i vështirë, më i rrezikshëm dhe, sipas mendimit të atyre që e aplikojnë, është sporti më i bukur. Por duhet të kihet parasysh, që këto vështirësi të mos u krijohen atyre në mënyrë artificiale. Edhe sukseset e këtyre alpinistëve janë të niveleve të mira si edhe tek disa sporte të tjerë. Por pak dihet për rezultatet e tyre. Nuk është parë asnjë gazetar sportiv mbi 2000 metra lartësi, si edhe nga TV-ja. Ndoshta mund të bëhet më tepër.

■ Alpinisti është sportist, atij nuk mund t'i thuhet se fillon veprimtaria te stanet e Munellës, e kur ta mbarojë aktiviteti në malin e Boshit, t'i thuhet "je i lirë, veprimtaria mbaroi". Ju kujtojmë se sportistët e tjerë dërgohen në vendin e ndeshjes me kujdesin më të madh, ndërsa alpinistët mund ta konsiderojnë eveniment, në qoftë se gjejnë një vend në karrocerinë e ndonjë kamioni në mal (ndoshta në të njëjtën kohë që autobusët e klubeve sportive mund të jenë duke çuar sportistët nëpër plazhe ku vendet e para i zënë familjarët).

■ Rrethi, ku zhvillohet veprimtaria alpinistike në bazë të kalendarit sportiv kombëtar, ka detyrë ta ndjek këtë veprimtari me të gjitha detyrimet që i përkasin (megjithëse në këtë rast ai nuk humbet si në ndeshje). Të presë dhe të përcjellë sportistët dhe jo si këtë vit, që klubi sportiv "Vllaznia", vuri në jetë proverbin popullor: "Më ka çu nana me la gojën!".

■ Alpinizmi është sport i vështirë. Në çdo çast ka rrezik. Ndihma mjekësore këtu ka domosdoshmërinë e vet, dhe jo të jetë spontane, sipas dëshirës të ndonjë mjeku të pasionuar. Ju kujtojmë se në një ndeshje volejboli apo basketboli, në pallatin e sportit "Partizani", ka patur personel mjekësor (6 deri 7 vetë), ndoshta më tepër se personeli mjekësor që bën një operacion në zemër. Në ngjitjet e kualifikuara shkëmbore, nuk kishte ndihmë mjekësore. Mjekëve sportivë t'u vihen detyra në këtë drejtim (qoftë edhe mbasi të kenë plotësuar detyrën

më të preferuar si, për shembull, shkuarjen pas ekipeve të futbollit, ose shoqërimin e skuadrave jashtë shtetit).

■ Në shkollën e Thethit ka një pllakë përkujtimore, ku tregohet se këtu në vitin 1956 filluan veprimtaritë e organizuara në vendin tonë. A do ishte me vend që të rinj nga këto zona të aktivizoheshin konkretisht në këtë sport me të drejtat që i përkasin sportistit të inkuadruar (si, për shembull, siç ka skiatorë Shistavec, ose të rinj që rrëshqasin mirë me ski nga Dardha ose Voskopoja).

■ Në ILKF “Vojo Kushi” nuk ka asnjë leksion ose praktikë për sportin e alpinizmit, siç ka, për shembull, program të rregullt për skitë ose notin, pavarësisht nga specialiteti që ka studenti. Jo vetëm në rishikimin e programeve por edhe duke u “ngushtuar” pak, mund të gjendet vend për të fituar njohuri për këtë sport (për shembull, të na falin specialistët: duke thjeshtëzuar pak leksionet e servisit të topit në volejball, ose mbrojtjes zonale në basketboll, pale në programin mjekësor të institutit).

■ Duke e njohur këtë sport prej 30 vjetësh, na ngelet sado pak kënaqësi kur japim ndonjë mendim (pale kur mendimi merret parasysh).

Zenel Kokomiri, 31 korrik

KARTELAT E ALPINISTËVE

